
Daljet në publik të
Guvernatorit për vitin 2021

Botuar nga: © Banka e Shqipërisë

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org
Printuar në:
Printuar nga:
ISBN: 978-9928-262-58-5

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

Prezantime në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave 6

KAPITULLI II

Konferenca për shtyp për vendimmarrjen e politikës monetare 35

KAPITULLI III

Konferenca për shtyp me Shefin e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave 91

KAPITULLI IV

Fjalime dhe prezantime në konferenca 99

KAPITULLI V

Intervista 147

FOTO GALERI

222



Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, 2021

KAPITULLI I

PREZANTIME NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCAVE

- *Fjala e Governorit Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, 20 prill 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020 në Kuvendin e Shqipërisë, 27 maj 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko gjatë prezantimit të opinionit të Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin 2022, 5 nëntor 2021*

Prezantimet në Kuvend

Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur, transparent dhe llogaridhënës. Procesi i llogaridhënies realizohet nëpërmjet një sërë instrumentesh, ku vendin më të rëndësishëm e zënë seancat dëgjimore të Governorit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendin e Shqipërisë. Çdo vit, Governori prezanton Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë në këtë Komision dhe Parlament, duke iu përgjigjur edhe interesit të deputetëve për çështje të veçanta të lidhura me të. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2015, Governori prezanton në një seancë dëgjimore të dedikuar edhe opinionin e Bankës së Shqipërisë për pikat kryesore të projektbuxhetit të shtetit për vitin pasardhës. Sipas rastit, zhvillohen edhe seanca të veçanta dëgjimore mbi aktivitetin operacional të Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar.



FJALA E GUVERNATORIT SEJKO GJATË PREZANTIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2020 NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCEVE - 20 prill 2021 -

Gjatë vitit 2020, Banka e Shqipërisë ndërmoi një paketë gjithëpërfshirëse masash, të cilat konsistuan në:

- *uljen e normës bazë të interesit në minimumin historik prej 0.5%, si dhe rritjen e injektimeve të likuiditetit;*
- *masa rregullatore, të cilat inkurajuan shtyrjen me 6 muaj të pagimit të kësteve të kredisë për klientët në vështirësi imediate;*
- *pezullimin e shpërndarjes së dividendit për sektorin bankar;*
- *eliminimin e kostove të përdorimit të platformave elektronike të pagesave që operon Banka e Shqipërisë;*
- *tajtimin në mënyrë të lehtësuar të ekspozimeve të bankave ndaj titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare në monedhë të huaj;*
- *një komunikim të shpeshtë dhe transparent me publikun, mbi masat e marra, efektin e tyre dhe pritjet për të ardhmen.*

*I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Në radhë të parë, më lejoni t'ju falënderoj për ftesën dhe mundësinë që më keni dhënë për të prezantuar përpara jush Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë. Ky Raport pasqyron kontributin e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar të vendit - një arritje e çmuar kjo në kontekstin e sfidave të paprecedenta me të cilat u përballëm gjatë vitit të shkuar - si dhe masat që kemi marrë në përmbushje të detyrave dhe angazhimeve tona të tjera ligjore e institucionale.

Pandemia COVID-19 dhe masat e nevojshme të marra për kontrollin e saj dhanë një goditje të fortë mbi ekonominë shqiptare, me pasojë negative në vëllimin e aktivitetit ekonomik, në punësim, në gjendjen financiare të familjeve dhe bizneseve shqiptare, si dhe në ekuilibrat e brendshëm dhe të jashtëm të vendit.

Në koordinim me stimulin fiskal, Banka e Shqipërisë vuri në jetë një paketë të plotë masash monetare, makroprudenciale dhe operacionale, të cilat synuan ruajtjen e likuiditetit në tregjet financiare, uljen e kostove të huamarrjes, vijimin e kreditimit dhe ruajtjen e një fluksi të pandërprerë të shërbimeve financiare. Nëpërmjet tyre, ne mundësuam: reduktimin e kostos financiare të krizës tek familjet dhe bizneset; shmangien e përcjelljes së saj tek sektori financiar; dhe ruajtjen e një ambienti të qetë monetar dhe financiar, duke krijuar kështu premiset për një rimëkëmbje sa më të shpejtë me normalizimin e situatës.

Për rrjedhojë, ndikimi i krizës në ekonomi rezultoi më i vogël nga sa pritej, duke dëshmuar si efektin pozitiv të masave të marra nga autoritetet publike ashtu, dhe fleksibilitetin e rezistencën e ekonomisë dhe të sistemit tonë financiar.

Parashikimet tona sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të shënojë një kthesë drejt rimëkëmbjes gjatë vitit 2021, me reduktimin gradual të ndikimit negativ të pandemisë. Vëllimi i aktivitetit ekonomik pritet të lëvizë në një trajektore rritëse në afatin e mesëm e të gjatë, i mbështetur nga kushtet e favorshme të financimit, nga reduktimi i pasigurive, si dhe nga rikuperimi progresiv i kërkesës së brendshme dhe të huaj. Megjithatë, garantimi i qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike dhe administrimi i rreziqeve të shumta të kahut të poshtëm do të kërkojnë vëmendje e kujdes të vazhdueshëm.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në vijim do të ndalem më në detaje në drejtimet dhe rezultatet kryesore të punës sonë gjatë vitit 2020.

1. ECURIA EKONOMIKE, STABILITETI I ÇMIMEVE DHE REAGIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Viti 2020 ishte një vit i vështirë dhe sfidues, i shënjuar nga efekti negativ i pandemisë COVID-19. Masat e marra për kontrollin e saj dhe rritja e pasigurisë e çuan ekonominë shqiptare në recesion, sollën rritjen e papunësisë dhe krijuan vështirësi financiare për shumë biznese e familje. Treguesit e balancave ekonomike u përkeqësuan: deficitit korrent u zgjerua, të ardhurat buxhetore pësuan rënie, borxhi publik i vendit u rrit, ndërsa bilancet e operatorëve të sektorit bankar e financiar të vendit u vunë në presion. Paralelisht me to, premiset për kthimin e inflacionit në objektiv u zbehën.

Shifrat e publikuara nga INSTAT për vitin 2020 japin një tablo të detajuar të ndikimit të kësaj krize në ekonominë shqiptare. Kështu, vëllimi i aktivitetit ekonomik u tkurr me 3.3% dhe shkalla e papunësisë u rrit në 11.8%. Rënia ekonomike pasqyroi kontraktimin e njëkohshëm të thuajse të gjithë përbërësve të kërkesës agregate dhe të të gjithë sektorëve të ekonomisë, por kriza goditi në mënyrë më të veçantë konsumin privat dhe flukset tregtare, ku rënie shënoi si eksporti i mallrave ashtu edhe ai i shërbimeve. Nga ana tjetër, konsumi dhe investimet publike erdhën në rritje, duke kompensuar pjesërisht rënien e kërkesës private. Rritja e shpenzimeve buxhetore paralelisht me rënien e të ardhurave fiskale sollën rritje të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Ky i fundit arriti në 76.1% të PBB-së në fund të vitit 2020, nga 66.3% në fund të vitit 2019.

Në terma kohorë, ndikimi maksimal negativ i krizës u shfaq në tremujorin e dytë, ndërkohë që dy tremujorët në vijim shënuan një përmirësim gradual të treguesve ekonomikë, por duke mbetur gjithsesi poshtë niveleve të shënuara gjatë vitit paraardhës. Në veçanti, prodhimi dhe punësimi mbeten në nivele më të ulëta në raport me vitin 2019, duke ilustruar pozicionin e dobët ciklik të vendit dhe duke sugjeruar se kërkesa agregate mbetet në nivele të pamjaftueshme për të gjeneruar punësim të plotë të faktorëve të prodhimit. Për rrjedhojë, presionet e brendshme inflacioniste mbetën të ulëta, ndërsa rënia e inflacionit në partnerët tanë tregtarë frenoi rritjen e inflacionit të importuar. Për pasojë, inflacioni mesatar i vitit 2020 rezultoi në nivelin 1.6%, duke mbetur poshtë objektivit tonë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Pandemia COVID-19 është sfida më serioze ekonomike me të cilën jemi përballur gjatë dy dekadave të fundit. Në këto rrethana, ndërhyrja e autoriteteve publike me masa të jashtëzakonshme stimuluese ishte e domosdoshme, jo vetëm për të lehtësuar efektet negative imediate të krizës, por edhe për të kufizuar ndikimin afatgjatë të saj në ekonomi.

Duke qëndruar brenda juridiksionit të saj, Banka e Shqipërisë ndërmoi një paketë gjithëpërfshirëse masash, të cilat konsistuan në:


- uljen e normës bazë të interesit në minimumin historik prej 0.5%, si dhe rritjen e injektiveve të likuiditetit, nëpërmjet adoptimit të një strategjie operacionale, e cila mundësoi injektim të pakufizuar të likuiditetit në tregun ndërbankar;
- masa rregullatore, të cilat inkurajuan shtyrjen me 6 muaj të pagimit

të kësteve të kredisë për klientët në vështirësi imediate, si dhe ristrukturimin e kredive për klientët të cilët kishin perspektiva solide biznesi, por vështirësi afatshkurtra dhe afatmesme financiare;

- pezullimin e shpërndarjes së dividendit për sektorin bankar, për të rritur kapacitetet amortizuese të sektorit ndaj goditjes;
- eliminimin e kostove të përdorimit të platformave elektronike të pagesave që operon Banka e Shqipërisë, duke synuar reduktimin e kontakteve fizike, rritjen e përdorimit të pagesave elektronike dhe administrimin më të mirë të kërkesave të ekonomisë për para fizike;
- trajtimin në mënyrë të lehtësuar të ekspozimeve të bankave ndaj titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare në monedhë të huaj, sipas rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe rregullores së ekspozimeve të mëdha, për titujt e emetuar gjatë vitit 2020;
- së fundi, ne u angazhuam në një komunikim të shpeshtë dhe transparent me publikun, mbi masat e marra, efektin e tyre dhe pritjet për të ardhmen.

Ne vlerësojmë se masat e marra kanë qenë efektive, duke mbështetur ekonominë në disa drejtime.

Grafik 1. Ecuria ekonomike kumulative, faktike dhe pa kontributin e politikës monetare (majtas); vëllimi real vjetor i aktivitetit ekonomik, faktik dhe pa kontributin e politikës monetare (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së pari, stimuli monetar dhe makroprudencial mundësoi uljen e kostove financiare dhe mbështetjen e vazhduar të familjeve dhe bizneseve shqiptare me kredi bankare.

Reagimi ynë i menjëhershëm dhe injektimi i sasive të bollshme të likuiditetit mundësuan aktivitetin normal të tregjeve financiare dhe

transmetimin e uljes së normës bazë tek çmimi i kredisë. Aktualisht, kostot e financimit dhe të shërbimit të borxhit në ekonomi janë më të ulëta se një vit më parë dhe kursi i këmbimit është i qëndrueshëm.

Normat e ulëta të interesit dhe likuiditeti i bollshëm u shoqëruan me një rritje mesatare prej 6.7% të portofolit të kredisë gjatë vitit 2020, duke mbështetur vijimin e investimeve dhe nevojat në rritje të ekonomisë për kapital qarkullues. Të ndihmuar edhe nga skemat e garancisë shtetërore, kontribuuesit kryesorë në rritjen e kredisë ishin kreditimi për biznese dhe ai në lekë. Në këtë drejtim, gjej me vend të evidentoj se, për herë të parë gjatë dy dekadave të fundit, pesha e portofolit të kredisë në lekë u barazua me peshën e portofolit të kredisë në monedhë të huaj në fund të vitit të shkuar. Ky trend pozitiv krijon premisa për rritjen e efektivitetit të politikës monetare dhe për forcimin e stabilitetit financiar të vendit.

“Reagimi ynë i menjëhershëm dhe injektimi i sasive të bollshme të likuiditetit mundësuan aktivitetin normal të tregjeve financiare dhe transmetimin e uljes së normës bazë tek çmimi i kredisë.”


Po ashtu, mbi 23,000 biznese e familje me kredi në vlerën e rreth 200 miliardë lekëve, përfituan nga moratoriumi i pagesës së kësteve të kredisë dhe ristrukturimi i kredive ekzistuese. Këto fonde të mbetura në dispozicion të tyre i kanë shërbyer zbutjes së vështirësive financiare me të cilat u përballën familjet dhe bizneset me fillimin e krizës.

Në tërësi, vlerësimet tona sugjerojnë se politika jonë stimuluuese monetare ka prodhuar një efekt pozitiv prej 3.7 pikë përqindjeje në vëllimin e aktivitetit ekonomik gjatë katër viteve të fundit, duke dhënë një kontribut të prekshëm në punësim dhe në mirëqenie për familjet shqiptare.

Së dyti, mbikëqyrja dhe monitorimi i kujdesshëm i performancës së sektorit bankar, komunikimi intensiv dhe i vazhduar me të, si dhe pezullimi i përkohshëm i shpërndarjes së dividendit, i shërbyen ruajtjes së një sistemi bankar likuid, të mirëkapitalizuar dhe me praktika të shëndosha për administrimin e rreziqeve.

Treguesit e cilësisë së aktiveve, të rezultatit financiar dhe të kapitalit të sektorit bankar, paraqiten në nivele të mira. Raporti i kredive me probleme ka mbetur në nivele të ulëta dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë i aktivitetit të tij ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrolluar.

Grafik 2. Tregues të përfitueshmërisë dhe shpenzimeve të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së treti, rritja e kapaciteteve operacionale për furnizimin e ekonomisë me para, garantimi i funksionimit të pandërprerë të sistemeve kombëtare të pagesave dhe ulja e kostove për pagesat online në lekë, mundësuan funksionimin normal të sistemit financiar.

Së fundi, intensifikimi i komunikimit me partnerët e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe me publikun e gjerë, ndihmuan në reduktimin e pasigurisë dhe rritjen e besimit në të ardhmen.

Në tërësi, ne vlerësojmë se ekonomia shqiptare i ka premiset e nevojshme për një rimëkëmbje të shpejtë të aktivitetit ekonomik, me normalizimin e situatës epidemiologjike. Ky vlerësim konfirmohet dhe nga parashikimet tona, të cilat projektojnë zgjerim të konsumit dhe investimeve, rritje të vëllimit të aktivitetit ekonomik, rritje të punësimit, dhe përmirësim të gjendjes financiare të bizneseve dhe familjeve gjatë periudhës në vazhdim. Rritja ekonomike do të ndihmojë në shtimin e presioneve inflacioniste dhe kthimin e inflacionit në objektiv, brenda vitit 2022.


2. MBIKËQYRJA BANKARE DHE STABILITETI FINANCIAR

Pavarësisht sfidave që paraqiti situata e pandemisë në vend, veprimtaria e sistemit bankar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme. Masat operacionale të marra nga bankat për sigurimin e vijueshmërisë

së funksioneve kritike dhe marrëdhënieve me klientelën, të ndërthurura me masat e marra nga autoritetet publike për zbatimin e goditjes së pandemisë, mundësuan që veprimtaria e ndërmjetësimit financiar të vijojë në mënyrë të përshtatshme dhe treguesit financiarë të sektorit bankar të mbeten në nivele të mira.

Aktivitetet e sektorit bankar u rritën me rreth 7%. Ndonëse sektori bankar mori përsipër një pjesë të madhe të barrës financiare të krizës gjatë vitit 2020, ai rezultoi me një rezultat financiar pozitiv, edhe pse 1.5% më të ulët se viti paraardhës. Paralelisht me të, niveli i kapitalizimit të sektorit mbetet i mirë, mbi nivelin 18%, duke i mundësuar atij të vijojë veprimtarinë e ndërmjetësimit financiar. Po kështu, cilësia e kredisë u përmirësua lehtë gjatë vitit, ku raporti i kredive me probleme zbriti në 8.1% në fund të vitit, nga 8.4% një vit më parë. Masat e marra prej Bankës së Shqipërisë për të ndihmuar bankat në trajtimin e kredive të kredimarrësve në vështirësi të përkohshme financiare dhe për ristrukturimet e kredive, krijuan hapësira për stabilizimin e nivelit të përgjithshëm të kredive me probleme, ndaj Banka e Shqipërisë mbetet veçanërisht e kujdesshme në monitorimin e këtij treguesi.

Grafik 3. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekspozimi i drejtpërdrejtë i aktivitetit të sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrolluar, por disa nga treguesit e këtyre rreziqeve kanë pasur prirje rritëse. Sektori bankar mbetet i ndjeshëm ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, përmes segmentit të kredisë së pambrojtur në valutë. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit mbetet i pranishëm, por

vlerësohet i kufizuar. Banka e Shqipërisë i ka adresuar këto rreziqe nëpërmjet veprimeve rregullatore të natyrës mikroprudenciale dhe instrumenteve të politikës makroprudenciale. Pasiguria për zhvillimet ekonomike, në kushtet e pranisë së pandemisë, mbetet e konsiderueshme, dhe të tilla mbeten edhe sfidat për veprimtarinë bankare e financiare. Megjithatë, vlerësimet e industrisë bankare dhe ushtrimet e provës së rezistencës, sugjerojnë që kapacitetet e sektorit bankar për t'u përballur me këto sfida janë të mjaftueshme.

Pas kësaj tabloje të sistemit bankar në vend, do të rendis shkurtimisht disa nga drejtimet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë për forcimin e mbikëqyrjes bankare dhe për mbështetjen e stabilitetit financiar.

Zbatimi i rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës (KiE) për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL). Në raportin vlerësues të Moneyval-it, subjektet financiare, e veçanërisht bankat, janë vlerësuar në nivel të lartë të efektivitetit ("*substantial*/i konsiderueshëm"), duke marrë përgjithësisht masat e duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Komiteti ka lënë dhe një sërë rekomandimesh për autoritetet shqiptare. Në kuadër të adresimit të tyre, ne jemi përfshirë në zbatimin e planit kombëtar të masave sipas përkatësisë, duke bërë plotësimet e nevojshme në kuadrin rregullator dhe duke forcuar procesin mbikëqyrës. Numri i inspektimeve me fokus të veçantë çështjet e financimit të terrorizmit dhe zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare është shtuar. Këto inspektime janë drejtuar veçanërisht për subjektet financiare jobanka dhe zyrat e këmbimit valutor.

Përafrimi rregullator e metodologjik dhe rritja e kapaciteteve mbikëqyrëse. Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për përmirësimin e kuadrit rregullator, nëpërmjet miratimit të akteve të reja rregullatore dhe rishikimit të rregulloreve në fuqi, duke e përafruar më tej këtë kuadër me *acquis* të BE-së, parimet e Komitetit të Bazelit dhe me praktikat më të mira të mbikëqyrjes bankare. Procesi i rishikimit të kuadrit rregullator në fuqi ka marrë në konsideratë dhe situatën e krijuar në vend nga pandemia. Gjithashtu, një pjesë e akteve nënligjore të miratuara kanë synuar të plotësojnë kuadrin rregullator në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, autoriteti përgjegjës për të cilën është Banka e Shqipërisë.

Monitorimi rigoroz i sistemit financiar nëpërmjet inspektimeve në vend. Situata e pandemisë dhe kufizimet e vendosura kanë detyruar kryerjen e diferencuar të inspektimeve në vend. Nga ana tjetër, ne kemi

shuar korrespondencat me bankat dhe institucionet financiare jobanka, për ndarjen e informacionit dhe rritjen e raportimeve. Gjatë vitit u zhvilluan 27 inspektime në banka e institucione financiare jobanka, si dhe 74 në zyrat e këmbimit valutor. Këto inspektime kanë pasur objektiv kryesor rrezikun e kredisë.

Tabelë 1. Numri i ekzaminimeve sipas tematikës

Ekzaminime të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku i Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfutshmëria	Kapitali
2018	8	10	9	8	8	8	9	8	28*	9	8
2019	13	13	16	13	13	14	13	13	14	13	15
2020	2	8	15	11	2	5	5	5	88**	2	6

* Në vitin 2018 janë kryer ekzaminime në 28 ZKV për Rrezikun Reputacional. Ndërsa, 10 inspektimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

** Në vitin 2020 janë kryer ekzaminime në 74 ZKV për Rrezikun Reputacional dhe 14 ekzaminime të tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe IFJB. Ndër këto, ekzaminimet për 2 banka, 1 IFJB dhe 1 ZKV, për këtë rrezik, janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe ekzaminimet për 3 banka janë kryer në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Fuqizimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka hartuar planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat sistemike, ka identifikuar pengesat potenciale ndaj zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ka hartuar masat për heqjen e këtyre pengesave. Gjithashtu, gjatë vitit 2020, ka përfunduar ciklin e parë të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në lidhje me bankat josistemike.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikës makroprudenciale në funksion të stabilitetit financiar. Banka e Shqipërisë ka një rol parësor në hartimin dhe zbatimin e politikës makroprudenciale. Kjo politikë parandalon akumulimin e rreziqeve dhe forcon rezistencën e sistemit financiar. Gjatë vitit 2020, janë futur në zbatim akte të reja rregullatore - si ai për raportin e mbulimit të likuiditetit dhe rregullorja për zbatimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit - të cilat synojnë zbutjen e rreziqeve dhe forcimin e rezistencës së sektorit bankar.

Realizimi i detyrave institucionale nënkupton dhe një vëmendje konstante ndaj fushave të tjera të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë, të cilat do të përpiqem t'i përmbledh më poshtë.


3. AKTIVITETE TË TJERA

Funksionimi i ekonomisë dhe i sistemit bankar është mbështetur nga një sistem eficient dhe i sigurt i pagesave. Dy sistemet që operon Banka e Shqipërisë në lekë - ai për pagesat me vlerë të vogël, AECH, dhe ai për pagesat me vlerë të madhe, AIPS - kanë treguar diponueshmëri maksimale dhe kanë funksionuar në mënyrë të sigurt dhe efikase. Gjatë vitit 2020, u bë rishikimi i kuadrit rregullator që lidhet me operimin e dy sistemeve të pagesave. Sistemet janë vlerësuar nga ekspertët ndërkombëtarë kundrejt parimeve të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BRN) dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE) dhe kanë rezultuar të përputhshme me këto parime.

Në kuadër të promovimit të reformave në tregun e pagesave, Banka e Shqipërisë vijon të luajë një rol aktiv në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023). Më shumë se 50% e masave të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë janë realizuar, nëpërmjet një sërë ndërhyrjesh rregullatore dhe masave për rritjen e edukimit financiar. Në funksion të realizimit të objektivave të strategjisë, Banka e Shqipërisë ka nisur punën për transpozimin e Direktivës së BE-së "Për Llogarinë e pagesës", e cila pritet të rrisë transparencën në shërbimet e pagesave dhe përfshirjen financiare të popullsisë.

Viti i kaluar shënoi një rritje me 18.5% të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, trend i cili është ndikuar edhe nga masat e Bankës së Shqipërisë për uljen e kostove të transfertave elektronike në lekë. Përdorimi i instrumenteve elektronike dhe zgjerimi i përfshirjes së popullatës në përgjithësi, pritet të nxitet më tej pas finalizimit të Ligjit "Për shërbimet e pagesave". Nismë e Bankës së Shqipërisë, miratimi i këtij ligji përbën një arritje të rëndësishme për rritjen e aksesit të popullatës në shërbimet e pagesave, si dhe shënon një hap më tej drejt integritimit me praktikatat më të mira të BE-së.

Grafik 4. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe në formë letër në vite (majtas) dhe numri i pagesave për frymë (+15 vjeç) në vite (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Si një nga institucionet e përfshira në planin kombëtar për integrimin evropian, Banka e Shqipërisë ka përbushur të gjitha detyrimet për raportim, si dhe ka integruar rekomandimet e Komisionit Evropian në realizimin e detyrave të saj të përditshme. Paralelisht me to, ne kemi vijuar me punën paraprake për përgatitjen për negociatën e Kapitujve 4 dhe 17, për të cilat Banka e Shqipërisë ka rolin e koordinatorit kombëtar, si dhe kemi forcuar dialogun për të identifikuar rrugët optimale për përballimin e goditjes.

Po ashtu, vëmendja jonë ka qenë e drejtuar tek masat parandaluese dhe efektet e pandemisë në aktivitetin e brendshëm të institucionit. Një vit më parë, ne përfunduam platformën për menaxhimin e vijueshmërisë së veprimtarisë. Gjatë vitit 2020, kjo platformë i mundësoi njësisë të Bankës së Shqipërisë të reagojnë me efikasitet për të siguruar vazhdimësinë normale të proceseve gjatë pandemisë. Të gjitha aktivitetet kryesore të Bankës kanë vijuar normalisht punën, pa asnjë ndërprerje.

Gjithashtu, gjej me vend të theksoj se Banka e Shqipërisë ka bërë progres edhe në fushat e tjera të veprimtarisë së saj, si në drejtim të përpilimit dhe shpërndarjes së statistikave financiare, të administrimit të rezervës valutore, të kërkimit shkencor dhe komunikimit me publikun, të administrimit të monedhës kombëtare etj. Të gjitha këto aspekte të punës sonë janë pasqyruar me vërtetësi në Raport.

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Ekonomia shqiptare shfaq një rezistencë të admirueshme ndaj goditjes gjatë vitit të shkuar dhe ka premisa pozitive zhvillimi edhe në të ardhmen e afërt e të largët. Megjithatë, rreziqet e kahut të poshtëm mbeten të shumta dhe mjedisi ekonomik e financiar mbetet sfidues.

Në gjykimin tonë, politikat makroekonomike duhet të vijojnë të ruajnë kahun e tyre stimules, derisa rritja ekonomike dhe zgjerimi i punësimit të jenë vendosur në shina të qëndrueshme. Më tej, prioriteti i politikave duhet të zhvendoset drejt shëndoshjes së balancave ekonomike, e në veçanti drejt reduktimit të borxhit publik dhe krijimit të hapësirave të nevojshme fiskale për përballimin e goditjeve të tjera në të ardhmen.

“Stimujt fiskalë, monetarë dhe financiarë, janë instrumente thelbësore për nxitjen e kërkesës agregate, por vetëm reformat strukturore mundësojnë zgjerimin e qëndrueshëm të kapaciteteve prodhuese të ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies shoqërore.”

Paralelisht me to, politikëbërësit, në çdo nivel, duhet të punojnë për të çuar përpara reformat strukturore. Stimujt fiskalë, monetarë dhe financiarë, janë instrumente thelbësore për nxitjen e kërkesës agregate, por vetëm reformat strukturore mundësojnë zgjerimin e qëndrueshëm të kapaciteteve prodhuese të ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies shoqërore. Më lejoni t’ju siguroj se, nëpërmjet ruajtjes së stabilitetit monetar e financiar, Banka e Shqipërisë mbetet e përkushtuar për të dhënë kontributin e saj në këtë drejtim.

Ju faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO GJATË PREZANTIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2020 NË KUVENDIN E SHQIPËRISË -27 maj 2021-

Objektivat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2020 ishin:

- (i) lehtësimi i impaktit afatshkurtër të krizës në ekonomi;*
- (ii) reduktimi i pasojave të mundshme negative në potencialin prodhues të vendit;*
- (iii) ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.*

*I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Më lejoni t'ju falenderoj për mundësinë që më jepni për të prezantuar përpara jush punën dhe rezultatet e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit të kaluar, nëpërmjet këtij komunikimi të drejtpërdrejtë.

Pandemia COVID-19 e vuri Bankën e Shqipërisë – ashtu si dhe gjithë ekonominë, shoqërinë dhe institucionet shqiptare – përballë sfidave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme. E ndërgjegjshme për madhësinë dhe kompleksitetin e problemit, në koordinim dhe me politikën fiskale, Banka e Shqipërisë ndërhyri në mënyrë të shpejtë dhe të plotë.

Objektiva të ndërhyrjes sonë ishin: (i) lehtësimi i impaktit afatshkurtër të krizës në ekonomi; (ii) reduktimi i pasojave të mundshme negative në potencialin prodhues të vendit; si dhe (iii) ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

Në tërësi, mendoj se masat tona për përballimin e krizës rezultuan të suksesshme:

- ndikimi i krizës në ekonomi rezultoi më i vogël së pritjet tona fillestare, duke ilustruar si rezistencën dhe fleksibilitetin e sektorit privat, ashtu dhe ndikimin pozitiv të përgjigjes së politikave publike;

- po ashtu, ndikimi i goditjes mbi faktorët afatgjatë të rritjes duket i përmbajtur. Me gjithë problemet e natyrshme, ne kemi shmangur falimentimet në masë të bizneseve dhe rritjen e fortë të papunësisë;
- së fundi, pavarësisht testit të fortë të cilit iu nënshtruam, ekuilibrat ekonomikë dhe financiarë të vendit mbetën solidë.

Në gjykimin tonë, ekonomia shqiptare i gëzon premiset për një rimëkëmbje të shpejtë në të ardhmen.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Më lejoni të theksoj se, gjatë vitit 2020, Banka e Shqipërisë ka përmbushur detyrat e saj të tjera ligjore, ka shënuar progres në implementimin e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit, si dhe ka zbatuar rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në vijim do të paraqes një shtjellim më të plotë të punës dhe rezultateve tona gjatë vitit të shkuar.

1. ECURIA EKONOMIKE DHE REAGIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Rritja e pasigurisë dhe masat e nevojshme të distancimit social, të marra për kufizimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, e çuan ekonominë shqiptare në recesion, sollën rritje të papunësisë dhe krijuan vështirësi financiare për shumë biznese e familje gjatë vitit 2020.

Treguesit e balancave ekonomike u përkeqësuan. Vëllimi i aktivitetit ekonomik u tkurr me 3.3%, ekonomia shqiptare humbi rreth 43,000 vende pune dhe shkalla e papunësisë u rrit në 11.8%. Rënia e të ardhurave solli rritjen e borxhit privat e publik. Në pasqyrim të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, në vend dhe në botë, inflacioni mesatar për vitin 2020 rezultoi 1.6%, duke vijuar të mbetet poshtë objektivit tonë.

Kriza goditi në mënyrë të veçantë flukset tregtare dhe konsumin privat. Për rrjedhojë, pasojat e krizës ishin prezente në të gjithë sektorët e ekonomisë, por, në veçanti, ato u ndjenë në sektorin e industrisë dhe në degë të veçanta të sektorit të shërbimeve.

Madhësia dhe kompleksiteti i goditjes e bëri të domosdoshëm adresimin e saj me politika të koordinuara stimuluese fiskale, monetare e financiare. Brenda fushës së vet të kompetencës, Banka e Shqipërisë mori një paketë të plotë masash. Më konkretisht, ne:

- ulëm normën bazë të interesit në minimumin e saj historik prej 0.5%, lehtësuam qasjen e sektorit bankar në fonde likuide dhe rritëm injektimet e likuiditetit në tregun ndërbankar;
- miratuam ndryshime rregullatore, të cilat inkurajuan shtyrjen me 6 muaj të kësteve të kredisë për klientët në vështirësi imediate, si dhe ristrukturimin e kredive për klientët në vështirësi më afatgjata;
- pezulluam shpërndarjen e dividendit për sektorin bankar, duke synuar të rrisim kapacitetet absorbuese financiare të sektorit ndaj goditjes;
- eliminuam kostot e përdorimit të platformave elektronike të pagesave ndërbankare që operon Banka e Shqipërisë, duke synuar përdorimin e pagesave elektronike.

Në vlerësimin tonë, masat e marra kanë qenë efektive për reduktimin e ndikimit të pandemisë në sektorin tonë.

Së pari, ndërhyrja jonë ndihmoi në ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit. Tregu financiar rezultoi i qetë, i karakterizuar nga një aktivitet normal dhe volatilitet i ulët. Ky zhvillim është një ndryshim cilësor nga episode të mëparshme goditjesh dhe dëshmi e maturitetit të rritur të sistemit tonë financiar.

Së dyti, stimuli monetar dhe makroprudencial krijoi kushtet e nevojshme për vijimin e kreditimit. Kredia për sektorin privat shënoi rritje mesatare prej 6.7% gjatë vitit 2020. Gjithashtu, mbi 23,000 biznese e familje përfituan nga moratoriumi i kësteve dhe ristrukturimi i kredisë, për një portofol kredie që kap vlerën e rreth 200 miliardë lekëve. Në tërësi, vlerësimet tona tregojnë se kursi stimulues i politikës monetare të ndjekur gjatë katër viteve të fundit ka gjeneruar një vëllim rreth 3.7% më të lartë të aktivitetit ekonomik, duke dhënë një kontribut të konsiderueshëm në përmirësimin e mirëqenies sociale.

“Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë ndihmoi në ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit. Tregu financiar rezultoi i qetë, i karakterizuar nga një aktivitet normal dhe volatilitet i ulët. Ky zhvillim është një ndryshim cilësor nga episode të mëparshme goditjesh dhe dëshmi e maturitetit të rritur të sistemit tonë financiar.”

Së treti, mbikëqyrja e monitorimi i kujdesshëm i ecurisë së sektorit bankar, komunikimi i vazhduar me të dhe pezullimi i përkohshëm i shpërndarjes së dividendit, i shërbyen ruajtjes së një sistemi bankar likuid, të mirëkapitalizuar dhe me praktika të shëndosha për administrimin e reziqeve.


Së fundi, garantimi i funksionimit të pandërprerë të sistemeve të pagesave dhe ulja e kostove për pagesat online në lek mbështeti funksionimin normal të tregut financiar.

2. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE

Sektori ynë bankar mbajti mbi shpatulla një pjesë të konsiderueshme të barrës financiare të krizës, duke ushtruar në mënyrë të denjë funksionin e amortizuesit të goditjeve. Ky zhvillim cilësisht i ndryshëm nga episodet e mëparshme të krizave, pasqyron punën e vazhdueshme që Banka e Shqipërisë ka kryer në drejtim të përmirësimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit, të përmirësimit të rrjetave të sigurisë, si dhe të konsolidimit të sektorit bankar.

Pavarësisht sfidave, veprimtaria e sektorit bankar u shfaq e qëndrueshme. Gjatë vitit 2020, aktivet e këtij sektori u rritën me rreth 7%, rezultati financiar mbeti në territor pozitiv, kapitalizimi i tij mbetet i kënaqshëm, ndërsa portorti i kredive me probleme zbriti në 8.1% në fund të vitit.

Grafik 5. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekspozimi i drejtpërdrejtë i aktivitetit të sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrolluar. Vlerësimet e industrisë bankare dhe ushtrimet e provës së rezistencës, sugjerojnë se kapacitetet e sektorit bankar janë të mjaftueshme për të përballuar rritje potenciale të tyre.

Krahas masave të marra në kuadër të pandemisë, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për forcimin afatgjatë të kuadrit mbikëqyrës të sistemit bankar. Drejtimet kryesore të punës konsistojnë në:

- zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve të KiE-së për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL), ku janë bërë plotësimet e nevojshme në kuadrin rregullator dhe është shtuar numri i inspektimeve me fokus në çështjet e financimit të terrorizmit;
- përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator, duke vijuar përafrimin me *acquis* të BE-së, parimet e Komitetit të Bazelit dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare;
- kryerjen e inspektimeve në vend, duke vendosur prioritete dhe duke kryer inspektime të targetuara në kushtet e kufizimeve;
- fuqizimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, ku në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, janë hartuar planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat sistemike.

3. AKTIVITETE TË TJERA

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Banka e Shqipërisë ka ruajtur një vëmendje konstante dhe ndaj fushave të tjera të aktivitetit të saj, të cilat kanë një kontribut direkt në zhvillimin e tregut financiar dhe në jetën ekonomike të vendit. Në këtë drejtim, gjej me vend të evidentoj:

- zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave, nëpërmjet përmirësimeve ligjore e infrastrukture;
- furnizimin e vazhduar të ekonomisë me para fizike dhe rritjen e cilësisë së saj;
- miradministrimin e rezervës valutore;
- mbështetjen e integritit evropian;
- përmirësimin e statistikave financiare;
- intensifikimin e përpjekjeve në drejtim të rritjes së edukimit dhe përfshirjes financiare; si dhe,
- punën kërkimore dhe përmirësimin e komunikimit me publikun.

Gjithashtu, sistemet e kontrollit të brendshëm të ngritura kanë vijuar të kontribuojnë në miradministrimin e proceseve normale të punës dhe vijueshmërinë e të gjitha funksioneve të bankës.

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Viti 2021 pritet të shënojë një kthesë pozitive në drejtim të gjallërimit të ekonomisë së vendit.

Hapja e ekonomive partnere, vaksinimi i popullsisë dhe stimuli monetar e fiskal në vend do të mbështesin zgjerimin e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021 dhe atij 2022. Megjithatë, pasiguritë mbi këto pritje mbeten të pranishme dhe probabiliteti i goditjeve të tjera negative në të ardhmen nuk është i neglizhueshëm.

“... përfundimi i krizës duhet të shoqërohet me rikthimin e plotë të vëmendjes në nevojën e përshpejtimit të axhendës së reformave strukturore. Këto reforma janë instrumenti i vetëm për përshpejtimin e qëndrueshëm të ritmit të rritjes ekonomike dhe për shndërrimin e fryteve të saj në një përmirësim sa më të gjerë të mirëqenies sociale.”

Rimëkëmbja e plotë e ekonomisë dhe kthimi i qëndrueshëm i inflacionit në objektiv duhet të vijojnë të mbështeten nga stimuj makroekonomikë në afatin e shkurtër. Në afatin e mesëm dhe të gjatë, politikat ekonomike duhet të zhvendosen drejt një balance më të qëndrueshme midis nevojës për të ofruar stimul dhe nevojës për të ruajtur stabilitetin monetar dhe financiar.

Në fund të fjalës sime, më lejoni të theksoj se përfundimi i krizës duhet të shoqërohet me rikthimin e plotë të vëmendjes në nevojën e përshpejtimit të axhendës së reformave

strukturore. Këto reforma janë instrumenti i vetëm për përshpejtimin e qëndrueshëm të ritmit të rritjes ekonomike dhe për shndërrimin e fryteve të saj në një përmirësim sa më të gjerë të mirëqenies sociale. Ato duhet të synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, përmirësimin e mëtejshëm të klimës së investimeve dhe të biznesit, si dhe forcimin afatgjatë të qëndrueshmërisë së financave publike.

Ju faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË SEANCËN DËGJIMORE TË KOMISIONIT PARLAMENTAR TË EKONOMISË DHE FINANCIVE MBI PROJEKTBUXHETIN 2022 -5 nëntor 2021-

*I nderuar zoti Kryetar i Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Në radhë të parë, më lejoni t'ju falënderoj për ftesën për t'u paraqitur në këtë Komision dhe për të prezantuar para jush opinionin e Bankës së Shqipërisë për Projektbuxhetin e vitit 2022.

Ky Projektbuxhet përcakton qëndrimin e politikës fiskale për vitin 2022, alokon fondet e nevojshme për financimin e programeve të zhvillimit, si dhe prezanton legjislacionin tatimor për vitin e ardhshëm. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe vlerëson në vazhdimësi diskutimin e hapur mbi projeksionet ku bazohet ky projekt, objektivat e përfshira në të, si dhe instrumentet e parashikuara për arritjen e tyre. Shpresoj që edhe kontributi ynë në këtë proces të japë një vlerë të shtuar.

Si gjithnjë, në respektim të mandatit ligjor, opinioni i Bankës së Shqipërisë për Projektbuxhetin do të përqendrohet në ato çështje, të cilat janë brenda sferës sonë të kompetencës dhe ekspertizës.

Më konkretisht, komentet e mia do të adresojnë çështjet e mëposhtme:

1. Kahu dhe efekti i politikës fiskale në ekonomi;
2. Huamarrja publike dhe ndikimi i saj në tregjet e brendshme financiare; dhe, së fundi,
3. Rritja e efektivitetit dhe e qëndrueshmërisë së financave publike.

Më lejoni, në fillim, të paraqes në mënyrë të përmbledhur vizionin tonë mbi perspektivën e zhvillimit të vendit dhe kontributin që ne si politikëbërës duhet të japim në të.

“Projektbuxheti i vitit 2022 merr jetë në kontekstin e një procesi rimëkëmbjeje të ekonomisë shqiptare, pas goditjes së dyfishtë të tërmetit dhe pandemisë, por edhe në sfondin e sfidave të vazhdueshme afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit që kemi përpara.”

1. KONTEKSTI MAKROEKONOMIK, POLITIKA FISKALE DHE PROJEKSIONET BUXHETORE

Projektbuxheti i vitit 2022 merr jetë në kontekstin e një procesi rimëkëmbjeje të ekonomisë shqiptare, pas goditjes së dyfishtë të tërmetit dhe pandemisë, por edhe në sfondin e sfidave të vazhdueshme afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit që kemi përpara.

Goditjet me të cilat u përballëm gjatë dy viteve të fundit testuan fort ekuilibrat ekonomikë, monetarë dhe financiarë të vendit, si dhe qëndrueshmërinë e burimeve të rritjes.

“Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, zhvillimet ekonomike të vitit 2021, dhe në veçanti: normat e larta të rritjes gjatë gjysmës së parë të vitit; rikuperimi i pjesshëm i treguesve të tregut të punës; përmirësimi gradual i bilanceve financiare të sektorit privat; stabiliteti i inflacionit dhe i kursit të këmbimit; si dhe kreditimi në rritje i sektorit privat; tregojnë se ekonomia shqiptare po e përballon me sukses këtë sfidë.”

Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, zhvillimet ekonomike të vitit 2021, dhe në veçanti: normat e larta të rritjes gjatë gjysmës së parë të vitit; rikuperimi i pjesshëm i treguesve të tregut të punës; përmirësimi gradual i bilanceve financiare të sektorit privat; stabiliteti i inflacionit dhe i kursit të këmbimit; si dhe kreditimi në rritje i sektorit privat; tregojnë se ekonomia shqiptare po e përballon me sukses këtë sfidë. Po ashtu, fakti se vëllimi i prodhimit në vend, si në nivel agregat dhe në pjesën më të madhe të sektorëve, ka kaluar nivelin që kishte para tërmetit dhe pandemisë,

tregon se ndikimi afatmesëm e afatgjatë i këtyre dy goditjeve në burimet e rritjes ekonomike, ka shumë gjasa të jetë i ulët.

Rimëkëmbja ekonomike është ushqyer nga reduktimi i kufizimeve të marra për kontrollin e pandemisë, nga përmirësimi i besimit të bizneseve dhe familjeve, nga përmirësimi i kërkesës së huaj, por edhe nga politika stimuluese monetare dhe fiskale. Ndër të tjera, këto politika garantuan stabilitetin monetar edhe financiar të vendit, nxitën kreditimin me kosto të ulët të aktivitetit ekonomik, si dhe lehtësuan barrën financiare të sektorit privat.

Banka e Shqipërisë gjykon se perspektiva e zhvillimit të vendit mbetet pozitive dhe se rimëkëmbja ekonomike po vjen drejt konsolidimit. Për këtë arsye, politikat tona ekonomike – ajo monetare dhe ajo fiskale – duhet të fillojnë të orientohen gradualisht drejt normalizimit. Ky normalizim do t'i shërbejë përmirësimit të ekuilibrave makroekonomikë, rritjes së hapësirës

për përbalimin e goditjeve potenciale në të ardhmen, si dhe forcimit të qëndrueshmërisë financiare të vendit. Në gjykimin tonë, sekuencimi optimal i këtij procesi normalizimi do të ishte konsolidimi fiskal, i pasuar dhe i mbështetur nga tërheqja graduale e stimullit monetar. Kjo përjasje ofron mbështetjen e duhur për procesin e rimëkëmbjes dhe zbut rreziqet fiskale që burojnë prej rritjes së borxhit publik.

Bazuar në sa më sipër, Banka e Shqipërisë dëshiron të ndajë me ju konstatimet e mëposhtme.

Ky Projektbuxhet bazohet në supozimin e një rritjeje pozitive dhe të qëndrueshme të ekonomisë, si gjatë vitit 2022 ashtu edhe në horizontin afatmesëm. Në veçanti, Projektbuxheti parashikon se të ardhurat buxhetore të vitit 2022 do të rriten me rreth 8% ndaj nivelit të pritur të vitit 2021, duke arritur në 28.7% të PBB-së.

Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, projeksionet makroekonomike, të cilat konturojnë buxhetin, janë realiste në skenarin e tyre bazë, edhe pse ato mbeten në kahun e sipërm të pritjeve tona. Po ashtu, projeksionet e të ardhurave buxhetore për vitin 2022 duken të pranueshme, por ato faktorizojnë dhe një efekt pozitiv të pritur nga rritja e formalizimit të ekonomisë.

Në këtë prizëm, Banka e Shqipërisë:

- sugjeron nevojën për vëmendje të vazhduar nga autoritetet fiskale ndaj ecurisë së të ardhurave, për të identifikuar në kohë diferencat e mundshme negative midis faktit dhe planit, si dhe për të marrë masat e nevojshme për kontrollin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik;
- inkurajon zbatimin në kohë dhe me vendosmëri të masave që mbështesin formalizimin e ekonomisë. Përvoja jonë ka treguar se – pavarësisht kostove të tyre afatshkurtra – reformat strukturore prodhojnë përfitime afatgjata për vendin;
- vlerëson të domosdoshëm finalizimin dhe zbatimin në një kohë sa më të shpejtë të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave publike. Ndër të tjera, kjo strategji duhet të synojë thjeshtimin e sistemit tatimor, rritjen e qëndrueshmërisë në kohë të tij dhe shmangien e përjashtimeve tatimore joefektive. Së bashku me rritjen e formalizimit, kjo do të mundësojë rritjen e shkallës së grumbullimit të të ardhurave dhe përmirësimin e konkurrencës, brenda dhe midis sektorëve.

“Banka e Shqipërisë mirëpret fillimin e procesit të konsolidimit fiskal gjatë vitit 2022. Shpejtësia e konsolidimit duket e kushtëzuar nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe nevoja e përfundimit të procesit të rindërtimit.”

Së dyti, Projektbuxheti i vitit 2022 parashikon fillimin e procesit të konsolidimit fiskal. Sipas projeksioneve të Projektbuxhetit, deficitit buxhetor programohet të ulët në 5.4% të PBB-së për vitin 2022, kundrejt nivelit 6.8% të pritur për vitin aktual. Po ashtu, deficitit primar programohet të regjistrojë një konsolidim prej 1.9 pikë përqindjeje të PBB-së gjatë vitit 2022, ndërsa borxhi publik bruto parashikohet të reduktohet me 1.1 pikë përqindjeje.

Banka e Shqipërisë mirëpret fillimin e procesit të konsolidimit fiskal gjatë vitit 2022. Shpejtësia e konsolidimit duket e kushtëzuar nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe nevoja e përfundimit të procesit të rindërtimit. Në mungesë të tyre, Banka e Shqipërisë gjykon se ky konsolidim do të duhej të ishte më ambicioz. Po ashtu, ne mirëpresim adoptimin e një objekti numerik për ritmin e konsolidimit fiskal, të materializuar përmes vendosjes në Ligjin Organik të Buxhetit të një objekti mbi një balancë primare pozitive duke filluar nga viti 2024.

Në këtë prizëm, Banka e Shqipërisë:

- inkurajon adoptimin e dispozitave relevante në Projektbuxhet, të cilat mundësojnë përshpejtimin e ritmit të konsolidimit fiskal gjatë vitit 2022 – pra reduktimin e mëtejshëm të deficitit dhe të borxhit – në rast se të ardhurat buxhetore rezultojnë më të larta se pritjet apo në rast se nevoja për subvencionimin e importeve të energjisë rezulton më e ulët se vlerësimi aktual;
- sugjeron rishikimin e dispozitave të nenit 7 të Projektligjit për Buxhetin e vitit 2022, duke mundësuar që të ardhurat në formë granti me destinacion financimin e rindërtimit të dëmtimeve të tërmetit të përdoren për reduktimin e deficitit buxhetor;
- inkurajon një ritëm më të shpejtë të konsolidimit fiskal në horizontin afatmesëm dhe afatgjatë;
- vlerëson se ky konsolidim, në linjë dhe me adoptimin e strategjisë afatmesme të të ardhurave publike, duhet të bazohet më shumë në rritjen e të ardhurave sesa në shkurtimin e shpenzimeve publike.

Së treti, Projektbuxheti i vitit 2022 parashikon investime publike në nivelin 6.4% të PBB-së. Ky nivel vjen në rënie të lehtë krahasuar me vitin paraardhës, por ai mbetet gjithsesi mjaftueshmërisht i lartë.

Banka e Shqipërisë inkurajon ruajtjen e hapësirave për investime kapitale në strukturën e buxhetit të vendit. Këto investime janë të nevojshme për përmirësimin e gjithanshëm të infrastrukturës së vendit, në interes të përshpejtimit të ritmit të rritjes ekonomike në afatin e mesëm dhe të gjatë, si dhe në interes të rritjes së mirëqenies së shoqërisë.

“Banka e Shqipërisë inkurajon ruajtjen e hapësirave për investime kapitale në strukturën e buxhetit të vendit. Këto investime janë të nevojshme për përmirësimin e gjithanshëm të infrastrukturës së vendit, në interes të përshpejtimit të ritmit të rritjes ekonomike në afatin e mesëm dhe të gjatë, si dhe në interes të rritjes së mirëqenies së shoqërisë.”

Në këtë prizëm, Banka e Shqipërisë:

- vlerëson se disiplinimi i shpenzimeve korrente dhe rritja e qëndrueshme e bazës së të ardhurave publike do të krijojnë premisa për ruajtjen e hapësirave për investime publike, edhe në prani të konsolidimit fiskal;
- gjykon se procesi i përzgjedhjes së projekteve të investimeve mund të përmirësohet më tej, nëpërmjet adoptimit të një strukture formale të vlerësimit të rentabilitetit të tyre në kohë.

2. TREGJET FINANCIARE, DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK

Projektbuxheti i vitit 2022 parashikon një deficit buxhetor prej rreth 101 miliardë lekësh ose 5.4% të PBB-së. Ky deficit parashikohet të financohet në masën 50 miliardë lekë (ose 2.7% të PBB-së) nga huamarrja e brendshme dhe 51 miliardë lekë (përsëri 2.7% të PBB-së) nga financimi i huaj.

Financimi në tregun e brendshëm parashikohet të sigurohet nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë. Ndërkohë, financimi i huaj pritet të sigurohet si më poshtë: 25 miliardë lekë (ose 1.4% e PBB-së) nga projektet e mbuluara nga financimi i huaj, rreth 17.5 miliardë lekë (ose 1% e PBB-së) nga mbështetja buxhetore e partnerëve ndërkombëtarë dhe pjesa e mbetur prej 8.5 miliardë lekësh (ose 0.3% e PBB-së) nga fondet e siguruara nga emetimi pritur i një Eurobondi në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2021.

Ky Eurobond (i pritur në nivelin e 700 milionë eurove, ose rreth 85 miliardë lekë) do të përdoret si më poshtë: 34.1 miliardë lekë për mbulimin e pagesave të borxhit të huaj gjatë vitit 2021, 42.5 miliardë

lekë për mbulimin e pagesave të borxhit të huaj në vitin 2022 dhe 8.5 miliardë lekë për financimin e deficitit buxhetor gjatë vitit 2022. Në mungesë të Eurobondit, qeveria do të duhej të ulti në një masë korresponduese shpenzimet e planifikuara gjatë periudhës 2021-2022, ose të rriste huamarrjen në tregun e brendshëm.

Banka e Shqipërisë vlerëson se ky plan financimi është i arsyeshëm, në kushtet e niveleve të larta të deficitit dhe huamarrjes së synuar nga qeveria në horizontin 2021-2022. Financimi tërësor i këtyre deficiteve në tregun e brendshëm financiar do të sillte rritje të normave të interesit dhe reduktim të fondeve në dispozicion të kreditimit të sektorit privat. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë mbështet objektivat dhe punën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zgjatjen e mëtejshme të strukturës së maturimit të borxhit publik.

“Banka e Shqipërisë gjen me vend të theksojë se trendi rritës i huamarrjes së huaj dhe asaj të denominuar në valutë, ekspozon borxhin publik jo vetëm ndaj rrezikut të normave të interesit por dhe ndaj rrezikut të luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit.”

Megjithatë, Banka e Shqipërisë gjen me vend të theksojë se trendi rritës i huamarrjes së huaj dhe asaj të denominuar në valutë, ekspozon borxhin publik jo vetëm ndaj rrezikut të normave të interesit, por dhe ndaj rrezikut të luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë gjykon se struktura e financimit të deficitit dhe të borxhit duhet të synojë një mbështetje më të madhe në tregjet dhe monedhën vendase në afatin e mesëm dhe të gjatë. Kjo përjasje do të reduktonte probabilitetin dhe intensitetin

e goditjeve të mundshme në të ardhmen.

Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë sugjeron:

- së pari, rishikimin e dispozitave të parashikuara në nenin 10 të Projektligjit për Buxhetin e vitit 2022, të cilat kufizojnë huamarrjen në tregjet e brendshme financiare – të destinuar për financimin e deficitit buxhetor – në nivelin maksimal prej 50 miliardë lekësh, dhe e reduktojnë këtë huamarrje për maksimalisht gjysmën e sasisë së të ardhurave të mundshme të privatizimit të përfuara gjatë vitit;
- së dyti, vijimin e punës për zgjerimin dhe diversifikimin e mëtejshëm të bazës së investitorëve në tregun e brendshëm. Ky objektivi duhet përbushur – ndër të tjera – nëpërmjet vijimit të programit të përmirësimit të funksionimit të tregut dytësor, çka rrit interesin e investitorëve vendas;

- së treti, adoptimin e një përqaasjeje më ambicioze për reduktimin e borxhit të huaj në horizontin afatmesëm dhe afatgjatë. Ky objektivi shkon në linjë me – dhe bëhet i mundur nga – objektivi primar i reduktimit të nivelit të borxhit publik.

Në vijim, më lejoni të përmbledh shkurtimisht disa sugjerime të Bankës së Shqipërisë, të cilat, në vizionin tonë, do të ndihmonin në rritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe efektivitetit të financave publike.

3. MBI RITJEN E EFEKTIVITETIT DHE QËNDRUESHMËRINË E FINANCIVE PUBLIKE

Duke vlerësuar Projektbuxhetin e vitit 2022 si një akt balancues midis – nga njëra anë – nevojave të mbështetjes së rikuperimit të ekonomisë dhe reduktimit përfundimtar të pasojave të tërmetit dhe pandemisë, dhe – nga ana tjetër – ruajtjes dhe konsolidimit të qëndrueshmërisë së financave publike, Banka e Shqipërisë gjen me vend të bëjë dhe sugjerimet e rekomandimet e mëposhtme.

Mbi deficitet e krijuara nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Projektbuxheti i vitit 2022 parashikon se deficitin e krijuar nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në nivelin e 101 miliardë lekëve ose 5.4% të PBB-së. Ky nivel është i barabartë me deficitin buxhetor të vitit 2022 dhe rreth dy herë më i lartë se niveli i deficitit buxhetor të targetuar për vitet 2024 – 2025.

Skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore vijnë të përbëjnë një barrë të ndjeshme për financat e shtetit. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh dhe trendet e pafavorshme demografike, Banka e Shqipërisë sugjeron rishikimin periodik të skemës së pensione, atë të sigurimeve shëndetësore dhe skemat e tjera të sigurimeve sociale, me synim ruajtjen e këtyre skemave në trajektore të qëndrueshme dhe të përballeshme për buxhetin e shtetit.

“Banka e Shqipërisë sugjeron rishikimin periodik të skemës së pensione, atë të sigurimeve shëndetësore dhe skemat e tjera të sigurimeve sociale, me synim ruajtjen e këtyre skemave në trajektore të qëndrueshme dhe të përballeshme për buxhetin e shtetit.”

Mbi administrimin e Programeve të Partneritetit Publik - Privat

Projektbuxheti i vitit 2022 parashikon se pagesat nga buxheti i shtetit për detyrimet që lindin nga kontratat koncesionare dhe PPP-të do të jenë brenda kufizimeve ligjore, më konkretisht në nivelin 3% të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës.

Megjithatë, në linjë dhe me qëndrimet tona të mëparshme, Banka e Shqipërisë sugjeron:

- përfshirjen e tavaneve ligjore afatgjata mbi vlerën e përgjithshme të kontraktuar të PPP-ve. Ky rregullim do të ishte një element plotësues i kontrollit të nivelit të rrezikut potencial që PPP-të mund të kenë mbi shëndetin e financave publike;
- integrimin e procesit të kontraktimit dhe përzgjedhjes së PPP-ve me programin strategjik të investimeve, sikundër janë identifikuar në programet afatgjata të zhvillimit të vendit;
- përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të njësive që administrojnë vlerësimin, kontraktimin dhe monitorimin e këtyre projekteve, sidomos sa i takon detyrimeve ligjore dhe financiare që ato i ngarkojnë Buxhetit.

Mbi ritmin e realizimit të shpenzimeve buxhetore

Së fundi, Banka e Shqipërisë vazhdon të përsërisë thirrjen për një shpërndarje më të mirë kohore të shpenzimeve gjatë vitit. Ritmi i realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit vazhdon të shfaqë një përqendrim të theksuar në tremujorin e katërt. Ky fenomen, i përsëritur dhe i diktuar në masën më të madhe nga ritmi jo i njëtrajtshëm i realizimit të investimeve, krijon luhatje të panevojshme gjatë vitit në treguesit e likuiditetit dhe të normave të interesit në tregun e brendshëm financiar.

Ju faleminderit për vëmendjen!



KONFERENCË PËR SHTYP

**RAPORTI I NDËRMJETËM I POLITIKËS
MONETARE**

6 TETOR 2021



KAPITULLI II

KONFERENCA PËR SHTYP PËR VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 3 shkurt 2021*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 24 mars 2021*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 5 maj 2021*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 7 korrik 2021*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 4 gusht 2021*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 6 tetor 2021*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 3 nëntor 2021*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 22 dhjetor 2021*

Konferencat për shtyp për vendimmarrjen e politikës monetare

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë zhvillon 15 mbledhje në vit, nga të cilat 8 i dedikohen vendimmarrjes së politikës monetare. Politika monetare hartohet në funksion të objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë - arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Pas çdo mbledhjeje, në orën 16:00, Guvernatori i shpjegon publikut në prani të medias në një konferencë për shtyp vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës mbi qëndrimin e politikës monetare dhe analizën e përdorur në mbështetje të këtij vendimi. Në fund të konferencës, Guvernatori i përgjigjet edhe pyetjeve të ngritura nga gazetarët pjesëmarrës në konferencë.

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -3 shkurt 2021-

Aktiviteti ekonomik ka ardhur në përmirësim gjatë gjysmës së dytë të vitit të shkuar.

Inflacioni vijon të mbetet poshtë objektivit, ndërsa aktiviteti ekonomik dhe punësimi vijojnë të mbeten nën nivelet e regjistruara përpara pandemisë.

Kërkesa agregate do të vijë në rritje dhe aktiviteti ekonomik do të vijë gradualisht drejt normalizimit gjatë dy viteve në vazhdim.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 3 shkurt 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë tregon se aktiviteti ekonomik ka ardhur në përmirësim gjatë gjysmës së dytë të vitit të shkuar. Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se ky përmirësim ka qenë më i shpejtë se pritjet e Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, ai vëren se inflacioni vijon të mbetet poshtë objektivit, ndërsa aktiviteti ekonomik dhe punësimi vijojnë të mbeten nën nivelet e regjistruara përpara pandemisë.


Përditësimi i parashikimeve tona sugjeron se kërkesa agregate do të vijë në rritje dhe se aktiviteti ekonomik do të vijë gradualisht drejt normalizimit gjatë dy viteve në vazhdim. Ky normalizim do të shoqërohet me rritje të punësimit, të pagave të punonjësve dhe të marzheve të fitimit të biznesit, çka do të krijojë premisa për kthimin e inflacionit në objektivin tonë prej 3% brenda vitit 2022.

Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se përmbushja e këtyre projeksioneve kërkon ruajtjen e kushteve të favorshme financiare gjatë gjithë horizontit afatmesëm. Në këtë kontekst, ai gjykoj se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm.

Aktiviteti ekonomik në vend shfaqti tendenca rikuperimi në gjysmën e dytë të vitit 2020, pas recesionit të thellë të shënuar në tremujorin e dytë. Megjithatë, ndikimi negativ i pandemisë vazhdon të jetë i pranishëm, si në treguesit makroekonomikë, ashtu edhe në treguesit e shëndetit financiar të bizneseve dhe familjeve.

Inflacioni shënoi një vlerë mesatare prej 1.6% në tremujorin e katërt, duke ardhur në rritje të lehtë nga tremujori i mëparshëm. Luhatjet e tij pasqyrojnë, në masën më të madhe, luhatjet e çmimeve të artikujve ushqimorë. Nga ana tjetër, inflacioni bazë, një tregues ky i cili pasqyron më qartë trendet afatmesme të rritjes së çmimeve, vijoi të jetë i qëndrueshëm, por nën nivelet e synuara nga Banka e Shqipërisë. Kjo ecuri pasqyron shuarjen e goditjeve të ofertës gjatë gjysmës së dytë të vitit dhe presionet e dobëta të gjeneruara nga kërkesa agregate.

Grafik 6. Norma e inflacionit në tremujorin e katërt




Burimi: INSTAT, llogaritje të BSh-së.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, aktiviteti ekonomik shënoi një rënie vjetore prej 3.5% gjatë tremujorit të tretë, duke shënuar një përmirësim relativ të ndjeshëm krahasuar me thellësinë e recesionit të tremujorit të dytë. Ky përmirësim pasqyrooi hapjen e ekonomisë, rritjen e investimeve dhe një rënie më të ngadaltë të konsumit privat dhe të eksporteve. Zgjerimi i kërkesës agregate u pasqyrua në rritje të aktivitetit në sektorin e ndërtimit dhe në një kontraktim më të ulët të sektorëve të industrisë dhe të shërbimeve.

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik u pasqyrua dhe në treguesit e punësimit. Punësimi u rrit me rreth 34 mijë persona gjatë tremujorit të tretë, duke rikuperuar rreth 2/3 e humbjeve të regjistruara në tremujorin paraardhës, ndërsa norma e papunësisë zbriti në 11.6%.

Grafik 7. Tregu i punës shfaqti përmirësim në tremujorin e tretë



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Të dhënat e disponuara për aktivitetin ekonomik të tremujorit të katërt janë vetëm indirekte dhe ende jo të plota. Megjithatë, Banka e Shqipërisë vlerëson se aktiviteti ekonomik në vend ka vijuar të rikuperohet më tej, pavarësisht vështirësive të shkaktuara nga pandemia dhe nga ambienti i pafavorshëm i huaj.


Përtej lehtësimit të masave kufizuese të marra për kontrollin e pandemisë, ky rikuperim është ndihmuar dhe nga stimuli fiskal i transmetuar gjatë vitit 2020 dhe nga politikat stimuluese monetare dhe financiare të ndjekura nga Banka e Shqipërisë.

Deficiti buxhetor arriti rreth nivelit 5.1% të PBB-së gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit. Ky deficit pasqyroi si rënien e të ardhurave gjatë vitit kalendarik, ashtu dhe rritjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale gjatë vitit.

Sipas vlerësimeve tona, politika jonë stimuluese monetare dhe lehtësimi i përkohshëm i rregulloreve të funksionimit të sektorit bankar, mundësuan funksionimin normal të tregjeve financiare dhe krijuan një ambient të përshtatshëm për rritjen e kredisë gjatë vitit të shkuar.

Tregjet financiare vijuan të funksionojnë normalisht edhe gjatë tremujorit të katërt. Kursi i këmbimit u paraqit i qëndrueshëm, normat e interesit mbetën pranë minimumeve të tyre historike, ndërsa kreditimi vijoi të rritet më tej. Në veçanti, kredia për sektorin privat regjistroi një rritje vjetore prej 7.7% gjatë vitit 2020, duke ndihmuar bizneset dhe familjet shqiptare në përballimin e nevojave për likuiditet dhe duke ofruar mjetet e nevojshme financiare për rritjen e konsumit dhe të investimeve.

Grafik 8. Rritja e kredisë për sektorin privat në tremujorin e katërt është nxitur nga zgjerimi i kredisë për biznese



*Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimet vjetore në % të kredisë për sektorin privat sipas agjentëve ekonomikë. Këto të dhëna janë të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci dhe luhatjet e kursit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Banka e Shqipërisë gjykon se sektori bankar ka ndihmuar në zbutjen e pasojave të goditjes së pandemisë. Ky sektor ka marrë përsipër një pjesë të barrës financiare të goditjes, duke ruajtur në të njëjtën kohë tregues të shëndetshëm likuiditeti, rentabiliteti dhe kapitalizimi. Në veçanti, raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 8.1% në fund të muajit dhjetor, një nivel ky pranë minimumeve historike të dekadës së fundit. Vijimi i këtij roli aktiv të sektorit bankar edhe gjatë periudhës së ardhshme do të jetë një element kyç në qëndrueshmërinë e rimëkëmbjes ekonomike.

Skenari ynë bazë i zhvillimeve të pritura është ndërtuar mbi supozimin e zbutjes graduale të masave të marra për kontrollin e pandemisë dhe reduktimin progresiv të pasojave të saj. Në këtë skenar, ekonomia shqiptare pritet të shënojë norma relativisht të shpejta dhe të qëndrueshme rritjeje gjatë dy viteve në vijim. Inflacioni pritet të qëndrojë pranë niveleve aktuale në vitin në vazhdim. Më tej, rikthimi i aktivitetit ekonomik pranë potencialit do të krijojë kushtet për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se normalizimi i situatës ekonomike duhet të vijojë të mbështetet nëpërmjet ruajtjes së një profili stimulues të politikave ekonomike. Po ashtu, ai konstatoi se balanca e rreziqeve vijon të mbetet në kahun e poshtëm. Në veçanti, këto rreziqe burojnë nga:

- një përkeqësim i mundshëm i situatës epidemiologjike, në vend dhe në botë;
- vështirësi të mundshme në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së normave të interesit dhe kostove të financimit të sektorit privat, në formën e rritjes së ngadaltë të kredisë bankare; si dhe nga,
- një reagim më i ngadaltë i biznesit dhe i familjeve ndaj kushteve të përmirësuara financiare.

Në mbyllje të diskutimeve, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm për nxitjen e rritjes ekonomike dhe për kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektivin tonë prej 3%.

Për këtë arsye, ai vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe të kredive njëditore, respektivisht në nivelin 0.1% dhe 0.9%.

Po ashtu, Këshilli Mbikëqyrës thekson se politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit kohor afatmesëm, duke synuar të sigurojë kushte financimi të favorshme për rritjen e ekonomisë dhe për kthimin e inflacionit në objektiv. Ndër të tjera, stimuli monetar do të përfitojë nga ruajtja e formës aktuale të injektimit të likuiditetit me çmim fiks dhe sasi të pakufizuara në sektorin bankar, të paktën dhe gjatë tremujorit të dytë të këtij viti.

Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës vëren se materializimi i këtyre rreziqeve do të kërkonte lehtësimin e mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare.

“... stimuli monetar do të përfitojë nga ruajtja e formës aktuale të injektimit të likuiditetit me çmim fiks dhe sasi të pakufizuara në sektorin bankar, të paktën dhe gjatë tremujorit të dytë të këtij viti.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -24 mars 2021-

Aktiviteti ekonomik ka shënuar një përmirësim gradual gjatë muajve të fundit.

Ecuria e aktivitetit ekonomik në vend është mbështetur nga politika monetare akomoduese dhe nga stimuli fiskal.

Qëndrimi aktual stimulues i politikës monetare mbetet i përshtatshëm.

Inflacioni regjistroi vlera më të ulëta se pritjet tona gjatë dy muajve të parë të vitit.


Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 24 mars 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.

Në balancë, informacioni i ri i marrë në analizë tregon se aktiviteti ekonomik ka shënuar një përmirësim gradual gjatë muajve të fundit. Rënia e inflacionit gjatë dy muajve të parë të këtij viti, duket se pasqyron efektin e përkohshëm të luhatjeve të ofertës. Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës vëren se inflacioni vijon të mbetet poshtë objektivit, ndërsa aktiviteti ekonomik dhe punësimi vijojnë të mbeten në nivelet e regjistruara përpara pandemisë.

Përditësimi i parashikimeve tona sugjeron se aktiviteti ekonomik do të vijë gradualisht drejt normalizimit gjatë dy viteve në vazhdim. Ky normalizim do të shoqërohet me rritje të punësimit, të pagave dhe të marzheve të fitimit të biznesit, çka do të krijojë premisa për kthimin e inflacionit në objektivin tonë prej 3% brenda vitit 2022.

Grafik 9. Norma bazë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual stimulues i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Banka e Shqipërisë do të synojë të ruajë kushte të favorshme financiare gjatë gjithë horizontit afatmesëm, për të garantuar rimëkëmbjen e ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Inflacioni regjistroi vlera më të ulëta se pritjet tona gjatë dy muajve të parë të vitit. Norma vjetore e inflacionit ra në nivelin 0.4% në muajin janar, dhe u rrit në 1.1% në muajin shkurt. Kjo ecuri u diktua nga luhatjet e çmimeve të ushqimeve, të cilat, ashtu si dhe gjatë vitit të shkuar, mbeten subjekt i luhatjeve të papritura të ofertës, në kontekstin e pandemisë.

Nga ana tjetër, faktorët me ndikim afatmesëm në inflacion, kërkesa agregate dhe ecuria e punësimit dhe e pagave, kanë qenë në linjë me pritjet tona. Ndonëse ende të pamjaftueshme për kthimin e inflacionit në objektiv, presionet e brendshme mbi pagat dhe çmimet shfaqen të qëndrueshme dhe vazhdojnë të kontribuojnë në mënyrë të qenësishme në formimin e inflacionit, sikurse ilustron dhe nga ecuria e inflacionit bazë. Për rrjedhojë, efekti i goditjeve të ofertës pritet të jetë kalimtar dhe të mos cenonjë kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Informacioni i ri mbi aktivitetin ekonomik është përgjithësisht në linjë me pritjet tona. Të dhënat direkte mbi ecurinë e prodhimit të brendshëm bruto dhe kërkesën agregate mungojnë, por treguesit e tërthortë sugjerojnë

vijimin e rimëkëmbjes gjatë dy tremujorëve të fundit. Rritja e vëllimit të shitjeve, rritja e konsumit të energjisë elektrike, ecuria më e mirë e të ardhurave fiskale, si dhe zgjerimi i eksportit dhe importeve, sinjalizojnë një ecuri më të mirë të ekonomisë.

Nga ana tjetër, tregu i punës shfaqi rënie të punësimit në tremujorin e katërt të vitit 2020, dhe rritje të shkallës së papunësisë në nivelin 11.8%. Shuarja e ndikimit pozitiv të sezonit veror në degët e shërbimeve, dhe shtrëngimi i masave për parandalimin e pandemisë kanë ndikuar negativisht dinamikën e punësimit në fund të vitit të shkuar.


Ecuria e aktivitetit ekonomik në vend është mbështetur nga politika monetare akomoduese dhe nga stimuli fiskal.

Politika fiskale ka vijuar të ruajë tipare stimuluese, kryesisht në sajë të rritjes së shpenzimeve kapitale. Të ardhurat buxhetore kanë shënuar një rënie të lehtë, ndërkohë që shpenzimet publike janë rritur. Në përputhje me buxhetin e miratuar, politika fiskale do të mbetet stimuluese edhe gjatë vitit 2021, duke nxitur rritjen e kërkesës agregate dhe zgjerimin e aktivitetit ekonomik.

Politika monetare stimuluese ka mundësuar krijimin e kushteve të favorshme të financimit. Tregjet financiare operojnë të qeta dhe karakterizohen nga likuiditet i bollshëm dhe nga prime të kontrolluara rreziku. Gjendja e mirë e tyre ka mundësuar përcjelljen efektive të stimullit monetar, i cili ka mbajtur në nivele të ulëta normat e interesit të kredisë për sektorin privat.


Grafik 10.

Leku është luhatur në kahun mbicmues ndaj euros dhe është nënçmuar kundrejt dollarit amerikan



*Shënime: Të dhënat tregojnë ecurinë ditore të kursit të këmbimit të lekut kundrejt monedhës euro dhe dollarit amerikan
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Përtej luhatjeve afatshkurtra, ecuria e kursit eur/lek sinjalizon pozicionin të balancuar të agjentëve në treg



Shënime: Të dhënat paraqesin treguesin e anshmërisë, i cili llogaritet si raport i numrit të ditëve kur kursi është mbicmues kundrejt ditëve kur ai është nënçmuar. Për më shumë shiko.
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Po ashtu, kursi i këmbimit është shfaqur i qëndrueshëm, në pasqyrim të balancës së kërkesës dhe ofertës për valutë.

Kushtet monetare stimuluese kanë mbështetur rritjen e kredisë bankare, e cila ka vijuar të jetë një burim i qëndrueshëm financimi për familjet dhe kompanitë shqiptare. Vëllimi i kredisë bankare për sektorin privat regjistroi një rritje vjetore prej 7.1% në muajin shkurt. Zgjerimi i kredisë ka qenë relativisht i balancuar, në drejtim të strukturës së monedhave, në drejtim të përfituesve biznese apo individë, si dhe në drejtim të destinacionit për financimin e investimeve apo mbulimin e kapitalit qarkullues. Po ashtu, sinjale inkurajuese në drejtim të rritjes së efektivitetit të politikës monetare vijnë nga zgjerimi progresiv i peshës së kredisë në lekë ndaj totalit. Ky tregues shënoi vlerën 50% në fillim të vitit 2021.

Ecuria në rritje e kreditimit po jep një ndikim të qenësishëm në nxitjen e kërkesës agregate dhe rikuperimin e ekonomisë. Ajo pasqyron efektin e masave stimuluese monetare, financiare e fiskale, për nxitjen e kreditimit, gjendjen e mirë financiare të sektorit bankar, si dhe qëndrimin proaktiv të adoptuar nga bankat në situatën që po kalojmë.

Duke e parë nga e ardhmja, Këshilli Mbikëqyrës pret që aktiviteti ekonomik t'i rikthehet normave pozitive të rritjes në vitin 2021 dhe në vijim. Rritja ekonomike pritet të mbështetet nga një stimul i konsiderueshëm monetar dhe fiskal, nga reduktimi i pasigurisë, si dhe nga rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik botëror. Këta faktorë pritet të nxitin rritjen e konsumit, të eksporteve dhe të investimeve, si dhe të rritin gradualisht të ardhurat në të gjithë sektorët e ekonomisë. Rritja e kërkesës do të ndihmojë rritjen e punësimit, duke u përkthyer më tej në rritje të pagave dhe në një kthim gradual të inflacionit drejt objektivit brenda vitit 2022.

Në çdo rast, këto projeksione mbështeten në supozimin e reduktimit progresiv të pandemisë gjatë vitit 2021, dhe janë të kushtëzuara dukshëm prej saj. Ecuria e pandemisë dhe ndikimi i saj në ekonomi kanë qenë dhe vijojnë të mbeten burim pasigurie në parashikimet ekonomike. Këshilli Mbikëqyrës gjykon se balanca e rreziqeve vijon të mbetet në kahun e poshtëm. Në veçanti, rreziqe të kahut të poshtëm burojnë nga:

- një zgjatje në kohë e pandemisë dhe e kufizimeve që ajo sjell në aktivitetin ekonomik;
- një rimëkëmbje më e ngadaltë e konsumit dhe investimeve, si pasojë e një sjelljeje më të kujdesshme të familjeve dhe të biznesit shqiptar;

- një transmetim më i ngadaltë i stimulit monetar, si pasojë e një sjelljeje më të kujdesshme të bankave në kredidhënie.

Në konsistencë me këto parashikime, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm.

Rrjedhimisht, ai vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, respektivisht në 0.1% dhe 0.9%.

Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës gjykon se politika monetare do të vijojë të mbetet akomoduese gjatë gjithë horizontit kohor afatmesëm, në funksionin të rikuperimit të qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik dhe të kthimit të inflacionit në objektiv.

Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës vëren se materializimi i rreziqeve të kahut të poshtëm do të kërkonte lehtësimin e mëtejshëm të qëndrimit të politikës monetare.

“... politika monetare do të vijojë të mbetet akomoduese gjatë gjithë horizontit kohor afatmesëm, në funksionin të rikuperimit të qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik dhe të kthimit të inflacionit në objektiv.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -5 maj 2021-

Ritmi i rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik u përshpejtua gjatë dy tremujorëve të fundit .

Perspektiva e zhvillimit ekonomik po vjen drejt përmirësimit.

Zgjerimi i aktivitetit pritet të udhëhiqet nga përshpejtimi i konsumit familjar, i investimeve, si dhe nga eksporti.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 5 maj 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë shqyrtoi dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i analizuar tregon se ritmi i rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik u përshpejtua dhe perspektiva e zhvillimit ka ardhur drejt përmirësimit gjatë dy tremujorëve të fundit. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se kjo ecuri pasqyron: (i) fleksibilitetin e ekonomisë shqiptare dhe qëndrueshmërinë e sistemit të saj financiar; (ii) mbështetjen e siguruar nga stimuli monetar, financiar dhe fiskal; si dhe, së fundmi, (iii) reduktimin e kufizimeve dhe rritjen e besimit në përgjigje të procesit të vaksinimit.

Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës vëren se – në stadin aktual – rimëkëmbja ekonomike nuk është e plotë dhe faktorët mbështetës të saj nuk janë ende të konsoliduar. Pasojat e pandemisë në ekonomi mbeten të dukshme, në nivelet ende të ulëta të kërkesës agregate, në rënien e punësimit dhe në rritjen e papunësisë. Po ashtu, inflacioni mbetet nën objektivin tonë prej 3%.

Në këtë kontekst, Këshilli gjykon se politika monetare duhet të vijojë të mbetet në kahun lehtësues. Stimuli monetar do t'i shërbejë nxitjes së konsumit dhe investimeve, çka do të përkthehet më tej në rritje të punësimit, të pagave dhe të marzheve të fitimit, në linjë me objektivin tonë të inflacionit.


Informacioni i ri ka qenë përgjithësisht në përputhje me pritjet tona, ndonëse rritja e aktivitetit ekonomik ka qenë disi më e lartë se to dhe norma e inflacionit kanë qenë disi më e ulët.

Inflacioni shënoi një rënie të shpejtë dhe të papritur në muajin janar, si pasojë e reduktimit të çmimeve të artikujve ushqimorë. Rikuperimi i këtyre çmimeve në periudhën pasuese solli dhe rritjen e inflacionit në muajt shkurt e mars, por norma mesatare e këtij treguesi për tremujorin e parë rezultoi e ulët, në nivelin 0.9%. Nga ana tjetër, inflacioni bazë rezultoi i qëndrueshëm, rreth nivelit 1.5%, duke sugjeruar se luhatjet e çmimeve të ushqimeve do të kenë efekte vetëm kalimtare në inflacion.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, vëllimi i aktivitetit ekonomik në vend u rrit me 3% në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, pas tre tremujorësh të njëpasnjëshëm në rënie. Rritja ekonomike u mbështet nga zgjerimi i konsumit, investimeve dhe eksporteve, dhe u pasqyrua në përmirësimin e aktiviteteve prodhuese dhe atyre të shërbimeve. Të dhënat e disponuara për tremujorin e parë të vitit aktual janë vetëm indirekte, por ato sinjalojnë vijimin e gjallërimit të ekonomisë, sikundër ilustron nga përmirësimi i besimit të agjentëve ekonomikë, i llogarive fiskale dhe i flukseve tregtare.


Grafik 11.

Aktivitetet prodhuese dhe të shërbimeve mbështetën rritjen ekonomike në tremujorin e katërt të vitit 2020



Shënim: *Viti 2018, të dhëna gjysmëpërfundimtare.
** Vitet 2019 dhe 2020, një vlerësim i parë.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Treguesi i ndjesisë ekonomike vijoi të përmirësohet, si nga rritja e besimit të bizneseve ashtu edhe besimit të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithatë, edhe pse në rritje, kërkesa agregate mbetet ende poshtë niveleve të regjistruara në periudhën përpara pandemisë dhe e pamjaftueshme për të vënë në shfrytëzim të plotë faktorët e prodhimit.


Për rrjedhojë, aktiviteti ekonomik në vend u tkurr me 3.3% gjatë vitit 2020, ekonomia shqiptare humbi rreth 43,000 vende pune, ndërsa shkalla e papunësisë u rrit në 11.8%. Po ashtu, ritmi i rritjes së pagave dhe të kostove të tjera të prodhimit erdhi në ngadalësim.

Dobësia e kërkesës agregate dhe e pozicionit ciklik të ekonomisë kanë kërkuar një përgjigje të fortë dhe të koordinuar nga politikat makroekonomike.

Stimuli fiskal i vitit 2020 mori formën e lehtësive të përkohshme tatimore, të ofrimit të garancive sovrane, si dhe të rritjes së shpenzimeve korrente e kapitale. Për vitin 2021, stimuli fiskal ka formën e rritjes së shpenzimeve kapitale, në mbështetje të programit të rindërtimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës. Të dhënat fiskale të tremujorit të parë janë në linjë me këtë ecuri, duke dëshmuar një zgjerim të njëkohshëm si të të ardhurave e shpenzimeve fiskale, ashtu dhe të deficitit buxhetor.


Grafik 12.

Deficiti u financua nga burime të brendshme e të huaja



Shënime: Deficiti buxhetor sipas tremujorëve dhe mënyra e financimit të tij, në miliardë lekë.
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Bankat mbajtën peshën kryesore në financimin me burime të brendshme



Shënime: Huamarrja e qeverisë në tituj të borxhit, sipas blerësve, në miliardë lekë, sipas tremujorëve.
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë ofroi stimulim e nevojshëm monetar, për të garantuar funksionimin normal të tregjeve financiare dhe për të nxitur më tej kreditimin e ekonomisë. Po ashtu, lehtësimi i përkohshëm dhe i targetuar i mbikëqyrjes së rregulloreve të funksionimit të sektorit bankar ofroi lehtësi të mëtejshme për bizneset dhe familjet shqiptare, në formën e moratoriumit gjashtëmujor të kësteve të kredisë dhe në formën e nxitjes së ristrukturimit të saj.

Stimujt monetarë e financiarë kanë pasur një transmetim të mirë. Për rrjedhojë, kushtet monetare në ekonomi kanë qenë dhe vijojnë të mbeten akomoduese. Tregjet financiare operojnë të qeta dhe normat e interesit vijojnë të jenë pranë minimumeve historike, pavarësisht luhatjeve afatshkurtra. Po ashtu, kursi i këmbimit shfaqet i qëndrueshëm. Në veçanti, sektori bankar ka vijuar të financojë bizneset dhe familjet, duke pasqyruar si shëndetin e bilanceve të sektorit bankar ashtu dhe reagimin e duhur të tij ndaj goditjes. Në muajin mars 2021, treguesi i kredive me probleme zbriti nën nivelin 8%, duke regjistruar vlerën më të ulët të regjistruar prej vitit 2009.

Kredia për sektorin privat njohu një rritje mesatare vjetore prej 7.5% në tremujorin e parë. Kjo rritje shfaqti një bazë të gjerë, e nxitur nga zgjerimi i kreditimit si në segmentin e individëve dhe në atë të bizneseve. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se rritja e kredive për qëllime investimi është një zhvillim inkurajues për rritjen ekonomike në të ardhmen. Po ashtu, zgjerimi progresiv i peshës së kredisë në lekë, tregues ky i cili shënoi vlerën 52% ndaj totalit në muajin mars, jep sinjale pozitive në drejtim të rritjes së efektivitetit të politikës monetare dhe të qëndrueshmërisë financiare.

Projeksionet tona për të ardhmen mbeten pozitive. Vijimi i procesit të vaksinimit në vend dhe në botë, stimuli monetar dhe fiskal, si dhe rikthimi i besimit në nivelet historike, do t'i hapin rrugë zgjerimit progresiv të aktivitetit ekonomik gjatë viteve në vazhdim. Skenari bazë i parashikimeve projekton një rimëkëmbje me ritme të qëndrueshme të ekonomisë gjatë viteve 2021 dhe 2022, pas kontraktimit të përjetuar në vitin 2020. Zgjerimi i aktivitetit pritet të udhëhiqet nga përshpejtimi i konsumit familjar, i eksportit të mallrave e të shërbimeve, si dhe nga investimet private në rritje. Në përgjigje të tyre, punësimi dhe pagat pritet të vijjnë po ashtu në rritje, duke mundësuar kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Në gjykimin e Këshillit, rimëkëmbja e plotë e ekonomisë dhe rritja e qëndrueshme e inflacionit drejt objektivit duhet të vijojë të mbështetet nga një profil stimulues i politikave ekonomike. Për sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm, për nxitjen e rritjes ekonomike dhe për kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv.

Për këtë arsye, ai vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe të kredive njëditore, përkatësisht në nivelet 0.1% dhe 0.9%.

Ndër të tjera, stimuli monetar do të përfitojë nga ruajtja e formës aktuale të injektimit të likuiditetit me çmim fiks dhe sasi të pakufizuara në sektorin bankar, të paktën dhe gjatë tremujorit të tretë të këtij viti.

Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës konstaton se balanca e rreziqeve vijon të mbetet në kahun e poshtëm në afatin e shkurtër, por ajo shfaqet më e balancuar në afatin e mesëm. Në veçanti, rreziqet në afatin e shkurtër burojnë nga:

- një përmirësim më i ngadaltë se pritet i situatës epidemiologjike, në vend dhe në botë;
- vështirësi të mundshme në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, në formën e rritjes së ngadaltë të kredisë bankare; si dhe nga,
- një reagim më i ngadaltë i biznesit dhe i familjeve ndaj kushteve të përmirësuara financiare.

Për këto arsye, Këshilli Mbikëqyrës thekson se politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit kohor afatmesëm. Çdo normalizim në kohë i politikës monetare do të jetë i kujdesshëm, duke mos cenuar qëndrueshmërinë e rimëkëmbjes ekonomike dhe duke mos dëmtuar premisat e kthimit të inflacionit në objektiv.

Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës gjen me vend të theksojë se normalizimi gradual i situatës ekonomike dhe forcimi i qëndrueshmërisë së rimëkëmbjes duhet të risjellin në fokus të vendimmarrësve nevojën e përshpejtimit të axhendës së reformave strukturore. Këto reforma duhet të synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, përmirësimin e mëtejshëm të klimës së investimeve dhe të biznesit, si dhe forcimin afatgjatë të qëndrueshmërisë së financave publike. Ato janë të vetmet instrumente që do të mundësojnë një rritje më të shpejtë e më të qëndrueshme afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

“... politika monetare do të vijojë të mbetet lehtësuese gjatë gjithë horizontit kohor afatmesëm. Çdo normalizim në kohë i politikës monetare do të jetë i kujdesshëm, duke mos cenuar qëndrueshmërinë e rimëkëmbjes ekonomike dhe duke mos dëmtuar premisat e kthimit të inflacionit në objektiv.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -7 korrik 2021-

Ekonomia shqiptare ka shfaqur tendenca të qarta rikuperimi në gjysmën e parë të vitit.

Faktorët mbështetës të rritjes ekonomike kanë ardhur drejt konsolidimit.

Inflacioni ka ardhur në rritje gjatë muajve prill e maj, duke korrektuar rënien e tremujorit të parë.

Ekonomia shqiptare pritet të shënojë një rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme gjatë vitit aktual dhe dy viteve të ardhshme.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 7 korrik 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i analizuar sugjeron se ekonomia shqiptare ka shfaqur tendenca të qarta rikuperimi në gjysmën e parë të vitit. Po ashtu, inflacioni ka ardhur në rritje gjatë muajve prill e maj, duke korrektuar rënien e tremujorit të parë.

Përditësimi i parashikimeve konfirmon skenarët që kemi prezantuar në vazhdimësi gjatë vitit 2021. Ekonomia shqiptare pritet të shënojë një rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme gjatë vitit aktual dhe dy viteve të ardhshme. Kjo rritje do të shoqërohet me zgjerim të punësimit dhe rritje të pagave, duke krijuar premisa për kthimin e inflacionit në objektiv gjatë vitit 2022.

Këshilli Mbikëqyrës gjykon se faktorët të cilët mbështesin rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare kanë ardhur duke u zgjeruar dhe forcuar. Po ashtu, rreziqet e kahut të poshtëm, ndonëse ende të pranishëm, kanë ardhur drejt zbehjes. Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës vëren se inflacioni vijon të mbetet nën objektiv, se punësimi vijon të mbetet poshtë nivelit potencial, dhe se qëndrueshmëria e rritjes ekonomike vijon të kërkojë ruajtjen e kushteve monetare stimuluese.

Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm.


Në vijim do t'ju njoh më në detaje me arsyet e vendimmarrjes dhe konkluzionet e diskutimeve të Këshillit.

Inflacioni erdhi në rritje gjatë muajve prill e maj. Norma mesatare e inflacionit shënoi vlerën 1.9% për këta dy muaj, duke qenë dukshëm më e lartë se mesatarja e tremujorit të parë. Rritja e inflacionit pasqyroi kryesisht rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës, ndërkohë që çmimet e artikujve të tjerë të shportës nuk pësuan ndryshime të ndjeshme. Kjo dinamikë konfirmoi vlerësimet tona të mëparshme se rënia e inflacionit në tremujorin e parë do të ishte e përkohshme. Në të njëjtën kohë, ajo sugjeron se shpejtësia aktuale e rritjes së tij nuk është e qëndrueshme.

Faktorët që kushtëzojnë kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv po vijnë drejt përmirësimit, por kthimi i tij në objektiv pritet të jetë një spektër afatmesëm. Rritja e kërkesës agregate nuk është përkthyer ende në rritje të qëndrueshme të punësimit e të pagave. Po ashtu, rritja e shpejtë e çmimeve të konsumit në vendet partnere duket, për momentin, se do të jetë një fenomen kalimtar. Së fundi, pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin vijnë të mbeten nën objektiv.


Grafik 13.

Pritjet për inflacionin vjetor pas një viti të bizneseve dhe të konsumatorëve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Pritjet për inflacionin vjetor të agjentëve financiarë sipas tre horizonteve kohore



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë vlerëson se të tre këta faktorë do të vijnë drejt përmirësimit në horizontin afatmesëm.

Në linjë me pritjet tona, aktiviteti ekonomik në vend ka ardhur drejt rikuperimit gjatë dy tremujorëve të parë të vitit. Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 5.5% gjatë tremujorit të parë të vitit, ndërkohë që analiza e të dhënave indirekte sugjeron për norma edhe më të shpejta rritjeje gjatë tremujorit të dytë.

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik shfaqet me bazë të gjerë. Në terma të kërkesës agregate, ai pasqyron zgjerimin e konsumit dhe të investimeve private, rritjen e shpenzimeve buxhetore, si dhe zgjerimin e eksportit të mallrave e shërbimeve. Në terma sektorialë, ky rikuperim pasqyroi zgjerimin e njëkohshëm të sektorëve prodhues dhe të shërbimeve.


Përmirësimi i aktivitetit ekonomik nuk është pasqyruar ende plotësisht në tregun e punës. Sipas të dhënave të INSTAT-it, punësimi shënoi një rënie vjetore prej 2.6% në tremujorin e parë të vitit, ndërkohë që norma e papunësisë shënoi vlerën 11.9%. Këta tregues sugjerojnë se ekonomia shqiptare është ende larg normalizimit të plotë të aktivitetit të saj dhe se ky proces duhet të vijojë të mbështetet nga politika stimuluese.

Faktorët mbështetës të rritjes ekonomike kanë ardhur drejt konsolidimit. Reduktimi i kufizimeve si pasojë e procesit të vaksinimit, përmirësimi i besimit të biznesit dhe konsumatorit, zgjerimi i kërkesës së huaj, si dhe stimuli fiskal dhe monetar, kanë gjeneruar premisat e nevojshme për një normalizim gradual të aktivitetit ekonomik.

Politika fiskale ka vijuar të ruajë një natyrë stimuluese gjatë gjysmës së parë të vitit. Stimuli fiskal ka marrë formën e zgjerimit të shpenzimeve korrente dhe kapitale, përkatësisht me 10% dhe 29% deri në muajin maj, ndërkohë që të ardhurat buxhetore kanë shënuar rritje me rreth 19%. Respektimi i projeksioneve të buxhetit nënkupton që stimuli fiskal do të mbetet i pranishëm gjatë vitit 2021, për të ardhur drejt tkurrjes në vitet në vazhdim. Banka e Shqipërisë vlerëson se ruajtja e këtij kahu të politikës fiskale i shërben si mbështetjes së rikuperimit ekonomik në afatin e shkurtër ashtu dhe forcimit të qëndrueshmërisë fiskale në afatin e gjatë. Paralelisht me stimulin fiskal, politika monetare stimuluese ka mundësuar krijimin e kushteve të favorshme të financimit. Tregjet financiare operojnë të qeta dhe karakterizohen nga likuiditet i bollshëm dhe nga prime të kontrolluara rreziku. Gjendja e mirë e tyre ka mundësuar përcjelljen efektive të stimullit monetar, i cili ka mbajtur në nivele të ulëta normat e interesit të kredisë për sektorin privat. Po ashtu, kursi i këmbimit mbetet relativisht i qëndrueshëm, në pasqyrim të balancës së kërkesës dhe ofertës për valutë.

Përmirësimi i kërkesës për kredi dhe kushtet e favorshme të ofertës, kanë sjellë një rritje relativisht të shpejtë të kreditimit. Portofoli i kredisë për sektorin privat shënoi një rritje vjetore prej 7.8% në muajin maj, kundrejt një norme mesatare rritjeje prej 6.8% gjatë vitit 2020. Përtej rritjes së përgjithshme të portofolit, dinamikat e kreditimit mbartin sinjale të tjera pozitive. Së pari, rritja e portofolit të kredisë ka shkuar gjerësisht për financimin e investimeve të bizneseve dhe për kredi hipotekare, duke sinjalizuar rritjen e investimeve të sektorit privat dhe një situatë në përmirësim të likuiditetit të tij. Së dyti, kredia në monedhën vendase vijon të ruajë norma më të larta rritjeje, duke u reflektuar në rritjen progresive të peshës së kredisë në lekë ndaj totalit. Ky zhvillim inkurajues krijon premisa për një përcjellje më të mirë të stimulit monetar dhe një rezistencë më të lartë të sistemit bankar ndaj rreziqeve të stabilitetit financiar. Së treti, treguesi i kredisë me probleme ra në nivelin 7.8% në muajin maj, duke sugjeruar një cilësi të kënaqshme të këtij portofoli.

Grafik 14. Kredia në Lek dhe kredia në valutë me dhe pa efektin e kursit të këmbimit, ndryshim vjetor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke gjykuar mbi trendet e faktuara të zhvillimeve ekonomike dhe monetare, si dhe mbi faktorët përcaktues të tyre, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se ekonomia shqiptare do të shënojë norma të shpejta dhe të qëndrueshme rritjeje ekonomike në horizontin afatmesëm. Rritja ekonomike do të mbështetet nga përmirësimi i ambientit të huaj, nga reduktimi i pasigurisë, nga një miks stimulues politikash monetare dhe fiskale, si dhe nga përmirësimi i bilanceve të sektorit privat. Këta faktorë pritet të nxitin rritjen e konsumit, të eksporteve dhe të investimeve, si dhe të rritin gradualisht të ardhurat në të gjithë sektorët e ekonomisë. Zgjerimi

i kërkesës do të ndihmojë rritjen e punësimit, duke u përkthyer më tej në rritje të pagave dhe në një kthim gradual të inflacionit drejt objektivit, brenda vitit 2022.

Në çdo rast, këto projeksione bazohen në supozimin e shmangies së kufizimeve serioze mbi aktivitetin ekonomik, si pasojë e goditjeve të mëtejshme të pandemisë. Megjithatë, ecuria e pandemisë dhe ndikimi i saj në ekonomi kanë qenë dhe vijojnë të mbeten burim pasigurie në parashikimet ekonomike.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se rreziqet e kahut të poshtëm shfaqen disi më të zbehta në këtë raund analize, dhe balanca e përgjithshme e rreziqeve paraqitet më neutrale. Në veçanti, rreziqet e kahut të poshtëm burojnë nga një përkeqësim i situatës epidemiologjike dhe i efektit negativ të saj në ekonomi, si dhe një rimëkëmbje më e ngadaltë e konsumit dhe investimeve, si pasojë e një sjelljeje më të kujdesshme të familjeve dhe të biznesit shqiptar. Në të kundërt, rreziqe të kahut të sipërm vijnë nga një politikë e brendshme fiskale më ekspansioniste se parashikimet aktuale, si dhe nga një rritje më e shpejtë se pritjet për inflacionin në vendet partnere.

Në konsistencë me këto parashikime, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm.

Rrjedhimisht, vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, përkatësisht në 0.1% dhe 0.9%.

Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës gjykon se politika monetare do të vijojë të mbetet akomoduese gjatë gjithë horizontit kohor afatmesëm, në funksion të rikuperimit të qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik dhe të kthimit të inflacionit në objektiv.

“ ... Këshilli Mbikëqyrës gjykon se politika monetare do të vijojë të mbetet akomoduese gjatë gjithë horizontit kohor afatmesëm, në funksion të rikuperimit të qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik dhe të kthimit të inflacionit në objektiv.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -4 gusht 2021-

Faktorët mbështetës të rritjes ekonomike janë forcuar gjatë tremujorëve të fundit.

Perspektiva e zhvillimeve ekonomike ka ardhur drejt përmirësimit.

Rreziqet e kahut të poshtëm, ndonëse të pranishme, kanë ardhur drejt zbehjes.

Inflacioni vijon të mbetet nën objektiv dhe pasojat e pandemisë në ekonomi vijojnë të jenë prezente.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 4 gusht 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare. Informacioni i ri i marrë në analizë sugjeron se ritmi i rikuperimit ekonomik po vjen në përshpejtim.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se faktorët mbështetës të rritjes ekonomike janë forcuar gjatë tremujorëve të fundit. Po ashtu, perspektiva e zhvillimeve ekonomike ka ardhur drejt përmirësimit dhe rreziqet e kahut të poshtëm – ndonëse të pranishme – kanë ardhur drejt zbehjes. Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës vëren se inflacioni vijon të mbetet nën objektiv, se pasojat e pandemisë në ekonomi vijojnë të jenë prezente dhe se rritja ekonomike vijon të kërkojë mbështetje nga një miks stimulues politikash monetare e fiskale.

Në këtë kontekst, Këshilli gjykon se politika monetare duhet të vijojë të mbetet në kahun lehtësues përgjatë gjithë horizontit afatmesëm. Stimuli monetar do të ndihmojë në ruajtjen e likuiditetit të bollshëm dhe kostove të ulëta të financimit, duke nxitur zgjerimin e konsumit dhe të investimeve të sektorit privat. Në këtë mënyrë, ky stimul do t'i shërbejë forcimit të qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike, rritjes së punësimit dhe të pagave, si dhe kthimit të qëndrueshëm të inflacionit në objektiv.

Sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm.

Në vijim, më lejoni të sqaroj më në detaje konkluzionet kryesore të Raportit Tremujor, pritjet tona për të ardhmen, si dhe arsyet që motivuan vendimin e sotëm të politikës monetare.

Informacioni i ri i përfutur gjatë tremujorit të fundit ka qenë në kahun e sipërm të pritjeve tona.

Inflacioni mesatar i tremujorit të dytë u rrit në vlerën 1.8%, duke korrektuar rënien e regjistruar në tremujorin e parë. Kjo rritje pasqyroi kryesisht një inflacion më të lartë të karburanteve dhe të artikujve ushqimorë, e sidomos të atyre të papërpunuar, ndërkohë që inflacioni i artikujve të tjerë të shportës ishte i qëndrueshëm. Në veçanti, inflacioni bazë – i cili përfaqëson më mirë balancën e faktorëve që ndikojnë ecurinë e çmimeve të artikujve të konsumit në afatin e mesëm – ishte i qëndrueshëm.


Në tërësi, ecuria e inflacionit gjatë tremujorëve të fundit ka qenë subjekt i luhatjeve të shpeshta e të papritura të faktorëve të ofertës, të cilat kanë shfaqur dhe pritjet të kenë një ndikim kalimtar. Nga ana tjetër, faktorët me ndikim afatmesëm në inflacion: rritja e pagave dhe e kostove të prodhimit, ecuria e çmimeve në vendet partnere dhe pritjet për inflacionin, shfaqen të qëndrueshme, por janë ende të pamjaftueshme për kthimin e inflacionit në objektiv.

Përditësimi i analizës dhe parashikimeve tona sugjeron se këta faktorë do të fuqizohen gjatë tremujorëve në vijim, duke mbështetur kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 5.5% gjatë tremujorit të parë, duke tejkaluar pritjet tona. Kjo rritje pasqyroi zgjerimin e njëkohshëm të konsumit dhe investimeve të sektorit privat e publik, si dhe rritjen e eksporteve të mallrave. Njëkohësisht, ajo përfitoi nga një efekt bazë më i lartë – si pasojë e rishikimit për poshtë nga INSTAT-i të rritjes ekonomike të vitit 2020 – si dhe nga faktorë tranzitorë, si rritja e shpejtë e prodhimit të energjisë elektrike. Informacioni i disponuar sugjeron një përshpejtim të fortë të aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë, ndonëse me një normë e cila nuk do të jetë indikative për ritmin e rritjes së mëtejshme të ekonomisë shqiptare.


Grafik 15.

Aktivitetet prodhuese dhe të shërbimeve mbështetën rritjen ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2021.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Treguesi i ndjesisë ekonomike u përmirësua ndjeshëm.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht këtij përmirësimi, tregu i punës ka shfaqur një ecuri të plogësht në tremujorin e parë. Niveli i punësimit vijon të mbetet poshtë atij të regjistruar përpara pandemisë, norma e papunësisë u rrit në 11.9%, ndërsa presionet e tregut për rritjen e pagave janë ende të zbehta. Bazuar në ecurinë historike, Banka e Shqipërisë gjykon se rritja e qëndrueshme e punësimit dhe e pagave do të ndjekë me vonesë kohore zgjerimin e kërkesës për mallra e shërbime.

Në planin makroekonomik, përshpejtimi i rritjes ekonomike ka pasqyruar reduktimin e kufizimeve, si pasojë e përmirësimit të situatës epidemiologjike dhe zgjerimit të vaksinimit, rritjen e besimit të biznesit dhe konsumatorit, përmirësimin e ambientit të huaj, si dhe politikat stimuluese fiskale dhe monetare.

Politika fiskale ka vijuar të ruajë një karakter ekspansionist gjatë gjysmës së parë të vitit. Deficiti buxhetor i kësaj periudhe qëndroi rreth nivelit 3.4% të PBB-së, duke gjeneruar një impuls pozitiv fiskal. Kjo ecuri pasqyroi rritjen më të shpejtë të shpenzimeve në raport me të ardhurat, ndonëse këto të fundit regjistruan një rritje vjetore prej rreth 37% në tremujorin e dytë.


Banka e Shqipërisë e ka konsideruar të domosdoshme natyrën stimuluese të politikës fiskale gjatë pikut të pandemisë. Nga ana tjetër, me përfundimin e emergjencës shëndetësore dhe ekonomike, ne presim një rikthim të vëmendjes së qeverisë drejt konsolidimit të financave publike.

Projeksionet tona për të ardhmen faktorizojnë një reduktim progresiv të stimulit fiskal gjatë gjysmës së dytë të vitit dhe periudhës në vijim.

Nga ana e saj, politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë ka vijuar të gjenerojë një ambient financiar të qetë, të karakterizuar nga: qarkullimi normal i fondeve në tregje; kosto të ulëta kreditimi; dhe kurs i qëndrueshëm këmbimi.

Kredia për sektorin privat shënoi një rritje mesatare prej 7.7% gjatë tremujorit të dytë, duke vijuar të pasqyrojë një rritje relativisht të shpejtë e të qëndrueshme të kredisë në Lek, të kredisë për qëllime investimi dhe të asaj për blerje banese. Rritja e raportuar e kërkesës për kredi në tremujorin e tretë dhe lehtësimi i kushteve të kreditimit premtojnë një mbështetje të vazhduar me fonde të nevojave për konsum dhe investime. Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm kanë luajtur dhe bilancet në përmirësim të bizneseve shqiptare, të cilat janë pasqyruar në rënien në nivelin 7.1% të raportit të kredive me probleme në muajin qershor.

Grafik 16. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përditësimi i parashikimeve në këtë raport tremujor sugjeron një ecuri pozitive të ekonomisë në horizontin afatmesëm, duke riparë për lart projektionin e ritmit të rritjes ekonomike gjatë vitit aktual. Rritja ekonomike do të mbështetet nga zgjerimi i konsumit dhe investimeve private, si dhe nga rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Kjo ecuri do të pasqyrojë përmirësimin e besimit të biznesit dhe konsumatorit, normalizimin gradual të aktivitetit ekonomik në vendet partnere, si dhe ambientin e favorshëm

financiar në vend. Më tej, rritja e kërkesës agregate do të ndihmojë rritjen e punësimit dhe të pagave, duke krijuar premisa për kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Këto parashikime janë ndërtuar mbi supozimin e: shmangies së kufizimeve të forta mbi aktivitetin ekonomik si pasojë e pandemisë; si dhe të reduktimit të ngadaltë, por progresiv, të stimulit fiskal në horizontin afatmesëm.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerësoi se stimuli monetar ka pasur një transmetim efektiv në tregjet financiare. Gjithashtu, ai vlerësoi se ky stimul duhet të vijojë të jetë i pranishëm në ekonomi edhe gjatë afatit të mesëm, duke synuar mbështetjen e ekonomisë me kredi të bollshme e me kosto të ulët, si dhe duke kompensuar reduktimin e pritur të stimulit fiskal.

Për këtë arsye, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe të kredive njëditore, respektivisht në nivelin 0.1% dhe 0.9%.

Këshilli Mbikëqyrës gjykon se rikuperimi ekonomik dhe kthimi i inflacionit në objektiv kërkojnë ruajtjen e kahut stimules të politikës monetare përgjatë horizontit të parashikimit.

Megjithatë, materializimi i skenarit bazë do të kërkojë dhe një normalizim gradual të politikës monetare, drejt niveleve më të qëndrueshme të normave të interesit. Në çdo rast, ky normalizim do të jetë transparent dhe i kujdesshëm, duke mos cenuar qëndrueshmërinë e rimëkëmbjes ekonomike dhe duke mos dëmtuar premiset e kthimit të inflacionit në objektiv.

Nga ana tjetër, Këshilli Mbikëqyrës konstatoi se rreziqet e kahut të poshtëm janë reduktuar, ndonëse situata epidemiologjike vazhdon të mbetet burim goditjesh potenciale dhe ndikimi afatgjatë i pandemisë në ekonomi - ndonëse për momentin duket minimal - mbetet ende për t'u vlerësuar.

Së fundi, Këshilli Mbikëqyrës thekson se normalizimi gradual i situatës ekonomike dhe forcimi i qëndrueshmërisë së rimëkëmbjes duhet të risjellin në fokus të vendimarrësve nevojën e përsheptimit të agjendës së reformave

struktorore. Këto reforma duhet të synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, përmirësimin e mëtejshëm të klimës së investimeve dhe të biznesit, si dhe forcimin afatgjatë të qëndrueshmërisë së financave publike.

“Këshilli Mbikëqyrës gjykon se rikuperimi ekonomik dhe kthimi i inflacionit në objektiv kërkojnë ruajtjen e kahut stimulus të politikës monetare përgjatë horizontit të parashikimit.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -6 tetor 2021-

Rritja e inflacionit pasqyroi goditjet që vijnë nga ambienti i huaj, si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Presionet inflacioniste të gjeneruara nga ekonomia e brendshme paraqiten në rritje, por ende të përmbajtura.

Politikat fiskale dhe monetare kanë siguruar mbështetjen e duhur për rimëkëmbjen ekonomike.

Stimuli fiskal mbetet në territor pozitiv, por intensiteti i tij ka ardhur në zbehje gjatë muajve të fundit.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në datën 6 tetor 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë tregon një rikuperim të shpejtë të aktivitetit ekonomik në vend, por dhe presione për rritje të inflacionit në Shqipëri dhe në botë. Nga njëra anë, reduktimi i kufizimeve, përmirësimi i besimit të familjeve e bizneseve dhe efektet pozitive të stimulit ekonomik, kanë sjellë rritje me bazë të gjerë të kërkesës për mallra e shërbime. Nga ana tjetër, disbalancat e përkohshme të kërkesës dhe ofertës në tregjet ndërkombëtare kanë sjellë goditje shtesë mbi inflacionin, përtej atyre të diktuar në mënyrë të natyrshme nga rimëkëmbja ekonomike.

Përditësimi i parashikimeve tona konfirmon projeksionet për një rritje të mëtejshme të ekonomisë shqiptare në afatin e mesëm, çka do të krijojë premisa për kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv gjatë vitit 2022.

Megjithatë, materializimi i këtyre projeksioneve mbetet i kushtëzuar nga ecuria e pandemisë, nga qëndrueshmëria e rimëkëmbjes së ekonomisë botërore, si dhe nga ndikimi i goditjeve aktuale të ofertës. Rritja e çmimeve në tregjet botërore do të ketë ndikimin e saj në ecurinë e inflacionit, në vend dhe në botë. Ky ndikim pritet të jetë kalimtar, por ai përbën një faktor rreziku për nivelin e inflacionit dhe – potencialisht – për shpejtësinë e rimëkëmbjes ekonomike.

Duke gjykuar mbi zhvillimet e pritura ekonomike dhe monetare, si dhe balancën e rreziqeve rreth tyre, Këshilli Mbikëqyrës e vlerësoi të nevojshme ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare. Stimuli monetar ka vijuar e do të vijojë t'i shërbejë kthimit të qëndrueshëm të inflacionit në objektiv, si dhe mbështetjes së rritjes ekonomike.

Në vijim do t'ju njoh më në detaje me arsyet e vendimmarrjes.

Informacioni i ri i muajve të fundit ka konfirmuar trendet e pritura nga Banka e Shqipërisë, ndonëse rritja ekonomike rezultoi më e shpejtë dhe niveli i inflacionit rezultoi disi më i lartë se to.


Inflacioni shënoi vlerat 2.2% dhe 2.4% në muajt korrik e gusht, duke ardhur në rritje kundrejt gjashtëmuorit të parë të vitit. Rritja e inflacionit pasqyroi, më së shumti, rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës, ndërkohë që inflacioni i artikujve të tjerë të shportës nuk pësoi ndryshime të ndjeshme.

Në këndvështrimin makroekonomik, rritja e inflacionit pasqyroi goditjet që vijnë nga ambienti i huaj, si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e lëndëve të para, të ushqimeve dhe të produkteve energjetike, kanë njohur një rritje të shpejtë gjatë muajve të fundit. Kjo rritje ka pasqyruar si rimëkëmbjen e kërkesës botërore, ashtu edhe vështirësitë që ka pasur rikthimi i ofertës në nivelet e parakrizës. Projeksionet aktuale flasin për një normalizim të situatës gjatë vitit të ardhshëm, duke sugjeruar se ndikimi i saj në çmimet finale të konsumit do të jetë i ndjeshëm, por kalimtar. Megjithatë, ecuria e çmimeve të produkteve energjetike dhe të lëndëve bazë vijon të mbetet në vëmendjen e bankave qendrore në të gjithë botën.

Nga ana tjetër, presionet inflacioniste të gjeneruara nga ekonomia e brendshme paraqiten në rritje, por ende të përmbajtura. Kjo ecuri diktohet nga një rritje e punësimit dhe e pagave, e cila është ende e pamjaftueshme për kthimin e inflacionit në objektiv.


Grafik 17.

Indekset kryesore kanë vijuar tendencën rritëse



Burimi: Banka Botërore.

Çmimi i naftës në vend ka reaguar në masë më të vogël se çmimet në tregjet botërore




Shënime: Ndryshim vjetor i treguesve. Çmimi i naftës në vend përfshihet me ndryshimin e indeksit të çmimit të naftës në shtoriën e IÇK. Burimi: INSTAT, llogaritje të stafit.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, rritja ekonomike shënoi nivelin 17.9% në tremujorin e dytë të vitit. Kjo ecuri sugjeron se ekonomia shqiptare ka rikuperuar thuajse tërësisht humbjet në aktivitetin ekonomik të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia.


Grafik 18.

Rritja ekonomike është përshpejtuar ndjeshëm me mbështetje si nga “prodhimi” ashtu edhe nga “shërbimet”



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Pothuajse të gjithë sektorët e aktivitetit ekonomik kanë kapur nivelet e periudhës para goditjes nga tërmeti dhe pandemia



Shënim: Vlera e situar e sektorëve të ekonomisë, e rregulluar sezonalisht, dhe e kthyer në indeks me bazë tremujorin e tretë 2019. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza e të dhënave të disponuara tregon se rritja e tremujorit të dytë pasqyron jo vetëm efektin e fortë bazë të rënies së fortë ekonomike gjatë tremujorit të dytë të vitit të shkuar, por edhe gjerësinë dhe forcën

e faktorëve që kanë ushqyer rritjen në gjysmën e parë të vitit. Po ashtu, analiza e të dhënave indirekte sugjeron për norma të shpejta rritjeje edhe gjatë tremujorit të tretë.

Rritja e aktivitetit ekonomik shfaqet me bazë të gjerë. Në terma të kërkesës agregate, ajo pasqyroj zgjerimin e konsumit dhe të investimeve private, rritjen e shpenzimeve buxhetore, si dhe zgjerimin e eksportit të mallrave e shërbimeve. Në terma sektorialë, ajo pasqyroj zgjerimin e njëkohshëm të aktivitetit ndërtues, të aktivitetit industrial dhe të atij të shërbimeve.

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik ka filluar të pasqyrohet në tregun e punës, ndonëse rikuperimi i tij mbetet i pjesshëm. Punësimi u rrit me 1.1% gjatë tremujorit të dytë, ndërsa shkalla e papunësisë zbriti në nivelin 11.6%. Pavarësisht tendencave përmirësuese, punësimi vijon të jetë më i ulët dhe shkalla e papunësisë më e lartë se nivelet e parapandemisë. Kthimi i ekonomisë në punësim të plotë duket se kërkon më shumë kohë dhe mbështetje të vazhduar me stimuj makroekonomikë.

Politikat fiskale dhe monetare kanë siguruar mbështetjen e duhur për rimëkëmbjen ekonomike.

Stimuli fiskal mbetet në territor pozitiv, por intensiteti i tij ka ardhur në zbehje gjatë muajve të fundit. Kjo ecuri është kushtëzuar nga ngadalësimi i ritmit të kryerjes së shpenzimeve publike kundrejt normave të larta të mbledhjes së të ardhurave. Për vitet në vijim, Banka e Shqipërisë pret një kthim në kahun konsolidues të orientimit të politikës fiskale. Kjo do t'i shërbente si rritjes së hapësirave të reagimit ndaj goditjeve potenciale në të ardhme, ashtu dhe sekuencimit të duhur të normalizimit të politikave.


Stimuli monetar ka siguruar një mjedis financiar të favorshëm për rritjen e ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv. Tregjet financiare funksionojnë normalisht, kostot e financimit të sektorit publik dhe privat janë të ulëta, dhe bilancet e sektorit bankar paraqiten të shëndetshme. Po ashtu, kursi i këmbimit të Lekut ka shfaqur një mbiçmim të lehtë gjatë muajve të verës, në përputhje me sjelljen e vet sezonale. Banka e Shqipërisë vlerëson se kushtet e financimit mbeten të përshtatshme për nxitjen e kërkesës agregate, dhe pasqyrojnë një transmetim të mirë të stimulit tonë monetar.

Kredia bankare ka vijuar të jetë një burim i qëndrueshëm financimi

për ekonominë, duke pasqyruar kushtet e favorshme të financimit, rritjen e kërkesës dhe përfaqshen pozitive të bankave ndaj kreditimit. Vëllimi i kredisë për sektorin privat u rrit mesatarisht me 8.4% në muajt korrik e gusht. Rritja e kredisë ka financuar zgjerimin e investimeve të bizneseve dhe të familjeve shqiptare, si dhe mbulimin e nevojave të tyre me likuiditet. Për më tepër, kreditimi vijon të ruajë dy tipare pozitive. Së pari, kredia në Lek vijon të shfaqë ritme të larta rritjeje, duke ilustruar një përcjellje të mirë të stimullit monetar dhe duke rritur rezistencën e sistemit bankar ndaj rreziqeve. Së dyti, treguesi i kredisë me probleme ra poshtë nivelit 7.0% në muajin gusht, duke sugjeruar një cilësi të kënaqshme të këtij portofoli.


Grafik 19.

Rritja e kredisë për sektorin privat është zgjeruar, e ndikuar nga kreditimi më i lartë në valutë



Shënime: Të dhënat përfaqësojnë kontributet vjetore të kredisë sipas monedhave në kredinë për sektorin privat.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përmirësimi i ritmeve të kredisë në tremujorin e tretë është mbështetur nga kreditimi i bizneseve



Shënime: Të dhënat përfaqësojnë kontributet vjetore të kredisë sipas agjentëve në kredinë për sektorin privat.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Perspektiva ekonomike mbetet përgjithësisht pozitive. Ekonomia shqiptare pritet të shënojë një rritje të shpejtë gjatë vitit aktual dhe të zgjerohet me ritme të qëndrueshme gjatë viteve në vijim. Kjo ecuri pritet të mbështetet nga ambienti i favorshëm i huaj, nga reduktimi i pasigurisë në vend, nga një miks stimulues politikash monetare dhe fiskale, si dhe nga përmirësimi i bilanceve të sektorit privat. Këta faktorë pritet të nxitin rritjen e konsumit, të eksporteve dhe të investimeve. Zgjerimi i kërkesës do të ndihmojë rritjen e punësimit dhe të pagave dhe në një kthim gradual të inflacionit drejt objektivit, brenda vitit 2022.

Rreziqet rreth këtij parashikimi janë të balancuara, ndonëse ecuria e ekonomisë mbetet subjekt i goditjeve të mundshme negative nga ecuria e pandemisë, ndërsa ecuria e inflacionit rrezikohet në kahun rritës nga ecuria e çmimeve në tregjet botërore.

Rreziqe potenciale të kahut të poshtëm janë: (i) rivendosja e kufizimeve, si pasojë e përkeqësimit të situatës epidemiologjike; (ii) rimëkëmbja më e ngadaltë e investimeve dhe konsumit, si pasojë e një përqsasjeje më të kujdesshme të bizneseve dhe familjeve; si dhe, (iii) një shtrëngim më i shpejtë i kushteve monetare në Eurozonë, si pasojë e rritjes së fundit të inflacionit.

Rreziqe potenciale të kahut të sipërm janë: (i) një rritje më e shpejtë e aktivitetit ekonomik, si pasojë e një konsolidimi më të zbutur fiskal; dhe (ii) një rritje më e shpejtë apo më e qëndrueshme në kohë e çmimeve në tregjet botërore. Në veçanti, skenari i fundit po merr një vëmendje në rritje gjatë javëve të fundit, në ilustrim të rritjeve të forta të çmimeve të naftës, të gazit dhe të energjisë në tregjet botërore, si dhe ndikimit që ato mund të kenë në shtrëngimin e politikave monetare.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm.

Rrjedhimisht, ai vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe kredive njëditore, respektivisht në nivelet 0.1% dhe 0.9%.

Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi të nevojshme ruajtjen e formës aktuale, me çmim fiks dhe sasi të pakufizuar, të ankandeve të injektimit të likuiditetit në sektorin bankar edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2021.

Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se materializimi i pritjeve të skenarit bazë – i cili parashikon adoptimin e një kahu konsolidues të politikës fiskale, vijimin e rimëkëmbjes ekonomike dhe ndikime kalimtare në inflacion nga goditjet e ofertës – do të kërkonte fillimin e normalizimit gradual të politikës monetare gjatë tremujorëve në vijim. Ky normalizim do t'i shërbente respektimit të objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve dhe qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike në afatin e mesëm dhe të gjatë.

Nga ana tjetër, Këshilli Mbikëqyrës mbetet në monitorim të pasojave që do të ketë rritja e çmimeve në tregjet botërore. Në rast se kjo rritje provohet të jetë më e fortë apo më e qëndrueshme në kohë, si dhe në rast se ndikimi i saj në inflacionin vendas është më i lartë se pritjet aktuale, Këshilli Mbikëqyrës mbetet i gatshëm të rishikojë qëndrimin e politikës monetare, duke u kujdesur që ajo të jetë gjithnjë në përputhje me objektivin tonë të inflacionit.

“Këshilli Mbikëqyrës mbetet i gatshëm të rishikojë qëndrimin e politikës monetare, duke u kujdesur që ajo të jetë gjithnjë në përputhje me objektivin tonë të inflacionit.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -3 nëntor 2021-

Ekonomia shqiptare po vijon të rimëkëmbet nga goditjet e marra nga tërmeti dhe pandemia.

Inflacioni shënoi rritje, si në ambientin e huaj dhe në atë të brendshëm, si pasojë e goditjeve të përkohshme të ofertës.

Parashikimet për të ardhmen mbeten pozitive.

Të nderuar përfaqësues të medias,


Sot, në datën 3 nëntor 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë tregon se ekonomia shqiptare po vijon të rimëkëmbet nga goditjet e marra nga tërmeti dhe pandemia. Kjo ecuri vihet re në rritjen e vëllimit të aktivitetit ekonomik, në zgjerimin e punësimit dhe rritjen e pagave, në përmirësimin e bilanceve financiare të sektorit privat, si dhe në rritjen e qëndrueshme të kredisë bankare.

Po ashtu, informacioni i ri tregon rritje të inflacionit, si në ambientin e huaj dhe në atë të brendshëm. Rritja e inflacionit u diktua kryesisht nga goditjet e ardhura si pasojë e disbalancave midis kërkesës dhe ofertës në tregjet ndërkombëtare. Këto disbalanca priten të jenë të përkohshme dhe efekti i tyre në inflacion pritet të jetë kalimtar. Nga ana tjetër, ndonëse në rritje, presionet e brendshme për rritjen e punësimit, të pagave dhe të inflacionit, janë ende të moderuara.


Grafik 20.

Presionet bazë dhe të brendshme u forcuan lehtësisht, por me qëndrueshmëri të kontributeve përkatëse



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të BSH-së.

Presionet afatshkurtra dhe të importuara kontribuan në përshpejtimin e inflacionit total në tremujorin e tretë.



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të BSH-së.

Parashikimet për të ardhmen mbeten pozitive. Projektionet tona sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet në horizontin afatmesëm, e mbështetur dhe nga stimuli monetar, duke krijuar premisa për kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv gjatë vitit të ardhshëm.

Sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i prishtatshëm.

[Në vijim, më lejoni të sqaroj më në detaje konkluzionet kryesore të Raportit Tremujor, pritjet tona për të ardhmen, si dhe arsytet që motivuan vendimin e sotëm.]

Informacioni i ri i marrë në analizë ka qenë në kahun e sipërm të pritjeve tona.

Inflacioni erdhi në rritje gjatë tremujorit të tretë, duke shënuar nivelin mesatar prej 2.4%. Kjo ecuri pasqyroi – në masën më të madhe – goditjet e ofertës të ardhura nga rritja e çmimeve të ushqimeve, të energjisë, të naftës dhe të kostove të transportit, në tregjet botërore.

Efkti i goditjeve të ofertës në inflacion pritet të jetë i pranishëm dhe gjatë tremujorit aktual dhe gjysmës së parë të vitit të ardhshëm, e të vijë në shuarje gjatë periudhës në vazhdim. Ky gjykim bazohet në konsensusin e analizave të institucioneve ndërkombëtare dhe pritjet

e tregjeve. Sipas këtij konsensusi, çmimet e naftës, të energjisë dhe të produkteve ushqimore, pritet fillimisht të stabilizohen e më pas të reduktohen gjatë vitit 2022, çka do të zvogëlojë presionin mbi kostot e prodhimit në vend dhe çmimet e konsumit.

Përkundrejt tyre, presionet e brendshme inflacioniste kanë shfaqur një dinamikë rritëse, por graduale dhe ende të përmbajtur. Kjo dinamikë pasqyron zgjerimin ende të pamjaftueshëm të punësimit, të pagave dhe të kostove të prodhimit, si dhe pritjet për inflacion të moderuar nga bizneset dhe tregjet financiare.

Aktiviteti ekonomik në vend po vijon të rimëkëmbet. Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 17.9% në tremujorin e dytë të vitit. Informacioni indirekt i disponuar sinjalizon një zgjerim të mëtejshëm të saj gjatë tremujorit të tretë.


Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik është mbështetur nga reduktimi i masave kufizuese, rritja e besimit, përmirësimi i ambientit të huaj, si dhe politikat stimuluese ekonomike.

Kjo rimëkëmbje ka pasur një bazë të gjerë. Në terma të kërkesës agregate, ajo pasqyroi rritjen e konsumit dhe të investimeve private, zgjerimin e eksporteve të mallrave e të shërbimeve, si dhe kontributin pozitiv – ndonëse në rënie – të stimullit fiskal. Në terma sektorialë, ajo pasqyroi rritjen e thuajse të gjithë sektorëve e degëve të prodhimit e të shërbimit, me përjashtim të atij bujqësor.

Zgjerimi i kërkesës për mallra e shërbime ka mundësuar rikthimin e aktivitetit ekonomik në nivelet e shënuara para tërmetit dhe pandemisë. Ky rikuperim, prezent si në nivel ekonomie ashtu dhe në nivel sektorial, sugjeron se potenciali prodhues i vendit ka mbetur relativisht i paprekur nga goditjet dhe se pasojat afatmesme dhe afatgjata të tyre në ekonomi do të jenë relativisht të ulëta.

Megjithatë, rimëkëmbja ekonomike ka pasur – deri më tani – një pasqyrim të pjesshëm në tregun e punës. Ndonëse norma e papunësisë zbriti në nivelin 11.6% në tremujorin e dytë, ajo mbetet ende larg niveleve të regjistruara përpara pandemisë. Rikuperimi më i ngadaltë i punësimit dhe pagave është një fenomen i njohur në procesin e rimëkëmbjes. Gjithsesi, ai dikton presione të përmbajtura për rritjen e inflacionit dhe kërkon vijimin e kursit akomodues të politikës monetare.

Grafik 21. Tregu i punës pasqyroj një rritje të lehtë të normës së papunësisë në tremujorin e parë 2021



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e Bankës së Shqipërisë.

Politika monetare stimuluese ka vijuar të transmetohet në kosto të ulëta financimi dhe kushte të përshtatshme kreditimi. Tregjet financiare shfaqen të qeta dhe karakterizohen nga vëllime normale tregtimi, nga prime të kontrolluara rreziku dhe nga norma të ulëta interesi. Po ashtu, kursi i këmbimit të lekut shfaqet i qëndrueshëm, duke regjistruar luhajtje të përbajtura, në linjë me ecurinë e faktorëve sezonalë.

Ky ambient financiar ka mundësuar një rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme të kredisë për sektorin privat. Portofoli i kredisë bankare u rrit me 8.9% në fund të tremujorit të tretë, i diktuar nga zgjerimi i kredisë në lekë, i kredisë për qëllime investimi dhe i asaj për blerje banese. Ecuria pozitive e kreditimit ka pasqyruar si zgjerimin e kërkesës ashtu dhe përmirësimin e ofertës. Kjo e fundit është ndikuar nga bilancet e shëndetshme të sektorit bankar, ku spikat reduktimi në nivelin 6.5% i raportit të kredisë me probleme në muajin shtator, si dhe nga qasja proaktive ndaj kreditimit e adoptuar nga sektori bankar.

Politika fiskale ka vijuar të ruajë natyrën e saj ekspansioniste gjatë vitit 2021, ndonëse intensiteti i stimulit fiskal ka ardhur në zbehje gjatë muajve të fundit. Deficiti buxhetor u reduktua në 2.7% të PBB-së gjatë tremujorit të tretë, duke pasqyruar një rritje më të shpejtë të të ardhurave në raport me shpenzimet, por ai pritet të vijë në zgjerim gjatë tremujorit të katërt.

Stimuli fiskal pritet të vijë drejt reduktimit gjatë viteve në vijim. Banka e Shqipërisë gjykon se forcimi i qëndrueshmërisë së rimëkëmbjes e bën të nevojshme një rritje të vëmendjes ndaj konsolidimit fiskal. Ky konsolidim rrit hapësirën për përballimin e goditjeve potenciale në të ardhmen, redukon primet e rrezikut në tregjet financiare dhe fuqizojnë stabilitetin makroekonomik të vendit.

Projeksionet tona të skenarit bazë mbeten pozitive. Sipas këtij skenari, ekonomia parashikohet të shënojë një rritje të shpejtë gjatë vitit 2021 dhe të vijojë të rritet me ritme më të ngadalta, por të qëndrueshme, në vitet në vijim. Kjo rritje do të pasqyrojë përmirësimin e besimit dhe të bilanceve financiare të sektorit privat, rritjen e kërkesës së huaj, si dhe ambientin e përshtatshëm financiar. Zgjerimi i kërkesës për mallra e shërbime do të sjellë rritjen e punësimit, të pagave dhe të marzheve të fitimit, në linjë me objektivin tonë të inflacionit.

Në këtë skenar, efekti i goditjeve të ofertës pritet të jetë kalimtar dhe inflacioni pritet të kthehet në objektivin tonë prej 3% gjatë vitit 2022. Po ashtu, sipas këtij skenari, miksi i politikave ekonomike do të mbetet i balancuar: ritmi i konsolidimit fiskal pritet të vijë drejt përshtetimit gjatë viteve të ardhshme, ndërsa stimuli monetar do të vijojë të mbetet i pranishëm, ndonëse intensiteti i tij do të vijë gradualisht drejt reduktimit.

Balanca e rreziqeve shfaqet e zhvendosur për lart në afatin e shkurtër dhe e balancuar në afatin e mesëm. Nga njëra anë, një rritje më e shpejtë apo më e gjatë në kohë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe një ritëm më i ngadaltë i konsolidimit fiskal, përbëjnë rreziqe të kahut të sipërm mbi inflacionin. Nga ana tjetër, një rimëkëmbje më e ngadaltë e ekonomisë botërore përbën rrezik të kahut të poshtëm mbi inflacionin.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm për mbështetjen e ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Për këtë arsye, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe të kredive njëditore, respektivisht në nivelet 0.1% dhe 0.9%.

Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se materializimi i skenarit bazë – ai i

konsolidimit të mëtejshëm të rimëkëmbjes dhe forcimit të presioneve të brendshme inflacioniste – do të kërkojë normalizimin gradual të politikës monetare gjatë tremujorëve në vijim. Po ashtu, përmirësimi i gjendjes së likuiditetit në sektorin bankar do të mundësojë adoptimin e formës tradicionale të ankandëve të injektimit të likuiditetit në sektorin bankar, duke filluar nga tremujori i parë i vitit të ardhshëm. Reduktimi gradual i stimullit monetar do të garantojë respektimin e objektivit tonë të inflacionit dhe do të krijojë premisa për një rritje më të qëndrueshme ekonomike në afatin e mesëm e të gjatë.

Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se materializimi i skenarëve të rrezikut do të kërkojë një rishikim të qëndrimit të politikës monetare, duke e afruar në kohë dhe përshpejtuar procesin e normalizimit të politikës monetare, apo duke e shtyrë në kohë dhe ngadalësuar atë.

Në çdo rast, Këshilli Mbikëqyrës vëren se ky qëndrim do të jetë tërësisht në linjë me respektimin e objektivit tonë të inflacionit në afatin e mesëm.

“Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se materializimi i skenarëve të rrezikut do të kërkojë një rishikim të qëndrimit të politikës monetare, duke e afruar në kohë dhe përshpejtuar procesin e normalizimit të politikës monetare, apo duke e shtyrë në kohë dhe ngadalësuar atë.”

BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -16 dhjetor 2021-

Trendi rritës i inflacionit gjatë vitit 2021 është diktuar nga rritja e kërkesës, e punësimit dhe e pagave.

Aktiviteti ekonomik është rritur me ritme të shpejta gjatë vitit 2021, dhe burimet e rritjes kanë pasur një bazë të gjerë.

Politika monetare stimuluese ka ulur kostot e financimit, ka nxitur rritjen e kredisë dhe ka ndihmuar në lehtësimin e gjendjes financiare të huamarrësve.


Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, në mbledhjen e datës 22 dhjetor 2021, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.

Analiza e informacionit të disponuar tregon vijimin e rikuperimit të aktivitetit ekonomik në vend, përmirësimin e treguesve të tregut të punës, por dhe një rritje të shpejtë të inflacionit gjatë dy muajve të fundit. Rritja e çmimeve të naftës, të energjisë dhe të ushqimeve në tregun botëror, ka filluar të pasqyrohet – në mënyrë direkte dhe indirekte – në çmimet e artikujve të konsumit në vend. Këto goditje janë krijuar nga një zhbalecim i përkohshëm i kërkesës dhe ofertës. Në këto rrethana, efekti i tyre do të jetë i pranishëm dhe gjatë gjysmës së parë të vitit në vazhdim, por – më tej – ai do të vijë drejt reduktimit.

Në skenarin bazë, konvergimi i ekonomisë në ekuilibër dhe reduktimi i efektit të goditjeve të ofertës do të mundësojnë kthimin e inflacionit në objektiv, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022.

Grafik 22. Pozicioni ciklik i ekonomisë vijoi të përmirësohet në tremujorin e tretë, duke u reflektuar në norma rritëse të inflacionit të brendshëm (bazë) edhe gjatë tremujorit të katërt



Shënime: Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve, mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve është llogaritur si devijim i vlerës aktuale nga mesatarja historike, dhe më pas është zbatuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i shkallës së papunësisë vlerësohet si mesatare e hendeqeve të papunësisë sipas 3 metodave, të cilat vlerësojnë normën ekuilibër të papunësisë. Ai shprehet si diferencë e shkallës ekuilibër të papunësisë me atë faktike dhe më pas zbatohet metoda e mesatares lëvizëse. Në grafik janë paraqitur rezultatet e rivlerësimit të përgjithshëm më të fundit të realizuar në dhjetor 2021 për hendekun e prodhimit dhe të papunësisë. Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.


Bazuar në sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm.

Në vijim, më lejoni të sqaroj më në detaje konkluzionet e Raportit.

Informacioni i ri i marrë në analizë ka qenë në përgjithësi në përputhje me pritjet tona.

Inflacioni në vend shënoi një rritje të shpejtë, duke kapur vlerën 3.1% në muajin nëntor. Trendi rritës i inflacionit gjatë vitit 2021 është diktuar nga rritja e kërkesës, e punësimit dhe e pagave. Megjithatë, rritja e inflacionit gjatë tremujorit të katërt pasqyron kryesisht efektin e rritjes së ndjeshme të çmimeve të ushqimeve, të naftës dhe të energjisë në tregjet botërore. Kjo goditje pritet ta mbajë inflacionin mbi objektivin tonë gjatë muajve në vijim. Më tej, ne presim riekulibrimin e raportit kërkesë-ofertë në tregjet botërore, zgjidhjen e problemeve logjistike dhe stabilizimin e çmimit të energjisë. Kjo ecuri do të lehtësojë presionet inflacioniste dhe do të reduktojë efektin e çmimeve të huaja në inflacionin në vend.

Grafik 23.



Burimi: INSTAT, BSH.

Aktiviteti ekonomik është rritur me ritme të shpejta gjatë vitit 2021, dhe burimet e rritjes kanë pasur një bazë të gjerë. Prodhimi i brendshëm bruto u zgjerua me 11.7% në gjashtëmuorin e parë, i nxitur nga rritja e konsumit dhe e investimeve, private e publike, si dhe nga rritja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve. Ndonëse informacioni i ri mbetet i pjesshëm dhe i tërthortë, ai sugjeron rritje të mëtejshme të ekonomisë në gjashtëmuorin e dytë. Megjithatë, ndërsa efekti i fortë i bazës krahasuese me vitin 2020 do të vijë drejt reduktimit, normat e rritjes ekonomike priten të jenë më të ulëta dhe të luhaten rreth nivelit potencial.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është shoqëruar me përmirësimin e tregut të punës. Gjatë tremujorit të tretë, punësimi u rrit me 0.7%, shkalla e papunësisë zbriti në 11.3%, ndërsa paga mesatare shënoi një rritje vjetore prej 6.9%. Përmirësimi i treguesve të tregut të punës dhe rritja e kërkesës për punë e raportuar nga bizneset sugjerojnë se presionet për rritjen e pagave do të vijojnë të forcohen në të ardhmen.

Rritja ekonomike është mbështetur nga rritja e besimit në ekonomi, nga përmirësimi i ambientit të huaj, si dhe nga politikat e brendshme stimuluese ekonomike. Kjo gamë e gjerë faktorësh premtan një qëndrueshmëri të rritjes ekonomike në të ardhmen.

Politika monetare stimuluese ka ulur kostot e financimit, ka nxitur rritjen e kredisë dhe ka ndihmuar në lehtësimin e gjendjes financiare të huamarrësve. Në këtë mënyrë, ajo ka mbështetur zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe ka krijuar parakushtet për kthimin e inflacionit në objektiv.

Normat e interesit të kredisë për bizneset dhe individët kanë mbetur në nivele të ulëta, në reflektim të gjendjes së mirë të likuiditetit, primeve të përmbajtura të rrezikut dhe përqaqjes mbështetëse të bankave për klientët e tyre. Po ashtu, kursi i këmbimit është karakterizuar nga luhatje të dykahshme gjatë dy muajve të fundit.

Kredia bankare ka regjistruar norma të larta rritjeje, duke mbështetur gjithmonë e më shumë rritjen e konsumit dhe të investimeve. Vëllimi i kredisë për sektorin privat regjistroi një rritje vjetore me 11% në muajin nëntor. Rritja e kredisë vërehet si tek bizneset dhe individët, si për qëllime investimi ashtu edhe për mbulimin e nevojave afatshkurtra, si në lekë edhe në valutë. Rritja e kërkesës për kredi, e raportuar tek vrojtimi i aktivitetit kreditues, lehtësimi i kushteve të kreditimit, dhe shëndeti i mirë i industrisë bankare sugjeron për një ecuri të mirë të kredisë në vazhdim. Në veçanti, rënia në nivelin 0.2% e raportit të kredive me probleme në muajin nëntor, ilustron si rritjen e aftësisë paguese të bizneseve dhe familjeve ashtu dhe shëndetin e përmirësuar të balanceve të sektorit bankar.

Rritja e shpejtë e të ardhurave dhe zbutja e ritmit të rritjes së shpenzimeve primare, kanë sjellë një ngadalësim të impulsit fiskal gjatë muajve të fundit. Megjithatë, niveli i lartë i akumuluar i shpenzimeve dhe i deficitit buxhetor në muajin dhjetor, nënkupton një rritje të mundshme të stimulit fiskal në ekonomi.

Banka e Shqipërisë gjykon se konsolidimi i politikës fiskale në të ardhmen është jo vetëm i arsyeshëm, në kushtet e forcimit të qëndrueshmërisë së rimëkëmbjes, po edhe i nevojshëm, për të rritur hapësirën për përballimin e goditjeve potenciale në të ardhmen dhe fuqizimin e stabilitetit makroekonomik të vendit.

Politika fiskale stimuluese ka mbështetur rritjen e ekonomisë, ndonëse në një masë më të ulët nga një vit më parë. Rritja e shpejtë e të ardhurave dhe zbutja e ritmeve të rritjes së shpenzimeve primare, kanë sjellë një ngadalësim të impulsit fiskal gjatë muajve të fundit. Megjithatë, niveli i lartë i akumuluar i shpenzimeve dhe i deficitit buxhetor në muajin dhjetor, nënkupton një rritje të mundshme të stimulit fiskal në ekonomi.

Projeksionet tona për të ardhmen mbeten pozitive. Në afatin e mesëm, rritja e ekonomisë pritet të mbështetet nga kushtet e favorshme të financimit, përmirësimi i besimit dhe i bilanceve të sektorit privat, dhe nga normalizimi gradual i aktivitetit ekonomik në vendet partnere. Këta faktorë pritet të nxitin rritjen e konsumit, të investimeve dhe të eksporteve. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik do të shoqërohet me rritjen më dinamike të punësimit, pagave dhe të kostove të tjera të prodhimit, duke forcuar presionet e brendshme inflacioniste. I mbështetur prej tyre, inflacioni parashikohet të kthehet në mënyrë të qëndrueshme tek objektivi 3% në fund të vitit 2022, dhe të qëndrojë pranë tij në afatin e mesëm. Nga ana tjetër, goditjet e huaja të ofertës do të diktojnë vlera të inflacionit mbi objektiv në afatin e shkurtër, por efekti i tyre pritet të jetë gjithsesi kalimtar.

Balanca e rreziqeve rreth inflacionit shfaqet e zhvendosur për lart në afatin e shkurtër dhe e balancuar në afatin e mesëm. Nga njëra anë, një rritje më e shpejtë apo më e gjatë në kohë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe një ritëm më i ngadaltë i konsolidimit fiskal, përbëjnë rreziqe të kahut të sipërm mbi inflacionin. Nga ana tjetër, një rimëkëmbje më e ngadaltë e ekonomisë botërore dhe shqiptare, si pasojë e zgjatjes në kohë të pandemisë apo e shtrëngimit të shpejtë të kushteve monetare në tregjet ndërkombëtare, përbën rrezik të kahut të poshtëm mbi inflacionin.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Stimuli monetar ndihmon rritjen e kërkesës për mallra dhe shërbime, kompenson reduktimin e pritur të stimullit fiskal, dhe krijon premisa për rritjen e punësimit, të pagave dhe të inflacionit në linjë me objektivin tonë.

Për këtë arsye, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe të kredive njëditore, respektivisht në nivelin 0.1% dhe 0.9%.

Në të njëjtën kohë, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se përbushja e objektivit të inflacionit në afatin e mesëm do të kërkojë normalizimin gradual të politikës monetare gjatë periudhës në vijim. Ky normalizim pritet të fillojë gjatë tremujorëve në vijim. Reduktimi i stimullit monetar garanton respektimin e objektivit tonë të inflacionit dhe krijon premisa për një rritje më të qëndrueshme ekonomike në afatin e mesëm e të gjatë.

Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës vëren se balanca e rreziqeve rreth inflacionit vazhdon të qëndrojë në kahun e sipërm, e diktuar nga kohëzgjatja dhe intensiteti i goditjes së ofertës në tregjet botërore. Sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës thekson se do të monitorojë me kujdes ecurinë e inflacionit dhe të faktorëve përcaktues të tij, për të siguruar – në çdo rrethanë – përshtatshmërinë e qëndrimit të politikës monetare me arritjen e objektivit të inflacionit.

“Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se përbushja e objektivit të inflacionit në afatin e mesëm do të kërkojë normalizimin gradual të politikës monetare gjatë periudhës në vijim.”

Të nderuar përfaqësues të medias,

Në mbyllje të këtij komunikimi, duke përfutur dhe nga fakti se ky takim është i fundit për këtë vit, më lejoni të ndaj me ju një pasqyrë të shkurtër të punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit që po lemë pas.

Dy vitet e fundit kanë qenë të paprecedenta dhe sfiduese për ekonominë dhe Bankën e Shqipërisë. Megjithatë, me kënaqësi konstatoj se institucioni diti të ngrihet në lartësinë e sfidave dhe përbushi me sukses detyrat e tij ligjore.

Siç e përmenda edhe në pjesën e parë të fjalës sime, **politika monetare** stimuluese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në procesin e rikuperimit të ekonomisë, pas goditjes së pandemisë.

“Thelbi i aktivitetit tonë mbikëqyrës ka qenë rishikimi i kuadrit rregullator, për të minimizuar pasojat e krijuara nga pandemia, por dhe vijimi i punës për konvergjencën e rregulloreve dhe praktikave tona të punës me standardet më të mira ndërkombëtare.”

Megjithatë, kjo politikë është shoqëruar me një vendimmarrje intensive të Bankës së Shqipërisë në drejtim të mbikëqyrjes, licencimit dhe rregullimit të veprimtarisë bankare. Thelbi i aktivitetit tonë mbikëqyrës ka qenë rishikimi i kuadrit rregullator, për të minimizuar pasojat e krijuara nga pandemia, por dhe vijimi i punës për konvergjencën e rregulloreve dhe praktikave tona të punës me standardet më të mira ndërkombëtare.

Në kontekstin e pandemisë, Banka e Shqipërisë:

- miratoi pezullimin deri në fund të muajit dhjetor 2021, të shpërndarjes së fitimit të vitit 2020 dhe të fitimit që do të realizohet gjatë vitit 2021 në industrinë bankare;
- zbatoi disa ndryshime të përkohshme rregullatore, të cilat shtynë pagesat e kësteve apo lehtësuan procesin e ristrukturimit të kredive, për ato biznese dhe individë të vënë në vështirësi financiare nga pandemia.

Paralelisht me to, gjatë vitit të fundit, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për zbatimin e detyrave të saj në kuadrin e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të sektorit bankar. Gjej me vend të theksoj progresin e mëtejshëm që shënuam në fushën e konsolidimit të industrisë bankare me: përthithjen e propozuar të Bankës Alfa nga Banka OTP; vazhdimin e bashkëpunimit me autoritetet homologe, në kuadër të kolegeve mbikëqyrëse dhe luftës ndaj pastrimit të parave; si dhe vijimin e punës për hartimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator mbikëqyrës, duke synuar përafrimin e tij të vazhdueshëm me acquis të BE-së dhe standardet e Komitetit të Bazelit.

Dy vitet e fundit kanë shënuar zhvillime edhe në fushën e **ndërrhyrjes së jashtëzakonshme** në banka, duke plotësuar kuadrin rregullator dhe metodologjik të ndërrhyrjes së jashtëzakonshme me akte të tjera nënligjore dhe dokumente metodologjike, në harmoni me kuadrin rregullator evropian, si dhe duke përgatitur të plota planet e ndërrhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat e sektorit bankar.

Në fushën e **sistemeve të pagesave** vëmendje e veçantë i është kushtuar përbushjes së objektivit strategjik për nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë dhe përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Ndërrhyrjet ligjore e rregullatore, zhvillimet infrastrukturore të ndërmarra nga viti 2018 deri tani, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, si dhe operacionalizimi i sistemit të shlyerjes së pagesave në Euro brenda vendit, kanë rezultuar të suksesshëm, ndërkohë që impakti i tyre pritet të bëhet dhe më i prekshëm në vitet në vijim.

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për **administrimin e rezervës valutore, në përputhje me objektivat bazë të investimit të saj**: likuiditetit dhe sigurisë. Në këtë drejtim, gjej me vend të theksoj se gjatë vitit 2021 u finalizua nënshkrimi i marrëveshjes së re me Bankën Qendrore Evropiane, e përfaqësuar nga Banka e Francës, për aprovimin e një linje krediti të kolateralizuar për shumën 400 milionë euro.

“Me gjithë vështirësitë e krijuara, përgjatë gjithë periudhës, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të kontribuojë me përgjegjshmëri në procesin e integritit evropian të vendit, në të gjitha dimensionet e tij.”

Me gjithë vështirësitë e krijuara, përgjatë gjithë periudhës, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të kontribuojë me përgjegjshmëri në procesin e integritit evropian të vendit, në të gjitha dimensionet e tij. Më konkretisht, është mundësuar një shkallë e lartë plotësimi angazhimesh që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Integritit të Vendit, si dhe një pjesëmarrje aktive në të gjitha takimet me nënkomitetet përkatëse të BE-së.

Komunikimi me publikun ka qenë një prioritet konstant i Bankës së Shqipërisë. Në qendër të punës sonë ka qenë edhe mbetet zbatimi i një politike komunikimi të përgjegjshme dhe transparente, në mënyrë që të sigurohet që detyrat dhe aktivitetet e institucionit të kuptohen në mënyrë të drejtë nga publiku i gjerë. Për këtë arsye, Banka Kombëtare e Austrisë, në raportin e saj me titull “Fokus mbi Integritimin Ekonomik Evropian” për tremujorin e dytë 2021, ku ka analizuar transparencën dhe komunikimin e bankave qendrore të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore me publikun, e ka renditur Bankën e Shqipërisë në vendin e parë.

Emetimi i kartëmonedhës, siguria fizike e saj dhe miradministrimi i parasë fizike, përbën një drejtim tjetër të rëndësishëm të veprimtarisë sonë. Banka e Shqipërisë përballoi me sukses situatën e emergjencës të krijuar për shkak të pandemisë. Në muajin qershor 2021, u nënshkrua me BQE-në një marrëveshje për mbrojtjen e kartëmonedhës Euro nga falsifikimi, duke e bërë kështu Bankën e Shqipërisë pjesë integrale të procesit evropian në luftën kundër falsifikimit të kartëmonedhave.

Po ashtu, ne kemi vijuar punën për plotësimin e serisë së re të kartëmonedhave. Në muajin qershor të vitit 2021 u hodhën në qarkullim edhe 2 prerje të tjera, ato 1,000 dhe 10,000 Lekë. Shtimi i kësaj të fundit, pra i kartëmonedhës me prerjen më të madhe në vlerën 10,000 Lekë, përbën edhe një risi në procesin e prodhimit të parasë sonë. Njëkohësisht, vlen të theksohet se në vitin 2021, kemi prodhuar edhe 2 kartëmonedhat e fundit të serisë, ato me prerje 500 dhe 2000 Lekë, të cilat pritet të hidhen në qarkullim në ditët në vijim, duke realizuar përfundimisht kompletimin e serisë sonë të re të kartëmonedhave, të përbërë nga 6 prerje.



Duke filluar nga data 17 janar 2022, kartëmonedhat e reja do të jenë në duart e publikut dhe do të qarkullojnë paralelisht me kartëmonedhat e serisë aktuale. Ato janë dizajnuar dhe prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës dhe janë të pajisura me elemente bashkëkohore dhe të sofistikuara sigurie.

Përmbushja e objektivave dhe rezultatet e Bankës së Shqipërisë nuk do të ishin të mundura pa vizionin, liderhipin dhe përkushtimin e **Këshillit Mbikëqyrës**. Ky Këshill ka garantuar mbarëvajtjen e punës së institucionit, si dhe ka orientuar e udhëhequr hartimin e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.

Në punën e tij, Këshilli është asistuar dhe nga **Auditimi i Brendshëm**. Ky funksion i rëndësishëm u certifikua në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, si dhe përmbushi angazhimet e planifikuara të auditimit.

Në përfundim, përfitoj nga rasti të theksoj se Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë një mbikëqyrëse e kujdesshme e realitetit ekonomik dhe financiar të vendit. Shumë sfida mbeten ende para nesh, por ajo që konstatoj me kënaqësi është se institucioni ynë është i aftë të përballet me to.

Duke shpresuar se viti 2022 do të sjellë përfundimin e pandemisë dhe kthimin në normalitet të jetës sociale dhe ekonomike, më lejoni të theksoj se Banka e Shqipërisë do të jetë plotësisht e angazhuar për marrjen e masave adekuate në përmbushjen e misionit të saj ligjor!

“Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë një mbikëqyrëse e kujdesshme e realitetit ekonomik dhe financiar të vendit. Shumë sfida mbeten ende para nesh, por ajo që konstatoj me kënaqësi është se institucioni ynë është i aftë të përballet me to.”



KAPITULLI III

KONFERENCA PËR SHTYP ME SHEFIN E MISIONIT TË FMN-SË DHE MINISTRIN E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- *Fjala e Governorit Sejko në konferencën e përbashkët për shtyp online me Shefin e Misionit të FMN-së dhe Ministren e Financave dhe Ekonomisë, 12 tetor 2021*

Konferencat për shtyp me Shefin e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave

Në kuadër të konsultimeve për Artikullin IV të neneve të marrëveshjes me FMN, misionet e Fondit vizitojnë Shqipërinë dhe kryejnë takime me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të vendit për të diskutuar mbi ecurinë makroekonomike dhe zhvillimet më të fundit të Shqipërisë. Në përfundim të çdo vizite të misionit, organizohet një konferencë e përbashkët për shtyp e Governorit të Bankës së Shqipërisë, Shefes së Misionit të FMN-së dhe Ministres së Financave dhe Ekonomisë.

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË KONFERENCËN E PËRBASHKËT PËR SHTYP ONLINE ME SHEFEN E MISIONIT TË FMN-SË DHE MINISTREN E FINANCEVE DHE EKONOMISË

-12 tetor 2021-

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sikundër jeni në dijeni, gjatë dy javëve të fundit, Banka e Shqipërisë dhe autoritetet shqiptare kanë qenë të angazhuara në diskutime intensive me misionin e FMN-së, të kryera në kuadër të Artikullit IV. Këto diskutime kanë pasur në fokus të tyre si sfidat aktuale me të cilat përballlet ekonomia shqiptare në rrugën e saj drejt rimëkëmbjes, ashtu edhe reformat strukturore, të cilat do të mundësonin një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm të vendit në planin afatgjatë.

Me kënaqësi konstatoj se Banka e Shqipërisë dhe Misioni ndajnë pikëpamje të ngjashme mbi zhvillimet aktuale ekonomike dhe financiare, mbi kahun e pritur të këtyre zhvillimeve në të ardhmen, si dhe mbi qëndrimin që duhet të mbajnë politikat fiskale, monetare dhe makroprudenciale, ndaj sfidave që kemi përpara.

Në vijim, më lejoni t'ju prezantoj shkurtimisht vizionin e Bankës së Shqipërisë mbi temat që preka më sipër.

“Banka e Shqipërisë dhe Misioni ndajnë pikëpamje të ngjashme mbi zhvillimet aktuale ekonomike dhe financiare, mbi kahun e pritur të këtyre zhvillimeve në të ardhmen, si dhe mbi qëndrimin që duhet të mbajnë politikat fiskale, monetare dhe makroprudenciale, ndaj sfidave që kemi përpara.”


Të dhënat e disponuara, të përfutuara gjatë nëntë muajve të parë të vitit, sugjerojnë se ekonomia shqiptare është në një fazë rimëkëmbjeje. Kjo rimëkëmbje ka rezultuar më e shpejtë se projeksionet tona dhe është mbështetur nga një gamë e gjerë faktorësh. Reduktimi i kufizimeve si pasojë e procesit të vaksinimit, përmirësimi i besimit të biznesit dhe të familjeve shqiptare, rritja e kërkesës së huaj, si dhe stimuli monetar dhe fiskal, kanë mbështetur rikuperimin e shpejtë të konsumit, të investimeve dhe të eksporteve.

Në këtë ecuri, një rol esencial pati stimuli i koordinuar fiskal dhe monetar, si dhe lehtësimi i përkohshëm dhe i targetuar i rregulloreve të funksionimit të sektorit bankar. Këto masa reduktuan barrën financiare të goditjes mbi bizneset dhe familjet shqiptare. Në këtë mënyrë, ato i dhanë frymëmarrje bizneseve në luftën e tyre për mbijetesë, frenuan rritjen e ndjeshme të papunësisë, si dhe krijuan premisa për një rimëkëmbje të shpejtë e të qëndrueshme të ekonomisë me përfundimin e pandemisë.

Në të njëjtën linjë, reformat strukturore që kemi ndërmarrë gjatë viteve të fundit për rritjen e qëndrueshmërisë dhe të eficiencës së sistemit financiar, dhanë frytet e tyre. Ndër të tjera, këto reforma synuan dhe arritën një përdorim më të madh të monedhës kombëtare në transaksionet financiare, reduktimin e kredive me probleme, konsolidimin e sektorit bankar, si dhe përmirësimin e mëtejshëm të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sistemit financiar në përgjithësi, dhe të sektorit bankar në veçanti. Implementimi në kohë i tyre, i mundësoi sektorit bankar të përballojë një pjesë të konsiderueshme të faturës financiare të krizës, si dhe të vazhdojë të ushqejë me kredi me kosto të ulët ekonominë shqiptare.

Grafik 24.


Konsumi privat përshpejtoi rritjen në tremujorin e dytë, në pasqyrim të rënies së pasigurisë së konsumatorëve



Shënime: Treguesi i pasigurisë konsumatore është matje nga vajtimi i besimit konsumator dhe shprehet në balancë neto në pikë përqindje.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Konsumi u drejtua nga rritja e shpenzimeve konsumatore për mallra të përdorimit afatgjatë



Shënime: Të gjithë treguesit janë shprehur në ndryshime vjetore.


Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Zgjerimi i kërkesës ka ndihmuar rikuperimin e prodhimit vendas, duke e sjellë atë pranë niveleve të parakrisës. Megjithatë, ky rikuperim nuk është ende i plotë në tregun e punës, ku niveli i punësimit është poshtë vlerave të regjistruara përpara pandemisë dhe ku rritja e pagave është ende e pamjaftueshme për të kthyer inflacionin në objektiv.

Për këtë arsye, inflacioni vijon të mbetet nën objektiv, me gjithë volatilitetin e shfaqur gjatë vitit të fundit. Së fundmi, ecuria e tij është bërë subjekt i goditjeve të ofertes, të cilat kanë ardhur nga rritja e çmimit të ushqimeve, të produkteve energjetike dhe të lëndëve të tjera të para në tregun botëror. Sipas informacionit që vjen nga tregjet dhe analizave tona, efekti i këtyre goditjeve pritet të jetë kalimtar, por ai përbën një element shtesë pasigurie.

Duke parë nga e ardhmja, projeksionet tona për ecurinë e ekonomisë shqiptare mbeten pozitive. Në mungesë të goditjeve, aktiviteti ekonomik në vend pritet të vijojë të rritet gjatë viteve në vijim. Ndonëse ritmi i rritjes ekonomike pritet të vijë në ngadalësim, ai do të jenë i qëndrueshëm dhe i mjaftueshëm për të gjeneruar një shfrytëzim më të mirë të kapaciteteve prodhuese, rritje të punësimit e të pagave, si dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2022.

Grafik 25. Pozicioni ciklik i ekonomisë vijoi të përmirësohet në tremujorin e tretë 2021



Shënim: Pozicioni ciklik vlerësohet nga treguesit e hendekëve të prodhimit, të papunësisë, të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese.
Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Ky skenar zhvillimesh rrethohet nga rreziqe të kahut të poshtëm në afatin e shkurtër. Në veçanti, përkeqësimi i mundshëm i situatës epidemiologjike apo rritja e çmimeve në tregjet botërore mund të sjellin efekte negative në ecurinë e ekonomisë botërore dhe të asaj shqiptare. Nga ana tjetër, balanca e rreziqeve shfaqet më simetrike në afatin e mesëm dhe të gjatë.

Banka e Shqipërisë gjykon se materializimi i zhvillimeve të skenarit bazë do të kërkojë një normalizim gradual të stimullit ekonomik. Ky normalizim do të mundësojë një balancë më të mirë midis rritjes ekonomike dhe stabilitetit monetar e financiar të vendit, si dhe do të rikrijojë hapësirat e nevojshme për përballimin e goditjeve të tjera potenciale në të ardhmen.

Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë vlerëson se procesi i normalizimit duhet të jetë i kujdesshëm, i kushtëzuar nga shpejtësia e rimëkëmbjes dhe qëndrueshmëria e burimeve të rritjes ekonomike, si dhe i koordinuar midis politikave dhe instrumenteve të përdorura.

“Banka e Shqipërisë mbështet një reduktim progresiv – por të qartë dhe të qëndrueshëm – të stimullit fiskal. Zhvendosja e fokusit të politikës fiskale drejt konsolidimit dhe reduktimit të borxhit publik, do të ndihmojë në reduktimin e primeve të rrezikut në tregjet financiare.”

Banka e Shqipërisë mbështet një reduktim progresiv – por të qartë dhe të qëndrueshëm – të stimullit fiskal. Zhvendosja e fokusit të politikës fiskale drejt konsolidimit dhe reduktimit të borxhit publik, do të ndihmojë në reduktimin e primeve të rrezikut në tregjet financiare. Gjithashtu, konsolidimi fiskal do të rrisë hapësirat për përballimin e goditjeve në të ardhmen.

Nga ana tjetër, vlerësimet tona sugjerojnë se politika monetare duhet të vijojë të mbetet akomoduese. Stimuli monetar do të vijojë të ofrojë mbështetjen e nevojshme për rikuperimin e ekonomik dhe do të lehtësojë procesin e konsolidimit fiskal. Goditjet aktuale të ofertës nuk priten të rrezikojnë stabilitetin e çmimeve në afatin e mesëm dhe, si të tilla, nuk kërkojnë ndërhyrje të politikës monetare. Megjithatë, Banka e Shqipërisë do të mbetet e vëmendshme për të vlerësuar ndikimin, kohëzgjatjen dhe transmetimin e këtyre goditjeve në ekonominë tonë. Kjo do të na ndihmojë të përshtatim në vazhdimësi qëndrimin e politikës sonë monetare me respektimin e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve.

“Vëmendja jonë në të ardhmen do të jetë te monitorimi i kujdesshëm i pasojave të pandemisë në bilancet e sektorit bankar, identifikimi në avancë i problemeve potenciale dhe marrja në kohë e masave korrektuese.”

Nga ana tjetër, vlerësimet tona sugjerojnë se politika monetare duhet të vijojë të mbetet akomoduese. Stimuli monetar do të vijojë të ofrojë mbështetjen e nevojshme për rikuperimin e ekonomik dhe do të lehtësojë procesin e konsolidimit fiskal. Goditjet aktuale të ofertës nuk priten të rrezikojnë stabilitetin e çmimeve në afatin e mesëm dhe, si të tilla, nuk kërkojnë ndërhyrje të politikës monetare. Megjithatë, Banka e Shqipërisë do të mbetet e vëmendshme për të vlerësuar ndikimin, kohëzgjatjen dhe transmetimin e këtyre goditjeve në ekonominë tonë. Kjo do të na ndihmojë të përshtatim në vazhdimësi qëndrimin e politikës sonë monetare me respektimin e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve.

Së fundi, gjej me vend të theksoj se Banka e Shqipërisë ka normalizuar tërësisht masat e përkohshme lehtësuese makroprudenciale. Vëmendja jonë në të ardhmen do të jetë te monitorimi i kujdesshëm i pasojave të pandemisë në bilancet

e sektorit bankar, identifikimi në avancë i problemeve potenciale dhe marrja në kohë e masave korrektuese.

Po ashtu, Banka e Shqipërisë do të vijojë të punojë për përafrimin e kuadrit të saj mbikëqyrës e rregullator me standardet e Bashkimit Evropian, si dhe – në bashkëpunim me aktorët e tjerë institucionalë – për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar dhe për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave.

Në mbyllje, dëshiroj të falënderoj Misionin e FMN-së për bisedimet e frytshme, të zhvilluara në një frymë konstruktive dhe transparente, si dhe t'i uroj Ministres së re të Financave dhe Ekonomisë suksese në punën e saj.

Ju faleminderit!



**KARTEMONEDHA
JONË e RE** e SIGURT &
MODERNE
Seria e Re e Kartëmonedhave Shqiptare
Banka e Shqipërisë, 15 qershor 2017

**KARTEMONEDHA
JONË e RE** e SIGURT &
MODERNE
Seria e Re e Kartëmonedhave Shqiptare
Banka e Shqipërisë, 15 qershor 2017

KAPITULLI IV

FJALIME DHE PREZANTIME NË KONFERENCA

- *Fjala e Governorit Sejko në Ceremoninë e Përfundimit të Projektit të Binjakëzimit "Forcimi i kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë në kuadër të përafimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, 18 janar 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në Konferencën Shkencore "Pandemia dhe rimëkëmbja - strategjitë e përbaljes dhe pritshmëritë", 9 shkurt 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në ceremoninë e hapjes së Javës së Parasë, 23 mars 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në konferencën "Normalja e re, sfidat dhe oportunitetet" të Universitetit Evropian të Tiranës, 30 prill 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në prezantimin e dy kartëmonedhave 1000 Lekë dhe 10000 Lekë të serisë së re të kartëmonedhave, 15 qershor 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në ceremoninë e promovimit të librit: "Përballë Krizës, sfidat e teorisë dhe politikave ekonomike", nga autorët Akad. Prof. Dr. Anastas Angjeli dhe Prof. Dr. Adrian Civici, 22 korrik 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në hapjen e fushatës ndërgjegjësuese "As i vjetër e as i ri, jam thjesht Lek!", 17 nëntor 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në çeljen e punimeve të Workshop-it XV të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, 6 dhjetor 2021*
- *Fjala e Governorit Sejko në takimin përmbyllës të vitit, të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, 16 dhjetor 2021*
- *Fjala e Governorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në takimin e fundvitit me gazetarë, analistë dhe drejtues të medias dhe ceremoninë e shpalljes së fituesve të Çmimit të Governorit për Diplomën më të mirë 2021, 20 dhjetor 2021*

Konferenca dhe seminare

Banka e Shqipërisë organizon një sërë aktivitetesh publike, konferenca, seminare apo tryeza diskutimi për të trajtuar çështje të rëndësishme të bankingut qendror dhe të ekonomisë me rëndësi të veçantë për Bankën e Shqipërisë. Përveç këtyre, Governori i Bankës së Shqipërisë merr pjesë dhe në shumë aktivitete të tjera të organizuara nga institucionet kryesore në vend, institucionet ndërkombëtare financiare dhe bankat qendrore. Gjatë këtyre pjesëmarrjeve, Governori prezanton vlerësime dhe analiza të detajuara të Bankës së Shqipërisë si dhe opinionin e tij për zhvillimet ekonomiko-financiare dhe rolin e Bankës së Shqipërisë në këto zhvillime, eksperiencën e saj me politikën monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit, si dhe sfidat e Bankës së Shqipërisë në çështje të ndryshme.

**FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË
CEREMONINË E PËRFUNDIMIT TË
PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT “FORCIMI
I KAPACITETEVE TË BANKËS SË
SHQIPËRISË NË KUADËR TË PËRAFRIMIT
ME LEGJISLACIONIN E BASHKIMIT
EVROPIAN
-18 janar 2021-**

Të nderuar zotërinj Ambasadorë Soreca, Bucci dhe Zingraf,

I nderuar z. Franco,

Të nderuar përfaqësues të Bankës së Italisë dhe Bankës së Gjermanisë,

Zonja dhe zotërinj, miq dhe kolegë,

Kam kënaqësinë t’ju uroj mirëseardhjen në ceremoninë e përfundimit të Projektit të Binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë në kuadër të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian”.

Projekti u prezantua në dhjetor të vitit 2019, dhe u financua nga fondet e Bashkimit Evropian, në vazhdimësi të projektit të mëparshëm “Identifikimi i nevojave për përafrimin e Bankës së Shqipërisë” - konceptuar dhe udhëhequr nga Banka Qendrore Evropiane, në partneritet me 11 banka qendrore të Bashkimit Evropian.

Në pjesën e parë të vitit 2020, të gjithë ne, u përballëm me shpërthimin dhe përhapjen e shpejtë globale të pandemisë COVID-19. Brenda një kohe të shkurtër, bota ndryshoi rrënjësisht shumë aspekte të normalitetit, të cilat kurrë më parë nuk ishin imagjinuar. Për shkak të situatës së jashtëzakonshme të krijuar, projekti u ndërpre përkohësisht. Megjithatë, duke parë se pandemia do të zgjaste, ashtu si e gjithë bota, ne u përshatëm me mënyrën e re, atë të punuarit në distancë. Ky realitet i ri shpejt rezultoi po aq efektiv sa mënyra “tradicionale e të punuarit”. Kështu, ja dolëm të përfundonim projektin me sukses dhe në kohë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Programi i Binjakëzimit përfshiu 8 departamente të Bankës së Shqipërisë, të cilët adresuan çështje të rëndësishme, në fushën e:

- mbikëqyrjes bankare dhe stabilitetit financiar;
- politikës monetare dhe statistikave;
- kontrollit të brendshëm;
- sistemeve të pagesave; si dhe
- funksioneve të tjera të bankingut qendror, si burimet njerëzore dhe integrimi evropian.

Secili prej komponentëve u pasqyrua në një numër rezultatesh të matshme, në formën e dokumenteve rregullatorë, manualeve dhe rekomandimeve specifike të natyrës politikëbërëse. Prandaj, me kënaqësi vë në dukje se:

- u miratuan akte nënligjorë për zbatimin e standardeve të Basel III dhe Direktivës për Kërkesat e Kapitalit;
- u hartuan dokumente dhe udhëzues të rinj për politikën me qëllim përafrimin me rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik;
- u publikua dokumenti i përmirësuar i Politikës Monetare;
- u hartuan akte nënligjorë dhe manuale të rinj me qëllim përafrimin e statistikave monetare të Bankës së Shqipërisë dhe të llogarive financiare me kërkesat e Bankës Qendrore Evropiane;
- u zhvilluan akte nënligjorë, manuale, dokumente të politikës dhe plane trajnimi për harmonizimin e veprimtarisë së auditimit me standardet e BQE-së dhe ato të SEBQ-së;
- u hartua akti i ri nënligjor me qëllim zbatimin e Direktivës për llogaritë e pagesave;
- u hartuan manuale të rinj për përafrimin me standardet e BQE-së, si dhe kuadri i mbikëqyrjes së sistemit të pagesave të Bankës së Shqipërisë;
- u zhvillua një analizë e hendekut të ndjekur nga një hartë gjurmimi për sistemin Target 2 të BQE-së (ECB Target 2 sytem);
- u hartuan udhëzime të reja për përafrimin me standardet e BQE-së në lidhje me proceset e rekrutimit, rekrutimin e aplikantëve nga jashtë dhe kushtet e punësimit të stafit;
- u strukturua një hartë gjurmimi për të përcaktuar rolin dhe sfidat e Zyrës së Integritimit Evropian.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të bëj disa falënderime për të gjithë institucionet dhe ekspertët e përfshirë në këtë angazhim dhe projekt të përbashkët. Së pari, dëshiroj të falënderoj Komisionin Evropian, mbështetja e të cilit mundësoi financimin e këtij projekti. Jam i bindur se Komisioni do të vijojë të na mbështesë edhe në nisma të tjera të që do të ndërmarrim në të ardhmen, me qëllim përfarimin dhe progresin në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Falënderoj në mënyrë të veçantë, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë për asistencën e tyre të vyer gjatë periudhës përgatitore të projektit. Shpresoj dhe uroj që Këshilli i BE-së do të miratojë së shpejti kuadrin për hapjen e negociatave me Shqipërinë, duke shënuar kështu një fazë të re në procesin e integritimit të Shqipërisë në BE.

Dëshiroj të falënderoj Bankën e Italisë, për angazhimin e saj afatgjatë në mbështetjen e institucionit tonë. Puna e shkëlqyer e kryer nga ekspertët italianë meriton lavdërime të veçanta, veçanërisht në rrethanat aktuale të jashtëzakonshme të pandemisë. Kështu, përfitoj nga rasti të falënderoj personalisht Drejtuesin e Projektit, z. Zeloni dhe Këshilltarin Rezident të Binjakëzimit, z. Gola, për angazhimin dhe mbështetjen e tyre në realizimin e këtij projekti.

Sigurisht, i jemi mirënjohës Bankës së Gjermanisë, për pjesëmarrjen e saj aktive në këtë projekt dhe për rolin e saj drejtues në projektin rajonal për "Fuqizimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore të Ballkanit Perëndimor në përafrimin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore". Gjithashtu, falënderoj Bankën Kombëtare të Rumanisë dhe Bankën e Francës për përfshirjen e tyre specifike në këtë projekt. Ne besojmë se bashkëpunimi me këto dy banka do të forcohet më tej në të ardhmen.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, dëshiroj të shpreh vlerësimin tim për stafin e Bankës së Shqipërisë, i cili kapërceu vështirësitë e shkaktuar nga pandemia COVID-19, dhe ja doli të përfundojë me sukses këtë projekt në të gjithë objektivat e tij të përcaktuar.

Dëshiroj të mbyll fjalën time duke siguruar se Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar në rrugën e saj për konvergjim dhe shpejtë me modelin

“Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar në rrugën e saj për konvergjim dhe shpejtë me modelin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Ne jemi besimplotë se ky është kontributi më i mirë që mund të japim për vendin tonë në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian - një objektiv strategjik që e kemi përfshirë në planin tonë të punës për vitin 2021 dhe më tej.”

e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Ne jemi besimplotë se ky është kontributi më i mirë që mund të japim për vendin tonë në procesin e integritit në Bashkimin Evropian - një objektiv strategjik që e kemi përfshirë në planet tona të punës për vitin 2021 dhe më tej. Jam i sigurt se bashkëpunimi ynë do të vazhdojë në të ardhmen dhe mbështetja e udhëheqja evropiane do të na shoqërojë në çdo hap që hedhim drejt integritit në familjen e përbashkët evropiane.
Faleminderit!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË KONFERENCËN SHKENCORE “PANDEMIA DHE RIMËKËMBJA - STRATEGJITË E PËRBALLJES DHE PRITSHMËRITË”

- 9 shkurt 2021-

Pandemia e COVID-19 dhe politika monetare: të gjithë me sytë nga bilanci i bankës qendrore

Pandemia e COVID-19 shkaktoi një goditje negative të paprecedentë dhe po kështu kërkoi një përgjigje të jashtëzakonshme nga autoritetet monetare e fiskale në të gjithë globin. Përballë kësaj goditjeje, bankat qendrore kanë dalë jashtë kornizave tradicionale, duke përvetësuar një politikë monetare ekspansioniste të bazuar në zgjerimin e bilancit të bankës qendrore. Ky material përshkruan dilemat dhe ndryshimet me të cilat po përballet teoria dhe praktika e politikës monetare, si rezultat i presionit të pandemisë në ekonomi; dhe analizon mundësinë për përdorimin e këtyre ndryshimeve në ekonominë të vogla të hapura në zhvillim siç është rasti i Shqipërisë.

“Përballë kësaj goditjeje, bankat qendrore kanë dalë jashtë kornizave tradicionale, duke përvetësuar një politikë monetare ekspansioniste të bazuar në zgjerimin e bilancit të bankës qendrore.”

Duke nisur nga SHBA-ja, në fillim të viteve 1980, politika monetare u fokusua në mbajtjen në kontroll të inflacionit dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste përmes administrimit të normës së interesit. Për pothuajse 30 vjet, ky qëndrim krijoi premisa për stabilitet e rritje të qëndrueshme ekonomike. Megjithatë, pas shpërthimit të krizës globale financiare të vitit 2008, bankat qendrore ulën menjëherë normat e interesit, të cilat shumë shpejt arritën kufirin e poshtëm 0. Kjo e bëri praktikisht të pavlefshme normën e interesit si instrumentin kryesor të politikës monetare. Për të riaktivizuar ekonominë, bankat qendrore të ekonomive të zhvilluara (Rezerva Federale, Banka Qendrore Evropiane, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë) kryen injektime masive të përkohshme likuiditeti përmes blerjeve të letrave me vlerë në tregjet e kapitaleve. Pavarësisht se programet e blerjeve u menduan të përkohshme, ato u ripërsëritën vazhdimisht për të mbështetur aktivitetin ekonomik dhe arritjen e objektivit të çmimeve. Kjo praktikë çoi në rritjen e parasë në ekonomi dhe në zgjerimin e bilancit të bankës qendrore.

Goditja negative e shkaktuar nga pandemia dhe përgjigjja e autoriteteve për kontrollin e saj, kërkoi një reagim edhe më të madh të politikës monetare. Bazuar në të njëjtat argumente teorike, sikurse edhe në rastin e krizës financiare, bankat qendrore hodhën në ekonomi sasi të jashtëzakonshme likuiditeti, duke blerë në treg çdo kategori letre me vlerë të borxhit apo të pasurisë që tregtohej. Një vit nga shpërthimi i pandemisë, katër bankat qendrore të lartpërmendura, në mënyrë eksplicite apo implicite, **e shikojnë ekspansionin monetar përmes zgjerimit të bilancit si një instrument të përhershëm të politikës monetare.** Madje duke pranuar në bilancin e tyre edhe letra me vlerë të borxhit e të pasurisë së sektorit privat. Edhe bankat e tjera qendrore të vendeve të zhvilluara kanë adoptuar një përfaqje të ngjashme, në përmasa të krahasueshme sipas mundësisë. Aplikimi i këtyre praktikave jokonvencionale ka bërë që aktualisht të gjithë t'i mbajnë sytë nga bilanci i bankës qendrore si një instrument shpëtimi nga efektet negative të pandemisë.

“Aplikimi i këtyre praktikave jokonvencionale ka bërë që aktualisht të gjithë t'i mbajnë sytë nga bilanci i bankës qendrore si një instrument shpëtimi nga efektet negative të pandemisë.”

Është rrjedhimisht e natyrshe që ekonomistët të përballen me dilemën nëse këto praktika jokonvencionale janë të përshtatshme edhe për ekonomitë e vogla, të hapura, me një shkallë të lartë euroizimi dhe monedha të dobëta (në kuptimin që nuk janë monedha të tregtueshme në tregjet ndërkombëtare). Përgjigjja e dhënë në këtë punim është: **ndoshta, por jo domosdoshmërisht!** Kjo sepse politikat jokonvencionale mbartin rreziqe me natyrë monetare e financiare. Shkurtimisht do të përpiqem ta diskutoj këtë çështje duke përdorur shembullin e ekonomisë shqiptare.

Duke u zhvendosur në situatën e ekonomisë shqiptare gjatë pandemisë, Banka e Shqipërisë vlerëson se pandemia ka dhënë një goditje të konsiderueshme në aktivitetin ekonomik, punësim e investime, duke vënë në vështirësi bizneset dhe familjet për përballimin e nevojave e detyrimeve financiare. Në përgjigje të këtyre goditjeve, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash të karakterit monetar, duke lehtësuar kushtet monetare përmes uljes së normës së interesit dhe injektimit të pakufizuar të likuiditetit në ekonomi. Njëkohësisht, janë marrë një sërë masash makro e mikroprudenciale për të siguruar që problematikat financiare afatshkurtra të biznesit dhe të familjeve të mos dëmtojnë stabilitetin e sistemit bankar, e të mos pengojnë aktivitetin dhe rolin e tij ndërmjetësues në ekonomi. Ky kuadër masash dhe ndryshimet rregullative, janë të ngjashme me ato të marra nga Banka Qendrore

Evropiane dhe bankat qendrore të rajonit. Statistikat e deritanishme na tregojnë se ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zbutjen e efekteve negative të pandemisë. Si rrjedhim, kostot e financimit të sektorit privat mbeten të ulëta, kursi i këmbimit është i qëndrueshëm dhe sektori bankar shfaq tregues të mirë likuiditeti dhe kapitalizimi. ***Në dallim nga bankat qendrore të ekonomive të zhvilluara, Banka e Shqipërisë nuk ka aplikuar masa jokonvencionale të politikës monetare për zgjerimin e bilancit e saj.*** Në vijim do të shtjelloj shkurtimisht arsyet përse kjo përjasje nuk është adoptuar në Shqipëri.

Së pari, dhe më e rëndësishmja, në momentin e shpërthimit të pandemisë, norma bazë e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë nuk ishte as në territor negativ, as pranë kufirit zero. Rrjedhimisht politika monetare kishte hapësirë të mjaftueshme për ekspansion monetar përmes uljes së normës së interesit në formën e vet konvencionale. Banka e Shqipërisë vlerëson se edhe në momentin aktual ka ende hapësirë për të ndërmarrë një politikë monetare lehtësuese përmes masave konvencionale.

“Në dallim nga bankat qendrore të ekonomive të zhvilluara, Banka e Shqipërisë nuk ka aplikuar masa jokonvencionale të politikës monetare për zgjerimin e bilancit e saj.”

Së dyti, politikat jokonvencionale ose aplikimi i koncepteve të reja të politikës monetare (QE), në rastin e ekonomisë shqiptare, kufizohen kryesisht nga mungesa e instrumenteve të tregtueshme në tregun e kapitaleve. Struktura e tregut të kapitaleve në Shqipëri është shumë e kufizuar dhe letrat me vlerë të borxhit e së pasurisë të sektorit privat janë joekzistente. Rrjedhimisht, zgjerimi i bilancit të bankës qendrore mbetet i kushtëzuar nga madhësia dhe oferta e kufizuar e tregut financiar.

Së treti, në mungesë të tregjeve të kapitalit, zgjerimi i bilancit të bankës qendrore përmes blerjes së letrave me vlerë të qeverisë në tregun sekondar çon automatikisht në rritjen e borxhit publik; dhe mund të vazhdojë deri në momentin kur borxhi publik arrin kufirin e qëndrueshmërisë afatgjatë. Rritja e borxhit publik përtej këtij kufiri dëmton drejtpërdrejt dhe njëkohësisht kredibilitetin e politikës fiskale dhe asaj monetare, duke e vendosur vendin përballë rreziqeve të krizave financiare e të bilancit të pagesave.

Në përgjithësi, konceptet e reja mbi natyrën dhe instrumentet e politikës monetare anashkalojnë disa parime themelore të qëndrueshmërisë së

bilanceve ndërkohore të qeverisë, bankës qendrore e ekonomisë në përgjithësi. Këto parime të shprehura në formën e kufizimeve sasiore përbëjnë thelbin e politikave të qëndrueshme për ekonominë e vogla e të hapura në zhvillim. Aplikimi i pastudiuar i këtyre praktikave mund të rezultojë i rrezikshëm për këto ekonomi.

Në konkluzion, suksesi dhe dobishmëria e ndryshimeve të propozuara për të arritur objektivat e politikës monetare, do të mbeten për t'u vërtetuar në të ardhmen nga rezultatet konkrete të bankave qendrore që i kanë aplikuar dhe studimet empirike të akademisë.

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË CEREMONINË E HAPJES SË JAVËS SË PARASË -23 mars 2021-

E nderuar zj. Ministre e Arsimit Sportit dhe Rinisë,

I nderuar z. Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave,

Të nderuar nxënës e mësues, miq dhe kolegë,

Kam kënaqësinë t'ju uroj mirëseardhjen në ceremoninë çelëse të Javës Globale të Parasë për vitin 2021. Prej pothuajse 10 vitesh, Banka e Shqipërisë është bërë pjesë e kësaj lëvizjeje ndërkombëtare, duke organizuar përgjatë çdo fund marsi aktivitetet edukative dhe ndërgjegjësuese për grupmoshat e nxënësve të arsimit para universitar dhe atij universitar. Si është tashmë e traditës, Java Globale e Parasë organizohet në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe me mbështetjen

e vyer të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për shkak të vështirësive shkaktuar nga pandemia COVID-19, Java Globale e Parasë për këtë vit nuk do të çelet si zakonisht në mjediset e Muzeut të Bankës së Shqipërisë, por virtualisht, në respektim të rregullave të distancimit social.

Ashtu si e kam theksuar edhe gjatë prezantimeve të shkuara, kjo javë është një nismë ndërkombëtare e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), e cila synon ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të përgjegjshëm financiarisht në të ardhmen.

Çdo vit, gjatë muajit mars, bankat qendrore, agjencitë shtetërore, institucionet financiare, dhe organizata të shoqërisë civile në mbarë botën organizojnë Javën e Parasë. Numri i vendeve të angazhuara në këtë event global dhe rrjedhimisht edhe i fëmijëve e të rriturve të përfshirë në të, ka ardhur në rritje. Këtë vit, Java Globale e Parasë do të organizohet në rreth se 175 vende të botës dhe pritet të përfshihen në të rreth 40 milionë fëmijë dhe të rinj.

***“Prej pothuajse 10 vitesh,
Banka e Shqipërisë është
bërë pjesë e kësaj lëvizjeje
ndërkombëtare, duke
organizuar përgjatë çdo fund
marsi aktivitetet edukative
dhe ndërgjegjësuese për
grupmoshat e nxënësve të
arsimit para universitar dhe
atij universitar.”***

Emergjenca globale shëndetësore dhe ekonomike e COVID-19, si dhe impaktet e saj shoqërore, kanë ndikuar pothuajse të gjitha aspektet e jetës të të gjitha nëngrupeve të shoqërisë. Tashmë është e qartë që grupmosha të ndryshme po i përjetojnë këto ndikime në mënyra të ndryshme. Kështu, sa i përket nxënësve dhe të rinjve, krahas aspektit shëndetsor, pandemia i ka përballur ata edhe me sfida në fushat e edukimit dhe punësimit. Për këto arsye, tashmë është më e rëndësishme se kurrë t’i pajisim ata me dijen e duhur mbi menaxhimin e financave personale dhe shfrytëzimin e saktë të produkteve bankare.

“Tema e këtij viti nënvizon rëndësinë kyçe që kanë njohuritë mbi një treg financiar gjithnjë e më të digjitalizuar dhe inovator, i cili i mundëson publikut të shmangë marrëdhënien fizike gjatë përdorimit të produkteve financiare e bankare, duke siguruar kështu edhe një mbrojtje më të mirë të shëndetit publik.”

Ndaj, konkurset dhe aktivitetet e këtij viti janë organizuar nën temën “Kujdesu për veten, kujdesu për paratë e tua”. Tema nënvizon rëndësinë kyçe që kanë njohuritë mbi një treg financiar gjithnjë e më të digjitalizuar dhe inovator, i cili i mundëson publikut të shmangë marrëdhënien fizike gjatë përdorimit të produkteve financiare e bankare, duke siguruar kështu edhe një mbrojtje më të mirë të shëndetit publik. Në këtë këndvështrim, Banka e Shqipërisë, si institucioni mbikëqyrës dhe nxitës i sistemit bankar shqiptar, përveç përgjigjes së

menjëhershme ndaj vështirësive të ardhura si pasojë e COVID-19, përmes një pakete të plotë masash monetare, mbikëqyrëse, makroprudenciale dhe operacionale, e gjen jo më pak të rëndësishme edhe hartimin dhe organizimin e iniciativave edukuese si është dhe Java Globale e Parasë.

Nëpërmjet aktiviteteve edukuese dhe ndërjegjësuese të kësaj jave, ne synojmë të afrojmë brezin e ri me botën e ndërlikuar të financave dhe bankingut; të prezantojmë dhe të përçojmë njohuri mbi mundësitë, por dhe rreziqet, që produktet e larmishme bankare e financiare mbartin; si dhe të prezantojmë publikun e ri me informacione të nevojshme mbi huamarrjen dhe kursimin. Ky komunikim dhe ndërjegjësim i brezit të ri, ndihmon gjithashtu që tregu financiar e ai bankar të bëhen më të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe eficientë.

Iniciativat edukuese të Bankës së Shqipërisë nuk kufizohen vetëm në aktivitetet e Javës Globale të Parasë. Edukimi financiar i publikut është pjesë e rëndësishme e punës tonë të përditshme. Kështu, përmes mjeteve edukative virtuale të vendosura në faqen tonë zyrtare, nxënësit dhe mësuesit mund të mësojnë gjatë gjithë vitit mbi çështje të financave,

duke parë video dhe shfletuar literaturë dedikuar arsimit parauniversitar dhe studentëve. Faqja jonë përmban informacione të thjeshtëzuar mbi tema të jetës së përditshme si hapja e një llogarie bankare, menaxhimi i buxhetit personal, hartimi i planeve të kursimit, aplikimi për kredi bankare etj.

Për ata që duan të marrin njohuri më të thelluara, faqja jonë zyrtare ofron gjithashtu mjete didaktike për të kuptuar më mirë aspekte të ekonomisë dhe financës që e ndikojnë jetën e të gjithë qytetarëve, si p.sh.: çfarë është rritja ekonomike, tregu i punës, fluksi qarkullues, si përhapen krizat financiare, çfarë është konkurrenca etj.

Gjithashtu, lënda me zgjedhje “Financat personale në duart tuaja”, e integruar prej vitesh në kurikulumën mësimore të shkollave të mesme, i njeh nxënësit me botën e financave personale, për t’i informuar dhe për të formuar tek ta aftësitë e nevojshme për të administruar në mënyrë sa më fitimprurëse paratë. Teksti mësimor ofrohet dhe shpërndahet falas për të gjitha shkollat e mesme që zgjedhin ta zhvillojnë atë. Ky tekst shoqërohet edhe me një udhëzues për mësuesit e lëndës së ekonomisë. Një përfaqje e ngjashme është zgjedhur edhe për më të vegjlit. Kështu, paketa mësimore dedikuar edukimit financiar të nxënësve që ndjekin klasën I, II dhe III, të shkollës 9-vjeçare, trajton tema të tilla si: ndryshimi mes nevojave dhe dëshirave, nga vjen paraja dhe për çfarë shërben ajo, administrimi i duhur i parave dhe kursimi etj. Ajo mund të përdoret në orët e lira mësimore, në orët dedikuar projekteve shkollore apo si projekt ndërleëndor.

Nga sa përmenda më sipër është e qartë se Banka e Shqipërisë vlerëson se edukimi financiar duhet të nisë sa më herët. Ky pohim përbën dhe filozofinë e programeve të institucionit tonë, i cili synon ndërtimin e urave të komunikimit, ndërgjegjësimin dhe rritjen e njohurive financiare tek brezi i ri. Ata duhet të përftojnë gradualisht njohuritë, aftësitë, qëndrimin dhe sjelljet e nevojshme për të marrë vendime të shëndosha financiare, me qëllim që në të ardhmen e tyre si individë të maturuar të arrijnë mirëqenie financiare si dhe të jenë të aftë të përballojnë situatat e emergjencës, siç është kjo që po kalojmë aktualisht.

“Banka e Shqipërisë vlerëson se edukimi financiar duhet të nisë sa më herët. Ky pohim përbën dhe filozofinë e programeve të institucionit tonë, i cili synon ndërtimin e urave të komunikimit, ndërgjegjësimin dhe rritjen e njohurive financiare tek brezi i ri.”

Për ta përmbyllur, dëshiroj të falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorët e Bankës së Shqipërisë në të gjitha iniciativat dhe e programet e saj edukuese, dhe specifikisht për Javën Globale të Parasë. Sigurisht që tematika të tilla si planifikimi i financave personale nuk janë çështje tërheqëse për grupmoshat e reja, megjithatë, duke njohur rëndësinë dhe ndikimin e tyre në jetën e secilit prej nesh, është vendimtare që ne si institucione, të mos i rreshtim përpjekjet tona për t'i sjellë ato në vëmendje të brezit të ri. Kjo është ajo që jemi përpjekur të bëjmë edhe përmes aktiviteteve dhe konkurseve që do të zhvillohen gjatë Javës Globale të Parasë 2021, dhe të cilat jeni të mirëpritur t'i ndiqni.

Ju falënderoj për zëmërsisht për kontributin tuaj, dhe i uroj të gjithë pjesëmarrësve suksese!

**FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË
KONFERENCËN “NORMALJA E RE,
SFIDAT DHE OPORTUNITETET” TË
UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS
-30 prill 2021-**

I nderuar Profesor Gjuraraj

I nderuar Profesor Xhepa,

Të nderuar studentë e pjesëmarrës,

Është kënaqësi për mua të përshëndes punimet e kësaj konference, të mbledhur për të trajtuar “normalen e re”, një temë kjo sa emergjente aq dhe e pazgjidhur e debatit aktual ekonomik. Të gjithë ne, politikëbërës, akademikë dhe operatorë të sektorit privat, jemi të vetëdijshëm se një realitet i ri na pret në botën post-pandemi. Por, “cilat do të jenë konturet e këtij realiteti të ri?”, “çfarë sfidash dhe oportunitetesh shtrohen para sektorit privat?”, si dhe “cilat duhet të jenë objektivat dhe instrumentet e politikave ekonomike?”, mbeten pyetje të cilat nuk kanë ende një përgjigje shteruese.

Për këtë arsye, dëshiroj të falënderoj Universitetin Evropian të Tiranës për zgjedhjen e kësaj teme të spikatur.

Ky universitet është një vatër dijeje, e cila ka arritur të pozicionohet në qendër të edukimit, të diskursit akademik dhe të nxitjes së inovacionit, dhe shfaq sot një profil të konsoliduar në debatin akademik.

Duke u përpjekur të përmbledh opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi temën e shtruar për diskutim, dëshiroj që, në vijim të fjalës sime, të ndalem më gjatë në tre çështje specifike. Së pari, do të paraqes shkurtimisht ndikimin e pandemisë në ekonominë shqiptare dhe masat e marra prej nesh për minimizimin e efekteve të saj. Më tej, do të fokusohem në diskutimin akademik mbi “normalen e re”. Në përfundim, dëshiroj të nënvizoj rolin që ka fleksibiliteti dhe vullneti institucional për ndryshim, si instrument për akomodimin e paradigmave të reja dhe adoptimin e praktikave më të mira në politikëbërje.

1. BANKA E SHQIPËRISË PËRBALLË SFIDAVE TË PANDEMISË

Pandemia COVID-19 dhe masat e nevojshme kufizuese të ndërmarra për mbrojtjen e shëndetit publik shkaktuan një krizë të paprecedentë ekonomike, në vend dhe në botë. Në Shqipëri, rritja e pasigurisë dhe kufizimi i detyruar i lëvizjes së mallrave, shërbimeve dhe njerëzve, rezultoi në kontraktimin me 3.3% të ekonomisë dhe në humbjen e mbi 40,000 vendeve të punës gjatë vitit 2020. Përtej kësaj, pandemia u shoqërua me probleme ekonomike, në nivel makro dhe mikro, dhe testoi qëndrueshmërinë e fondamenteve të ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare.

“Banka e Shqipërisë ndërhyri me një paketë masash monetare e financiare që synonin jo vetëm kufizimin e ndikimet afatshkurtër të pandemisë, por dhe ruajtjen e kapaciteteve prodhuese dhe të stabilitetit ekonomik e financiar të vendit, dy parakushte të domosdoshme këto për rritjen e shpejtë, të qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.”

Në përgjigje të saj, reagimi i autoriteteve publike në vend, si dhe kudo në botë, ishte i shpejtë dhe i paprecedentë. Banka e Shqipërisë ndërhyri me një paketë masash monetare e financiare. Këto masa synonin jo vetëm kufizimin e ndikimet afatshkurtër të pandemisë, por dhe ruajtjen e kapaciteteve prodhuese dhe të stabilitetit ekonomik e financiar të vendit, dy parakushte të domosdoshme këto për rritjen e shpejtë, të qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Në këtë kontekst, ne:

- ulëm normën bazë të interesit në muajin mars të vitit 2020 në 0.5%, në nivelin më të ulët historik, dhe krijuam kushtet e nevojshme operacionale për të furnizuar bankat me likuiditet të mjaftueshëm;
- më tej, krijuam lehtësitë e nevojshme rregullatore dhe udhëzuar bankat tregtare të ndihmojnë bizneset apo individët që përballen me vështirësi, nëpërmjet ofrimit të një moratoriumi afatshkurtër mbi shlyerjen e pagesave të kredisë dhe nëpërmjet rristurimit të kredive aty ku ishte e nevojshme;
- hoqëm përkohësisht komisionet të aplikuara nga bankat për përdorimin e platformave të pagesave elektronike dhe tarifat për pjesëmarrësit në sistemet e pagesave AIPS dhe AECH;
- së fundi, pezulluam shpërndarjen e fitimit nga bankat e nivelit të dytë për vitin 2020, për të mundësuar ruajtjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar.

Masat stimuluuese të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë u bashkërenduan me një stimul të shtuar fiskal. Stimujt fiskalë morën formën e lehtësive tatimore dhe transfertave direkte për bizneset apo individët, të ardhurat e të cilëve u prekën nga mbyllja e aktivitetit, si dhe formën e garancive sovrane për kreditë ndaj bizneset, më synim minimizimin e efektit negativ nga të ardhurat dhe të ruajtjes së gjendjes likuide në bilanci të tyre.

Politikat makroekonomike stimuluuese ndihmuan në kufizimin e ndikimit të pandemisë në sektorin real dhe atë financiar të vendit, si dhe arritën të ruanin të pacënuar stabilitetin makroekonomik. Kontraktimi ekonomik, rënia e punësimit dhe dëmi në bilanci financiar të bizneseve, rezultuan më të ulët se projeksionet tona fillestare.

Sektori bankar vijon të jetë i mirëkapitalizuar, likuid dhe fitimprurës. Primet e rrezikut dhe normat e interesit në tregun financiar mbeten në nivele të ulëta, duke ndihmuar mbështetjen me kredi të ekonomisë, në përgjigje të nevojave të saj për kapital qarkullues, konsum apo investime. Në veçanti, kreditë me probleme mbetën në nivel të ulët, pavarësisht pozicionit të përqësuar ciklik të ekonomisë, duke dëshmuar dobinë e procesit të konsolidimit të sektorit bankar, si dhe frytet përmirësimeve të vazhdueshme të kuadrit mbikëqyrës e rregullator.

Politikat stimuluuese të ndërmarra kanë ndihmuar në zvogëlimin e rrezikut në afat të shkurtër, por nuk mund të adresojnë ndryshime strukturore, ndryshime të cilat kanë kohë që po vihen re në horizont apo të cilat kanë lidhje direkte me pandeminë. Një "normale e re" pritet të udhëheqë nevojën për adaptim të sektorit privat dhe një rikonceptim të paradigmeve të qeverisjes institucionale.

"Një "normale e re" pritet të udhëheqë nevojën për adaptim të sektorit privat dhe një rikonceptim të paradigmeve të qeverisjes institucionale."

2. SFIDAT E SË ARDHMES

Institucionet politikëbërëse pritet të përballen me sfida strukturore komplekse, të cilat do të përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e një realiteti të ri brenda një të ardhmeje jo shumë të largët. Rritja e barrierave në tregtinë ndërkombëtare, plakja e popullsisë, emigrimi, frenimi i inovacionit, ngrohja globale, rritja e pabarazisë dhe tensionet në rritje sociale, janë probleme akute globale.

Në përgjigje të tyre, autoritetet publike duhet të angazhohen pa humbur kohë në reforma të koordinuara strukturore të cilat adresojnë – ndër të tjera – nxitjen e inovacionit dhe rialokimin e burimeve midis sektorëve të ekonomisë, tregtinë e lirë, qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve dhe ruajtjen e konsensusit social.

Për më tej, një “normale e re” do të kërkojë një koordinim të kujdesshëm të politikave publike, në mënyrë që të arrihet një balancë optimale mes rritjes ekonomike dhe stabilitetit ekonomik, monetar e financiar.

Më lejoni ta shtjelloj disi më tej këtë çështje.

Kriza financiare globale dhe pandemia sollën në vëmendje rolin e pazëvendësueshëm që ka politika fiskale si instrument i stabilizimit të ekonomisë dhe i zbutjes së krizave. Ky mësim pritet të mbetet relevant edhe në afatin e mesëm e të gjatë, duke i hapur rrugë një roli më aktiv të politikës fiskale në të ardhmen. Megjithatë, ai nuk duhet të anashkalojë në asnjë rast nevojën për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale. Në të kundërt, stabiliteti fiskal mbetet parakusht i rritjes afatgjatë dhe mundëson krijimin e hapësirave të nevojshme për amortizimin e goditjeve.

“Në fushën e bankngut qendror, “normalja e re” do të vijojë të karakterizohet nga një kurbë Filipsi e sheshuar ku pagat, punësimi apo rritja ekonomike, do të vijojnë të kenë një lidhje të dobët me inflacionin.”

Në fushën e bankngut qendror, “normalja e re” do të vijojë të karakterizohet nga një kurbë Filipsi e sheshuar ku pagat, punësimi apo rritja ekonomike, do të vijojnë të kenë një lidhje të dobët me inflacionin. Sfidat në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve do të vijojnë të jenë të pranishme. Kjo dikton nevojën për përmirësimin e mekanizimit të transmetimit të politikës monetare dhe duke e bërë të nevojshëm eksplorimin e instrumenteve jokonvencionale si alternativa të mundshme e të vlefshme për administrimin e goditjeve në

të ardhmen.

Të gjitha këto sfida bëjnë të nevojshme rritje e fleksibilitetit të institucioneve publike, për t'i bërë ato më të afta për të evoluar, për të përvetësuar ndryshimet rreth tyre, dhe për të nxitur inovacionin. Në këtë kontekst, ndihem krenar tek shikoj te Banka e Shqipërisë një institucion i cili ka qenë dhe mbetet në pararojë të ndryshimit.

3. BANKA E SHQIPËRISË SI NJË INSTITUCION NË ZHVILLIM

Përgjatë gjithë historisë së tranzicionit, Banka e Shqipërisë ka treguar se është e aftë të ndryshojë e të përqafojë praktikat më të mira dhe më eficiente bashkëkohore.

Natyra dhe funksionet e institucionit u transformuan rrënjësisht në vitin 1992, periudhë kur nisi tranzicioni i ekonomisë shqiptare drejt një ekonomie të tregut të lirë. Brenda një periudhe të shkurtër dhe në mungesë të një trashëgimie institucionale, Banka e Shqipërisë arriti të krijojë konturet e një politike monetare të pavarur, e cila merr jetë në prani të një kursi të lirë këmbimi, si dhe të rregullojë e të mbikëqyrë një sektor bankar privat. i cili funksionon mbi parimet e tregut.

Transformimi cilësor i Bankës së Shqipërisë drejt një bankë qendrore moderne mori një hov të mëtejshëm me adoptimin e ligjit të ri të Bankës së Shqipërisë në vitin 1997, i cili përcaktoi si objektiv kryesor "arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve". Ky ligj sanksionoi pavarësinë vendimmarrëse, financiare dhe operacionale të bankës qendrore në përmbushje të objektivave të saj, duke e sjellë atë në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ndër të tjera, inkurajues është fakti se kjo pavarësi institucionale gëzon një konsensus të gjerë shoqëror.

Gjatë këtyre viteve tranzicion, politika jonë monetare ka bërë progres të dukshëm në drejtim të zhvillimit të kuadrit teorik, në drejtim të ndërtimit të plotësimi të njohurive tona me studime empirike, në drejtim të përsosjes së instrumenteve të zbatimit të saj, si dhe në drejtim të komunikimit transparent me publikun. Prej vitit 2015, ne kemi adoptuar në mënyrë formale regjimin e "inflacionit të shënjestruar", si një regjim i cili ofron incentivat, disiplinën dhe fleksibilitetin e duhur, për maksimizimin e mirëqenies afatgjatë shoqërore.

Paralelisht me zhvillimin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë ka ndërtuar ndër vite një kuadër rregullator bankingu modern dhe efikas, në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ne kemi zbatuar në kohë standardet rregullatore të Basel I, II dhe III. Më tej, ne kemi ndihmuar në krijimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe kuadrit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dy elemente kyçe këto për stabilitetin sistemit financiar, po ashtu, në bashkëpunim me autoritetet e tjera publike, ne kemi punuar për zhvillimin e arkitekturës së plotë mbikëqyrëse e rregullatore të sistemit financiar, ku gjej me vend të përmend zhvillimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Financiare dhe Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar.

“Banka e Shqipërisë ka treguar se është një institucion që adaptohet dhe ndryshon me hapin e kohës. Paralelisht me këtë, për ne ka qenë gjithnjë i rëndësishëm evolimi gradual, i mirë menduar e deri-diku konservator, në mënyrë që të adoptojmë eksperiencat më të mira ndërkombëtare që i rezistojnë kohës.”

Duke konsideruar këtë historik të pasur të zhvillimit dhe të evoluimit, Banka e Shqipërisë ka treguar se është një institucion që adaptohet dhe ndryshon me hapin e kohës. Paralelisht me këtë, për ne ka qenë gjithnjë i rëndësishëm evolimi gradual, i mirë menduar e deri-diku konservator, në mënyrë që të adoptojmë eksperiencat më të mira ndërkombëtare që i rezistojnë kohës. Besoj se të dy këto tipare zhvillimi ofrojnë garancitë e duhura se ne do të dimë të përballemi me sfidat e “normales së re”.

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të theksoj edhe njëherë kënaqësinë time që pata mundësinë të adresoj punimet e kësaj konference sot dhe të nënvizoj rëndësinë e shkëmbimit të njohurive dhe të eksperiencave mes nesh mbi këtë temë kaq të rëndësishme.

Dëshiroj të mbyll fjalën time duke ju falënderuar për dhe një herë për ftesën!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË PREZANTIMIN E DY KARTËMONEDHAVE 1000 LEKË DHE 10000 LEKË TË SERISË SË RE TË KARTËMONEDHAVE -15 qershor 2021-

Të nderuar,

Ju uroj mirëseardhjen në këtë ditë të veçantë, në të cilën do të prezantojmë për publikun dy prerjet e radhës së serisë së re të kartëmonedhës shqiptare.

Një nga përgjegjësitë kryesore dhe detyrimet ligjore për Bankën e Shqipërisë është të garantojë furnizimin e ekonomisë me para të gatshme, si në vlerë ashtu edhe në strukturë, si dhe të sigurojë besimin e publikut tek monedha kombëtare. Pas një periudhe mbi 20-vjeçare, Banka e Shqipërisë, në vitin 2016, mori iniciativën për të filluar projektin e prodhimit të një serie të re të kartëmonedhës me kurs ligjor, duke e përmirësuar dhe sjellë atë në një formë dhe stil krejt të ri.

Në këtë kuadër, në muajin shtator 2019, Banka e Shqipërisë prezantoi serinë e re të kartëmonedhëve, e cila përbëhet nga 6 prerje: 200, 500, 1000, 2000, 5000 dhe 10000 Lekë.

Tematika e serisë së re të kartëmonedhëve shqiptare mishëron figurat më të ndritura kombëtare dhe evokon momentet më të rëndësishme të historisë së kombit tonë, në përpjekjet e tij për liri dhe prosperitet. Ajo përmban të gjitha etapat historike, duke filluar nga antikiteti, mesjeta, rilindja kombëtare, pavarësia e vendit, dhe përmblyllet me simbolet e flamurit kombëtar dhe himnit të flamurit në prerjen më të re, atë me vlerë nominale më të lartë, 10000 Lekë. Kështu, kartëmonedhat tona promovojnë trashëgiminë historike e kulturore të vendit tonë dhe theksojnë arritjet më të mëdha të shumë personaliteteve të shquar të saj ndër shekuj.

Me kënaqësi konstatoj se dy prerjet e para të serisë, 200 dhe 5000 Lekë, në qarkullim prej muajit shtator 2019, janë mirëpritur nga publiku,

“Tematika e serisë së re të kartëmonedhëve shqiptare mishëron figurat më të ndritura kombëtare dhe evokon momentet më të rëndësishme të historisë së kombit tonë, në përpjekjet e tij për liri dhe prosperitet.”

kanë përmbushur pritshmërinë e bankës dhe tashmë gradualisht janë pjesë e qëndrueshme e parasë në qarkullim, duke mbështetur rritjen në vijimësi të cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim, me qëllim ruajtjen e integritetit të kartëmonedhës në raport me publikun, si dhe ruajtjen e një imazhi dinjitoz të Bankës së Shqipërisë dhe të vetë Shtetit Shqiptar.

Dhe sot, afërsisht 2 vjet pas prezantimit dhe hedhjes në qarkullim me sukses të dy prerjeve të para, Banka e Shqipërisë prezanton 2 kartëmonedha të tjera, pjesë e serisë së re të kartëmonedhave shqiptare, prerjet 1000 Lekë dhe atë 10000 Lekë, ku kjo e fundit është një prerje tërësisht e re në serinë e kartëmonedhave shqiptare.

Shtypja dhe hedhja në qarkullim për herë të parë e kartëmonedhës së re të prerjes më të lartë, me vlerë 10000 Lekë, përfaqëson në vetvete përshtatjen e strukturës së kartëmonedhave me evoluimin e strukturës së çmimeve dhe pagave, shkallën e zhvillimit të sistemit elektronik të pagesave, si dhe treguesve të tjerë që lidhen me trajtimin e parasë.

Kjo kartëmonedhë e prerjes më të lartë shoqëron zhvillimin ekonomik të vendit dhe, sipas të gjitha analizave, plotëson kërkesat e tregut për ta pasur në strukturën e serisë sonë të kartëmonedhave me kurs ligjor. Prezantimi dhe hedhja e saj në qarkullim do të mundësojë një qarkullim më të mirë dhe më efikas të parasë së gatshme, duke ndihmuar strukturën e monedhës në qarkullim, duke ulur kostot e prodhimit, magazinimit dhe shpërndarjes, dhe në këtë mënyrë, duke rritur efikasitetin e Bankës së Shqipërisë në administrimin e parasë fizike dhe emisionit. Gjithashtu, prezenca e kësaj prerjeje të re më të lartë në strukturën e kartëmonedhave shqiptare rrit efikasitetin e Bankës së Shqipërisë edhe për të administruar një stok strategjik sa më të përshtatshëm, për të përballuar raste të rritjeve të paparashikuara të kërkesës së tregut për para fizike.

Pavarësisht zhvillimit të mjeteve të tjera të pagesës, si p.sh. ato elektronike, paraja në qarkullim vijon të ketë ndër vite një trend rritës, i cili pasqyron kërkesën e vazhdueshme të ekonomisë për para fizike si mjet pagese. Banka e Shqipërisë planifikon me kujdes për të garantuar plotësimin e kësaj kërkesë të tregut, si në situata normale ashtu edhe në ato jotipike. Edhe situata më e fundit e pandemisë COVID-19, është një shembull konkret në këtë drejtim. Gjatë kësaj periudhe, ka rezultuar një rritje shtesë e kërkesës së ekonomisë për para fizike. Kështu gjatë vitit

“Pavarësisht zhvillimit të mjeteve të tjera të pagesës, si p.sh. ato elektronike, paraja në qarkullim vijon të ketë ndër vite një trend rritës, i cili pasqyron kërkesën e vazhdueshme të ekonomisë për para fizike si mjet pagese.”

2020, para ja në qarkullim është rritur me rreth 52 miliardë lekë ose rreth 3 herë më shumë se rritja e shënuar gjatë vitit 2019. Gjithashtu, edhe në 5 muajt e parë të vitit 2021 është shënuar një rritje prej rreth 10 miliardë lekësh. Plotësimi i kërkesës së tregut për para fizike është mbështetur nëpërmjet sigurimit dhe planifikimit të stokut të mjaftueshëm të parasë në Bankën e Shqipërisë, e cili jep siguri jo vetëm për të tashmen, por edhe për të ardhmen.

Më lejoni tani të ndalem shkurtimisht në disa veçori të këtyre dy prerjeve të reja.

Kartëmonedha 1000 Lekë pjesë e serisë së re, vjen me një dizajn të rifreskuar, por ruan të njëjtat motive të paraqitura në prerjen ekzistuese, duke pësuar ndryshime, të cilat lidhen me konfigurimin në tërësi të të gjitha elementeve të shtuara dhe përmirësuar.

Kartëmonedha 10000 Lekë mbart si tematikë simbolet e flamurit dhe himnit kombëtar - simbole kryesore këto të identitetit tonë kombëtar - të shoqëruara me portretin e poetit të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, njëkohësisht autor i "Himnit Kombëtar", Aleksandër Stavre Drenova - njohur me pseudonimin letrar "Asdreni".

Prezantimi i një serie të re kartëmonedhash do të thotë më shumë se sa një ndryshim i thjeshtë i pamjes së saj. Banka e Shqipërisë përmirëson vazhdimisht cilësinë e kartëmonedhës në qarkullim, me qëllim ruajtjen e integritetit të saj. Dy kartëmonedhat e reja, si të gjitha prerjet e serisë së re, përmbajnë elemente sigurie të përparuara, të prodhuara me teknologjitë më të fundit të fushës dhe të personalizuar sipas prerjeve.

"Prezantimi i një serie të re kartëmonedhash do të thotë më shumë se sa një ndryshim i thjeshtë i pamjes së saj. Banka e Shqipërisë përmirëson vazhdimisht cilësinë e kartëmonedhës në qarkullim, me qëllim ruajtjen e integritetit të saj."

Kartëmonedha 1000 Lekë ka të integruar shtypin e ngritur te portreti i Pjetër Bogdanit, numrat dhe shkronjat, si dhe elementin e njohjes nga të verbrit, fillin e sigurisë që duket si vijë e errët e pandërprerë kundrejt dritës dhe që ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt në kënde të ndryshme shikimi, figurën e diellit me ngjyrë të ndryshueshme sipas këndit të lëvizjes dhe shiritin e shndritshëm në pjesën e pasme që shfaq vlerën 1000 Lekë.

Kartëmonedha 10000 Lekë ka të integruar shtypin e ngritur te portreti i Asdrenit, numrat, shkronjat dhe pjesë të tjera të kartëmonedhës, si dhe elementin e njohjes nga të verbrit, figurën ujore, hologramën të

shoqëruar me efekte të ndryshme optike, fillin e sigurisë që duket si vijë e errët e pandërprerë kundrejt dritës dhe që ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt në kënde të ndryshme shikimi, figurën e librit me pendë me ngjyrë të ndryshueshme sipas këndit të lëvizjes dhe shiritin e shndritshëm në pjesën e pasme që shfaq vlerën 10000 Lekë.

Një kartëmonedhë e sigurt do të thotë që ne mund të përdorim parane fizike me besim dhe lehtësi për identifikimin e saj si një kartëmonedhë e vërtetë origjinale. Ky përbën themelin e një sistemi të shëndoshë financiar: besimi te veprimet bazë financiare ku para ja ka rolin e saj të pazëvendësueshëm si ndërmjetësuese.

Nga 30 qershori 2021, kartëmonedhat e serisë së re 1000 Lekë dhe 10000 Lekë do të kenë kurs ligjor në Republikën e Shqipërisë dhe do të përdoren si mjet pagese, së bashku me kartëmonedhat ekzistuese.

Duke parë bukurinë dhe cilësinë e këtyre kartëmonedhave, mund të them me besim të plotë se puna e bërë për realizimin e tyre ka qenë mjaft e vlefshme. Prandaj, në emër të Bankës së Shqipërisë, dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që kanë ndihmuar dhe janë angazhuar në mënyrë aktive për realizimin me sukses të tyre. Përveç punës së palodhur të stafit të bankës, këtu dëshiroj të theksoj edhe kontributin tepër të çmuar të shumë akademikëve, historianëve, albanologëve, numizmatëve dhe ekspertëve të kompanive më të njohura në botë në fushën e prodhimit të kartëmonedhave.

“... dëshiroj të inkurajoj gjithë përdoruesit të jenë shumë të përgjegjshëm në trajtimin e çdo kartëmonedhe që mbajnë në dorë, për të ruajtur jetëgjatësinë, cilësinë dhe integritetin e tyre në qarkullim. Kartëmonedhat janë më shumë se një letër me vlerë.”

Ndërkohë, Banka e Shqipërisë po vijon punën për plotësimin e serisë së re edhe me dy kartëmonedhat e tjera, atë 500 Lekë dhe 2000 Lekë, të cilat janë në proces prodhimi.

Në mbyllje, dëshiroj të inkurajoj gjithë përdoruesit të jenë shumë të përgjegjshëm në trajtimin e çdo kartëmonedhe që mbajnë në dorë, për të ruajtur jetëgjatësinë, cilësinë dhe integritetin e tyre në qarkullim. Kartëmonedhat janë më shumë se një letër me vlerë. Ato nxisin dhe mbështesin aktivitetin ekonomik të vendit tonë dhe njëkohësisht lidhin me fije të padukshme identitetin tonë kombëtar.

Uroj që edhe dy kartëmonedhat e reja që po prezantojmë sot të mirëpritën nga publiku ashtu si pararendëset e tyre.

**FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË
CEREMONINË E PROMOVIMIT TË LIBRIT:
“PËRBALLË KRIZËS, SFIDAT E TEORISË
DHE POLITIKAVE EKONOMIKE”, NGA
AUTORËT AKAD. PROF. DR. ANASTAS
ANGJELI DHE PROF. DR. ADRIAN CIVICI
-22 korrik 2021-**

Pandemia COVID-19 e vuri shoqërinë botërore përballë sfidave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme. Emergjenca e shëndetit publik e njëkohësisht vështirësitë ekonomike e financiare të shkaktuara nga kjo goditje dhe nga masat e ndërmarra për kufizimin e pandemisë dominuan dhe vazhdojnë të marrin vëmendjen e shoqërisë dhe politikëbërësve, si dhe të ndikojnë vendimmarrjet e tyre. Kompleksiteti i problemeve me të cilat përballemi kërkon ndërhyrje të shpejtë, të fuqishme dhe të koordinuar midis autoriteteve shëndetësore, fiskale e atyre monetare. Masat e ndërmarra nga autoritetet mund të minimizojnë efektet negative të pandemisë dhe kanë krijuar premisat për një rimëkëmbje të shpejtë, duke shpresuar që vaksinimi dhe masat e tjera shëndetësore do t'i japin fund pandemisë.

Ky diskutim vjen i shtjelluar me shumë profesionalizëm dhe realizëm në librin “Përballë Krizës, sfidat e teorisë dhe politikave ekonomike”, nga autorët Anastas Angjeli dhe Adrian Civici. Duke ndjekur problematikat shëndetësore, zhvillimet ekonomike, dhe përshkruar vendimmarrjen e autoriteteve, ata kanë analizuar e përshkruar qartë mekanizmin e kësaj krize dhe të politikave ekonomike e financiare të ndërmarra si përgjigje ndaj saj.

Pandemia COVID-19 ka venë autoritetet përballë zgjedhjeve të vështira dhe komplekse dhe ka thëlluar edhe me tej problematikat me të cilat përballen shoqëritë tona dhe njerëzimi në nivel global. Autoritet kryejnë vendimmarrje të shpejta për t'ju përgjigjur zhvillimeve të papritura. Politikat e adaptuara kanë imponuar ndryshimin e atyre tradicionale me ato jokonvencionale që kanë sjellë ndryshime të rëndësishme, jo vetëm në mënyrën e operimit të institucioneve, por edhe në ndryshimin e mandateve e objektivave të tyre.

Pas një periudhe relativisht të gjatë e të vrullshme politikëbërjeje, autoritetet janë duke i vlerësuar këto politika. Vlerësimi kryhet jo vetëm për të matur suksesin e tyre, por edhe për të kuptuar efektet potenciale dytësore që ato mund të transmetojnë në ekonomi dhe shoqëri në përgjithësi.

“Përmes një kombinimi të ngjarjeve, historisë dhe doktrinave të teorive ekonomike autorët paraqesin një situatë të qartë të problemeve më të mprehta të kohës, si dhe të nevojës për të rishikuar mendimin ekonomik.”

Zanafilla e librit është pikërisht ky diskutim. Përmes një kombinimi të ngjarjeve, historisë dhe doktrinave të teorive ekonomike autorët paraqesin një situatë të qartë të problemeve më të mprehta të kohës, si dhe të nevojës për të rishikuar mendimin ekonomik. Profesorët Angjeli e Civici e zbresin analizën nga niveli teorik në atë praktik, duke dhënë rekomandime konkrete mbi politikëbërjen dhe duke u ndalur në rastin e ekonomisë shqiptare.

Ky diskutim i hap rrugën një analize të thelluar të krizës mbi ekonominë shqiptare, e cila sipas tyre ka goditur kryesisht bizneset e vogla. Analiza paraqet përgjigjen e autoriteteve dhe vlerëson ndikimet e politikave të ndërmarra në ekonomi dhe në sektorët e veçantë të saj. Autorët përmbledhin e krahasojnë vlerësimet e kryera nga institucionet shqiptare dhe ato ndërkombëtare, si dhe paraqesin një vlerësim të thelluar mbi efektet e pandemisë në kuadrin e përgjithshëm makroekonomik e financiar. Ata identifikojnë vulnerabilitetet dhe çështjet ekonomike e financiare që meritojnë të trajtohen me kujdes të veçantë. Një vëmendje e posaçme i kushtohet ndryshimeve strukturore në sistemin financiar dhe në tregjet e punës e të edukimit. Sa më sipër e këthen fokusin e diskutimit mbi drejtimit themelore që do të përcaktojnë edhe potencialet e rritjes e të zhvillimit në të ardhmen afatmesme e afatgjatë.

Pa dashur të përsëritëm, theksoj se profesorët pohojnë me korrektësi që ky transformim nuk do të ndalet vetëm tek sistemi bankar por do të shtrihet në të gjithë ekonominë shqiptare. Transformimi duhet t'i përgjigjet zhvillimeve sektoriale, ndryshimeve strukturore dhe tendencave të digjitalizimit që do të prekin ekonominë. Orientimi i programeve edukuese duhet të mbajë parasysh zhvillimet ekonomike e tregtare në rrafshin global. Këto janë veçanërisht të rëndësishme për një ekonomi të vogël e të hapur si e jona.

Pas një përshkrimi të hollësishëm të paketave të ndihmës dhe të situatës financiare e ekonomike të bizneseve, libri paraqet një shpjegim të saktë

të suksesit dhe të efekteve që pati vendimarrja e autoriteteve të biznesit dhe në ekonomi. Në këtë kuptim libri i ofron lexuesve një mundësi për të vlerësuar ndikimet e politikave nga një këndvështrim i pavarur dhe kritik. Ai ofron gjithashtu një mundësi për të optimizuar e koordinuar politikëbërjen në të ardhmen.

Autorët me të drejtë konstatojnë se revolucioni digjital është një mundësi e madhe për zhvillimin e sistemit bankar dhe përfshirjen e shpejtë dhe të sigurt financiare të ndërmarrjeve. Ky është gjithashtu edhe një rast i volitshëm për krijimin e instrumenteve fleksibël që mundësojnë përgjigje të shpejta ndaj goditjeve negative dhe garantojnë stabilitetin financiar të bizneseve dhe ekonomisë. Digjitalizimi do të pasurojë gjithashtu me aktorë dhe shërbime të reja sistemet bankare e financiare.

“... revolucioni digjital është një mundësi e madhe për zhvillimin e sistemit bankar dhe përfshirjen e shpejtë dhe të sigurt financiare të ndërmarrjeve. Ky është gjithashtu edhe një rast i volitshëm për krijimin e instrumenteve fleksibël që mundësojnë përgjigje të shpejta ndaj goditjeve negative dhe garantojnë stabilitetin financiar të bizneseve dhe ekonomisë.”

Gjatë krizës njerëzimi, por edhe shoqëria shqiptare u përball me zgjedhje dhe dilema shumë të forta. Zgjedhja e vështirë mes ekonomisë dhe shëndetit evidentohet nga autorët si një dilemë themelore dhe më e vështira me të cilën u përballen autoritetet. Megjithatë në analizën e mëtejshme shtjellohet se zgjedhja mes ekonomisë dhe shëndetit, e cila dominoi vendimarrjen afatshkurtër nuk është e shkëputur prej vendimarrjeve të tjera me të cilat përballen shoqëritë tona, të tilla si: sundimi i ligjit, barazia përpara tij, si dhe reduktimi i pabarazive ekonomike e financiare. Nëse do t'i shtonim këtyre edhe problematikat mjedisore, si për shembull ngrohja globale, do të kuptojmë se së bashku ato kanë një rol të rëndësishëm për kapacitetin e një shoqërie për të përballuar goditjet negative nga pandemia.

“Gjatë krizës njerëzimi por edhe shoqëria shqiptare u përball me zgjedhje dhe dilema shumë të forta. Zgjedhja e vështirë mes ekonomisë dhe shëndetit evidentohet nga autorët si një dilemë themelore dhe më e vështira me të cilën u përballen autoritetet.”

Siç e thashë edhe më lart, këto sfida kanë peshë themelore për rishikimin e mandatit dhe objektivave të institucioneve, përfshirë edhe të bankave qendrore. Qëndrimi që mbajmë ndaj tyre ka një efekt të drejtë për drejtë për qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të familjeve, bizneseve dhe të gjithë ekonomisë.

Së fundi, dua të them se profesorët me shume zgjuarsi i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë politikave dhe strategjive të adaptuara nga SHBA dhe BE për përballimin e krizës. E theksoj, me zgjuarsi, pasi filozofia e politikave dhe strategjive të zhvilluara dhe instrumenteve të adaptuar në dy ekonomitë më të mëdha të tregut, janë jo vetëm një objekt i rëndësishëm studimi nga këndvështrimi akademik, por shërbejnë edhe si një udhëzues për të gjitha ekonomitë e tjera. Për më tepër, ekonomitë e zhvilluara janë partnerët kryesorë të ekonomive të vogla dhe të hapura. Ato emetojnë dy monedhat dominuese për ekonominë dhe financat botërore. Për të gjitha këto arsye zhvillimet në SHBA dhe në BE kanë një vlerë të madhe dhe ndikim të drejtëpërdrejtë në ekonominë tonë. Rrjedhimisht duhet të mbahen parasysh në kontekstin e vendimmarrjes ekonomike e financiare.

Në mbyllje, dëshiroj të përgëzoj Prof. Angjelin e Prof. Civicin për punën dhe përkushtimin gjatë analizës së shkëlqyer të efekteve ekonomike, financiare e shoqërore që COVID-19 solli në ekonominë botërore e atë shqiptare. Jam i bindur se analizat, komentet dhe rekomandimet e autorëve do të jenë shumë të vlefshme për institucionet dhe politikëbërësit.

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË HAPJEN E FUSHATËS NDËRGJEGJËSUESE “AS I VJETËR E AS I RI, JAM THJESHT LEK!”

-17 nëntor 2021-

I nderuar Prof.Dr. Civici,

E nderuar Dr. Treska,

Të nderuar pjesëmarrës, kolegë e gazetarë,

Kam kënaqësinë t'ju uroj mirëseardhjen në këtë aktivitet të organizuar nga Banka e Shqipërisë, me rastin e hapjes së fushatës ndërgjegjësuese “As i vjetër e as i ri, jam thjesht Lek!”. Kjo iniciativë e re e institucionit tonë në lëmin e edukimit financiar të publikut nuk është e vetme, por bën pjesë në një korpus të gjerë programesh dhe projektsh në kuadër të njohjes dhe përkujdesjes për monedhën dhe kartëmonedhën kombëtare.

Ajo është gjithashtu kurorëzimi i përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë në përmbushje të rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutat për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit tonë, për përdorimin e termave të gabuar “lek i ri” dhe “lek i vjetër”. Të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm, se për fat të keq, kjo ndodh rëndom jo vetëm në komunikimin e përditshëm të qytetarëve me njëritjetritin, por edhe në marrëdhëniet e tyre ekonomike dhe financiare, duke u kthyer kështu në burim për keqkuptime të qëllimshme ose jo.


“Kjo iniciativë e re e institucionit tonë në lëmin e edukimit financiar të publikut nuk është e vetme, por bën pjesë në një korpus të gjerë programesh dhe projektsh në kuadër të njohjes dhe përkujdesjes për monedhën dhe kartëmonedhën kombëtare.”

Por, përpara se të vijoj me parashtrimin e fushatës, më lejoni të them dy fjalë mbi kontekstin historik të lindjes së këtij fenomeni. Reforma monetare e vitit 1965 solli zëvendësimin e kartëmonedhave të mëparshme Lek me kartëmonedha të reja, në raportin 10 me 1, duke ndryshuar në të njëjtën shkallë shprehjen e çmimeve, pagave dhe të çdo veprimi tjetër financiar. Pra, që prej asaj kohe, një pjesë e mirë e publikut nuk është përshtatur ende me këtë ndryshim dhe komunikim me “lekë të vjetër”, duke shkaktuar konfuzion në komunikimin e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve dhe leximin e drejtë të treguesve ekonomikë e financiarë.

Edhe përpara çeljes së kësaj fushate ndërgjegjësuese, të shtyrë në kohë për shkak të vështirësive të shkaktuara nga kufizimet e gjendjes së pandemisë COVID-19, Banka e Shqipërisë në vazhdimësi është kujdesur që ta përfshijë këtë mesazh në botimet dhe programet e saj edukative, siç është p.sh. Java Globale e Parasë apo fushata për hedhjen në qarkullim të prerjeve të reja të kartëmonedhave.

Ndërkohë së fundmi, kemi kryer matjen e shkallës së përdorimit të terminologjisë “lek i ri - lek i vjetër” në bazë kombëtare, përmes përfshirjes së disa pyetjeve në anketën për matjen e kulturës financiare të popullsisë shqiptare të krijuar sipas modelit të Rrjetit Ndërkombëtar për Edukimin Financiar (INFE, OECD). Analiza e këtyre pyetjeve jep informacion mbi shkallën e përdorimit të gabuar të terminologjisë sipas vendbanimit, grup-moshave, gjinisë, arsimimit, punësimit dhe nivelit mesatar të të ardhurave, si dhe ambienteve ku përdoret më shpesh, me qëllim përshtatjen e fushatës së ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë për heqjen e termit “lek i ri - lek i vjetër”.

Grafik 26. Leximi i vlerës së kartëmonedhës (majtas) dhe ambienti ku komunikohet më shumë me “lekë të vjetër” (djathtas)



Burimi: Vrojtimi për Matjen e Kulturës Financiare (2019), Banka e Shqipërisë.

Rezultatet e mbledhura nga anketa tregojnë se të vendosur përballë një kartëmonedhe 500 Lekë më shumë se gjysma (54%) e të intervistuarve instinktivisht e lexojnë apo e identifikojnë gabim vlerën e saj, duke i shtuar një 0 për ta kthyer në “lek të vjetër”. Situatat apo ambientet në të cilat të anketuarit shprehen se flasin rëndom, në mbi 80% të rasteve, me “lek të vjetër”, janë kryesisht ambientet joformale apo familjare: dyqanet e vogla apo tregjet e fruta/perimeve; bisedat me familjarë, miq dhe

kolegë; të ndjekur nga mjetet e transportit publik. Nga ana tjetër, të dhënat dëshmojnë se komunikimi i gabuar i vlerës së lekut ndodh shumë më rrallë në institucione financiare (banka, jobanka etj.) me vetëm 28.1%, apo në zyra të administratës publike (39.4%), megjithëse mund të pritej që këto shifra të ishin edhe më të ulëta.

Përveç institucioneve shtetërore dhe financiare, një faktor tjetër vendimtar që e ndikon mënyrën e komunikimit të publikut është edhe media, si ajo e shkruar ashtu edhe ajo audio-vizuale. Sipas perceptimit të 20% të publikut, mediat i komunikojnë gjithmonë ose shpesh çmimet dhe vlerat monetare në “lekë të vjetër”. Kjo përqindje, megjithëse e ulët, nxjerr në dritë nevojën për më shumë përfshirje të mediave në përpjekjen për ta zhdukur plotësisht këtë fenomen, veçanërisht duke pasur parasysh detyrimin e saj për përcjelljen e informacionit të vërtetë dhe të saktë tek publiku, si dhe rolin edukativ të saj.

Sa i përket analizës sipas grupeve socio-demografike, rezultatet e vërtetimit tregojnë se vlerën monetare në “lek të vjetër” e komunikojnë më shpesh: (i) meshkujt; (ii) personat e moshuar; (iii) individët me nivel më të ulët arsimor; (iv) individët joaktivë në tregun e punës; si dhe (v) ata me nivel të ulët të të ardhurave familjare. Pikërisht këto grupe të identifikuar nga vërtetimi do të përbëjnë edhe fokusin e projekteve ndërgjegjësuese të fushatës për eliminimin e përdorimit të terminologjisë së gabuar “Lek i ri/Lek i vjetër”.

Për të gjitha këto arsye, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë këtë fushatë ndërgjegjësuese që po çelim sot, e cila do të shtrihet në kohë dhe do të synojë të jetë sa më gjithpërfshirëse, duke prekur grupe të ndryshme interesi. Në një periudhë afatmesme dhe përmes kanaleve të shumëllojta, synojmë të trokasim në dyert e të gjithë shqiptarëve për çrrënjosjen e termave “i ri” apo “i vjetër”, duke shmangur konfuzionin në komunikimin e çmimeve dhe në leximin e treguesve ekonomikë e financiarë. Në Shqipëri, monedha kombëtare është Leku dhe vlera nominale e çdo monedhe apo kartëmonedhe është ajo e shkruar mbi të.

Megjithatë, fakti që ky keqpërdorim është trashëguar në të folurën e përditshme dhe i ka rezistuar kohës për mbi 55 vjet, dëshmon që përpjekjet sporadike dhe të izoluar të një institucioni të vetëm për ta korrigjuar

“... fakti që ky keqpërdorim është trashëguar në të folurën e përditshme dhe i ka rezistuar kohës për mbi 55 vjet, dëshmon që përpjekjet sporadike dhe të izoluar të një institucioni të vetëm për ta korrigjuar fenomenin, nuk mjaftojnë.”

fenomenin, nuk mjaftojnë. Nevojitet një angazhim i përbashkët dhe i koordinuar mes institucioneve qendrore të vendit, mediave dhe aktorëve të tjerë relevantë. Veçanërisht i rëndësishëm për suksesin e kësaj fushate është roli i medias, e cila me fuqinë e përçimit të mesazheve në publik, ka aftësinë të ndikojë mendësinë dhe normën e komunikimit të publikut të gjerë. Një tjetër aktor me rëndësi për krijimin dhe ngulitjen e një mendësie të re, ka edhe shkolla, e cila mund të ndikojë në ndërprerjen e një zinxhiri 55-vjeçar dhe mos përcjelljen e tij tek brezi i ri.

Në emër të Bankës së Shqipërisë, ftoj të gjitha institucionet pjesëmarrëse dhe jo vetëm, të na bashkohen në angazhimin tonë për të edukuar publikun shqiptar që të lërë pas njëherë e përgjithmonë përdorimin e kësaj terminologjie të gabuar në marrëdhëniet ekonomike e financiare, për ta kthyer atë përfundimisht në një relikto linguistik.

Ju falënderoj përzemërsisht për kontributin tuaj dhe ju kujtoj se monedha jonë nuk është as e vjetër e as e re, por është thjesht Lek!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË ÇELJEN E PUNIMEVE TË WORKSHOP- IT XV TË KËRKIMEVE EKONOMIKE PËR EVROPËN JUGLINDORE -6 dhjetor 2021-

Të nderuar profesorë dhe studiues nga akademja,

Të nderuar kolegë dhe studiues të bankave qendrore,

Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi të hap punimet e Workshop-it XV të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, të cilin edhe këtë vit po e organizojmë online për shkak të kufizimeve që vazhdojnë të mbeten në fuqi si pasojë e pandemisë. Përfitoj nga rasti t'ju uroj të gjithëve shëndet dhe sa më pak probleme të shkaktuara nga COVID-19. Shpresoj se vaksinimi, avancimi i njohurive e kurave për COVID-19 dhe lehtësimi i pandemisë do të na mundësojnë që vitin tjetër të mund t'ju mirëpresim në Tiranë. Vërej me kënaqësi se

edhe këtë vit kemi një pjesëmarrje të gjerë dhe një program të pasur, ku në dy ditët e aktivitetit do të prezantohen punët e kolegëve dhe kërkuesve nga bankat qendrore dhe universitetet prestigjioze brenda dhe jashtë vendit. Duke vlerësuar shumë interesimin tuaj për pjesëmarrje dhe punimet kërkimore në Bankën e Shqipërisë gjatë vitit 2021, shpreh bindjen se do të keni diskutime interesante në të gjitha panelet e Workshop-it.

Organizimi i përvitshëm i këtij workshop-i, na ka shërbyer jo vetëm për këmbimin e eksperiencave me bankat qendrore të vendeve pjesëmarrëse, por kanë pasuruar punën kërkimore e përmes kësaj janë bërë pjesë integrale e formulimit të politikave. Ato kanë dhënë një kontribut të vlefshëm për konfirmimin e modeleve dhe interpretimin e rezultateve të kërkimit që mundësojnë hartimin, kalibrimin dhe implementimin e masave për përbalimin e pandemisë dhe goditjeve të ngjashme. Konkluzionet, komentet dhe diskutimet tuaja u vijnë në ndihmë autorëve tanë të

“Organizimi i përvitshëm i këtij workshop-i, na ka shërbyer jo vetëm për këmbimin e eksperiencave me bankat qendrore të vendeve pjesëmarrëse, por kanë pasuruar punën kërkimore e përmes kësaj janë bërë pjesë integrale e formulimit të politikave.”

përmirësojnë studimet, e përmes, kësaj kontribuojnë në formulimin dhe vendimmarrjen e politikave në bankën qendrore. Evidencat, analizat dhe parashikimet e bazuara në punën që ju do të paraqisni në këto dy ditë do të ofrojnë informacion të saktë dhe të vlefshëm për orientimin dhe koordinimin e vendimmarrjes edhe në të ardhmen.

Këtë vit do të prezantohen e diskutohen 20 punime, të cilat pavarësisht se mbulojnë një gamë të gjerë tematikash mbeten të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin dhe interesin e bankës qendrore. Kemi prekur pothuajse të njëjtat tema edhe një vit më parë, megjithatë kushdo që ndjek debatin aktual të bankingut qendror, mund të thotë me habi: "Kush është diferenca krahasuar me një vit më parë?".

E them këtë sepse kujtoj se vjet diskutimi fokusohej te politika monetare moderne, sipas të cilës bilanci i bankës qendrore mund e duhet të përdoret gjerësisht si një instrument i përhershëm i politikës monetare për të nxitur kërkesën agregate.

"Tema që mbizotëron sot diskutimin e politikës monetare, është shqetësimi për inflacionin e vërejtur së fundi dhe jetëgjatësinë e tij. Zhvillimet e fundit inflacioniste i kanë ndarë akademikët dhe bankierët qendrorë në dy kampe që mbajnë qëndrime diametralisht të kundërta."

Ndërkohë, tema që mbizotëron sot diskutimin e politikës monetare, është shqetësimi për inflacionin e vërejtur së fundi dhe jetëgjatësinë e tij. Zhvillimet e fundit inflacioniste i kanë ndarë akademikët dhe bankierët qendrorë në dy kampe që mbajnë qëndrime diametralisht të kundërta. Në njërin anë janë ata që mendojnë se inflacioni aktual është një fenomen i rrezikshëm që rrezikon të nxisë një situatë inflacioniste e rrjedhimisht kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme për të zhbërë politikën e bilancit e rritjen e normave të interesit. Në anën tjetër, qëndron grupi i cili

mendon se zhvillimet aktuale të inflacionit janë fenomene të përkohshme, të nxitura nga problematikat e ofertës që reflektojnë efektet negative të pandemisë. Kuptohet që këto pikëpamje diametralisht të kundërta ndërmjet ekonomistëve tregojnë se puna për përmirësimin e modeleve të inflacionit nuk duhet të ndalet, sidomos kur edhe pas gjithë këtyre viteve pune dhe kërkimi për njohjen e fenomenit të inflacionit përsëri kemi dyshime dhe qëndrime të dyzuara.

Ashtu siç parashikuam në workshop-in e vitit të kaluar, pasiguria e lartë për prodhimin dhe shpërndarjen janë faktorë që mbajnë peng rimëkëmbjen. Pandemia duket se ka ngritur barriera për globalizimin dhe kjo pritet të

ketë efekte të rëndësishme në ekonomi. Kombinimi i këtyre dy efekteve e ka dhënë ndikimin e vet të menjëhershëm te çmimet, duke nxitur rritjen e inflacionit si pasojë e këtyre efekteve të ofertës. Megjithatë, ky nuk është një konkluzion i qartë. Jo pak zëra nga bota akademike dhe ajo e bankngut qendror mendojnë se inflacioni mund të jetë efekt edhe i politikave ekspansioniste të bankave qendrore. Natyrisht qëndrimet e kundërta vijnë si rezultat edhe i paqartësive mbi efektet, gjeografinë dhe masën me të cilën pandemia ka prekur ekonominë. Prandaj studimet mbi efektet e pandemisë duhet të vazhdojnë. Ndërkohë, që është e qartë se të gjitha modelet, sado të mira të jenë, kanë nevojë për interpretim nga këndvështrimi i ngjarjeve të momentit dhe fenomeneve mbisunduese të kohës.

Të nderuar pjesëmarrës,

COVID-19 me problematikat dhe kufizimet e tij, vazhdon të mbetet një faktor dominant i jetës dhe aktivitetit ekonomik e shoqëror dhe natyrisht është pjesë e rëndësishme e analizës dhe kërkimit edhe për bankën qendrore. Kjo nuk është një surprizë dhe mendoj se goditja që pandemia shkaktoi dhe efektet e saj do të vazhdojnë të mbeten në agjendat e kërkimit për një kohë të gjatë edhe pas mbarimit të saj.

E megjithatë, zhvillimet e vitit të fundit tregojnë se agjendat e kërkimit të bankave qendrore janë pasuruar me studimin e rreziqeve të tjera, si ato që lidhen me ndryshimin e klimës e mjedisin, rreziqet demografike, digjitalizimi dhe monedhat digjitale etj. Këto janë identifikuar si sfida të mëdha e afatgjata për ekonominë globale dhe autoritetet e çdo vendi. Banka e Shqipërisë ka filluar punën për krijimin e infrastrukturës për modelimin dhe analizën e këtyre fenomeneve. Është e rëndësishme që për këto tema të mos mendohet vetëm në formën e testimit të hipotezave apo diskutimeve akademike, por të mendohet më shumë në kuadrin konkret të politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Jam i sigurt se ato do të bëhen tema të rëndësishme diskutimi Workshop-it tonë të Kërkimeve në të ardhmen.

“Zhvillimet e vitit të fundit tregojnë se agjendat e kërkimit të bankave qendrore janë pasuruar me studimin e rreziqeve të tjera, si ato që lidhen me ndryshimin e klimës e mjedisin, rreziqet demografike, digjitalizimi dhe monedhat digjitale etj.”

Duke uruar që të keni dy ditë të mbushura me diskutime dhe komente produktive, ju ftoj në panelet e prezantimeve dhe diskutimeve frytdhënëse!

FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË TAKIMIN PËRMBYLLËS TË VITIT, TË ORGANIZUAR NGA SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE -16 dhjetor 2021-

I nderuar zoti Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave,

Të nderuar drejtues dhe kolegë të sistemit bankar në Shqipëri,


Të nderuar zonja e zotërinj!

Është një kënaqësi të rikthehem bashkë me ju në takimin tradicional të fund vitit, të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, veçanërisht pas dy viteve shkëputjeje, për shkak të masave të marra në kuadër të pandemisë. Rikthimi dhe pjesëmarrja në këtë aktivitet merr rendësi të veçantë për të ndarë së bashku përvojat, momentet kyçe, sfidat, dhe pse jo, edhe arrijtet tona gjatë dy viteve të fundit, vite të cilat na vunë para një situatë të paprecedentë.

Më lejoni të ndalem fillimisht në ecurinë e përgjithshme ekonomike të vendit në vitin 2021.


Grafik 27.

Rritja ekonomike është përshpejtuar ndjeshëm me mbështetje si nga "prodhimi" ashtu edhe nga "shërbimet"



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Pothuajse të gjithë sektorët e aktivitetit ekonomik kanë kapur nivelet e periudhës para goditjes nga tërmeti dhe pandemia



Shënim: Vlera e situar e sektorëve të ekonomisë, e rregulluar sezonalisht, dhe e kthyer në indeks me bazë tremujorin e tretë 2019.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekonomia shqiptare ka treguar një rimëkëmbje të dukshme gjatë vitit 2021, duke tejkaluar pritshmëritë tona fillestare. Ritmi i vazhduar pozitiv i rritjes ekonomike është i fortë, me bazë të gjerë dhe i prekshëm. Prodhimi i brendshëm bruto tashmë ka arritur nivelin e parakrizës; punësimi po rimëkëmbet; bilanci financiarë janë rritur; ndërsa treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar janë përmirësuar.


Në këtë drejtim, më lejoni të theksoj se burimet e rritjes ekonomike i janë rikthyer tendencës së tyre rritëse dhe asaj të diversifikimit të duhur. Nga ana e kërkesës agregate, rigjallërimi i rritjes ekonomike u mbështet nga ecuria në rritje e eksporteve të mallrave e shërbimeve, si dhe nga rritja e konsumit dhe investimeve të brendshme.

Në këndvështrimin sektorial, zgjerimi i aktivitetit ekonomik reflektoi në masë të konsiderueshme rimëkëmbjen e sektorit të industrisë dhe të atij të shërbimeve. Nga këndvështrimi i politikave të ndjekura, falë stimujve të fuqishëm fiskalë dhe monetarë, u mundësua vazhdimësia e rimëkëmbjes ekonomike. Për më shumë, kjo reflekton një kërkesë të huaj në rritje, bilance të qëndrueshme të sektorit privat dhe optimizëm më të lartë të bizneseve dhe individëve.

Ekonomia shqiptare zotëron të gjitha parakushtet për një rrije ekonomie të qëndrueshme dhe të mbështetur në të ardhmen, ndërsa çelja e pritjeve dhe negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian do të forconte rritjen ekonomike dhe do të nxiste investimet e huaja dhe ato vendase.

Sektori bankar shqiptar, edhe këtë vit, vijoi tendencën e tij të ecurisë pozitive dhe u shfaq i qëndrueshëm ndaj goditjeve nga jashtë (efekteve prej dy vjetësh të pandemisë). Veprimtaria e sektorit vijoi të zgjerohej (mbi 9%), mbështetur kryesisht nga depozitat vendase (mbi 80% e aktiveve), por pa ndikuar kapitalizimin e përgjithshëm të sistemit bankar (18.4%), falë shtesave të rritura të kapitalit dhe politikave të kujdesshme të dividendit, të ndjekura nga bankat, në bashkëpunim të plotë me Bankën e Shqipërisë. Fitimi është përmirësuar ndërsa likuiditeti mbetet i lartë.

Grafik 28. Depozitat sipas afatit dhe valutës (majtas) dhe depozitat sipas afatit dhe sektorit (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Portofoli i kredive tregon një rritje të mirëdiversifikuar (+10 në total), si në lekë dhe në monedhë të huaj, për biznese, për kredi për tregti me pakicë dhe atë hipotekare.

Raporti i kredive me probleme është ulur (nga 8.13% në 6.3%), duke përfituar nga rritja e portofolit total të kredive dhe nga reduktimi i kredive me probleme (-17%). Përveç rënies së shifrave të kredive me probleme, raporti i mbulimit total u përmirësua (nga 65% në 70%).

Grafik 29. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjone



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithatë, ende ka hapësirë të bollshme për rritjen e kredisë, duke pasur parasysh rezervat e bollshme likuide, raportet kredi/depozitë në nivele të ulëta dhe fitimin pozitiv, të cilët mund të mbështesin plotësisht kapitalin.

Të nderuar përfaqësues të sektorit bankar,

Në kontekstin e këtyre dy viteve të vështira, perspektiva e rritjes ekonomike në Shqipëri është pozitive dhe optimiste, ndërsa i ofron sistemit bankar një bazë mbështetëse solide për të zgjeruar veprimtarinë e tij, nëpërmjet angazhimit, përpjekjeve dhe devotshmërisë së të gjithë aktorëve.

Më lejoni të ndaj me ju disa nga sfidat e përbashkëta me të cilat do të përballemi në vitet në vijim.

Së pari, sektori bankar do të vijojë të konsolidohet më tej vitin që vjen, pas blerjes 100% të aksioneve të Alpha Bank sh.a. nga OTP NYRT. Ky zhvillim pritet të sjellë rritje të konkurrencës, veçanërisht ndërmjet aktorëve më të mëdhenj të tregut. Portofoli i kredive mbetet kontribuuesi kryesor në të ardhurat e bilanceve, dhe për të mbajtur pozicion konkurrues, bankat duhet ta ruajnë dhe ta rrisin atë në vazhdimësi. Ndërkohë që tregu ofron mundësi për rritje të kreditimit dhe bankat kanë likuiditet dhe mjaftueshmëri të kapitalit, është e domosdoshme të krijohet një vizion afatgjatë dhe të përcaktohen objektiva strategjike, të hartuar me kujdes për të shfrytëzuar këtë potencial në afatgjatë, me qëllim ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme në bankë dhe forcimin e marrëdhënieve me klientët.

“Sektori bankar shqiptar, edhe këtë vit, vijoi tendencën e tij të ecursë pozitive dhe u shfaq i qëndrueshëm ndaj goditjeve nga jashtë (efekteve prej dy vjetësh të pandemisë).”

Së dyti, Banka e Shqipërisë, si autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e 90% të tregut financiar, luan një rol të rëndësishëm në procesin e përafrimit të kuadrit ligjor me atë të Bashkimit Evropian. Pjesë e këtij procesi janë dhe kërkesat shtesë të kapitalit, të cilat u prezantuan gjatë vitit të kaluar. Qëllimi ynë është prezantimi i kujdesshëm i këtyre kërkesave, pa dëmtuar konkurrencën e bankave individuale dhe kufizuar potencialin e tyre për rritje. Ky proces shtrihet në një kuadër kohor afatgjatë

dhe gjatë këtij afati, ne do të monitorojmë nga afër progresin e krijimit të kapitalit të nevojshëm dhe plotësimin e Kërkesës Minimale për Kapital dhe Detyrime të pranuar (MREL), si dhe do të kalibrojmë me kujdes dhe fleksibilitet kërkesat agregate për kapital, me qëllim që të mos pengohet

rritja organike dhe e shëndetshme e veprimtarisë bankare. Ndërkohë, fitimi pozitiv ofron një mbështetje të sigurt për rritjen e kapitalit.

Së treti, ndërsa kemi qenë të vendosur për të prezantuar për herë të parë tavanin e Normës Efektive të Interesit (NEI), kemi kuptuar se këto rregullore të reja do të kenë efekte operacionale dhe financiare në tregun tonë. Në vitin 2021, Banka e Shqipërisë nisi një proces gjithëpërfshirës konsultimi në lidhje me ndryshimet rregullative sa i përket prezantimit të tavanit për NEI. Këto ndryshime u bënë të nevojshme, pas zgjerimit të tregut të kredive konsumatore, me qëllim reduktimin e asimetrive brenda këtij tregu dhe në përmbushje të rolit të Bankës së Shqipërisë në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit dhe përfshirjen financiare. Kemi marrë opinione të ndryshme nga aktorët e tregut (kryesisht pozitive) dhe në pjesën më të madhe, komentet e sugjerimet e tyre i kemi reflektuar. Në këtë kontekst, ne do të jemi të përgatitur dhe fleksibël për të siguruar një kalim të kalibruar e të butë në këtë drejtim. Vitin tjetër, do të vazhdojmë dialogun me industrinë, pasi të kemi rezultatet e zbatimit të tavanit për NEI dhe veçanërisht atij të penaltiteve për huatë konsumatore, e cila është dhe pjesa më e debatuar.

Së katërti, infrastruktura financiare e sektorit bankar është konsoliduar më tej gjatë dy viteve të fundit. Banka e Shqipërisë dhe Komiteti Kombëtar i Sistemeve të Pagesave kanë zbatuar një strategji kombëtare për fuqizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe rritjen e përfshirjes financiare të qytetareve. Rezultatet e para janë premtuese dhe do të ndiqen nga hapa të tjerë që do të ndërmarrë Banka e Shqipërisë dhe sektori bankar, të cilat kanë si objektiv, dyfishimin e numrit të qytetarëve që kanë një llogari bankare në vitin 2023. Së shpejti, ne do të prezantojmë edhe sistemin e ri të pagesave për shlyerjen e pagesave në monedhën Euro në Shqipëri. Ky sistem ka për qëllim të rrisë efektivitetin e këtij segmenti të tregut, duke ulur kostot e mbartura nga bankat nëpërmjet zgjidhjeve aktuale, të cilat kanalizohen tek klienti i fundit dhe më tej. Kjo do të shërbejë gjithashtu për të forcuar formalizimin e ekonomisë shqiptare.

Në mbyllje, më lejoni të rikonfirmoj dhe të ritheksoj përkushtimin dhe qëndrimin e palëkundur të Bankës së Shqipërisë për të qenë gjithnjë transparente, e hapur dhe mbështetëse ndaj sektorit bankar, gjatë gjithë veprimtarisë së saj.

Duke ju uruar festat, ju falënderoj për vëmendjen!

Qoftë viti i ardhshëm, një vit i begatë për të gjithë ju dhe familjet tuaja!

**FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS
SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO, NË
TAKIMIN E FUNDVITIT ME GAZETARË,
ANALISTË DHE DREJTUES TË MEDIAS
DHE CEREMONINË E SHPALLJES SË
FITUESVE TË ÇMIMIT TË GUVERNATORIT
PËR DIPLOMËN MË TË MIRË 2021
-20 dhjetor 2021-**

Të nderuar analistë dhe gazetarë,

Të nderuar studentë,

Të nderuar kolegë e pjesëmarrës,

Pas një periudhe të vështirë për shkak të pandemisë që na detyroi të ruajmë distancat nga njëri-tjetri, ritakimi në mjediset e Bankës së Shqipërisë për të kaluar pak kohë së bashku në këtë prag festash, merr një vlerë të veçantë. Përgjithësisht takimet e fundvitit që shoqërojnë periudhën festive, shërbejnë si një bilanc për të na kujtuar arritjet e një viti që përgatitemi të lëmë pas, si dhe sfidat që kemi përpara për vitin e ri.

Këto dy vitet e fundit kanë qenë veçanërisht sfiduese për të gjithë globin dhe në mënyrë të veçantë për vendin tonë, i cili përveç pandemisë u përball edhe me sproven e tërmetit shkatërrues të nëntorit 2019. Takimi i sotëm na bën optimistë dhe na jep shpresë se në të ardhmen do të kemi mundësi të komunikojmë e të bashkëpunojmë në kushte normale dhe larg shqetësimeve e kufizimeve të pandemisë. Goditjet me të cilat u përballëm gjatë dy viteve të fundit ndikuan fort mënyrën tonë të jetesës, testuan ekuilibrat ekonomikë, monetarë dhe financiarë të vendit, si dhe qëndrueshmërinë e burimeve të rritjes. Ato na tregojnë se qëndrueshmëria e stabiliteti ekonomik e financiar varen jo vetëm nga puna e institucioneve monetare por edhe nga aftësia dhe kapaciteti i shoqërisë për të vepruar me

“Takimi i sotëm na bën optimistë dhe na jep shpresë se në të ardhmen do të kemi mundësi të komunikojmë e të bashkëpunojmë në kushte normale dhe larg shqetësimeve e kufizimeve të pandemisë.”

shpejtësi dhe efikasitet në luftën kundër pandemisë; së pari dhe mbi të gjitha në aspektin shëndetësor, ku vaksinimi dhe me shpresë kurat që do të zhvillohen, shndërrohen në instrumente të fuqishme për kufizimin e efekteve të pandemisë në ekonomi e në financë.

Lajmi i mirë është se sipas analizave të Bankës së Shqipërisë, rimëkëmbja ekonomike, arritja e objektivit të çmimeve dhe ruajtja e stabilitetit financiar po materializohen sipas parashikimeve optimiste të Bankës së Shqipërisë. Vazhdimi i politikave stimuluese monetare dhe fiskale garantuan stabilitetin monetar edhe financiar të vendit, nxitën kreditimin me kosto të ulët të aktivitetit ekonomik, si dhe lehtësuan barrën që zgjatja e pandemisë vendosi mbi sektorin privat dhe familjet.

“Politikëbërja e kujdesshme është mbështetur dhe ka përfituar nga roli i rëndësishëm që media dhe ju keni luajtur për zbërthimin dhe përcimin e saktë të mesazhit të politikës te publiku dhe ndërgjegjësimin e tij.”

Politikëbërja e kujdesshme është mbështetur dhe ka përfituar nga roli i rëndësishëm që media dhe ju keni luajtur për zbërthimin dhe përcimin e saktë të mesazhit të politikës te publiku dhe ndërgjegjësimin e tij. Pandemia me kufizimet e saj jo vetëm që vendosi një barrierë në komunikimin me publikun duke rritur distancën me institucionet, por mbi të gjitha mori pjesën dërrmuese të hapësirës së informimit në media dhe të vëmendjes së publikut. Rrjedhimisht, më duhet të përgëzoj e të falënderoj të gjithë gazetarët (në veçanti ata të ekonomisë), të cilët falë angazhimit profesional dhe me integritet ndihmuan publikun e gjerë në përvetësimin e vendimmarrjes së autoriteteve monetare dhe fiskale gjatë kësaj situatë të jashtëzakonshme.

Profesionalizmi në ndërtimin dhe transmetimin e lajmit dhe analizës ekonomike ka qenë një ndihmë e vyer dhe një domosdoshmëri për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve e atij financiar. Më lejoni që t’ju falënderoj edhe një herë për punën dhe përkushtimin e treguar gjatë këtij viti. Shpreh besimin tim se edhe vitin në vijim, puna juaj do të vazhdojë të karakterizohet nga pasqyrimi me vërtetësi dhe objektivitet i lajmit ekonomik dhe financiar!

Ju siguroj se Banka e Shqipërisë do të vijojë të jetë një institucion transparent, i gatshëm të japë opinionet dhe vlerësimet e saj në të gjitha debatet publike që lidhen me ecurinë e ekonomisë së vendit dhe tregjet financiare. Dëshmi e këtij angazhimi dhe e suksesit të Bankës së Shqipërisë në komunikimin me publikun është edhe renditja në vendin

e parë nga të gjitha bankat e vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, për komunikimin mjaft aktiv me publikun, kryer së fundmi nga Banka Kombëtare e Austrisë në raportin e saj me titull “Fokus mbi Integrimin Ekonomik Evropian” për tremujorin e dytë 2021.

Të nderuar pjesëmarrës,

Edukimi financiar dhe puna kërkimore janë vazhdimisht në fokus të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë, si parakushte të zhvillimit ekonomik-social të vendit dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve të tij. Në këtë drejtim, do të doja ta ktheja vëmendjen në atë që tashmë është kthyer në një traditë tonën, ceremonia e shpërndarjes së Çmimit të Guvernatorit për Diplomën më të Mirë.

“Edukimi financiar dhe puna kërkimore janë vazhdimisht në fokus të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë, si parakushte të zhvillimit ekonomik-social të vendit dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve të tij.”

Sivjet është viti i 15-të, që Banka e Shqipërisë përzgjedh dhe vlerëson tre punime shkencore të përgatitura nga studentë shqiptarë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit. Nga viti në vit, me kënaqësi konstatojmë rritjen e cilësisë së punimeve shkencore të studentëve pjesëmarrës në konkurs, duke i bërë analizat dhe hulumtimet gjithmonë e më profesionale.

Edhe këtë vit, studentët shqiptarë nga universitetet e vendit dhe ato të huaja kanë shfaqur interes duke sjellë në këtë konkurs punët e tyre më të mira. Vërejmë me kënaqësi se pjesëmarrja dhe interesi nga ana e studentëve ka qenë e lartë, duke dëshmuar vlerësimin, besueshmërinë dhe reputacionin e këtij aktiviteti. Në konkursin e sivjetshëm janë paraqitur 25 punime, të cilat karakterizohen nga tema që trajtojnë realitetet e dy viteve të fundit. Ato fokusohen kryesisht në ndikimet ekonomike, financiare e sociale të pandemisë dhe në qëndrueshmërinë e tregut dhe institucioneve financiare ndaj kësaj goditjeje. Nga ana tjetër, nuk mungojnë as

“Vërejmë me kënaqësi se pjesëmarrja dhe interesi nga ana e studentëve ka qenë e lartë, duke dëshmuar vlerësimin, besueshmërinë dhe reputacionin e këtij aktiviteti. Në konkursin e sivjetshëm janë paraqitur 25 punime, të cilat karakterizohen nga tema që trajtojnë realitetet e dy viteve të fundit.”

temat me vështrim nga e ardhmja e tregut financiar, me fokus te efektet e monedhave digjitale; shfrytëzimi i dabazave të mëdha me të dhëna të detajuara për vlerësimin e sjelljes të segmenteve të tregut financiar që kanë qenë jashtë vëmendjes së studimit por që janë të rëndësishëm për

zhvillimin e vendit; duke mos harruar edhe trajtimin e çështjeve të tjera të rëndësishme për vendin si politika fiskale etj.

Temat dhe konkluzionet e tyre bazohen në aplikimin e metodologjive bashkëkohore të kërkimit shkencor, si dhe në shfrytëzimin e një informacioni statistikor granular, të mirë menduar e strukturuar. Mbi të gjitha, ky informacion është shfrytëzuar me rigorozitet sipas standardeve dhe kërkesave akademike për të hulumtuar dhe argumentuar përmes diskutimesh teorike dhe empirike, hipotezat mbi fenomenet dhe ngjarjet ekonomike e financiare.

Për këtë arsye, komisioni e pati të vështirë përzgjedhjen pasi të gjitha temat ishin koherente, interesante e të mirëtrajtuara. Megjithatë arritëm të identifikojmë me sukses ato diferenca të vogla dhe nuanca të spikatura që dalluan temat fituese ndërmjet gjithë punimeve të tjera. Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2021, tashmë, i ka vendosur tre temat fituese. Pavarësisht kësaj, së bashku me tre fituesit, dëshiroj që të përfitoj nga ky rast për të përgëzuar e falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në garë për angazhimin e tyre, për idetë, metodat e përdorura dhe konkluzionet e bazuara në metodologjitë e sakta. Uroj që ky pasion e ky përkushtim t'ju ndjekë gjatë gjithë karrierës tuaj!

Vijojmë me prezantimin e studentëve fitues.

Ju faleminderit dhe gëzuar festat!



MONITOR

VITI XXI | BOTIMET NR. 21 (983) | 24 MAJ - 31 MAJ 2021

Çmimi 500 lekë • 4 EURO

BIZNES • EKONOMI • TREG

www.monitor.al

pensionistët

Gjenerata e varfër e së ardhmes

Page: 20

sektor

Industria e birrës, drejt normalitetit

Page: 26

karantina

Covid 19 shton depresionin

Page: 34

EKONOMIA PAS COVID-19

E POSAÇME

FLET Z. GENT SEJKO, GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË

KAPITULLI V

INTERVISTA

- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin “Argument” në televizionin Scan, 17 maj 2021*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për televizionin Scan, 19 maj 2021*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për revistën “Monitor”, 7 qershor 2021*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për Televizionin News 24, 17 qershor 2021*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për Fax News, 17 qershor 2021*
- *Intervistë e Guvernatorit Sejko për emisionin “Top Talk” në Televizionin Top Channel, 21 qershor 2021*

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN “ARGUMENT” NË TELEVIZIONIN SCAN

-17 maj 2021-

Gazetari: *Mirëmbërëma të gjithëve, përshëndetje, mirë se vini në Scan, mirë se vini në Argument!*

Ne sot ndodhemi në selinë e Bankës Qendrore të Shqipërisë për të folur me Guvernatorin, z. Gent Sejko, pikërisht mbi pritshmëritë dhe analizën e pothuajse gjysmës së vitit 2021 dhe vitin 2020. Jemi këtu për të folur mbi shëndetin e ekonomisë shqiptare, porë në këndvështrimin e ekonomisë reale dhe sigurisht mbarëvajtjen e institucioneve financiare, qofshin këto banka apo institucione financiare jobanka, apo dhe agjentëve të tjerë ekonomikë, që merren me aktivitetin financiar të vendit.

Kemi pyetur Guvernatorin për çështje që në fakt prekin shumë prej nesh, për çështje që lidhen me aftësinë e Shqipërisë për të dalë nga kriza që përjetoi në vitin 2020 si pasojë e pandemisë. Nivelin e rritjes ekonomike, aftësinë e kompanive për të punësuar njerëz, apo më tej akoma dhe fuqinë e ekonomisë shqiptare për të qenë një aktor i rëndësishëm në rajon, qoftë i fuqizuar apo i ushqyer nga turizmi, po ashtu pse jo edhe nga aktiviteti financiar.

Kemi marrë gjithashtu informacion mbi hedhjen në treg të 10 mijë lekëshit të ri, një prerje kartëmonedhe që qarkullon për herë të parë në historinë ekonomike moderne të Shqipërisë. Kemi folur gjithashtu dhe për paranë jashtë sistemit, apo për ato çështje që ishin relativisht problematike në muajt e fundit të vitit të kaluar, gjatë pandemisë. Luftën e madhe të edukimit financiar për përfshirjen e secilit qytetar, shtetas shqiptar, në organizimin e madh financiar të përdorimit të kartave të kreditit, pagesave online apo dhe të marketingut elektronik. Të gjitha këto dhe shumë të tjera do të mund t'i mësoni nga kjo intervistë me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko. Ju ftoj të gjithëve të na ndiqni!

Guvernatori: *Përshëndetje të gjithëve, jemi në sallën e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës Shqipërisë, këtu ku merren gjithë vendimet më të rëndësishme të institucionit më të lartë financiar në vend.*

Gazetari: *Unë kam kënaqësinë dhe nderin që më jepet mundësia për të intervistuar Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko. Shumë faleminderit që pranuat ftesën.*

Guvernatori: Faleminderit dhe mirë se erdhët!

Gazetari: *Zoti Sejko, po e nis me një çështje që ka qenë mjaft problematike përgjatë vitit 2020, kur Banka e Shqipërisë lehtësoi bankat tregtare që të mund të shtynin këstet e kredive për bizneset dhe individët. Sot në pothuajse fund të gjysmës së parë të vitit 2021, situata kërkon përsëri një ndërhyrje të tillë apo paraqitet më e stabilizuar?*

Guvernatori: Situata sigurisht është më e stabilizuar. Shifrat dhe indikatorët e tregojnë qartë që situata është përmirësuar ndjeshëm. Viti 2020 ishte një vit tejet i vështirë. Përballë kësaj situatë krize të rënduar u pa e nevojshme të realizoheshin një sërë ndërhyrjesh dhe masash emergjente. Ne si institucion financiar mbikëqyrës dhe rregullator ndërmorëm masat tona. Një nga këto masa që vlen të përmendet këtu ishte edhe shtyrja e kësteve të kredisë me dy tremujorë. Paralelisht, ne ndërmorëm edhe disa masa me karakter makroprudencial, si për shembull disa ndryshime rregullative të cilat kishin të bënin me dhënien e mundësisë të bankave të niveli të dytë për të bërë ristrukturime proaktive të kredisë. Pra, në këtë kontekst, ne i lehtësuam bankat nga kërkesat rregullative për provigjione dhe fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë.

Masat që përmenda më sipër ndikuan pozitivisht në koordinimin e punës të bankave të nivelit të dytë me klientët, bizneset dhe individët. Ne kishim një pritshmëri të caktuar me fillimin e krizës, një pritshmëri e cila ishte më negative nga ajo çka ndodhi në realitet. Fatmirësisht, treguesit rezultuan mjaft pozitivë në nivel total. Kështu, niveli i prodhimit të përgjithshëm bruto pësoi një rënie më pak të ulët nga ajo çka pritej. Më konkretisht, rënia ekonomike arriti në nivelin -3.3% nga një parashikim i Fondit Monetar Ndërkombëtar që shkonte deri në -7.5%.

Gazetari: *Madje në disa raste parashikimi për rënien ekonomike arrinte deri në -12%.*

Guvernatori: Në një moment të caktuar, parashikimi për rënien ekonomike arriti deri në -12%. Në fakt, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 pati një rënie të thellë ekonomike, e cila u kompensua në dy tremujorët në vijim, ku sigurisht dhanë impaktin e tyre edhe masat e

sipërpërmendura. Këto masa dhanë një efekt mjaft pozitiv në vijimësinë e jetës ekonomike dhe qëndrueshmërinë jo vetëm të sistemit bankar por edhe të aktivitetit ekonomik në përgjithësi.

Fundi i vitit 2020 rezultoi me disa tregues mjaft më pozitivë nga çka ne prisnim, jo vetëm në raport me PBB-në, por edhe në raport me treguesit e tjerë të sistemit financiar. Kreditë me probleme nuk pësuan rritje të mëtejshme por përkundrazi u ulën më tej. Këto kredi shënuan një rënie më të madhe nga ajo çka pritej krahasuar edhe me nivelin e mëparshëm duke arritur në vlerën prej 7.96%.

“Fundi i vitit 2020 rezultoi me disa tregues mjaft më pozitivë nga çka ne prisnim, jo vetëm në raport me PBB-në, por edhe në raport me treguesit e tjerë të sistemit financiar.”

Pavarësisht parashikimeve tona për një rritje të kredive me probleme, sistemi bankar vijon të jetë mjaft optimist në këtë drejtim. Ky optimizëm mbështetet edhe në rritjen e depozitave dhe kreditimit, por edhe në një rritje totale të bilanceve të sistemit bankar pavarësisht gjithë situatës së krizës përmes të cilës kaloi vendi ynë.


Masat tona rregullative makro dhe mikroprudenciale u kombinuan me mjaft efektivitet edhe me masat fiskale dhe paketat e qeverisë shqiptare, të tilla si garancitë sovraane, të cilat u kanalizuan nëpërmjet sistemit bankar. Në këtë kontekst, harmonizimi i masave lehtësuese, politika monetare lehtësuese, ulja e normës bazë të interesit, në nivelin e saj minimal historik 0.5% ndihmuan për të stimuluar kreditimin, konsumin dhe investimet.

Tregjet financiare tashmë paraqiten më të qeta dhe me qëndrueshmëri të kënaqshme. Kursi i këmbimit është i qëndrueshëm dhe parashikimet tona janë mjaft më optimiste. Sa i përket rritjes ekonomike, për këtë vit, ne si bankë qendrore pas rishikimeve përkatëse vlerësojmë se do të arrijë në nivelin 5.3%. Në vijimësi, për vitet e ardhshme, ne parashikojmë një rritje ekonomike pak më poshtë se 5.3% por gjithmonë në këto nivele, midis 4.5 dhe 5%. Sigurisht që kjo është e kushtëzuar edhe nga situata e pandemisë.

E përsëris se të gjitha këto parashikime janë të kushtëzuara nga rreziqet që vijnë nga një tejzgjatje e pandemisë. Bazuar në informacionin e përftuar nga ekspertët e fushës dhe mjekët në arenën ndërkombëtare dhe kombëtare po vërejmë një tendencë rënëse të infektiveve. Aktualisht, jemi përpara sezonit turistik dhe turizmi ka një ndikim të madh në ekonominë

shqiptare. Të ardhurat nga turizmi në përgjithësi janë në nivelin e 2-3 miliardë eurove, të cilat hyjnë çdo vit në ekonominë shqiptare. Viti i kaluar regjistroi një rënie pothuajse me 50% në nivelin e turizmit. Kjo rënie mund të kishte qenë edhe më e ndjeshme nëse nuk do të ndikonte pozitivisht turizmi rajonal që vinte nga Maqedonia, Kosova apo vendet kufitare. Ky vit ka një pritshmëri më pozitive, por parashikimet dhe prirjet tona janë të kushtëzuara nga kohëzgjatja e pandemisë.

Grafik 30. Të ardhura neto nga turizmi (mln euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gazetari: Në kushtet aktuale, ne ende nuk mund të kemi dijeni për surprizat që mund të na sjellë pandemia. Pavarësisht këtij momenti, dëshiroj t'ju pyes: A është sistemi bankar i shëndetshëm, i mirëkapitalizuar dhe likuid për t'u përballur me çdo lloj situatë të papritur?

Guvernatori: Sikurse e theksova edhe më lart, me gjithë impaktin që pati pandemia mbi sistemin bankar, përsëri ai mbetet i shëndetshëm dhe me një nivel të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit në mbi 18% krahasuar me nivelin prej 12% që është norma minimale e kërkuar.

Njëkohësisht, sistemi bankar disponon një tepricë të lartë likuiditeti, tepricë të cilën e ka disponuar edhe më parë. Sigurisht, kjo tepricë likuiditeti duhet përkthyer në kredi të shëndetshme për ekonominë. Sikurse e përmenda edhe më sipër, niveli i kredive me probleme ka qëndruar në nivele mjaft të ulëta dhe kjo tregon se kreditimi bankar është mjaft prudent dhe serioz, pra është proaktiv, por gjithmonë me kriterë serioze dhe rregullative.


Sistemi bankar është në gjendje mjaft të mirë. Shëndeti i sistemit bankar ka një efekt domethënës dhe ka shërbyer si një nga shtyllat kryesore për të mbajtur në këmbë dhe stimuluar ringritjen ekonomike. Kjo për shkak se shëndeti dhe cilësia e mirë e sistemit bankar përbëjnë një parakusht themelor për vijimësinë e rritjes ekonomike në të ardhmen.

Gazetari: Zoti Guvernator, ne raportuam para pak ditësh për një rritje të lehtë të inflacionit, i cili mbështetur edhe në raportin e Bankës së Shqipërisë, qëndron në nivelin 1%, që është dhe limiti fundor i këshilluar nga Banka e Shqipërisë. A kemi ne pasoja nga një inflacion i ulët? Pa u futur në thellësi të çështjeve shumë teknike, mund të na jepni një shpjegim sa më të thjeshtë për të sqaruar publikun e gjerë?

Guvernatori: Sigurisht. Aktualisht, ne kemi një nivel inflacioni prej 1.9%. Ky nivel pësoi një rënie të lehtë dhe përgjithësisht ka shfaqur luhatje për shkak të çmimeve të shportës, të cilat përbëjnë paketën nga del inflacioni. Inflacioni ka qene nën objektivin ligjor të Bankës së Shqipërisë prej 3%. Sigurisht që kjo nuk përbën një problem madhor për ne, por është një simptomë e ekonomisë në përgjithësi për shkak se inflacioni tregon nivelin e çmimeve. Nëse ne do të përjetonim një inflacion të tejritur, atëherë do të ishim përpara një situatë me rritje çmimesh e cila nuk do të ishte e pëlqyeshme.


Grafik 31.

Presionet inflacioniste afatmesme ruajtën ndikimin e qëndrueshëm dhe në rritje të lehtë tek inflacioni total



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet të BSH-së.

Presionet afatshkurtra dhe të importuara u pakësuan ndjeshëm, duke përcaktuar ngadalësimin e inflacionit total



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet të BSH-së.

Ne kërkojmë ta stimulojmë ekonominë. Ne kërkojmë të arrijmë si objektivi një nivel inflacioni të tillë që të ketë impakt në rritjen ekonomike. Ta tejnxehim pak ekonominë, pasi është shumë e vakët.

Gazetari: Ta ndezim...

Guvernatori: Duam ta ndezim ekonominë. Ky është qëllimi ynë, prandaj ndjekim një politikë monetare lehtësuese. Duke marrë në konsideratë faktin se situata pas krizës së vitit 2008-2009 në mbarë botën, përfshirë këtu Eurozonën dhe Shtetet e Bashkuara ka qenë jo shumë e favorshme, me një rënie të ndjeshme të kërkesës, qarkullimit të parasë dhe investimeve. Në këtë kontekst, sistemi financiar ka përjetuar një situatë me probleme madhore nga humbjet nga kreditë. Gjithë kjo situatë tejet e rënduar ka krijuar një stepje dhe ngërç në ekonomi dhe për këtë arsye bankat qendrore kanë ndërmarrë politika monetare lehtësuese përmes uljes së normës bazë të interesit në nivele minimale historike, madje edhe në terrene negative.

Shumë banka qendrore të shteteve të mëdha kanë aplikuar norma negative interesi dhe praktikisht kjo është bërë për të nxitur investitorët, konsumin dhe investimet. Pra, për të bërë të mundur transferimin e kursimeve dhe investimeve nga sistemi financiar në ekonominë reale. Të njëjtën gjë kemi bërë edhe ne si bankë qendrore, por pa arritur në nivelet e normave negative të interesit. Gjithsesi, kemi bërë të mundur uljen e normës së interesit për të stimuluar ekonominë dhe për të arritur objektivin tonë të inflacionit, i cili qëndron në nivelin prej 3%.

Niveli i ulët i inflacionit i shoqëruar nga një situatë e rënduar tregon që ekonominë operojnë nën potencialin e tyre. Pra tregojnë një kërkesë të vakët të konsumit dhe të investimeve. Ne parashikojmë që objektivi ynë i inflacionit të arrihet rreth fundit të vitit 2022, në mënyrë që ekonomia të operojë në potencialin e saj brenda kësaj periudhe.

Gazetari: Ne kemi ndjekur nga afër raportet e Bankës së Shqipërisë dhe vendimin mbi uljen e normës bazë të interesit në nivelin 0.5%, që është edhe norma më e ulët historike. Sikurse, ju pyeta edhe në fillim të intervistës tonë: A janë bizneset në një situatë më të favorshme pas ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë apo do të duhet të shohim ulje të mëtejshme të normës bazë të interesit?

Guvernatori: Sigurisht, që ky është një vendim që merret nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Aktualisht, situata parashikohet


të vijë drejt përmirësimit. Në këto kushte, nuk vlerësoj se do të jetë e nevojshme një ulje e mëtejshme e normës bazë të interesit.

Vetëm nëse do të kishim një përqendrim të situatës ekonomike dhe materializim të rreziqeve që përmenda më sipër, atëherë ne do të mund të ndërmerrem një veprim të tillë. Por e përsëris edhe një herë se nuk e besoj se do të gjendemi përpara një situatë të tillë.

Megjithatë e rritksoj se kjo normë interesi vazhdon të jetë mjaft stimuluese për ekonominë shqiptare. Politika jonë monetare është transmetuar mirë në të gjitha segmentet e tregut financiar, si në bono thesari, kredi ashtu edhe në depozita.


Grafik 32.

Yield-et në tregun primar prej muajit mars kanë shfaqur prirje rënëse



Shënim: Të dhënat tregojnë normat e interesit (mesatare mujore) të bonove edhe obligacioneve shtetërore të emetuara në tregun primar. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kurba e yield-eve është sheshuar lehtës dhe ka zbutur harkimin në segmentin afatmesëm



Shënim: Të dhënat tregojnë norma interesi (mesatare mujore) të titujve të borxhit të qeverisë, sipas maturiteteve të ndryshme të llogaritura sipas modelit Nelson Siegel. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Gazetari: Zoti Guvernator, sapo përmbyllëm fushatën elektorale dhe zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 25 prillit. Gjatë periudhës së fushatës dhe veçanërisht dy apo tre muajt e fundit qarkullonin zëra për një rritje të parasë jashtë sistemit. Meqenëse kam mundësinë t’ju pyes, sa të vërteta janë këta zëra dhe çfarë mendon Banka e Shqipërisë mbi këtë rrezik potencial?

Guvernatori: Sigurisht që paraja jashtë sistemit është rritur. Ky ka qenë një fenomen të cilin ne e kemi marrë në konsideratë edhe gjatë periudhës së krizës. Ky fenomen ka ndodhur edhe në vendet e rajonit dhe më gjerë.

Si pasojë e situatës së pandemisë dhe shpenzimeve për të adresuar problematikat përkatëse, ne kemi përjetuar një rritje të masës monetare në përgjithësi të shoqëruar me rritje të kredisë dhe depozitave, por edhe me një zgjerim të deficitit buxhetor, deri në masën prej 100 milionë lekë.


Grafik 33.

Deficiti u financua nga burime të brendshme e të huaja



*Shënime: Deficiti buxhetor sipas tremujorëve dhe mënyra e financimit të tij, në miliardë lekë.
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

Bankat mbajtën peshën kryesore në financimin me burime të brendshme



*Shënime: Huamarrja e qeverisë në tituj të borxhit, sipas blerësve, në miliardë lekë, sipas tremujorëve.
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

Njëkohësisht, vlen të përmendet se situata specifike e krijuar nga pandemia i ka orientuar njerëzit drejt mbajtjes së parasë *cash*.

Ne jemi ende një ekonomi me nivel të lartë përdorimi të parasë *cash*. Ky përben një problem që jemi munduar ta adresojmë në mënyrë konstante. Për këtë arsye kemi ndërmarrë edhe një paketë masash në nivel reformash strukturore dhe financiare. Pavarësisht kësaj rritjeje specifike që lidhet me situatën e pandemisë, objektivi ynë mbetet i pandryshueshëm për formalizimin e ekonomisë dhe rritjen e përfshirjes financiare dhe edukimit financiar.

E rëndësishme është që të theksohet se pavarësisht rritjes së përdorimit të parasë *cash* në ekonomi gjatë kësaj periudhe përsëri sistemi bankar mbeti i qëndrueshëm, likuid dhe me parametra të shëndetshëm.

Gazetari: Do të vazhdojë të qëndrojë si objektiv i juaji një fushatë për edukimin financiar dhe uljen e parasë *cash* në ekonomi?

Guvernatori: Patjetër. Ne synojmë, që kjo reformë strukturore me objektivat tona madhore të fokusohet te edukimi financiar në kuadër të përfshirjes financiare dhe modernizimit të sistemit të pagesave. Në funksion të këtij qëllimi, ne miratuar edhe ligjin për shërbimet e pagesave në vitin 2020. Në zbatim të këtij ligji përfshihen disa reforma për të modernizuar sistemin e pagesave, të cilat po ndiqen hap pas hapi me plane dhe me masa konkrete.

Sigurisht, gjithë kjo veprimtari po kryhet në bashkëveprim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me aktorët e tjerë të tregut. Por, banka qendrore luan këtu rolin kryesor, si koordinues dhe iniciues për këto reforma.

Në këtë kuadër, ne jemi duke punuar për të bërë të mundur operacionalizimin e qarkullimit të pagesave në euro, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Aktualisht, banka qendrore kryen qarkullimin e pagesave në lekë. Ndërkohë që pagesat në euro, dollar apo në valutë të huaj kryhen nëpërmjet bankave korrespondente. Përmes këtyre ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe rregullativ, ne do të mund të realizojmë që nëpërmjet sistemit tonë të kryhet jo vetëm qarkullimi i pagesave të brendshme, por edhe i atyre në valutë si në euro, dollar dhe valuta të tjera.

“... ne do të mund të realizojmë që nëpërmjet sistemit tonë të kryhet jo vetëm qarkullimi i pagesave të brendshme, por edhe i atyre në valutë si në euro, dollar dhe valuta të tjera.”

Ky operacionalizim do të përshpejtonte kohën e transfertave të pagesave dhe do të ulte mjaft kostot e tyre. Pra, do të ndihmonte agjentët ekonomikë në të dy drejtimet e mundshme, si në përshpejtimin e kohës për kryerjen e transfertës, ashtu edhe në uljen e ndjeshme të kostove të transfertës.

Gazetari: *Kjo besoj vlen edhe për ne konsumatorët si përfituesit finalë në këtë proces.*

Guvernatori: Patjetër. Po përpiqem t’ua shpjegoj sa më thjesht. Nëse do të donim të bënim një transfertë nga një bankë tek një bankë tjetër brenda territorit të Shqipërisë në valutë, atëherë sot kjo transfertë do të kryhet nëpërmjet një banke korrespondente që ndodhet për shembull në New York apo Washington, nëse transfertë është në dollar, apo në Frankfurt nëse do të jetë në euro; pra në vendin ku do të kishte drejtorinë e përgjithshme banka korrespondente.

Me ndryshimet e realizuara, transfertat do të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe do të realizohen përmes bankave vendase. Në këtë kontekst, datë valuta apo afati i kryerjes së pagesës do të shkurtohet, por ajo që është më e rëndësishmja do të ulen ndjeshëm edhe kostot përkatëse. E përsëris edhe një herë, arsyeja kryesore këtu qëndron në uljen e kostove dhe në synojmë ta realizojmë këtë brenda vitit 2020.

“... ne parashikojmë të ndërmarrim edhe një set masash të tjera si: implementimi i një switch-i, dhe i një platforme kombëtare për kryerjen e pagesave me kartë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”


Në të njëjtën kohë, ne parashikojmë të ndërmarrim edhe një set masash të tjera si: implementimi i një switch-i, dhe i një platforme kombëtare për kryerjen e pagesave me kartë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Dëshiroj këtu të theksoj se kjo masë do të ulte mjaftueshëm kostot për përdoruesit e kartave dhe do të rriste ndjeshëm përdorimin e tyre, si të debiitit ashtu edhe të kreditit. Në drejtim të përfshirjes financiare, një masë tjetër që vlen të përmendet është edhe implementimi i një skeme debiitimi direkt pavarësisht marrëveshjeve që

mund të kenë bankat me kompanitë utilitare, siç janë kompanitë e ujit dhe dritave.

Synimi ynë është që edhe shtresat më të varfra të popullatës dhe individët me të ardhura minimale, të mund të kenë akses në llogaritë bankare, përmes kryerjes së pagesave me komisione shumë të ulëta apo ndoshta edhe me komision zero. Në këtë mënyrë rriet ndjeshëm përfshirja financiare, ku çdo individ ka llogarinë e vet bankare dhe është pjesë e sistemit financiar. Këto janë disa elemente mjaft inovatore për Shqipërinë, por që janë aplikuar gjerësisht në shtete të tjera. Në këtë aspekt, objektivi ynë është të rrisim formalizimin e ekonomisë dhe njëkohësisht edhe përfshirjen financiare. Sa më shumë biznese dhe individë të përfshirë, aq më e konsoliduar bëhet marrëdhënia e tyre me bankat. Kjo ndikon pozitivisht në shumë aspekte dhe mbi të gjitha në zbutjen e pabarazisë midis shtresave të ndryshme sociale.

Grafik 34. Numri I llogarive me akses nga Interneti (majtas) dhe zgjerimi i përdorimit të pagesave elektronike ndër vite (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sigurisht që çelësi këtu është edukimi financiar. Edukimi financiar është edukimi i drejtë i publikut për arritjen e objektivave që sapo përmenda, dhe këtu kuptohet dhënia e një informacioni të përshtatshëm jo vetëm për bizneset, të cilat janë më të mirinformuara, por edhe për individët e thjeshtë. Më konkretisht, këtu ne diskutojmë për individë në zonat rurale dhe në zona të tjera të cilët disponojnë një nivel të ulët informacioni për produktet bankare dhe nuk arrijnë të përfitojnë prej tyre.

Ne parashikojmë të ndërmarrim veprime konkrete në kuadër të reformave strukturore financiare që ne po ndjekim si bankë qendrore. Këto reforma do t'i shërbejnë modernizimit të sistemit të pagesave, i cili duhet të ecë me hapin e kohës njëlloj si në shtetet e tjera.

Aktualisht, mund të themi me bindje se është bërë një progres i ndjeshëm gjatë këtyre viteve. Po të rikthehemi pas në kohë, mund të kujtojmë se vetëm 10 apo 15 vite më parë, ne nuk dispononim karta debiti apo krediti dhe ekonomia shqiptare funksiononte mbështetur plotësisht te paraja *cash*.

Progres i madh është realizuar edhe në drejtim të përdorimit të ATM-ve – nëpërmjet përdorimit të kartave të debitit si dhe atyre të kreditit. Por, sigurisht që ne tashme po jetojmë në epokën e digjitalizimit dhe duhet ta modernizojmë sistemin jo vetëm në drejtim të rritjes së përdorimit të

pagesave me kartë, por edhe përmes implementimit të pagesave me celular dhe digjitalizimit të pagesave.

Gazetari: Z. Guvernator ju e prekët pak më lart çështjen e politikës së deeuroizimit që ka ndjekur Banka e Shqipërisë. Dëshiroj t’ju pyes fillimisht për rezultatet e arritura. A kemi ne tashmë një stabilitet të kursit të këmbimit në Shqipëri përballë valutave të tjera? A është kjo edhe rezultat i kësaj politike dhe a kanë lidhje këto të dyja me njëra-tjetrën?

Guvernatori: Nuk kanë lidhje direkte me njëra-tjetrën këto dy elemente. Në vendin tonë, ne aplikojmë një regjim të lirë të kursit të këmbimit, që bazohet tek oferta dhe kërkesa. Aktualisht, ne kemi një kurs të qëndrueshëm që përbën një element mjaft pozitiv për ekonominë dhe për agjentët tregtarë dhe veçanërisht për eksportuesit dhe importuesit.

Stabiliteti i kursit të këmbimit zbut rreziqet që mund të vijnë nga humbjet e shkaktuara nga luhatjet e kursit të këmbimit. Por sigurisht që ndikon edhe në sistemin financiar, si tek bankat ashtu dhe tek kredimarrësit për shkak se luhatjet në kursin e këmbimit qoftë për mbiçmimin apo nënçmimin e lekut do të shkaktonin humbje sipas ekspozimeve të ndryshme që do të kishin agjentët; ndërkohë që një kurs stabël i ndihmon të gjithë aktorët pjesëmarrës.


Grafik 35.

Leku është luhatur në kahun mbiçmues ndaj euros dhe është nënçmuar kundrejt dollarit amerikan



*Shënim: Të dhënat tregojnë ecurinë ditore të kursit të këmbimit të lekut kundrejt monedhës euro edhe dollarit amerikan
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Përtej luhatjeve afatshkurtra, ecuria e kursit eur/lek sinjalizon pozicionim të balancuar të agjentëve në treg




Shënim: Të dhënat paraqesin treguesin e anshmërisë, i cili llogaritet si raport i numrit të ditëve kur kursi është mbiçmuar kundrejt ditëve kur ai është nënçmuar. Për më shumë shiko.
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Sigurisht që kemi përjetuar luhatje të lehta të kursit, pasi kemi një regjim të lirë. Ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm se me këtë kurs të lirë këmbimi do të kemi flukse të larta hyrjesh në monedhën euro. Shqipëria pavarësisht se nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, gjeografikisht është në Eurozonë. Partnerët tanë kryesorë tregtarë janë brenda Eurozonës. Emigrantët shqiptarë janë kryesisht të punësuar në Eurozonë. Turistët vijnë kryesisht nga Eurozona, por dhe ata që nuk vijnë nga jashtë saj, përsëri përgjithësisht sjellin euro. Investimet e huaja direkte kryesisht kryhen me euro. Pra, me gjithë këto flukse të mëdha hyrjesh në euro, përsëri kursi i këmbimit ka qenë i qëndrueshëm. Pa përmendur këtu shifra konkrete, mund të themi se janë miliarda euro që hyjnë në ekonominë shqiptare nga këto burime. Dhe ruajtja e një kursi stabil tregon qartë qëndrueshmërinë e lekut.

Deeuroizimi ka të bëjë me uljen e përdorimit të euros aty ku nuk është e nevojshme dhe kjo ndodh për dy arsye. Ne kemi monedhën kombëtare që është Leku dhe për sa kohë që ne përdorim këtë monedhë ndihmojmë ekonominë tonë në dy drejtime.

Së pari, kemi një transmetim më të mirë të politikës monetare. Është një instrument të cilin ne e disponojmë, ndërkohë që shumë shtete të zhvilluara, që nga momenti që janë bërë anëtare të Eurozonës nuk e kanë më në dispozicion për shkak se politika e tyre monetare kryhet nga Banka Qendrore Evropiane.

Grafik 36. Kredia në Lek dhe kredia në valutë me dhe pa efektin e kursit të këmbimit, ndryshim vjetor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sikurse e theksuam edhe në fillim të intervistës, ne kemi mundësi që nëpërmjet politikës monetare të stimulojmë kreditimin, të stimulojmë konsumin dhe investimet. Ky instrument na ka ndihmuar që gjatë 4 viteve të fundit të kemi një rritje ekonomike përafërsisht 4%. Padyshim që këtu kanë ndikuar edhe reformat strukturore të ndërmarra nga qeveria shqiptare, Banka e Shqipërisë dhe aktorë të tjerë.


Por nga kahu tjetër, na kanoset një rrezik serioz mbi sistemin financiar që është ekspozimi në euro për ata klientë të cilët i kanë të ardhurat në monedhën lokale në lekë. Për shembull, nëse ju keni përfutur një kredi në monedhë të huaj, qoftë si biznes apo individ (le të themi në euro meqenëse euro është monedha më e përdorshme), dhe të ardhurat i disponon në lekë, atëherë në kushtet e një situatë inflacioniste pra në një periudhë afatmesme apo afatgjatë nëse do të kishim një zhvlerësim të monedhës kombëtare, atëherë klientëve të bankës do t'iu ulj ndjeshëm aftësia paguese e kësteve të kredisë.

Dhe jo vetëm klientët nuk do të mund të paguanin këstet e kreditë, por njëkohësisht dhe bankat do të kishin probleme serioze me bilancet e tyre. Duke marrë në konsideratë faktin se një e katërta e totalit të kredive është në valutë të huaj dhe e pambrojtur, atëherë ne do të përballeshim me një përkeqësim të ndjeshëm të bilanceve të bankave. Dhe ky është një ekspozim serioz. Ndodhemi përballë të njëjtës situatë sikurse është pjesa e borxhit të jashtëm në valutë që ka marrë qeveria shqiptare, ndërkohë që të ardhurat buxhetore janë në monedhën lokale.

Në këtë këndvështrim, si borxhi i jashtëm ashtu edhe ekspozimi i klientëve ndaj bankave përbëjnë një rrezik serioz në rast zhvlerësimi të kursit të këmbimit. Sigurisht, që aktualisht ndodhemi përpara në një situatë të qëndrueshme për sa kohë ne aplikojmë një regjim të lirë të kursit të këmbimit.

Megjithatë, ekonomia është shumë komplekse dhe ne kemi qenë dëshmitarë të eksperiencave nga më të ndryshmet që kanë ndodhur edhe në shtetet më të zhvilluara, si në Zvicër me frangën zvicerane, ku u shfaqën probleme serioze jo vetëm në sistemin bankar, por edhe në ekonomi. Për këto arsye, ne kemi aplikuar një politikë deeuroizimi me qëllim uljen e nivelit të përdorimit të euros dhe aktualisht kjo politikë ka funksionuar.

Grafik 37. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këtë kuadër, Grupi Këshillimor i Komitetit të Stabilitetit Financiar i përbërë nga Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe agjencitë e tjera rregullatore nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për Politikën e Deeuroizimit, në vitin 2017, dhe në shkurt të vitit 2018 i dhamë udhë këtij projekti. Që prej këtij momenti, kemi një rënie të ekspozimeve në euro si në aktive ashtu dhe në pasive, si në kredi ashtu edhe në depozita.

Aktualisht, ne po përjetojmë një rritje të ndjeshme të kreditimit në lekë që është një zhvillim mjaft pozitiv. Pra, individët dhe bizneset janë ndërgjegjësuar që nuk kanë pse të kenë ekspozime në valutë të huaj kur të ardhurat i kanë në lekë dhe normat e interesit të lekut qëndrojnë në nivele shumë të ulëta pothuajse si normat e euros.

Kësti binte më i ulët kur norma e interesit në euro që më e ulët se në lekë. Tashmë që janë pothuajse të përafërta nuk ke dhe për momentin nuk vlen më, kështu që si në afat të shkurtër dhe në afat të gjatë, mirë është që dhe kredia të merret në lekë. Ky program është dhe një reformë në kuadër të kërkesave të Bashkimit Evropian. Pra, nuk është shpikje e jona, pasi i njëjti program është implementuar në të gjitha vendet në zhvillim, që kanë të njëjtin fenomen. Natyrisht që ka pasur një keqkuptim, po e përmend përsëri se përse duhet të përdorim lekun dhe jo euron.

Gazetari: Është kjo pyetje?

Guvernatori: Ne jemi ende larg standardit të BE-së. Ekonomia jonë, pavarësisht progresit pozitiv, është ende larg standardeve dhe konvergimit me ekonominë e Bashkimit Evropian. Mund të marrim si shembull Republikën Çeke, e cila ende ka monedhën e saj dhe është gati për t'u bërë pjesë e Eurozonës, por vijon të dëshirojë të ketë në dorë këtë instrument të politikës monetare pavarësisht se ka përmbyshur plotësisht standardet për të adoptuar monedhën euro.

Kroacia po aplikon një tjetër program, atë të adoptimit gradual të euros. Ne e kemi të nevojshme të përdorim instrumentet e politikës monetare. Kur ne të arrijmë nivelin e kërkuar - nuk mund të përcaktojmë këtu një periudhë të saktë kohore, por ndoshta pas disa vitesh, pasi të ndjekim me seriozitet hapat e këtyre vendeve, të cilat sot gëzojnë një standard më të lartë ekonomik - nuk do të jetë e largët dita që edhe ne të jemi jo vetëm anëtarë të Bashkimit Evropian, por edhe pjesë përbërëse e Eurozonës.

Për momentin, në këtë stad zhvillimi ekonomik, ne implementojmë këtë politikë që është dhe kërkesë e Bashkimit Evropian.

Gazetari: A janë këto politika të përshtatshme për stadin aktual të zhvillimit tonë ekonomik?

Guvernatori: Nuk do të doja të zgjerohesha së tepërmi në këtë çështje për të mos kaluar në detaje teknike, por do të doja të theksoja se përdorimi i euros nuk është i lejuar dhe mbart në vetvete disa rreziqe evidente. Në këtë kontekst, ka vende të cilat e kanë adoptuar euron si monedhë të tyre, si p.sh. Kosova dhe Mali i Zi, dhe shpeshherë bëhen krahasime me vendin tonë.

Gazetari: Dhe këto shtete nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian?

Guvernatori: Po, këto shtete nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe, në momentin që kanë fituar pavarësinë, nuk kanë pasur monedhën e tyre kombëtare. Në këto kushte, është bërë një marrëveshje dhe janë lejuar nga Eurozona që të mund të përdorin euron si monedhë kombëtare. Kështu, kanë bërë të mundur shmangien e riskut të kursit të këmbimit, por nuk i disponojnë më instrumentet e politikës monetare.

Aktualisht ne jemi në një situatë krejt tjetër. Edhe sikur të mos kishim gjykimin dhe logjikën e këtyre avantazheve apo disavantazheve, nuk do të na lejohej të implementonim adoptimin e euros.

Gazetari: Po, kushdo që kishte pyetje, e mori përgjigjen.

Guvernatori: Nuk do të mund ta bënim dhe nëse do të ishim lejuar, kjo është arsyeja. Dhe arsyet themelore janë ato që përmenda më sipër, që ne duhet të stimulojmë ekonominë në mënyrë që të kemi rritje ekonomike, në funksion të mirëqenies së qytetarëve shqiptarë.

Këto janë instrumente që ndikojnë në drejtim të rritjes ekonomike. Pra, janë politikat monetare, financiare, makroekonomike, që duhet të harmonizohen me politikat fiskale të qeverisë shqiptare për të pasur rezultatin e kërkuar të rritjes ekonomike.

Gazetari: Zoti Guvernator, më lejoni një pyetje të fundit. Këtë vit ne presim emetimin e kartëmonedhës së parë 10 mijë lekëshe, një kartëmonedhë që nuk e kemi pasur asnjëherë. Kur do të ndodhë kjo dhe kur do mundemi ta kemi në përdorim?

Guvernatori: Shumë shpejt. Në qershor, planifikojmë të bëjmë njoftimin përkatës dhe të nisim prezantimin për hedhjen në qarkullim të kartëmonedhës 10 mijë lekëshe. Ne kemi ndryshuar të gjithë serinë e kartëmonedhës shqiptare. Vjet kemi prezantuar serinë e re të kartëmonedhës. Janë hedhur dy prerje të reja të kartëmonedhës në qarkullim që janë ato 5000 Lekë dhe 200 Lekë. Këtë vit do të hedhim dy prerje të reja, të kësaj serie që janë 10000 Lekë dhe 1000 Lekë.

Gazetari: 10000 Lekëshi është një prerje e re që nuk ka qarkulluar më parë?

Guvernatori: Po, është një prerje e re që do të hidhet në qarkullim. Prerja më e madhe deri tani ka qenë 5000 lekëshi dhe këtë vit ne planifikojmë të hedhim në qarkullim 10000 lekëshin e ri. Vlerësoj se është koha e përshtatshme, pasi kemi vite që çmimet janë shtrënjtur. Kjo monedhë do të jetë më e thjeshtë për përdoruesit, pasi është një prerje më e madhe për ta mbajtur qoftë në portofol qoftë në qarkullim. Në këtë kontekst ulët nevoja për sasi të mëdha përdorimi të *cash-it*.

Së bashku me 10 mijë lekëshin do të hidhet në qarkullim edhe prerja 1 mijë lekëshe, si pjesë e serisë së re. Pra, do të jetë e njëjta tematikë, te

1 mijë lekëshi, por do të ndryshojë dizajni, pamja, dhe janë shtuar disa elemente të sigurisë. Ne parashikojmë që në qershor të hedhim këto dy prerje të reja në qarkullim.

Ndoshta nga fundi i këtij viti apo fillimi i vitit tjetër do të jenë dhe dy prerjet e fundit të serisë që do të hidhen në qarkullim. Kështu, në qarkullim do të jetë e gjithë seria e re.

Dua të ritheksoj për të sqaruar dhe një herë që të mos ketë keqkuptime. Këto prerje të reja do të jenë në qarkullim paralelisht me prerjet e vjetra, pra edhe prerjet e vjetra do të vazhdojnë të jenë funksionale. Patjetër që 10 mijë lekëshi është vetëm një dhe s'ka prerje të vjetër, por për të gjitha prerjet e tjera do të kemi nga dy kartëmonedha me kurs ligjor. Pra kemi në qarkullim 5 pesë mijë lekëshin e ri dhe të vjetrin. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me kartëmonedhat e tjera.

Gazetari: Deri sa të realizohet zëvendësimi i plotë i tyre me kartëmonedhat e reja?

Guvernatori: Po. Deri sa të zëvendësohen plotësisht me kartëmonedhat e reja. Prerjet e vjetra me përdorimin e madh konsumohen dhe asgjësohen gradualisht. Ka një formulë specifike në qarkullimin e parasë. Pra, paraja e vjetër tërhiqet gradualisht nga qarkullimi dhe asgjësohet dhe vendin e saj e merr gradualisht paraja e re, prerjet e reja.

Gazetari: Ju falënderoj shumë zoti Guvernator. Morëm prej jush informacione shumë të rëndësishme. Për më tepër që nga qershori do të kemi një kartëmonedhë të re, dhe lajmi më i mirë është që ekonomia shqiptare është stabilë dhe drejt një rritjeje të qëndrueshme.

Zoti Guvernator shumë faleminderit për intervistën, punë të mbarë!

Guvernatori: Faleminderit juve!

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR REVISTËN “MONITOR”

-7 qershor 2021-

1. Si e përballoi ekonomia shqiptare krizën e shkaktuar nga pandemia, në krahasim me vlerësimet fillestare dhe pse?

Ndonëse ka kaluar më shumë se një vit nga përhapja e pandemisë COVID-19 në vendin tonë, ekonomia shqiptare vijon të përballlet ende me pasojat e saj. Megjithatë, mbulimi gjithnjë e më i plotë me statistika i periudhës kohore që kemi kaluar nën pandemi, si dhe fakti se treguesit kryesorë ekonomikë kanë marrë një kthesë drejt përmirësimit, na lejojnë të bëjmë një bilanc paraprak të situatës.

Ky proces i shërben për evidentimit kritik të pikave të forta e të dobëta të ekonomisë dhe të sistemit tonë financiar, si dhe nxjerrjes së mësimëve të nevojshme për të ardhmen.

Në fillim të vitit 2020, thuajse e gjithë bota pa pandeminë globale të shndërrohej në një kërcënim serioz për shëndetin e njerëzve, si dhe të lerë gjurmë të thella në jetën sociale dhe atë ekonomike. Nën efektin e saj, vëllimi i aktivitetit ekonomik në Shqipëri u tkurr, papunësia u rrit dhe shëndeti financiar i shumë bizneseve dhe familjeve u përkeqësua - një tablo e ngjashme kjo në të gjitha vendet e prekura.

Ndonëse impakti negativ i krizës në ekonomi ishte i paevitueshëm, madhësia e tij ishte më e vogël se pritjet tona. Krahasuar me pritjet tona fillestare, ekonomia shqiptare shfaq një rënie më të vogël të aktivitetit ekonomik dhe të punësimit, një numër më të ulët falimentimesh, një stabilitet të kënaqshëm të treguesve monetarë e financiarë, si dhe ruajtje të mirë të shëndetit të sektorit bankar. Në këtë kontekst, gjej me vend të konstatoj se ekonomia jonë e kaloi me sukses testin e pandemisë, duke shfaqur një qëndrueshmëri dhe fleksibilitet të admirueshëm përballë krizës COVID-19.

“Krahasuar me pritjet tona fillestare, ekonomia shqiptare shfaq një rënie më të vogël të aktivitetit ekonomik dhe të punësimit, një numër më të ulët falimentimesh, një stabilitet të kënaqshëm të treguesve monetarë e financiarë, si dhe ruajtje të mirë të shëndetit të sektorit bankar.”

Në gjykimin tim, tre janë faktorët të cilët kanë luajtur një rol parësor në këtë drejtim.


Së pari, reagimi në kohë dhe me vendosmëri i politikave publike i ofroi ekonomisë mbështetjen e duhur. Stimuli i njëkohshëm fiskal, monetar dhe financiar, rezultoi efektiv në shmangien e pasojave më negative të goditjes. Stimuli fiskal mori formën e lehtësive të përkohshme tatimore, të ofrimit të garancive sovrane, si dhe të rritjes së shpenzimeve korrente e kapitale. Ai dha një kontribut të drejtpërdrejtë në kërkesën agregate, duke amortizuar rënien e të ardhurave të sektorit privat dhe duke e mbështetur atë me likuiditet. Po ashtu, Banka e Shqipërisë rriti stimulimin monetar dhe lehtësoi përkohësisht rregulloret e funksionimit të sektorit bankar. Këto masa mundësuan një ecuri normale të tregjeve financiare dhe krijuan një ambient të përshtatshëm për rritjen e kredisë. Kostot e financimit mbetën të favorshme, kursi i këmbimit u paraqiti i qëndrueshëm, dhe normat e interesit mbetën pranë minimumeve të tyre historike. Rritja e kredisë ndihmoi bizneset dhe familjet shqiptare në përbalimin e nevojave për likuiditet dhe ofroi mjetet e nevojshme financiare për rritjen e konsumit dhe të investimeve. Mobilizimi i masave tona mbështeti kërkesën e brendshme dhe ndihmoi në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar. Masat e mirëkalibruara dhe të koordinuara, si dhe shpejtësia e përgjigjes, ndihmuan në ruajtjen e vendeve të punës, të pagave, të kapaciteteve prodhuese dhe likuiditetit.

Së dyti, sektori bankar dha një kontribut substancial në zbutjen e pasojave të goditjes. Ky sektor mori përsipër një pjesë të barrës financiare të goditjes, duke ruajtur në të njëjtën kohë tregues të shëndetshëm likuiditeti, rentabiliteti dhe kapitalizimi. Qëndrueshmëria e tij ka ardhur në përmirësim, e mbështetur nga reformat dhe masat tona të vazhdueshme për adresimin e dobësive, për rritjen e rezervave të likuiditetit dhe të kapitalit, si dhe për forcimin e kuadrit të menaxhimit të rreziqeve. Paralelisht me masat rregullatore të marra gjatë kohës së pandemisë, ne forcuam dialogun me industrinë bankare, për të kuptuar qëndrueshmërinë operationale dhe dinamikat e biznesit, si dhe për të adresuar rreziqet e likuiditetit dhe të kredisë.

Së treti, aftësia e bizneseve dhe e punonjësve për t'u përshtatur me kushtet e reja. Adaptimi i shpejtë i mënyrës së të punuarit, të prodhuarit dhe të konsumuarit kontribuoi në ruajtjen e marrëdhënieve biznes – klient dhe biznes – punonjës.

Në tërësi, veprimi i këtyre faktorëve rezultoi në një ekonomi më pak të prekur nga kriza dhe krijon premisa për një rimëkëmbje ekonomike të shpejtë dhe të fortë. Kushtet financiare stimuluese, reduktimi i masave kufizuese si pasojë e vaksinimit, si dhe përmirësimi i besimit të agjentëve ekonomikë, i hapin rrugë një rimëkëmbjeje të qëndrueshme.

Grafik 38. Norma e rritjes ekonomike dhe e papunësisë (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Megjithatë, pandemia mbetet ende një rrezik për zhvillimet ekonomike në të ardhmen e afërt dhe se ekonomia nuk është restauruar plotësisht në gjendjen e saj para pandemisë. Kjo nënkupton se ekonomia ka ende nevojë për mbështetje me stimuj makroekonomikë, por këta stimuj duhet të jepen të sinkronizuar dhe në mënyrë të kujdesshme, për të evituar akumulimin e rreziqeve në një horizont afatmesëm e afatgjatë.

Në mbyllje, më lejoni të theksoj se reformat strukturore duhet të mbeten një instrument i rëndësishëm për të akomoduar një rialokim eficient të burimeve të rritjes, duke nxitur kështu rritjen e produktivitetit dhe të potencialit të ekonomisë sonë.

2. Sistemi bankar deri tani ka rezultuar i qëndrueshëm ndaj goditjeve të krizës, i ndihmuar dhe nga mbështetja me masa rregullatore të përkohshme nga Banka e Shqipërisë. Si e vlerësoni ju ecurinë e tij dhe sfidat me të cilat do të përballlet ai në momentin që efekti i këtyre masave do të shuhet?

Ecuria e veprimtarisë bankare gjatë 12 muajve të fundit mund të vlerësohet si e kënaqshme. Sektori ka shënuar zgjerim të veprimtarisë, rritje të fortë të depozitave dhe ecuri të mirë të kreditimit në monedhën kombëtare, tregues mjaft të mirë të likuiditetit, performancë financiare pozitive dhe të qëndrueshme, si edhe nivele të përshtatshme të kapitalizimit të veprimtarisë.

Grafik 39. Normat e rritjes së kredisë dhe depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Masat rregullatore të Bankës së Shqipërisë kanë ndihmuar performancën e sektorit bankar gjatë kësaj periudhe, por vlerësojmë se ndikim të madh ka pasur edhe gjendja e mirë financiare në të cilën, fillimisht tërmeti i nëntorit 2019 dhe me pas pandemia, e gjetën sektorin bankar.

Duke u përqendruar tek masat lehtësuese prudenciale, qëllimi i tyre ishte të lehtësonin goditjen e pandemisë për huamarrësit dhe paralelisht edhe për bankat. Nëpërmjet moratoriumit të shlyerjes së kësteve të kredisë dhe ruajtjes së status-quo-së për klasifikimin dhe provigjionimin e kredive të ristrukturuara, bankave dhe huamarrësve iu krijua mundësia që së bashku të gjenin alternativën më të përshtatshme për ristrukturimin e borxhit dhe ruajtjen e cilësisë së tij. Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të masave lehtësuese rregullatore, Banka e Shqipërisë ka komunikuar me bankat për të siguruar që ato bënin përzgjedhjen e duhur të kredive për ristrukturim dhe që e shfrytëzonin mundësinë për të realizuar një proces ristrukturimi sa më efektiv. Kjo ishte e rëndësishme jo vetëm për zbutjen e goditjes fillestare të pandemisë, por edhe për ecurinë e cilësisë së

portfolit të kredisë në përfundim të masave lehtësuese rregullore. Për të vlerësuar këtë të fundit, Banka e Shqipërisë ka mbledhur informacion paraprak nga bankat. Në bazë të informacionit të mbledhur, rezulton se bankat kanë vlerësime heterogjene për ecurinë e cilësisë së kredisë, por në përgjithësi presin që në rastin e rënies eventuale të cilësisë së portfolit të kredisë, ajo të jetë e kufizuar dhe e përballueshme. Pavarësisht nga ky vlerësim, ne kemi kryer rregullisht ushtrimet e provës së rezistencës për të përfshirë në goditje skenarë me ndikim më negativ, dhe për të vlerësuar kapacitetin e bankave për përthithjen e këtyre goditjeve.

Në mars 2021 kanë përfunduar masat lehtësuese rregullore të Bankës së Shqipërisë për kredinë e ristrukturuar, dhe trajtimi i saj i është rikthyer standardit normal. Ecuria e cilësisë së kredisë do të duket në muajt e ardhshëm, por ndërkohë, Banka e Shqipërisë ruan kufizimet për shpërndarjen e fitimit të bankave si një instrument më shumë për ruajtjen e pozicionit të kapitalit dhe përthithjen e kostove eventuale shtesë që lidhen me rrezikun e kredisë.

Zhvillimet e mësipërme tregojnë se rreziqet e veprimtarisë bankare janë të pranishme, por në vlerësojmë se treguesit e veprimtarisë konfirmojnë rezistencën e fortë financiare të sektorit bankar për përballimin e tyre. Paralelisht, ne vijojmë të përmirësojmë kuadrin tonë rregullativ mikro dhe makroprudencial, në linjë me standardet më të mira të fushave respektive, me qëllim që të sigurojmë banka të shëndetshme dhe një sektor bankar të qëndrueshëm, që zgjeron veprimtarinë dhe forcon mbështetjen për zhvillimin ekonomik të vendit.

3. Si ka ndikuar procesi i konsolidimit të sistemit bankar i tre viteve të fundit?

Vitet e fundit, zhvillimet në sistemin bankar kanë qenë mjaft dinamike. Panorama e sistemit bankar ka pësuar ndryshime të ndjeshme, si nga përbërja numerike e numrit të bankave ashtu edhe nga origjina e kapitalit apo volumni dhe natyra e veprimtarisë.

Gjendja aktuale e sistemit bankar është rezultante e zhvillimeve të nisura shumë vite më parë, kur shfaqej interes nga aktorë të ndryshëm, vendas e të huaj, për t'u bërë pjesë e sistemit bankar shqiptar, gjë që përkonte edhe me vendimet e aktorëve

“Panorama e sistemit bankar ka pësuar ndryshime të ndjeshme, si nga përbërja numerike e numrit të bankave ashtu edhe nga origjina e kapitalit apo volumni dhe natyra e veprimtarisë.”


ekzistues për të ndryshuar fokus. Vendimi i grupeve të mëdha bankare për t'u larguar nga rajoni dhe ndikimin e vet edhe në Shqipëri, ndërkohë që largimi i disa bankave ishte pasojë edhe e vendimmarrjes nga autoritetet e Bashkimit Evropian, të cilat kushtëzuan praninë e filialeve të bankave, kryesisht me origjinë nga Greqia, në vende të ndryshme të Evropës Juglindore.

Rezultat i këtyre zhvillimeve është sot një sistem bankar me 12 banka nga 16 që ishin në fund të vitit 2017. Këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e bashkimit me përrhithje të tre bankave nga tre banka të tjera, si dhe likuidimi vullnetar i një banke të katërt.

Ndërkohë që panorama është e ndryshuar edhe përsa i përket origjinës së kapitalit. Kapitali vendas ka fituar peshë të ndjeshme në aktivet e sistemit bankar, duke arritur në mbi 30% të sistemit, dhe në rritje të vazhdueshme. Kjo prani është edhe më e madhe nëse i referohemi portofolit të kredisë, kur pesha e tyre zë mbi 36% të portofolit të sistemit. Madje vitin e fundit kemi edhe zgjerim të veprimtarisë jashtë kufijve të Shqipërisë kur dy prej bankave që operojnë në tregun shqiptar, njëra prej të cilave me kapital vendas, zhvillojnë veprimtari bankare edhe në Kosovë.

Me këtë panoramë të ndryshuar, sistemi bankar paraqitet me tregues të shëndetshëm financiarë kur treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është mbi nivelin 18% tashmë prej disa vitesh dhe treguesi i likuiditetit është po ashtu i lartë, në rreth 44% kundrejt minimumit rregullator prej 20%. Prania më e madhe e bankave vendase ka sjellë një vëmendje të shtuar të bankave ndaj tregut vendas dhe portofoli i kredisë është rritur me 6% në 12 muajt e fundit, ndërsa treguesi i kredive me probleme ka rënë me 0,4 pikë përqindjeje për të njëjtën periudhë. Rezultati financiar i sistemit, në muajin prill, arriti në 6,56 miliardë lekë, me një kthyesmëri të mirë kur ROA rezulton në 1,23% dhe ROE në 11,97%.

Grafik 40. Tregues të përfitueshmërisë dhe shpenzimeve të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendjen e duhur procesit të konsolidimit, për shkak të rëndësisë strategjike dhe të rëndësisë për vazhdimësinë e qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Nën këndvështrimin e situatës së paraqitur, të dhënat tregojnë për një proces të kënaqshëm konsolidimi me ruajtjen e parametrave financiarë brenda pritisshmërisë prudençiale, të zhvillimit ekonomik dhe të stabilitetit financiar të vendit.

4. Niveli i kredive me probleme ka vijuar uljen, pavarësisht pandemisë, i ndikuar dhe nga masat lehtësuese të Bankës së Shqipërisë. Me përfundimin e këtyre masave, si e prisni ecurinë e këtij treguesi? Cilët janë sektorët që e kanë përjetuar më shumë krizën dhe si është reflektuar kjo në aftësinë paguese të kredive ndaj bankave?

Treguesi i kredive me probleme arriti në 7,88% në fund të muajit prill 2021. Megjithë krizën e përjetuar, ky tregues ka ardhur në rënie në krahasim me fillimin e pandemisë, pavarësisht luhatjeve periodike.

Në fakt, ky tregues ka ardhur në rënie të vazhdueshme prej disa vitesh me rradhë. Në shtator 2015, Banka e Shqipërisë u angazhua në planin kombëtar për uljen e kredive me problem. Ky plan përfshinte disa reforma të rëndësishme ligjore dhe iniciativa të Bankës së Shqipërisë, veprimtari të cilat janë përmbushur plotësisht nga institucionet e përfshira. Si rezultat i këtij plani, treguesi i kredive me probleme ka rënë me rreth 12,7 pikë përqindjeje që nga hartimi i tij. Efektet e tij vijnë të ndjehen edhe aktualisht me ngritjen e infrastrukturës së përshtatshme që i ndihmon bankat në administrimin e portofolit të kredive me probleme.

Grafik 41. Kreditë me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me administrimin e situatës së pandemisë, është e rëndësishme të kuptohet që marrja e masave nuk kishte vetëm efekte matjeje të kredive me probleme. Ajo ishte një mundësi që iu dha bankave për të lehtësuar huamarrësit nga pagesat e detyrimeve, me qëllim ata të përmirësonin situatën e brendshme financiare, nëpërmjet likuiditetit të krijuar për të rifituar aftësinë e tyre paguese; kjo gjë ndodhi për një numër të madh huamarrësish.

Duke qenë se masat ishin të ndara me etapa kohore, mbyllja e etapës së parë, si më e rëndësishmja, gjatë së cilës u ndërpreu shlyerjet e detyrimeve për një numër të madh huamarrësish, pritej të shoqërohej me rritje të kredive me probleme, dukuri që u shfaq me materialitet shumë të ulët kur treguesi i kredive me probleme rezultoi në 8,3% në shtator 2020, kundrejt nivelit prej 8,18% që ishte në fund të shkurtit 2020. Që nga shtatori 2020, ky tregues ka ardhur në ulje të vazhdueshme.

E megjithatë, ecuria e tij për pjesën tjetër të vitit 2021 do të varet nga një sërë faktorësh, ku amplituda e krizës së lidhur me pandeminë mund ta shtrijë efektin edhe tek huamarrësit në varësi të shtrëngimeve të kushtëzuara, si nga zhvillimet në vend ashtu edhe nga ato në vendet me të cilat është e lidhur ekonomia jonë.

Shtrirja e efekteve të krizës në sektorët e ekonomisë është përafërsisht në raport të drejtë me peshën që çdo sektor ka në portofolin e kredisë. E rëndësishme për këtë mbetet qasja që kanë ndjekur bankat në dhënie


e zgjidhjeve gjatë ristrukturimeve të kredive për t'iu përshtatur cikleve të biznesit me planet e reja të pagesës.

5. Si do ta vlerësonit ecurinë e depozitave dhe sidomos të kreditimit të ekonomisë në vitin pandemik dhe çfarë duhet bërë për të nxitur atë në të ardhmen?

Ecuria e depozitave dhe e kredive, apo – me fjalë të tjera – e dy kaheve të bilancit të sektorit bankar, ka qenë një ndër surprizat pozitive të reagimit të sistemit tonë financiar gjatë pandemisë.

Me gjuhën e shifrave, depozitat në banka u rritën me 93 miliardë lekë, apo pothuaj me 8%, gjatë vitit 2020. Dëshiroj të theksoj se kjo rritje e shpejtë ka pasqyruar më së shumti zgjerimin e depozitave në monedhën vendase, të cilat gjeneruan mbi 60% të depozitave shtesë në banka. Në një plan më të gjerë historik, rritja e depozitave në një vit krize përbën një diferencë të qartë me të kaluarën, kur rritja e pasigurisë është shoqëruar jo rrallë me tkurrje të kursimeve të depozituara në banka. Kjo dukuri sinjalizon një besim të konsoliduar të publikut në shëndetin e sektorit bankar dhe është një produkt konkret i punës sonë të përbashkët në këtë drejtim.

Grafik 42. Ecuria e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontributi në normën vjetore të ndryshimit)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Po ashtu, e zhveshur nga luhatjet e kursit dhe procesi i pastrimit të bilanceve të sektorit bankar nga kreditë e humbura, kredia për sektorin privat u rrit me pothuaj 50 miliardë lekë, apo 7.7%, gjatë vitit 2020. Siç e nënvizova dhe më parë, zgjerimi i kreditimit gjatë vitit 2020 ishte një

nga çelësat e suksesit të Shqipërisë në përballimin e goditjes. Po ashtu, një element pozitiv është dhe struktura e kreditimit, e cila u bazua në zgjerimin e kredisë në monedhë vendase (mbi 60% të shtesës së kredisë) dhe zgjerimin e kredisë për bizneseve (mbi 70% të shtesës së kredisë). Ashtu si dhe në rastin e depozitave, rritja e kredisë në vit krize përbën një risi për sektorin tonë financiar dhe është një sinjal inkurajues për rolin që ky sektor mund të luajë në të ardhmen, jo vetëm në mbështetjen e rritjes ekonomike, por edhe në përballimin e goditjeve.

Duke parë nga e ardhmja, mendoj se rritja e kreditimit do të mbështetet në baza më solide.

Grafik 43. Kredia në Lek dhe kredia në valutë me dhe pa efektin e kursit të këmbimit, ndryshim vjetor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga njëra anë, ne shohim një trend rritës të kërkesës për kredi, sidomos në segmentin e bizneseve dhe në drejtim të financimit të investimeve. Nga ana tjetër, ne kemi bërë progres të konsiderueshëm gjatë viteve të fundit në drejtim të ofertës së kredisë. Sektori bankar paraqitet me bilance të shëndetshme, procesi i konsolidimit ka rritur konkurrencën dhe ka sjellë në treg aktorë të rinj e të motivuar, ndërkohë që rreziku i kreditit ka një reduktim strukturor, si pasojë e reformës që kemi ndërmarrë për adresimin e kredive me probleme.

Për të qenë më i plotë, më lejoni të theksoj se ecuria e kreditimit do të përfitonte nga adresimi i të njëjtave probleme strukturore që ka ekonomia shqiptare. Në këtë kontekst, jam i bindur se përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit, ulja e informalitetit, rritja e konkurrencës

dhe transparencës së biznesit, si dhe nxitja e investimeve vendase e të huaja, do ti hapnin rrugë një kreditimi më të shpejtë e më të shëndetshëm.

6. Norma bazë e interesit është në nivele minimale historike, ndërsa Banka e Shqipërisë është shprehur se politika monetare lehtësuese do të vazhdojë. Sa hapësira të mëtejshme ka banka që të vijojë me këtë politikë lehtësuese? Cili ka qenë efekti i deritanishëm i saj dhe si e vlerësoni shpejtësinë e transmetimit të këtyre politikave?

Sikundër e dini, në muajin mars 2020, ne ndërmorëm një lehtësim të mëtejshëm të politikës monetare, nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit dhe rritjes së injektimeve të likuiditetit në sektorin bankar. Stimuli i fortë monetar ka pasur një transmetim të mirë, i cili vijon të jetë i pranishëm edhe gjatë këtij viti. Në përgjigje të tij, tregjet financiare paraqiten të qeta, likuiditeti qarkullon normalisht dhe primet e rezikut janë të kontrolluara.

Duke garantuar funksionimin e mirë të tregjeve financiare, kemi bërë të mundur që efekti i politikës sonë monetare të arrijë tek huamarrësit e fundit, familjet e bizneset shqiptare, në formën e kostove të ulëta të financimit dhe rifinancimit të aktivitetit, si në formën e rritjes së vëllimit të kredisë. Po ashtu, mjedisi me norma të ulëta interesi nuk ka ushtruar presion për forcimin e kursit të këmbimit, çka do të vështirësonte edhe më shumë ecurinë e eksporteve tona. Në tërësi, kushtet e financimit janë akomoduese dhe kanë nxitur rritjen e kreditimit të sektorit privat, i cili ka mbështetur konsumin dhe investimet.

Vlerësimet tona tregojnë se, falë stimulit tonë monetar, vëllimi i aktivitetit ekonomik në vend dhe inflacioni janë përkatësisht 3.7 dhe 0.7 pikë përqindje më të lartë se niveli i tyre hipotetik në mungesë të këtij stimuli gjatë katër viteve të fundit.

Për sa i takon kahut të politikës monetare në të ardhmen, ai – si gjithmonë – diktohet nga nevoja e krijimit të kushteve të përshtatshme për respektimin e objektivit tonë të inflacionit në afatin e mesëm. Banka e Shqipërisë është shprehur për ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare përgjatë gjithë horizontit afatmesëm. Ky komunikim pasqyron gjykimin e Bankës së Shqipërisë se kushtet monetare duhet të vijojnë të mbeten akomoduese përgjatë gjithë këtij horizonti, duke synuar nxitjen e kërkesës agregate, krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe rritjen e pagave dhe të marxheve të fitimit në linjë me objektivin tonë të inflacionit. Në terma më të thjeshtë, kjo do të thotë se ne do të ruajmë një normë

bazë interesi relativisht të ulët, duke ju mundësuar familjeve dhe bizneseve të marrin më shumë kredi, të shërbejnë borxhet ekzistuese me më pak kosto, si dhe të rrisin konsumin dhe investimet. Konsistente me këtë politikë dhe këto projeksione, është dhe pritja jonë se inflacioni do të kthehet në objektiv brenda vitit 2022.

Ndonëse perspektiva ekonomike është pozitive, rrjedha e pasigurt e pandemisë ende paraqet rreziqe në afatin e shkurtër. Në rast të lindjes së nevojës për rritje të stimulit monetar, ne zotërojmë mjetet e nevojshme për ta arritur këtë. Lehtësimi i mëtejshëm monetar mund të realizohet si nëpërmjet uljes së normës bazë - ndonëse jemi të ndërgjegjshëm se hapësirat në këtë drejtim mbeten të pakta - ashtu edhe nëpërmjet politikave të lehtësimit sasior. Në çdo rast, stimujt e ofruar nga ne do të ndërmerren duke pasur në konsideratë një analizë të plotë të kostove dhe përfitimeve të mundshme, shkallën e zhvillimit të tregut tonë financiar, kufizimet ligjore dhe nevojën për ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar të vendit.

7. Jeni shprehur që do ketë përdorim të instrumenteve jokonvencionale. A mund të jeni më specifikë për cilat instrumente flasim dhe kur pritet të fillojë aplikimi i tyre? Cili është ndikimi i pritshëm në financimin e ekonomisë së vendit?

“Stimuli i ofruar nëpërmjet instrumentit konvencional të politikës monetare – normës bazë të interesit – vazhdon të përcillet në ekonomi, duke siguruar kushte financimi të përshtatshme për të mbështetur rikuperimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv.”

Sikurse e përmenda, kushtet aktuale të ekonomisë dhe pritjet tona për të ardhmen nuk diktojnë nevojën për një rritje të mëtejshme të stimulit monetar. Stimuli i ofruar nëpërmjet instrumentit konvencional të politikës monetare – normës bazë të interesit – vazhdon të përcillet në ekonomi, duke siguruar kushte financimi të përshtatshme për të mbështetur rikuperimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë harton në vazhdimësi plane kontigjence, të cilat na ndihmojnë të jemi të përgatitur për çdo eventualitet. Pjesë e këtyre planeve është dhe përdorimi i instrumenteve jokonvencionale të politikës monetare, në rast se vendi do të përballej me një goditje shtesë negative pasojat e së cilës nuk mund të adresoheshin nëpërmjet hapësirës së kufizuar që kemi në rrafshin konvencional.

Përzgjedhja e instrumentit më të përshtatshëm mban parasysh një matricë kriteresh, ku ndër më të rëndësishmit janë kuadri ligjor, stadi i zhvillimit të tregjeve financiare dhe natyra e goditjeve potenciale. Bazuar në këto dimensione, ne gjykojmë se lehtësimi sasior do të ishte opsioni më i mirë.


Si do të funksiononte ai në praktikë? Banka qendrore blen letra me vlerë të qeverisë në tregun dytësor. Duke kryer operacione të tilla, ajo ul normat e interesit për këto letra dhe rrit vëllimin e likuiditetit në ekonomi, duke inkurajuar bankat të japin më shumë kredi. Zbatimi i këtij instrumenti nënkupton një injektim të përhershëm likuiditeti në sistem, rrjedhimisht ai duhet të përdoret në raste tejet specifike dhe për periudha kohore afatshkurtra.

Përdorimi i tij do të konsiderohej i përshtatshëm në rastet e konstatimit të mungesës së likuiditetit në tregjet financiare dhe/ose rritjes së primeve të rrezikut, të cilat do të zhvendosnin lart kurbën e normave të interesit. Aktualisht, ne nuk konstatojmë pengesa të tilla në mekanizmin e transmetimit të politikës sonë monetare dhe, rrjedhimisht, nuk shohim nevojën e përdorimit të këtij instrumenti.

8. Niveli i parasë jashtë bankave ka shënuar rritje të vazhdueshme vitet e fundit, pavarësisht masave që ju keni marrë për të ulur përdorimin e parasë cash. Si e shpjegoni këtë rritje dhe çfarë masash shtesë duhen ndërmarrë për të nxitur përdorimin e pagesave elektronike?

Para jashtë bankave u rrit me rreth 53 miliardë lekë në vitin 2020, kundrejt një rritjeje prej vetëm 16.7 miliardë lekësh në vitin paraardhës. Megjithatë, ky përshtetësi i rritjes së këtij treguesi nuk është një fenomen i izoluar, por pasqyron tendencën e përgjithshme të përshtetimit të të gjithë treguesve të tjerë monetarë, si depozitat apo kredia.

Grafik 44. Paraja jashtë bankave/M2 (raport)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Siç e kemi theksuar dhe më parë, rritja relativisht e shpejtë e parasë në qarkullim gjatë vitit 2020 është produkt i disa faktorëve, ku spikasin:

- rritja e shpejtë e masës monetare në ekonomi, si përgjigje e niveleve të larta të deficitit buxhetor dhe rritjes relativisht të shpejtë të kreditit gjatë vitit të shkuar;
- prezenca e pandemisë, e cila rriti preferencën për *cash* të familjeve, si rezultat i pasigurisë, por dhe i dëshirës për të reduktuar kontaktet fizike. Ky fenomen është vënë re gjerësisht dhe në vende të tjera.

Ajo që mendoj se duhet evidentuar është fakti se rritja e lartë e parasë fizike në ekonomi nuk ka ardhur në kurriz të depozitave. Sikundër e thashë, këto të fundit u rritën me rreth 93 miliardë lekë gjatë vitit 2020, duke i mundësuar sektorit bankar fonde të mjaftueshme për ndërmjetësim financiar.

Përtej këtyre faktorëve, dëshiroj të theksoj se prezenca e lartë e parasë fizike në ekonominë shqiptare favorizohet dhe nga tipare strukturore të saj, si ekonomia informale, shkalla e kulturës financiare, si dhe përqendrimi relativisht i lartë i popullsisë në zonat rurale. Mendoj se këto çështje duhen adresuar përmes reformave strukturore në sistemin e pagesave, edukimit të vazhdueshëm të popullatës, si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit fiskal.

Nga ana jonë, Banka e Shqipërisë ka qenë dhe mbetet një aktor institucional i investuar në vazhdimësi në drejtim të rritjes së edukatës financiare dhe përmirësimit të sistemit të pagesave.

9. Pas miratimit të ligjit të ri të pagesave nga Banka e Shqipërisë, si pritet të ndikohet sistemi i pagesave në vend? Sa konkurrent është ai?

Shërbimet e pagesave janë pjesë integrale e sistemeve të pagesave dhe si të tilla janë në fokus të vazhdueshëm të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, si një nga shërbimet financiare më bazike, ato konsiderohen si mjet i parë, por njëkohësisht dhe tepër i rëndësishëm për nxitjen e përfshirjes financiare.

Në këtë kuadër, sikurse është shprehur dhe më parë në komunikimet publike, Banka e Shqipërisë dhe Komitetit Kombëtar i Sistemit të Pagesave, që prej vitit 2018, kanë ndërmarrë një reformë për modernizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, e materializuar në Strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023). Qëllimi parësor i kësaj strategjie është nxitja e përfshirjes financiare të popullsisë (nga 40% në vitin 2016, në 70% në vitin 2023) dhe ajo e përdorimit të pagesave elektronike (duke arritur 10 pagesa për fryme në 2023, nga 4.3 në vitin 2016), nëpërmjet krijimit të një tregu modern e gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri.

Ligji “Për shërbimet e pagesave” konsiderohet si një nga masat më të rëndësishme për përmbushjen e reformës dhe arritjen e objektivave të përmendur më sipër. Në radhë të parë, nëpërmjet prezantimit të aktorëve dhe shërbimeve të reja, si dhe ridimensionimit të veprimtarisë aktuale të institucioneve financiare jobanka që ofrojnë shërbime pagesash dhe transfertash, ligji vlerësohet se do të nxisë konkurrencën në tregun e pagesave. Për të konkretizuar akoma më tej pritshmëritë tona në lidhje me nxitjen e konkurrencës, dëshiroj të shpjegoj se ligji krijon një ambient i cili synon të kalibrojë kërkesat rregullative midis bankave dhe jobankave, duke i vendosur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për të vepruar në mënyrë të barabartë në fushën e shërbimeve të pagesave dhe kryesisht atyre në formë elektronike. Kjo konkurrencë natyrisht do të krijojë shërbime më efikase si nga pikëpamja e kostove të mbartura në përdorim ashtu edhe nga pikëpamja e lehtësisë së përdorimit nga publiku i gjerë.

Për më shumë, prezantimi i dy veprimtarive të reja inovative – asaj të inicimit të shërbimit të pagesës dhe të informimit mbi llogarinë - përtej promovimit të inovacionit, vlerësohet se ndikon edhe në nxitjen e mëtejshme të konkurrencën. Thënë në mënyrë më të kuptueshme për publikun e gjerë, ofrimi i këtyre shërbimeve nga të ashtuquajturat kompani fintech nxit përdorimin e tregtisë elektronike, një objektiv ky me mjaft

interes për t'u zhvilluar në nivel kombëtar, duke mundësuar alterantiva pagesash online më lehtësisht të përdorshme dhe me kosto më të ulta. Krahas shërbimit të inicimit të pagesave, shërbimet e informimit të llogarisë u mundësojnë konsumatorëve dhe bizneseve të kenë një pamje globale mbi gjendjen e tyre financiare, si dhe të konsolidojnë llogaritë e ndryshme të pagesave që mund të kenë me një ose më shumë banka ose institucione pagesash. Vlen të theksohet se, për qëllime të përdorimit të këtyre shërbimeve, ligji krijon edhe konceptin e ashtuquajtur të bankës së hapur (open banking) që vlerësohet si një nga risitë e tregut të pagesave dhe në rang ndërkombëtar.

Gjithashtu, çështje të tjera me rëndësi të rregulluara nga ky ligj janë dhe krijimi i një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit, duke krijuar kushte si për transparencën ashtu edhe për të drejtat dhe detyrimet e palëve. Për më shumë, ligji parashikon edhe ngritjen e një njësie të posaçme për adresimin e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatë që vlerësohet të ketë një ndikim të ndjeshëm në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit. Vlen të nënvizohet se, krijim i një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit bëhet akoma edhe më domethënës për një treg me edukim dhe përfshirje financiare jo tejet të zhvilluar.

Të gjitha këto zhvillime ligjore e rregullative janë mbështetur dhe do të vijojnë të mbështeten nga ana e Bankës së Shqipërisë dhe e tregut, edhe me zhvillime infrastrukturore, ku do doja të përmendja sistemin e shlyerjes së pagesave brenda vendit në euro dhe projektet afatmesme dhe njëkohësisht mjaft ambicioze të Instant Payment dhe Switch-it Kombëtar.

“Projekti Instant Payment / Switch-it Kombëtar synon të krijojë platforma kombëtare të cilat, nëpërmjet reduktimit të ciklit të pagesave dhe promovimit të inovacionit, synojnë të nxisin pagesat në distancë si nëpërmjet reduktimit të kostove, ashtu dhe përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve të përdorura.”

Operacionalizimi i sistemit të shlyerjes së pagesave në euro brenda vendit, një projekt ky drejt finalizimit, ka për qëllim t'i mundësojë qytetarëve shqiptarë kryerjen e pagesave në euro brenda vendit me kosto shumë më të ulta dhe brenda një afati kohor shumë më të shkurtër nga procesi aktual i kryer nëpërmjet bankave korrespondente. Gjithashtu, ky projekt vlerësohet të ketë efekte mjaft pozitive edhe nga pikëpamja e administrimit të parasë fizike në euro nga ana e bankave.

Nga ana tjetër projekti Instant Payment / Switch-it Kombëtar synon të krijojë platforma kombëtare të cilat, nëpërmjet reduktimit të ciklit të pagesave dhe promovimit të inovacionit, synojnë të nxisin pagesat në distancë si nëpërmjet reduktimit të kostove, ashtu dhe përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve të përdorura.

10. Banka e Shqipërisë do të hedhë në qarkullim dy kartëmonedha të reja të serisë së re: 1 000 dhe 10 000 Lekë. Kur do të hidhen në qarkullim këto kartëmonedha? Përse Banka e Shqipërisë ndjeu të nevojshme të shtojë prerje 10.000 Lekë në serinë e re të kartëmonedhave dhe çfarë mund të na zbuloni më shumë për këtë kartëmonedhë?

Kartëmonedhat e serisë së re, të prerjes 1 000 Lekë dhe 10 000 Lekë, parashikohen të hidhen në qarkullim në fund të muajit qershor 2021. Shtypja e kartëmonedhave të reja 1000 dhe 10 000 Lekë është pjesë e vijimësisë së një pune disaveçare të Bankës së Shqipërisë për të emetuar serinë e re të kartëmonedhave Lek, si dhe njëkohësisht për të garantuar në çdo moment furnizimin e ekonomisë me para të gatshme.

Më lejoni të nënvizoj se një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është të garantojë furnizimin e ekonomisë me para të gatshme, si në vlerë ashtu edhe në strukturë. Shtypja dhe hedhja në qarkullim për herë të parë e kartëmonedhës së re të prerjes më të lartë, me vlerë 10 000 Lekë, përfaqëson në vetvete përshtatjen e strukturës së kartëmonedhave me strukturën e çmimeve dhe pagave, zhvillimet e sistemit të pagesave, si dhe treguesve të tjerë që lidhen me trajtimin e parasë.

“Hedhja në qarkullim për herë të parë e kartëmonedhës së re të prerjes më të lartë, me vlerë 10 000 lekë, përfaqëson në vetvete përshtatjen e strukturës së kartëmonedhave me strukturën e çmimeve dhe pagave, zhvillimet e sistemit të pagesave, si dhe treguesve të tjerë që lidhen me trajtimin e parasë.”

Kjo kartëmonedhë e prerjes më të lartë shoqëron zhvillimin ekonomik të vendit dhe sipas të gjitha analizave, plotëson kërkesat e tregut për ta pasur në strukturën e serisë sonë të kartëmonedhave me kurs ligjor. Prezantimi dhe hedhja e saj në qarkullim do të mundësojë për një qarkullim më të mirë dhe më efikas të parasë së gatshme, duke ndihmuar strukturën e monedhës në qarkullim dhe njëkohësisht duke ulur kostot e prodhimit, magazinimit dhe shpërndarjes, dhe në këtë mënyrë duke rritur efikasitetin e Bankës së Shqipërisë në administrimin

e parasë fizike dhe emisionit. Gjithashtu, prezenca e kësaj prerjeje të re më të lartë në strukturën e kartëmonedhave shqiptare rrit efikasitetin e Bankës së Shqipërisë edhe për të administruar një stok strategjik sa më të përshtatshëm për të përballuar raste të rritjeve të paparashikuara të kërkesës së tregut për para fizike.

Pavarësisht zhvillimit të mjeteve të tjera të pagesës, si ato elektronike, paraja në qarkullim vijon të ketë ndër vite një trend rritës, i cili pasqyron kërkesën e vazhdueshme të ekonomisë për para fizike si mjet pagese. Banka e Shqipërisë planifikon me kujdes për të garantuar plotësimin e kësaj kërkesë të tregut, si në situata normale ashtu edhe në ato jotipike. Edhe situata më e fundit e pandemisë COVID-19, është një shembull konkret në këtë drejtim. Gjatë kësaj periudhe ka rezultuar një rritje shtesë e kërkesës së ekonomisë për para fizike. Kështu, gjatë vitit 2020, paraja në qarkullim është rritur me rreth 52 miliardë lekë ose rreth 3 herë më shumë se rritja e shënuar gjatë vitit 2019. Gjithashtu, edhe në 5 muajt e parë të vitit 2021 është shënuar një rritje prej rreth 10 miliardë lekësh. Plotësimi i kërkesës së tregut për para fizike është mbështetur nëpërmjet sigurimit dhe planifikimit të stokut të mjaftueshëm të parasë në Bankën e Shqipërisë, e cila jep siguri jo vetëm për të tashmen, por edhe për të ardhmen.

Kartëmonedha 10 000 Lekë mbart si tematikë simbolet e flamurit kombëtar dhe himnit, të shoqëruar me portretin e poetit tonë të rilindjes kombëtare Asdreni, për shkak të pranimit mbarë popullor të Asdrenit si autor i tekstit të "Himnit Kombëtar" të shqiptareve, një krijim i cili së bashku me Flamurin Kombëtar janë që prej pavarësisë simbole identiteti të shqiptareve. Si të gjitha prerjet e serisë së re, edhe kjo kartëmonedhë përmban elemente sigurie të avancuara, të prodhuara me teknologjitë më të fundit të fushës, të cilat lehtësojnë identifikimin nga publiku, rrisin besueshmërinë tek paraja kombëtare dhe bëjnë më të vështirë falsifikimin.


11. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat do të përballlet ekonomia në rimëkëmbjen pas pandemisë? Çfarë duhet bërë në mënyrë që të nxitet një zhvillim i qëndrueshëm dhe i orientuar nga inovacioni dhe rritja e vlerës së shtuar?

Sfidat me të cilat përballen institucionet e ngarkuara me hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike janë të dyfishta.

Në një dimension më të afërt kohor, ne duhet të kujdesemi të garantojmë qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike dhe rikuperimin e plotë të ekonomisë

pas goditjes së pandemisë. Kjo do të kërkojë, në vija të përgjithshme, një mix stimulues politikash ekonomike në horizontin afatmesëm. Përshtatshmëria e këtij mixi duhet riparë në vazhdimësi, si në drejtim të intensitetit ashtu dhe në drejtim të kompozimit. Forcimi i qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike duhet të shoqërohet me një riorientim gradual të politikës fiskale drejt konsolidimit të borxhit publik, çka do të nënkuptonte dhe një rritje të peshës relative që politika monetare ka si instrument i mbështetjes së ekonomisë.

Grafik 45. Treguesit fiskalë në % të PBB-së



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në një plan më të gjatë kohor, ekonomia shqiptare do të përfitonte nga përshejtimi i reformave strukturore, në drejtim të rritjes së shpejtësisë dhe të qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike. Banka e Shqipërisë e ka përsëritur në vazhdimësi këtë thirrje. Në këtë kontekst, gjej me vend të nënvizoj se diagnozat që i bëhen shkallës së zhvillimit të ekonomisë shqiptare, aftësisë së saj për të gjeneruar investime të brendshme dhe për të tërhequr investime të huaj, si dhe aftësisë së saj për të konkurruar në tregun botëror, janë publike dhe transparente.

Në funksion të adresimit të dobësive tona strukturore, si dhe të zhvillimit të avantazheve strategjike, mendoj se një program i plotë dhe gjithëpërfshirës reformash duhet të orientohet në tre tema kryesore:

- së pari, zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës fizike dhe dixhitale të vendit, si dhe ndërlidhjen e saj me ekonominë e rajonit dhe të botës;
- së dyti, përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit, në drejtim të uljes së informalitetit, promovimit të konkurrencës, uljes së primeve

të rrezikut politik dhe ekonomik të vendit, si dhe përmirësimin e garantimit të kontratave;

- së treti, rritjen e investimeve në arsim dhe shëndetësi, orientimin e kurrikulave shkollore drejt arsimit profesional dhe degëve të teknologjisë së informacionit, për të rritur kualifikimin e fuqisë sonë punëtore dhe për të synuar një pozicionim më të lartë të vendit në shkallën e vlerës së shtuar.

“Akhenda jonë e reformave strukturore duhet të orientohet nga prioritetet e qarta, të ketë ankora të qëndrueshme politike dhe sociale, si dhe të jetë mjaftueshmërisht fleksibel në terma të instrumenteve operacionale.”

Mendoj se Shqipëria po i adreson tashmë të tre këto prioritetet, por ajo që duhet të kuptojmë është se gjendemi në një garë rajonale dhe globale, të cilën nuk duhet dhe nuk mund ta humbim. Në këtë kontekst, mendoj se axhenda jonë e reformave strukturore duhet të orientohet nga prioritetet e qarta, të ketë ankora të qëndrueshme politike dhe sociale, si dhe të jetë mjaftueshmërisht fleksibel në terma të instrumenteve operacionale.

Së fundi, gjej me vend të theksoj se të gjitha këto masa duhen komplementuar nga ruajtja e një ambienti të qëndrueshëm monetar e financiar, mbështetja e të cilit ka qenë dhe do të mbetet objektiv primar i punës së Bankës së Shqipërisë.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR TELEVISIONIN NEWS 24

-17 qershor 2021-

Gazetarja: Banka e Shqipërisë ka prezantuar dy kartëmonedha të reja, të cilat do të hidhen në qarkullim në datën 30 qershor. Për këtë temë do të flasim sot me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko. Gjithashtu do të flasim edhe për ecurinë e ekonomisë pas pandemisë COVID-19. Përshëndetje z. Guvernator!

Guvernatori: Përshëndetje, mirë se erdhe!

Gazetarja: Faleminderit. Siç e thashë edhe pak më parë do të flasim lidhur me kartëmonedhat që pritet të hidhen në qarkullim në datën 30 qershor. A mund të na thoni se cilat janë këto prerje dhe çfarë do të sjellë kjo për qytetarët?

Guvernatori: Prerjet e reja të kartëmonedhës u prezantuan pardje në ambientet e Bankës së Shqipërisë, dhe ato janë prerjet 1000 Lekë dhe 10000 Lekë. Kjo e fundit është një prerje tërësisht e re. Seria e re e kartëmonedhave shqiptare u prezantua e rishikuar në shtator të vitit 2019. Në serinë e re janë ndryshuar përmasat dhe janë shtuar elementet e sigurisë në kartëmonedhë me qëllim përmirësimin e saj, por nuk ka ndryshuar tematika.



Ndryshimet e reja, gjithashtu, synojnë përshtatjen me standardet ndërkombëtare të kartëmonedhave, duke iu referuar kryesisht euros, por edhe kartëmonedhave të vendeve të zhvilluara. Qëllimi ynë është të kemi një kartëmonedhë më të sigurt dhe më cilësore në duart e agentëve ekonomikë dhe qytetarëve shqiptarë. Prerja më e lartë e kartëmonedhës është ajo me vlerë 10 000 Lekë, prerje tërësisht e re, me temë himnin e flamurit dhe me portretin e poetit të rilindjes kombëtare, Asdreni. Të dyja kartëmonedhat 1000 Lekë dhe 10000 Lekë të serisë së re do të marrin kurs ligjor dhe do të përdoren si mjet pagese në tregun shqiptar në datën 30 qershor. Këto ditë, ne po prezantojmë dhe informojmë publikun për këto dy kartëmonedha.

Gazetarja: Të ndalemi pak te elementet e sigurisë, duke qenë se ne do të kemi edhe një kartëmonedhë të re, e cila do të hidhet në qarkullim më 30 qershor. Le të ndalemi pak te kartëmonedha 10 000 Lekë që sikurse u shprehët edhe ju është një prerje e madhe, një prerje e re, e monedhës shqiptare. Ku bazohet Banka e Shqipërisë kur merr vendime të tilla dhe a i duhet ekonomisë shqiptare, një kartëmonedhë me prerje kaq të madhe?

Guvernatori: Në fakt, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për këtë prerje është marrë 9 apo 10 vite më parë. Ndërkohë, gjatë këtyre viteve është zhvilluar edhe një projekt i ri për ridizenjimin dhe rishikimin e kartëmonedhës, e cila po materializohet me prerjet e reja në qarkullim sipas njoftimeve që ne kemi bërë më parë.

Sigurisht që kishte ardhur momenti, pasi të gjithë aktorët si: tregu shqiptar, sistemi financiar, sistemi bankar, agjentët ekonomikë dhe përdoruesit; kishin nevojë për një prerje më të lartë. Sikurse jeni në dijeni, prerja më e lartë e kartëmonedhës shqiptare, ka qenë ajo 5000 Lekë, e cila është pjesë e emisionit të vitit 1996. Po të kemi parasysh se sa vite kanë kaluar dhe sa ka qenë niveli i pagave dhe i çmimeve në Shqipëri, krahasuar me vitin 1996, mund të kuptojmë qartë nevojën për një prerje më të lartë.

Kjo prerje më e lartë sigurisht ishte një domosdoshmëri jo vetëm e tregut, por edhe e ekonomisë shqiptare. Njëkohësisht, ajo do të ndihmojë bankën qendrore për një miradministrim të rezervës së parasë, sistemin bankar në tërësi për administrimin e parasë që disponon në thesaret e tyre dhe gjithashtu bizneset dhe individët shqiptarë. Kjo prerje mund të ishte hedhur edhe më herët në treg, por mund të themi që jemi ende në kohë për një prerje më të lartë në serinë e kartëmonedhës shqiptare.

Gazetarja: Pra kjo do të thotë zoti Guvernator, që ka pasur një diskutim të gjatë në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me hedhjen në treg të kartëmonedhës 10000 Lekë për të marrë një vendim?

Guvernatori: Po, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës ka qenë më i hershëm. Sigurisht ka një procedurë të përcaktuar ligjore, jo vetëm për prerjen dhe sasinë e kartëmonedhës, por dhe për tematikën.

Në serinë e re të kartëmonedhës nuk kemi ndryshuar tematikën për prerjet, por kemi ndryshuar madhësinë. Ndërkohë, simbolet e të gjitha kartëmonedhave janë ato që kanë qenë dhe që pasqyrojnë historinë e kombit shqiptar që nga lashtësia deri në ditët e sotme me përpjekjet e tij për liri dhe prosperitet. Në këtë kontekst, kartëmonedha e fundit përfaqëson himnin e flamurit. Sigurisht që tematika e kartëmonedhës nuk është atribut vetëm i Bankës së Shqipërisë, por edhe rezultat i punës së një komisioni që përbëhet nga historianë, numizmatë, albanologë, ekspertë të fushës dhe sigurisht ekspertë të Bankës së Shqipërisë.

“... tematika e kartëmonedhës nuk është atribut vetëm i Bankës së Shqipërisë, por edhe rezultat i punës së një komisioni që përbëhet nga historianë, numizmatë, albanologë, ekspertë të fushës dhe sigurisht ekspertë të Bankës së Shqipërisë.”

Është pikërisht ky komision, i cili ka përzgjedhur tematikën për prerjen e kartëmonedhës 10000 Lekë, me himnin e flamurit. Pas marrjes së vendimit të Këshillit Mbikëqyrës mbi prerjen e kartëmonedhës, vjen momenti që komisioni të vendosë tematikën përkatëse dhe më pas ekspertët vendosin elementet e sigurisë dhe formatimin në prerje, të cilat janë të lidhura me pamjen e kartëmonedhës. I gjithë ky proces është përmbyllur me sukses dhe tashmë ne kemi në duart tona prerjen më të lartë që është ajo prej 10000 Lekësh.

Gazetarja: Zoti Guvernator, kartëmonedha 10000 Lekë është ajo që siç e thatë edhe ju ka një tematikë me simbolet e flamurit kombëtar por gjithashtu dhe të himnit kombëtar. Ndërkohë që nga pjesa e përparme kemi portretin e Asdrenit, që është njëkohësisht dhe autor i himnit kombëtar. Të ndalemi pak te fotoja e Asdrenit, pasi kjo ka shkaktuar edhe debate të forta në rrjetet sociale për ngjashmërinë me politikanët e sotëm. A keni një koment në lidhje me këtë çështje ju?

Guvernatori: Në fakt nuk i kam lexuar komentet në rrjetet sociale, të cilat mund të kenë qenë nga më të ndryshmet. Poeti Asdreni është

një poet i shquar i Rilindjes Kombëtare dhe autor i tekstit të himnit të flamurit kombëtar. Pikërisht komisioni që ju përmenda më sipër ka bërë përzgjedhjen e tematikës për prerjen 10000 Lekë, të cilën ne po hedhim në qarkullim.

Duhet marrë në konsideratë fakti që e gjithë seria e kartëmonedhës sonë mbart një portret - në rastin konkret lidhur me tematikën e himnit të flamurit. Portreti është i rilindasit tonë të shquar Asdreni. Komentet me ngjashmërinë e politikanëve mund të jenë nga më të ndryshmet. Unë mendoj që tematika e zgjedhur nga komisioni me ekspertët përkatës në detyrim të ligjit, në funksion të kartëmonedhës 10000 Lekë, ka një tematikë të përzgjedhur me seriozitetin dhe kujdesin e duhur.

Gazetarja: Përveç prerjes 10000 Lekë, po prerjet 500 dhe 2000 Lekë, zoti Guvernator, kur pritet të hidhen në treg?

Guvernatori: Seria e re ka edhe dy prerje të tjera, të cilat janë në proces prodhimi. Në shtator të vitit 2019, ne kemi nxjerrë fillimisht prerjen 200 Lekë me material polimer dhe atë 5000 Lekë, të cilat janë sot në duart e përdoruesve dhe janë mirëpritur nga publiku.

Ndërsa tani po hedhim në qarkullim prerjet 1000 Lekë dhe 10000 Lekë që janë dy prerjet e tjera të serisë. Dy prerjet e fundit 500 Lekë dhe 2000 Lekë pritet të vijnë në muajin nëntor ose dhjetor në varësi të situatës që do të ketë fabrika. Në këto kushte, parashikimi ynë është që në fillim të vitit tjetër të hidhen në qarkullim. Pas këtij momenti, mund të themi se seria e re e kartëmonedhës shqiptare do të jetë e kompletuar plotësisht. Edhe njëherë e theksoj, që prerjet e reja do të jenë në qarkullim paralelisht me prerjet ekzistuese.

Gazetarja: Prerjet ekzistuese do të jenë akoma në qarkullim?

“Prerjet ekzistuese do të vazhdojnë të jenë në qarkullim në duart e publikut dhe agjentëve ekonomikë paralelisht me prerjet e reja.”

Guvernatori: Po, prerjet ekzistuese do të vazhdojnë të jenë në qarkullim në duart e publikut dhe agjentëve ekonomikë paralelisht me prerjet e reja. Gradualisht, me kalimin e kohës do të tërhiqen nga qarkullimi prerjet ekzistuese dhe vendin e tyre do ta zënë plotësisht kartëmonedhat e reja. Por, për një periudhë të gjatë kohe do t'i kemi të dyja seritë e kartëmonedhave në qarkullim me kurs ligjor.

Gazetarja: *Ne, zoti Guvernator, folëm për kartëmonedhat e reja që do të hidhen në qarkullim, por ashtu siç e thashë dhe pak më parë dua që të prekim edhe tematikën e ekonomisë pas pandemisë së COVID-19. Kur ka kaluar më shumë se një vit e gjysmë nga fillimi i pandemisë COVID-19, a mund të na thoni, zoti Guvernator se si e përballoi ekonomia shqiptare këtë goditje që në fakt ishte shumë e vështirë jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjitha vendet e botës dhe kur e vlerësoni ju se pritjet të kemi një rimëkëmbje të plotë?*

Guvernatori: Ekonomia shqiptare e ka përballuar mjaft mirë dhe është treguar fleksibël dhe rezistente ndaj pandemisë. Rezultatet e treguesve ekonomikë vërtetojnë që ekonomia jonë ka pësuar një tkurrje më të vogël nga ajo që kishim parashikuar në fillim të pandemisë. Po të rikthehemi në kohë, vitin e kaluar institucionet ndërkombëtare, të cilat bëjnë vlerësimet përkatëse për ecurinë ekonomike, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, nxorën disa parashikime mjaft pesimiste me një rënie ekonomike deri në nivelin 7.5%. Ndërkohë që për tremujorin e dytë të vitit të kaluar, parashikimi për rënie ekonomike mbërriti në nivelin 12.5%. Frika dhe pasiguria mbi mënyrën se si do të reagonin ekonomitë e shteteve më të mëdha nga goditja e pandemisë dominonin të gjithë botën. Por, fatmirësisht si pasojë e masave të ndërmarra nga qeveria shqiptare në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, dhe me reagimin e agjentëve të tregut, ekonomia u tregua rezistente dhe rënia ekonomike rezultoi në nivelin 3.3%.

Parashikimi i Bankës së Shqipërisë është në linjë me Fondin Monetar Ndërkombëtar për këtë vit, për një rritje ekonomike në nivelin 5.3%. Pra, ne parashikojmë të kemi një rritje të konsiderueshme ekonomike duke filluar nga ky vit. Ndërkohë që për vitin në vijim kemi parashikuar një rritje në nivelin 4.1%. Gjithsesi, është shumë e rëndësishme të theksohet se pandemia është miradministruar dhe ne po shohim numra në rënie të infektiveve prej saj. Shpresojmë që sezoni i verës jo vetëm të ketë një ringritje në sektorin e turizmit, i cili ka një impakt të fuqishëm në ekonominë shqiptare, por kjo ringritje të shkojë paralelisht me rënien e infektiveve. Nëse në vjeshtë e më pas ne do të kemi një mirëmenaxhim të krizës nga pandemia, sigurisht që do të materializohen edhe parashikimet tona për ringritje ekonomike.

Shenjat janë mjaft pozitive. Ne jemi në pritje të një ringritjeje ekonomike këtë vit të pasuar nga viti i ardhshëm. Përbën një lajm mjaft pozitiv fakti që ekonomia shqiptare ka rezistuar dhe tregjet financiare kanë qenë të qeta dhe kursi i këmbimit i qëndrueshëm.


Sistemi bankar ka reaguar pozitivisht dhe ka treguar rezistencë ndaj goditjes së pandemisë. Vlen të përmendet, ndër të tjera, edhe rritja e kreditimit në një nivel të konsiderueshëm prej 7.5%, një tregues ky mjaft pozitiv për një vit kaq të vështirë pandemie.

Parashikimet kanë qenë mjaft pesimiste. Për këtë arsye, ne vazhdojmë të jemi shumë të kujdesshëm në drejtim të kredisë së keqe dhe kredisë me probleme, e cila jo vetëm që nuk pësoi rritje gjatë kësaj periudhe krize, por përkundrazi regjistroi një rënie të mëtijshme. Nëse ne nuk do të kishim përjetuar krizën financiare apo goditjen nga pandemia, rënia e kredisë me probleme do të ishte akoma më e konsiderueshme.

Ndërkohë kredia me probleme zbriti nga niveli 8.1% në fund të vitit 2020, në nivelin prej 7.8%. Nga komunikimet institucionale me bankat e nivelit të dytë, të cilat kanë një komunikim të drejtpërdrejtë me klientët, mund të themi se në të ardhmen ne nuk presim një përkeqësim të kredisë me probleme.

Sigurisht që në analizën tonë si bankë qendrore, ne kemi marrë në konsideratë edhe skenarët më pesimistë. Gjithsesi, sistemi ynë bankar rezulton i mirëkapitalizuar dhe me gjendje shumë të mirë likuiditeti. Në këto kushte, ai do ta përballonte me sukses çdo lloj situatë të përkeqësuar. Fatmirësisht, ne nuk ndodhemi përballë një situatë të tillë, përkundrazi presim një ringritje dhe përmirësim të ekonomisë dhe të sistemit bankar si mbështetës në financimin e saj.

Grafik 46. Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistematike



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gazetarja: Z. Guvernator, cilat janë sfidat me të cilat përballlet ekonomia në rimëkëmbjen pas pandemisë, çfarë duhet bërë për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm të saj?

Guvernatori: Sfidat janë të shumta për çdo ekonomi dhe veçanërisht për ekonominë tonë. Në radhë të parë, sfida jonë kryesore do të jetë jo për ekonominë, por për sistemin shëndetësor. Kjo sfida lidhet me administrimin e mirë të situatës së pandemisë. Fatmirësisht, sinjalet janë mjaft pozitive dhe optimiste me vaksinimin e popullatës që po ecën me ritme të larta.

Sa i përket ekonomisë, në cilësinë e institucionit financiar mbikëqyrës dhe rregullator, ne kemi objektiva të qartë, të cilët janë përcaktuar edhe në ligj. Si objektivi parësor, ne kemi stabilitetin e çmimeve dhe stabilitetin financiar.

Për ne si bankë qendrore, sfida kryesore është ruajtja e stabilitetit të çmimeve dhe arritja e nivelit të shënjestruar të inflacionit. Paralelisht, një sfida tjetër madhore për ne është ruajtja e një sistemi financiar të qëndrueshëm, i cili do të ndihmojë ekonominë për një ringritje në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve shqiptarë.

Sikurse e kemi theksuar edhe më parë, ne do të vijojmë të ndjekim politikën tonë monetare lehtësuese me një normë interesi në minimumin e saj historik. Kjo politikë na shërben më së miri për të stimuluar konsumin, investimet dhe kreditimin.

Njëkohësisht, edhe politika fiskale do të duhet të mbetet lehtësuese për një periudhë të caktuar kohore. Në vijim, pasi situata të jetë kapërcyer, politika fiskale duhet të shkojë drejt konsolidimit fiskal, pra drejt uljes së nivelit të borxhit. Në momentin, kur ne të arrijmë nivelin e synuar të inflacionit prej 3%, atëherë politika jonë monetare do të duhet të bëhet më shtrënguese.

Ky moment parashikohet të ndodhë përpara fundit të vitit 2022. Në këtë kontekst, politika monetare dhe politika fiskale do të vijojnë të jenë lehtësuese dhe të koordinuara mirë me njëra-tjetrën. Ne si bankë qendrore e kemi komunikuar në vazhdimësi se politika jonë monetare do të vijojë të jetë lehtësuese.

Aktualisht, nuk vlerësohet i nevojshëm përdorimi i planeve të kontingjencës, pra të lehtësimit sasior. Kjo për arsye se ekonomia jonë ka reaguar mjaft

mirë dhe nuk na është dashur përdorimi i këtij plani. Sfidat e tjera kanë të bëjnë kryesisht me reformat strukturore.

Aktualisht, kemi përpara nesh një sërë reformash strukturore, të cilat duhen ndërmarrë në ekonominë shqiptare. Këto reforma konsistojnë në përmirësimet infrastrukturore në të gjitha aspektet e jetës, duke nisur me përmirësimin e klimës së biznesit, uljen e nivelit të informalitetit dhe implementimin e një konkurrence të ndershme në treg. Këto reforma duhet të vijojnë me prekjen e sektorëve kyç të jetës sonë ekonomike dhe sociale. Ndër to, reformat në arsim dhe shëndetësi kanë një rëndësi jetike. Nga arsimi varet e ardhmja jonë dhe shëndetësia provoi qartësisht se sa e rëndësishme është për të gjithë ne.

Shqipëria është në rrugën e procesit të integritimit evropian dhe sigurisht që këto reforma janë të koordinuara, të mbikëqyruara dhe të konsultuara gjerësisht edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Banka qendrore si një institucion financiar ka pjesën e saj të reformave strukturore, të cilat duhet të jenë të koordinuara dhe të harmonizuara edhe me reformat e tjera. Në këtë kontekst, dëshiroj të theksoj se sfida jonë kryesore mbetet ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit. Fatmirësisht dhe në këtë periudhë krize, ne kemi mundur të administrojmë si duhet situatën, e cila për asnjë moment nuk ka dalë jashtë kontrollit. Paralelisht, duhet të vijojmë me menaxhimin e të gjitha sfidave të tjera që përmenda më sipër.

Gazetarja: Ju zoti Guvernator folët për ekonominë në tërësi dhe për reformat që janë ndërmarrë dhe duhet të ndërmerren. Në këto kushte që ndodhemi, a mund të flasim pak dhe për situatën e sistemit bankar pas pandemisë COVID-19?

Guvernatori: Sistemi bankar sikurse e theksova më lart paraqitet i mirëkapitalizuar dhe në një gjendje shumë të mirë likuiditeti. Jo vetëm gjatë krizës së pandemisë, por edhe në vitet që lamë pas, sistemi bankar është përballur me një sërë sfidash.

“... realizimi i një procesi të bashkimit me përrthithje të bankave të mëdha ndërkombëtare është reflektuar edhe në filialet e tyre në rajon dhe Shqipëri.”

Sistemi bankar ka kaluar përmes një procesi konsolidimi si pasojë e ndryshimeve strukturore jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon dhe më gjerë. Në këtë kontekst, realizimi i një procesi të bashkimit me përrthithje të bankave të mëdha

ndërkombëtare është reflektuar edhe në filialet e tyre në rajon dhe Shqipëri. Ne kemi parë tërheqjen nga sistemi të disa prej bankave evropiane më me peshë në tregun shqiptar dhe rajon. Fillimisht, ky proces nisi me tërheqjen e bankës franceze dhe pastaj të asaj greke. Për bankën qendrore ka qenë një sfidë e veçantë administrimi me sukses i këtij procesi tejet delikat.

Aktualisht, sistemi bankar ka në përbërjen e tij 12 banka tregtare, nga 16 që operonin pak kohë më parë. Parë nga ky këndvështrim, një nga objektivat madhorë të bankës qendrore ka qenë edhe konsolidimi i sistemit bankar. Kredia me probleme ka pësuar një rënie të ndjeshme nga 25% që rezultonte në pikun e saj, në nivelin 7.8%. Me gjithë goditjet e forta që ka përjetuar ekonomia jonë, si nga tërmeti ashtu dhe nga pandemia, ne po vijojmë të administrojmë me sukses kreditë me probleme dhe t'i mbajmë ato nën kontroll të plotë.


Kreditimi për ekonominë ka rezultuar me rritje edhe gjatë periudhës së krizës, në nivelin prej 7.7%. Ne parashikojmë që edhe në të ardhmen të kemi një rritje të mëtejshme të kreditimit. Sigurisht që kjo rritje është e ndërlidhur drejtpërdrejt edhe me nivelin e kërkesës, për shkak se sistemi bankar disponon ofertën për financim, por kërkesa lidhet me ekonominë reale.

Tregjet financiare janë paraqitur përgjithësisht të qeta dhe kursi i këmbimit ka rezultuar i qëndrueshëm. Sistemi bankar i ka rezistuar mjaft mirë krizës. Ai ka një tepricë të lartë likuiditeti dhe kjo reflekton një siguri dhe garanci për depozituesit. Nga ana tjetër, këto depozita përfaqësojnë kosto për bankat dhe duhen përkthyer në kredi të shëndetshme për ekonominë. Në këtë mënyrë, bankat mund të rrisin përfitueshmërinë dhe ekonomia do të përfitojë nga rritja e kreditimit. Paralelisht edhe klientët e bankave do të ndihen më të sigurt për investimet e tyre.

Pritshmëritë tona janë për një ringritje ekonomike. Sistemi bankar rezistoi mjaft mirë gjatë vitit të kaluar, i cili mund të cilësohet si një vit tejet i vështirë. Këtu ndikuan ndjeshëm edhe masat e ndërmarra nga ana jonë për shyrjen me moratorium me dy tremujorë të pagesave të kësteve të kredive për të ndihmuar bizneset dhe individët. Njëkohësisht, një kontribut të vlefshëm dha edhe ristrukturimi proaktiv i vetë bankave në funksion të ndryshimeve rregullative të realizuara nga banka qendrore për t'iu përshtatur situatës së pandemisë.

Tashmë këto masa janë përmbushur plotësisht. Bankat nuk kanë më nevojë për një asistencë të tillë pasi situata paraqitet mjaft më e përmirësuar. Nga ana tjetër, nëpërmjet shoqatave, ne informohemi se mbizotëron një gjendje optimizmi në treg dhe në industritë e ndryshme. Të gjithë aktorët janë në pritje të një ringritjeje ekonomike pavarësisht shenjave që do të lërë pandemia. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të ritheksojmë se sistemi bankar është në gjendje shumë të mirë për të ndikuar në ringritjen e ekonomisë shqiptare.

Grafik 47. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gazetarja: Z. Sejko, kohët e fundit ju keni zhvilluar një takim me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në këtë takim, përfaqësuesit e FMN-së ju kanë rekomanduar që të vijoni me një politikë monetare lehtësuese për të rritur stimulimin monetar. A keni një koment në lidhje me këtë çështje?

Guvernatori: Po. Gjatë javës që shkoi, ne përmbyllëm misionin e radhës me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Në kuadër të marrëveshjes institucionale, FMN-ja komunikon, vlerëson dhe ndjek zhvillimet ekonomike. Vlerësimet dhe rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, nga misioni i fundit, janë plotësisht në linjë dhe në përputhje me konkluzionet dhe analizat e Bankës së Shqipërisë. Një ndër rekomandimet e FMN-së ka qenë edhe ndjekja e një politike monetare lehtësuese. Të njëjtën linjë ka ndjekur në qëndrimin e tij edhe Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë për të vijuar me një politikë

monetare lehtësuese, mbajtje të normës së interesit në nivelin minimal historik, në funksion të ringritjes ekonomike dhe nxitjes së konsumit, investimeve dhe kreditimit për një periudhë kohe derisa ekonomia të jetë forcuar mjaftueshëm dhe objektivi ynë i inflacionit të jetë arritur.

Gjithashtu, Fondi Monetar Ndërkombëtar, në misionin e fundit, vlerësoi pozitivisht qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Sigurisht që ne duhet të qëndrojmë vigjilentë për të monitoruar situatën, pasi periudhat para dhe pas krizës mbartin në vetvete rreziqe të mjaftueshme.

Aktualisht, ne kemi një bashkëveprim mjaft domethënës me FMN-në në kuadër edhe të asistencës që ne përfitojmë nga ky institucion. Kjo asistencë është kanalizuar edhe përmes konsulentëve të përhershëm rezidentë si dhe konsulentëve të tjerë me seli në Washington. Të gjitha projektet apo reformat e ndërmarra nga ana jonë kanë kaluar përmes një konsultimi të ngushtë me përfaqësuesit e FMN-së.

Gazetarja: Zoti Guvernator, ju falënderoj për intervistën.

Guvernatori: Faleminderit juve.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR FAX NEWS

-17 qershor 2021-

Gazetarja: Duke filluar nga 30 qershori, do të dalin në qarkullim kartëmonedhat 1000 Lekë dhe 10000 Lekë. Kryesisht debate do të ketë për kartëmonedhën 10000 Lekëshe, duke qenë se është prerja më e madhe që ne kemi tashmë apo që do të kemi pas 30 qershorit. Përse lindi nevoja për këtë kartëmonedhë dhe a mund të favorizojë korrupsionin një prerje më e madhe e monedhës? Të gjitha këto çështje do të kemi mundësinë t'i diskutojmë sot me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, zotin Gent Sejko.

Zoti Guvernator, faleminderit për të gjithë materialin që pranuat të ndajmë me shikuesin, duke qenë se është atraktive kur printohet një monedhë e re, normalisht edhe me vlera më të mëdha.

Pyetja ime fillestare është, përse lindi e nevojshme një kartëmonedhë, e cila do të jetë në vlerën e 10000 lekëve, duke qenë se ne kemi 5000 Lekëshin tashmë në përdorim?

Guvernatori: Faleminderit që erdhët.

Banka e Shqipërisë ka realizuar rishikimin e plotë të serisë së kartëmonedhave dhe në vijim ka bërë komunikimet përkatëse mbi serinë e rishikuar në shtator të vitit 2019. Pjesë e serisë së re të rishikuar të kartëmonedhave është edhe prerja e re prej 10000 Lekësh. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në fakt ka miratuar prerjen e re 10000 Lekë shumë vite më parë, madje përpara mandatit tim në Bankën e Shqipërisë, duhet të jenë 9 apo 10 vjet përpara, dhe sigurisht gjatë gjithë kësaj periudhe, ka marrë kohën e duhur procesi i përcaktimit të tematikës, dizenjimit dhe në fund i prodhimit të kësaj prerjeje.

Aktualisht, prerja më e madhe prej 5000 lekësh ka qenë pjesë e emisionit të vitit 1996. Ne jemi të ndërgjegjshëm se që nga ajo kohë çmimet dhe pagat janë rritur me disa herë në vendin tonë. Në këto kushte, ka lindur si domosdoshmëri për t'u hedhur në qarkullim një prerje më e lartë.

Pra, duke nisur nga data 30 qershor këto dy kartëmonedha, prerjet e reja 1000 Lekë dhe 10000 Lekë janë bërë pjesë e serisë së re të rishikuar

që do të marrin kurs ligjor në Republikën e Shqipërisë dhe do të jenë në përdorim si mjet pagese. Prerja më e madhe ka qenë në përdorim për një periudhë shumë të gjatë më parë. Prandaj ndryshimet në nivelin e çmimeve, pagave, si dhe nevojat e ekonomisë shqiptare e kanë bërë të domosdoshëm prezantimin e një prerjeje të re prej 10000 lekësh.

Gazetarja: Pra, do të lehtësojë kryerjen e transaksioneve të përditshme?

“Prerja më e lartë prej 10000 lekë ndihmon jo vetëm institucionin qendror, por edhe sistemin bankar dhe financiar në administrimin e sasisë së parasë në qarkullim.”

Guvernatori: Sigurisht. Me një gjuhë më të thjeshtë, për qytetarin dhe për publikun, pa hyrë në nevojën që ka miradministrimi i rezervës në para letër, kjo prerje më e lartë ndihmon jo vetëm institucionin qendror, por edhe sistemin bankar dhe financiar në administrimin e sasisë së parasë në qarkullim, si dhe përdoruesit në përcaktimin e nivelit të çmimeve.

Natyrisht që hedhja në qarkullim e kësaj kartëmonedhe nuk do të thotë që janë përjashtuar kartëmonedhat e tjera. Ne i kemi në qarkullim të gjitha prerjet e mëparshme. Kjo është një prerje më e madhe, e cila do të shërbejë për blerje më të mëdha dhe qarkullime në sasi më të mëdha. Jam i bindur se ka ardhur momenti i duhur që kjo prerje të bëjë të mundur lehtësimin e qarkullimit të parasë letër, si nga përdoruesit individë ashtu edhe nga bizneset dhe sistemi bankar. Paralelisht, dëshiroj të theksoj se kjo do të ndihmojë edhe institucionin e bankës qendrore për miradministrimin e parasë letër.

Gazetarja: Në informacionin e përgjithshëm që kanë qytetarët, prerjet e mëdha kanë më pak mundësi falsifikimi, pra ato disponojnë elemente sigurie më të larta. Paralelisht, dëshiroj t’ju pyes se çfarë duhet të ketë parasysh një person që mban për herë të parë në dorë një kartëmonedhë 10000 Lekëshe, duke marrë në konsideratë faktin se kur hyn në treg edhe mundësitë janë më të mëdha për t’u mashtruar, nëse do të mund ta përdorja këtë term?

Guvernatori: Seria e re e kartëmonedhës ka një përsosje të elementeve të sigurisë. Një ndër arsytet për rishikimin e saj është edhe rritja e standardeve në përdorimin e kartëmonedhës, dhe në këto standarde bëjnë pjesë elementet e sigurisë për të parandaluar falsifikimin. Po t’i shohim më në detaje teknike, do të vëmë re që sa më e lartë është prerja e kartëmonedhave aq më shumë shtohen elementet e sigurisë.

Për shembull, prerjet 5000 Lekë dhe 10000 Lekë kanë si element sigurie hologramën, të cilën nuk e kanë prerjet e tjera dhe që është një element shumë i vështirë për t'u falsifikuar. Banka e Shqipërisë në momentin që ka prezantuar prerjet e reja të kartëmonedhës, ka nisur edhe procesin e trajnimit të punonjësve të bankave të nivelit të dytë dhe të sistemit bankar në tërësi për elementet e sigurisë dhe cilësinë e kartëmonedhës. Të parat janë bankat ato që do të trajnohen dhe ambientohen me kartëmonedhën dhe informacionin për këto elemente sigurie. Njëkohësisht, ky informacion do të shpërndahet edhe në zyrat e postës edhe te agjentët e tjerë financiarë.

Pas trajnimit të kësaj pjese të specializuar, do të nisë informimi i publikut shqiptar mbi elementet që përmban kartëmonedha e re, si një proces standard që ka ndodhur gjithmonë me emisionin e kartëmonedhës. Elementet e sigurisë janë elemente bashkëkohore dhe gjykoj se janë të mjaftueshme për të parandaluar falsifikimin e kartëmonedhës. Kartëmonedhat prodhohen nga kompani ndërkombëtare dhe aktualisht ka një numër të kufizuar të kompanive ndërkombëtare, të specializuara, të cilat përgjithësisht prodhojnë kartëmonedhat e të gjitha shteteve. Këto dy prerje kartëmonedhe janë prodhuar nga kompania franceze Oberthur.

Ndërkohë që dy prerjet e kaluara janë prodhuar nga kompania angleze De La Rue. Këto janë dy nga kompanitë më të mëdha në botë të specializuara në shtypin e kartëmonedhave. Ridizenjimi është bërë nga kompania gjermane GID. Padyshim që kompanitë e sipërpërmendura janë të specializuara dhe janë pikërisht këto kompani që ofrojnë elementet e sigurisë së kartëmonedhave në mbarë botën. Kartëmonedhat kanë pikërisht këto elemente sigurie, të cilat i bëjnë ato më të sigurta për përdoruesin.

Gazetarja: Në fakt ne jemi një shoqëri që kemi një përdorim të gjerë të kartëmonedhave cash në ekonomi. Nga raportet e publikuara nga Banka e Shqipërisë mund të themi se rreth 40% e individëve në moshë madhore kanë llogari bankare, dhe nga këta vetëm 4% përdorin transaksionet online. Për të drejtuar qytetarët dhe edukimin financiar të tyre është lançuar dhe më herët një program dhe strategji kombëtare për edukimin financiar. Çfarë është bërë në drejtim të edukimit financiar sa i përket rritjes së përdorimit të transaksioneve bankare dhe reduktimit të parasë cash në ekonomi?

“Edhe për ne si institucion financiar, rregullator dhe mbikëqyrës, lufta kundër informalitetit përbën një nga objektivat kryesorë në drejtim të modernizimit të sistemit të pagesave, rritjes së përfshirjes financiare dhe edukimit sa më të gjerë të publikut për këto qëllime.”

Guvernatori: Kjo që ju thoni është patjetër një nga objektivat kryesorë të bankës qendrore, por dhe një sfidë për ne. Lufta kundër informalitetit në vija të përgjithshme është sfidë për mbarë Shqipërinë. Edhe për ne si institucion financiar, rregullator dhe mbikëqyrës, lufta kundër informalitetit përbën një nga objektivat kryesorë në drejtim të modernizimit të sistemit të pagesave, rritjes së përfshirjes financiare dhe edukimit sa më të gjerë të publikut për këto qëllime.

Pavarësisht nga përmirësimi i cilësisë së kartëmonedhës si mjet pagese, ne po punojmë në drejtim të modernizimit të sistemeve të pagesave dhe rritjes së përfshirjes financiare, që do të thotë rritja e numrit të qytetarëve dhe bizneseve të përfshirë në marrëdhënie me bankat dhe të pajisur me llogari bankare. Për këtë qëllim, vitin e kaluar është miratuar ligji për shërbimet e pagesave, i cili krijon një hapësirë të re dhe përmirëson më të mundësitë ligjore dhe rregullative.

Aktualisht jemi duke realizuar përmirësimet përkatëse në kuadrin rregullator në zbatim të ligjit për të përsosur sistemin e pagesave elektronike dhe për të modernizuar më tej sistemin e pagesave në Republikën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë, gjithashtu, kryeson Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, i cili përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave. Në këtë këndvështrim, po merren në konsideratë të gjitha mënyrat e mundshme për të zbatuar forma të reja të pagesave elektronike në sistemin bankar dhe tregun financiar, me qëllim lehtësimin e pagesave për qytetarët shqiptarë dhe rritjen e përfshirjes financiare.

“Përfshirja financiare zbut pabarazinë për shkak se lehtësitë që përfitojnë njerëzit nga përdorimi i kanaleve bankare krijojnë një impakt real në mirëqenien e tyre sociale.”

Bazuar në studimet empirike, përfshirja financiare zbut pabarazinë për shkak se lehtësitë që përfitojnë njerëzit nga përdorimi i kanaleve bankare krijojnë një impakt real në mirëqenien e tyre sociale. Pra, nga njëra anë ashpërsohet lufta kundër informalitetit dhe nga ana tjetër lehtësohen marrëdhëniet e qytetarëve me sistemin financiar dhe me gjithçka tjetër.

Në këtë kontekst, janë ndërmarrë një sërë masash, përfshirë këtu edhe një plan për edukimin financiar. Ne kemi ndërmarrë një seri aktivitete të re

kuadër të Javës së Parasë, por jo vetëm, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe bankat e nivelit të dytë.


Vetë bankat e nivelit të dytë janë institucione që ndikojnë në edukimin financiar të publikut pasi dhe vetë konkurrenca në sistemin bankar sjell prezantimin e produkteve të reja në treg. Pavarësisht nga strategjia e Bankës së Shqipërisë, kjo është një sfidë e cila ka qenë, është dhe do të vazhdojë për shumë vite. Po ta vëmë re, në qytetet dhe zonat më të zhvilluara, edukimi financiar dhe përfshirja financiare kanë avancuar ndjeshëm.

Gazetarja: Edhe mbulimi bankar.

Guvernatori: Dhe mbulimi bankar, pikërisht për këto arsye, mbulimi bankar është më i plotë dhe ka një nivel më të lartë qoftë te edukimi financiar qoftë te përfshirja financiare, ndërkohë që zonat rurale janë ende mbrapa në këtë fushë.

Aktualisht, objektivi ynë është modernizimi i mëtejshëm i sistemit të pagesave dhe i përdorimit të pagesave elektronike. Një element që vlen për t'u përmendur si shembull, është se gjatë periudhës së pandemisë ne realizuam një ndryshim në kuadrin rregullativ për të lehtësuar bankat nga komisionet, në mënyrë që përdoruesi i fundit, pra qytetari shqiptar, të paguante komisione më të ulëta për pagesat elektronike dhe të shmangte përdorimin e parasë cash. Si pasojë e kësaj ndërhyrjeje mund të thuhet se pati një rritje të lartë në përdorimin e pagesave elektronike.

Grafik 48. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe në formë letër, në vite (majtas); dhe numri i pagesave për frymë (+15 vjeç) në vite (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Paralelisht, përdorimi më i gjerë i kartave të debitit dhe kreditit, si instrumente pagese, do të lehtësonte dhe modernizonte sistemet. Ky është një proces i gjatë dhe me shumë hapa. Ne kemi një strategji me objektiva konkrete, e cila po ndiqet në mënyrë rigoroze.

Sigurisht që ne parashikojmë që për dy apo tre vjet të ketë një rritje më të lartë në përfshirjen financiare. Po të shohim ku kemi qenë dhe ku jemi, mund të themi se është bërë një progres shumë i madh.

Nuk do të mund të harrojmë që deri para pak kohe, 10 apo 15 vite më parë, ne nuk kishim as ATM në Shqipëri dhe as përdorim të kartave bankare, pra kishte vetëm përdorim *cash* në ekonomi. Edhe pagat merreshin me *cash*, ndërkohë që sot njerëzit sidomos në qytete kanë llogari bankare dhe pagesat kryhen nëpërmjet kanaleve bankare. Përgjithësisht, kushdo që ka një llogari bankare ka edhe një kartë debiti dhe mund të tërheqë sasinë e parave në përdorim nëpërmjet ATM-ve.

Pra ka disa elemente pagesash më të modernizuara në një kohë relativisht të shkurtër. Ne vijmë nga një nivel shumë bazik dhe kemi arritur një nivel zhvillimi të konsiderueshëm, që ka ardhur si pasojë e ndryshimeve ligjore dhe rregullatore që ka bërë banka qendrore.


Njëkohësisht, vlen të përmendet edhe impakti që kanë pasur bankat evropiane dhe bankat e huaja. Në këtë kontekst, bankat lokale kanë ndjekur padyshim të njëjtin standard. Pra, tregu e ka rritur standardin e kërkuar por sigurisht që ende ka nevojë për përmirësime dhe progres të mëtejshëm. Ne po punojmë për këtë qëllim. Këto janë sfida afatmesme dhe afatgjata, prandaj kërkojnë kohën e tyre. E rëndësishme është që të ketë progres. Gradualisht dhe hap pas hapi, ky është një prej objektivave tanë kryesorë.

Gazetarja: Z. Guvernator, unë nuk mund të iki nga kjo intervistë pa ju pyetur edhe për procesin e deeurizimit.

Guvernatori: Siç e kemi deklaruar edhe më herët, ky proces ka nisur me vrull, ndërkohë që po përjetojmë një rënie të të ardhurave nga turizmi, reduktim të remitancave dhe një numër të lartë të blerjeve të mëdha dhe të vogla në euro. Nuk mund të thuhet se projekti ka ngecur në vend, por edhe ky projekt, njëlloj si çështja e mëparshme që diskutuam si pjesë përbërëse e përfshirjes financiare, është një projekt afatgjatë dhe sfidant për ekonominë shqiptare.

Ekonomia jonë është një ekonomi e vogël, por e hapur. Partnerët tanë tregtarë janë në Eurozonë. Emigrantët shqiptarë janë kryesisht në vendet e Eurozonës. Shkëmbimet kryesore tregtare, import-eksportet janë nga vendet e Eurozonës. Ne rretohemi me shtete fqinje si Italia, Greqia por edhe Mali i Zi e Kosova, të cilat kanë në përdorim euron. Pra në të gjitha drejtimet, euro është një kartëmonedhë e fortë, e cila ndikon në ekonominë shqiptare dhe hyrjet kryesore në ekonominë shqiptare janë në euro. Sigurisht turizmi, investimet e huaja dhe të gjitha elementet e tjera janë po ashtu transaksione që kryhen në euro.

Grafik 49. Indeksi i euroizimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka qendrore si institucion financiar ka kryesisht objektiv stabilitetin e çmimeve dhe stabilitetin financiar. Stabiliteti i çmimeve kryesisht arrihet nëpërmjet instrumentit kryesor të bankës qendrore, që është norma e interesit. Nëpërmjet uljes dhe rritjes së normës së interesit, bankat qendrore synojnë të stimulojnë konsumin, investimet dhe kreditimin në ekonomi në mënyrë që të kemi një ringritje dhe rritje ekonomike në funksion të mirëqenies së qytetarëve shqiptarë.

Në këtë kontekst, ky instrument bazë që përdor banka qendrore bën që nëpërmjet normës së interesit të ushtrohet kontroll mbi kartëmonedhën vendase. Meqenëse, Banka Qendrore Evropiane është banka që emeton Euron në Bashkimin Evropian, atëherë ulja ose rritja e normës së saj të interesit ushtrohet mbi këtë monedhë.

Ne kemi monedhën tonë kombëtare, e cila është Leku, dhe norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë ndikon te Leku. Në këtë këndvështrim, niveli i lartë i euroizimit në ekonomi do të kufizonte transmetimin e politikës monetare të bankës qendrore. Pra, do të kufizonte mundësinë që ka banka qendrore për të ndikuar në mirëqenien e qytetarëve shqiptarë dhe rritjen ekonomike.


Fatmirësisht edhe Banka Qendrore Evropiane ka ndjekur një politikë të uljes së normës së interesit, pra ka mbajtur një normë interesi minimale, të cilat aktualisht janë norma negative dhe kjo ka ndikuar pozitivisht në pjesën e kreditimit në euro në bankat e nivelit të dytë.

Paralelisht, edhe ne si bankë qendrore kemi ndjekur të njëjtën politikë monetare lehtësuese. Në këtë kuptim, nëse do të ketë një përdorim të ri më të lartë të monedhës kombëtare në ekonomi, atëherë do të rritet edhe fuqia e politikës monetare të bankës qendrore.

Nga krahu tjetër qëndron stabiliteti financiar. Sigurisht që ne si bankë qendrore do të donim që për të mirën e agjentëve ekonomikë dhe qytetarëve shqiptarë, të cilët i marrin pagat në monedhë kombëtare, të kreditoheshin po ashtu në monedhën kombëtare, për të shmangur riskun e kursit të këmbimit valutor.

Me një shpjegim të thjeshtë, nëse ju do të merrnit një kredi për të blerë një apartament në euro dhe e keni rrogën në monedhën kombëtare Lek, dhe në rast se në një periudhë afatgjatë do të kishim një zhvlerësim të monedhës kombëtare, atëherë ju do ta kishit të pamundur ta shlyenit kredinë. Aktualisht, një e katërta e portofolit të kredive në Shqipëri janë në monedhë të huaj pra janë në euro, të pakolateralizuara, "*unhedged*" sikurse i quajmë ne, me klientë që kanë të ardhura në monedhën kombëtare, pra jemi përpara një ekspozimi serioz ndaj riskut të këmbimit valutor. Njëkohësisht, borxhi i Republikës së Shqipërisë, borxhi i huaj qëndron në një nivel të konsiderueshëm. Sikurse jemi në dijeni, niveli i borxhit është rreth 68% të PBB-së.

Grafik 50. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve (% ndaj PBB-së nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesa dërrmuese e këtij borxhi, më shumë se 50% e tij është në monedhë të huaj. Duke marrë në konsideratë faktin se të ardhurat e buxhetit të shtetit janë në monedhën vendase, këtu kemi një ekspozim të lartë dhe pikërisht për këtë arsye rekomandohet nga Bashkimi Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar që të ndiqet një politikë deeuroizimi për të rritur transmetimin e politikës monetare dhe për të ruajtur stabilitetin financiar me qëllim zbutjen e rrezikut që rrjedh nga ekspozimi ndaj kursit të këmbimit. Këto janë disa nga arsyet kryesore për të cilat Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një politikë të thellë deeuroizimi.

Gazetarja: Pyetja është jo pse e keni ndërmarrë, por pse nuk ka përparuar ky proces?

Guvernatori: E kam shpjeguar vazhdimisht këtë çështje me qëllim informimin e publikut në kuadër të transparencës, por edhe për të kuptuar qëllimin e politikës së deeuroizimit, e cila shpeshherë ngatërrohet me kursin e këmbimit. Për këtë arsye, duke marrë shkas edhe nga kjo intervistë, nëpërmjet televizionit tuaj të nderuar, më lejoni ta ritheksoj edhe njëherë këtë objektiv madhor. Për të dhënë një përgjigje më konkrete për pyetjen tuaj nëse politika e deeuroizimit ka pasur apo jo progres, mund të përmendja disa fakte si: rritja e lartë e kreditimit në lekë dhe rritja e transparencës së gjerë ndaj publikut, si dy elemente të rëndësishme të kësaj politike.

Transparenca është një nga elementet më kryesore për të kuptuar rrezikun që vjen nga euroizimi i ekonomisë. Në këtë kontekst, klientët e sistemit bankar, si biznesi ashtu edhe individët, e kanë kuptuar tashmë rrezikun që iu kanoset nga ekspozimi ndaj kursit të këmbimit nëse përfiton një kredi në monedhë të huaj. Pra, nëse të ardhurat e tua janë në lekë, kredinë është mirë ta përfitosh në lekë dhe jo në monedhë tjetër. Ky është edhe qëllimi i këtij shpjegimi të detajuar që jam munduar t'ju jap juve sot.

Në këtë kontekst, ne kemi përjetuar një rritje të konsiderueshme të kreditimit në lekë. Gjatë vitit të kaluar, kreditimi është rritur me 7.7%, ku pjesa dërrmuese vjen nga rritja e kreditimit në lekë. Ky fakt tregon qartë se ky element i politikës tonë të deeuroizimit ka funksionuar.

Paralelisht, edhe depozitat kanë pësuar një rritje të konsiderueshme në monedhën kombëtare. Pra, në parametrat që ne kishim parashikuar për një progres pozitiv në politikën e deeuroizimit. Dua të ritheksoj që ne nuk parashikojmë të heqim euron nga qarkullimi. Euro patjetër është një monedhë që do të ekzistojë në qarkullim.

Gazetarja: Për më tepër që vendi ynë aspirojnë të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, pra në këtë kontekst nuk ka arsye të pretendojmë ta heqim Euron nga qarkullimi.

Guvernatori: Patjetër, ne jemi në fazën që ekonomia shqiptare ka nevojë të ringrihet. Ekonomia shqiptare i duhen reforma të thella strukturore dhe një nga këto reforma për institucionin e Bankës së Shqipërisë është pikërisht politika e deeuroizimit. Kur ekonomia shqiptare të arrijë një stad të caktuar zhvillimi ekonomik, atëherë ne do të mund të kalonim në një fazë tjetër siç janë sot Kroacia apo Republika Çeke, që kanë standarde të përafërta me Bashkimin Evropian dhe janë shumë afër adoptimit të euros si monedhë kombëtare.


Gazetarja: Le të qëndrojmë pak te kreditimi i ekonomisë. Përveç pandemisë, a ka arsye të tjera të cilat e frenojnë këtë proces apo investitorët janë duke kërkuar të sigurojnë financat e tyre në rrugë të tjera jobankare?

Guvernatori: Kreditimi i ekonomisë në fakt është rritur mjaftueshëm mirë duke pasur parasysh situatën e krijuar nga kriza e pandemisë dhe nga tërmeti. Rajoni dhe Eurozona që pas vitit 2008 kanë përjetuar një situatë tepër të vështirë financiare. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

Bashkimi Evropian përjetuan një goditje të fortë financiare nga kriza e vitit 2008. Aktualisht, ne ende jemi në një situatë post krize si rrjedhojë e pandemisë COVID-19, një goditje e rëndë kjo për ekonominë mbarëbotërore, por edhe për Shqipërinë dhe rajonin. Pavarësisht kësaj shtate tejet të vështirë, kreditimi ka pasur një rritje të konsiderueshme. Aktualisht, ne shikojmë në horizont një ringritje ekonomike përgjatë këtij viti, por edhe një rritje të mirë të kreditimit, bazuar në informacionin e përftuar nga bankat si dhe analizat dhe pyetësorët e kryer për këtë qëllim.

Sigurisht bankat janë institucione që ofrojnë kredi, pra janë nga kahu i ofertës, ndërkohë që kërkesa vjen nga ekonomia reale. Sa më shumë të rritet ekonomia reale, aq më shumë do të rritet edhe kërkesa e shëndetshme për kredi dhe aq më shumë banka do të mund të kreditojnë.

Grafik 51. Indeksi i shëndetit bankar*



* Rritja e vlerës së treguesit tregon stabilitet më të ulët. Gjerësia e çdo dimensionit nënkupton kontributin e tij ndaj rrezikut.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këtë kontekst, një element shumë pozitiv është që bankat kanë tepriçë likuiditeti. Padyshim për bankat, kjo është një kosto e lartë dhe problematike në aspektin e përfitueshmërisë. Për ekonominë, kjo tregon siguri për depozituesit dhe mundësi financiare për të kredituar ekonominë. Ringritja ekonomike, gjallërimi i aktiviteteve ekonomike dhe agjentëve tregtarë që operojnë në Republikën e Shqipërisë, do të rrisë kërkesën për kredi dhe kjo do të bëjë që dhe kreditimi të rritet nga ana e bankave të nivelit të dytë.

Gazetarja: Kemi të bëjmë me një deformim tregu apo me një kërkesë për financim jashtë tregut bankar?

Guvernatori: Përsa i përket kreditimit të ekonomisë nga ana e tregut joformal, ne si Bankë Shqipërie kemi kryer analizat tona dhe na rezultoi se nuk kemi një treg joformal, i cili konkurrin sistemin bankar.

Huamarrja dhe huadhënia në Republikën e Shqipërisë janë të ligjruara me kod dhe nuk janë të ndaluara. Shqetësimi ynë do të ishte nëse do të funksiononin institucione financiare të palicencuara që kryenin aktivitet të palicencuar dhe spekulonin me depozitat dhe fondet e bizneseve dhe qytetarëve. Si përfundim, mund të themi me bindje se ky fenomen nuk është më shqetësues dhe nuk qëndron në ato nivele që shpeshherë komentohet, pasi si në aspektin e përfshirjes financiare apo luftës kundër informalitetit dhe modernizimit të sistemit të pagesave janë arritur rezultate të prekshme. Megjithatë, sfida të tilla si rritja e kreditimit dhe rritja ekonomike qëndrojnë të hapura dhe janë të ndërlidhura ngushtë ndërmjet tyre.

Gazetarja: Unë ju falënderoj për intervistën dhe shpresoj që të kemi një ringritje të shpejtë të ekonomisë dhe përdoruesit e këtyre kartëmonedhave t'i kenë sa më gjatë në duar dhe të përfshihen sa më shumë në shërbimet bankare.

Guvernatori: Faleminderit juve.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN “TOP TALK” NË TELEVIZIONIN TOP CHANNEL

-21 qershor 2021-

Gazetari: *Përrshëndetje miq, kemi nisur kështu Top Talk për ditën e sotme. Sikurse jeni njoftuar më parë, në datën 30 qershor do të dalë në qarkullim një kartëmonedhë e re. Është 10 mijë Lekëshi i ri ose thënë ndryshe siç njihet në gjuhën popullore 100 mijë Lekëshi i vjetër. Në fakt ka pasur disa polemika mbi arsyen se pse ndodhi pikërisht në këtë moment dhe sa do t'i shërbejë popullatës kjo prerje e re kartëmonedhe.*

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko është në Top Talk për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, që kanë ngritur disa prej njerëzve që hulumtojnë tregun financiar dhe kanë objeksionet e veta. Faleminderit zoti Sejko që vjen në Top Talk.

Guvernatori: Faleminderit Denis për ftesën.

Gazetari: *Fillimisht le të shuajmë një kuriozitet. Pse u vendos tani që të dilet me këtë prerje të re dhe të madhe të lekut ose të kartëmonedhës shqiptare, pra 10 mijë Lekëshit?*

Guvernatori: Atëherë në fakt, siç e kam theksuar, shtypja e kësaj prerjeje është vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë që në vitin 2014...


Gazetari: *Politikë...*

Guvernatori: Si politikë vendimmarrjeje, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka marrë vendim për herë të parë në vitin 2014, mbështetur edhe në analizat e realizuara nga Departamenti i Emisionit të Bankës së Shqipërisë që prerja prej 10 mijë Lekësh në kartëmonedhën shqiptare do të duhej të hidhej në qarkullim. Më pas është marrë gjithë koha e nevojshme dhe në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës, kemi gjykuar që ta rishikojmë të gjithë serinë e kartëmonedhës përtej kësaj prerjeje. Në këtë kuptim, kemi marrë në konsideratë disa arsye, të cilat i kemi shpjeguar në vijimësi, të tilla si: rritja e elementeve të sigurisë dhe standardeve të cilësisë së kartëmonedhës.

Gazetari: *Ju përmendni rritjen e elementeve të sigurisë, por a kemi ne raste falsifikimi të kartëmonedhave, besoj se në memorien time nuk është se kemi pasur raste të tilla...*

Guvernatori: Aktualisht nuk mund të themi se kemi raste të falsifikimit të monedhës, megjithatë gjithmonë ekziston një risk potencial. Meqenëse ju po më pyesni, në prerjet 1000 Lekë dhe 2000 Lekë, mund t’ju them se rastet kanë qenë në shifra të vogla dhe nuk kanë përbërë problem, pasi dhe cilësia e falsifikimit ka qenë e dobët, me 8.5 raste në 1 milion copë.

Grafik 52. Statistika të kartëmonedhave të falsifikuara



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gazetari: *Pra risku është shumë i vogël për të pasur një histori falsifikimesh të monedhës?*

Guvernatori: Risku është shumë i vogël. Edhe kartëmonedhat ekzistuese do të jenë paralelisht në qarkullim. Si 1000 Lekëshi i ri, por edhe prerjet e tjera, të cilat ne po hedhim në qarkullim të ridizenjuara, por që kanë të njëjtën tematikë, do të qarkullojnë dhe do të jenë në përdorim me kurs ligjor, paralelisht me prerjet e vjetra.

Gazetari: *Ju thatë që keni vite që mendoni të hidhni në qarkullim kartëmonedhat e reja, tani çështja është kujt i shërbejnë ato? Më lejoni t’ju pyes fare thjesht. Shumë njerëz kanë paga të nivelit 40, 50 apo 60 mijë lekë, dhe mendoj se 10 mijë lekëshi i ri është i tepërt për*

të shkuar, fjala vjen për të bërë pazar. Me fjalë të tjera, kujt do t'i shërbejë kjo kartëmonedhë?

Guvernatori: Kartëmonedha i shërben jo vetëm qytetarëve dhe bizneseve, por dhe bankave dhe bankës qendrore si mjet qarkullimi monetar. Kartëmonedha letër është një nga mjetet e pagesës. Në këtë kuptim, vlerësimet dhe vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nisen në radhë të parë nga administrimi i parasë letër që bën banka qendrore dhe sistemi bankar. Prandaj themi se është normale të kemi një prerje më të lartë referuar këtu parasë në qarkullim dhe administrimit të parasë letër. Ky proces do të lehtësojë administrimin dhe procesin e thesarizimit.

Gazetari: Ç' do të thotë proces i thesarizimit?

Guvernatori: Proces i thesarizimit do të thotë që ne të kemi rezerva të parasë letër në qarkullim të mjaftueshme për t'i shërbyer nevojave të sistemit financiar dhe indirekt ekonomisë shqiptare.

Gazetari: Kam një pyetje. Shqipëria është një nga vendet me goxha informalitet nëse mund ta themi në kuptimin e dy elementeve, e para që shqiptarët vijojnë t'i mbajnë paratë poshtë jastëkut, dhe e dyta hyrja e parave përmes kanaleve ilegale pra e parasë së pisët, siç e quajmë ndryshe. Tani besoj që prerja e madhe shkon automatikisht si një ndihmesë për paratë e këtij lloji. Pra për paratë e pisët dhe atë ilegale. A e keni menduar ndonjëherë këtë fakt që qëndron si një kontrovers i asaj që ju vetë përpiqeni të promovoni?

Guvernatori: Nuk mund të themi se është një proces kontrovers. Sa i përket çështjeve që ju referuat më sipër, mund të themi se aty ndërthuren disa problematika, të cilat vlerësoj se mund t'i trajtojmë të ndara nga njëra-tjetra.

Së pari, sa i përket parandalimit të pastrimit të parave që vijnë nga trafiku ilegal, ju informoj se ka një set masash ligjore zbatuese ku bëjmë pjesë dhe ne si Bankë Shqipërie. Me këtë rast dëshiroj të theksoj se Komiteti Moneyval për pastrimin e parave i ka bërë Shqipërisë një vlerësim pozitiv në raportin drejtuar Komisionit Evropian, në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian.

Në këtë raport ata shprehen se banka qendrore dhe sistemi bankar janë thelbësorë në këtë proces. Megjithatë ka disa elemente të tjera, të cilat duhen adresuar në mënyrë adekuate dhe veçanërisht dua të ndalemi te qarkullimi i parasë *cash* në ekonomi. Tashmë ne e kemi të qartë se trafiqet ndërkombëtare kryhen me monedhat e forta, siç janë euro dhe paundi britanik. Pra, me një vëzhgim të thjeshtë, ne mund të kuptojmë se sasitë e parave ilegale të kapura nga aktivitetet kriminale nuk janë në lekë. Leku është vetëm për qarkullimin e brendshëm.

Gazetari: A mund ta kthejë kjo lekun në një objektiv, për ta shndërruar pastaj atë në një stivë le të themi. Duke pasur prerje të madhe, ti fillon dhe mendon për të ruajtur paratë e tua në lekë.

Guvernatori: Kartëmonedha është një instrument, një mjet pagese, i cili duhet të ekzistojë patjetër dhe ekziston në të gjitha ekonomitë e zhvilluara dhe të pazhvilluara. Prandaj, pavarësisht këtyre rreziqeve që sipërpërmendët, bankat qendrore nuk mundet të mos prodhojnë prerjet për të cilat ka nevojë tregu dhe sistemi i pagesave. Ndërkohë nga krahu tjetër duhen ndërmarrë gjithë masat e nevojshme për të parandaluar trafiqet dhe për të mos paralizuar ekonominë.

Gazetari: Po mirë, 50 mijë Lekëshi i vjetër ose 5 mijë lekëshi i ri, të cilin e kemi si prerje prej kohësh, nuk e plotësonte këtë kuadër?

Guvernatori: Patjetër, 5 mijë Lekëshi i ri është pjesë e emisionit të vitit 1996 dhe praktikisht kishte ardhur koha që të kishte një prerje edhe më të lartë, si pasojë e analizave të kryera.

Gazetari: Do vazhdojë të jetë 5 mijë Lekëshi ndërkohë?

Guvernatori: Të gjitha prerjet do të vazhdojnë të jenë në qarkullim.

Gazetari: Nuk përjashtohet asnjëra prej tyre.

Guvernatori: Nuk bëhet fjalë, ne e kemi komunikuar disa herë, seria e re...

Gazetari: Zgjerohet gama..

Guvernatori: Zgjerohet gama për efekt të administrimit të parasë, të thesarizimit dhe të përdorimit nga përdoruesit e tjerë si agjentë, individë dhe biznese.

Gazetari: *Po, patjetër që do të jenë të gjitha prerjet e tjera. Kam dëgjuar disa komente, që thonë se ne nuk po emetojmë 10 mijë Lekëshin e ri dhe po heqim prerjet e tjera. Ne do t'i kemi të gjitha prerjet e tjera në qarkullim. Kështu për nevoja pagesash më të vogla do të përdoren prerjet më të vogla dhe për nevoja pagesash më të larta, do të përdoren prerjet më të larta. Kjo është një ndihmesë dhe një element shtesë. Pra, nuk i zëvendëson kjo prerje prerjet e tjera.*

Guvernatori: Natyrisht, një tjetër kundërshti logjike nëse mund ta cilësoj kështu, më korrigjoni nëse jam gabim, është fakti që e gjithë propaganda ose politika sensibilizuese është drejt fiskalizimit ose drejt formalizimit...

Gazetari: *Formalizimit dhe kalimit në kanale bankare të të gjithë qarkullimit të parasë...*

Guvernatori: Patjetër...

Gazetari: *Që njerëzit të përdorin sa më shumë karta debiti ose krediti për shkak se gjithçka pastaj është më transparente, më e kontrolluar, më e monitoruar, por dhe më e sigurt. Tani me hedhjen në qarkullim të kësaj prerjeje, kartëmonedhe të re, duket sikur në një kuptim kundërshtohet politika që i fton njerëzit të përdorin sa më pak para cash.*

Guvernatori: Absolutisht jo.

Gazetari: *Pse?*

Guvernatori: Paraja, kartëmonedha dhe prerjet e kartëmonedhës janë një tjetër element në drejtim të modernizimit të sistemit të pagesave, si dhe luftës kundër informalitetit në ekonomi. Formalizimi dhe puna që zhvillohet për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me paranë elektronike, kartat e debitit dhe kreditit, janë iniciativa të tjera të cilat ecin paralelisht me njëra-tjetrën.


Gazetari: *A dispononi ju statistikën përkatëse, meqenëse u prek si çështje, mbi përqindjen e shqiptarëve të cilët përdorin ATM-të ose kartën e debitit dhe kreditit?*

Guvernatori: ATM-në e përdorin një numër shumë i lartë shqiptarësh, por kartat e kreditit ...

Gazetari: A është edukata jonë në nivel mesatar, në nivel të ulët apo po shkojmë drejt...

Guvernatori: Edukata jonë është rritur ndjeshëm në këtë drejtim. Progresi i realizuar me kartat e kreditit, debitit dhe me pagesat elektronike që lidhen me përdorimin e *internet banking* është mjaft i ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Këtu vlen të përmendet se vetëm 10 apo 15 vite më parë, niveli i përdorimit të ATM-ve ishte tejet i ulët për të mos thënë inekzistent.

Grafik 53. Zhvillimet e ATM dhe POS (majtas); si dhe zhvillimet e kartave të debitit, kreditit dhe kartave të parapaguara (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gazetari: Por jemi ndërkohë në vitin 2020, kështu që...

Guvernatori: Ne ende mund të themi se klasifikohemi në vendet e prapambetura në këtë drejtim...

Gazetari: Ne jemi në vendet e prapambetura....

Guvernatori: Aktualisht, ne si bankë qendrore kemi një strategji kombëtare. Paralelisht, vlen të përmendim këtu edhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, i cili ka ndërmarrë një sërë

iniciativash mjaft të vlefshme në këtë fushë që do të mund t'i trajtonim në një emision të posaçëm pasi janë me një rëndësi të veçantë.

Gazetari: *Është fakt, fjala vjen, që ka ende kompani të mëdha apo nuk e di subjekte të ndryshme, të cilat përdorin dy bilance.*

Guvernatori: Standardi i dy bilanceve i shërben evazionit fiskal dhe kjo çështje është adresuar.

Gazetari: *A kanë lidhje?*

Guvernatori: Paraja dhe evazoni fiskal janë padyshim të lidhura me njëra-tjetrën. Paraja kartëmonedhë shërben si instrument pagese, për të lehtësuar pagesat dhe administrimin e parasë nga bankat e nivelit të dytë dhe nga banka qendrore. Masat kundër informalitetit janë një set tjetër masash, të cilat janë pjesë përbërëse e reformave strukturore që duhet të ndërmerren nga qeveria shqiptare, nga Banka e Shqipërisë dhe nga të gjithë aktorët e tjerë ligjzbatues në Republikën e Shqipërisë.

“Paraja kartëmonedhë shërben si instrument pagese, për të lehtësuar pagesat dhe administrimin e parasë nga bankat e nivelit të dytë dhe nga banka qendrore.”

Gazetari: *Kam dy pyetje. Së pari, ju u shprehët pak më parë që paraja e pisët qarkullon kryesisht në euro ose në paund. Aktualisht dhe qarkullimi legal në tregti dhe eksportet kryhen në monedhën euro. Në këtë kontekst, sa larg euros jemi ne sot që flasim dhe a po përgatitemi ne që të adoptojmë euron apo jemi ende larg zyrtarizimit të saj si kartëmonedhë? A duhet të investohemi ne te euro dhe jo tek leku?*

Guvernatori: Përsëri janë dy çështje të ndara, po njëkohësisht edhe të lidhura me njëra-tjetrën. Shqipëria është në një fazë të caktuar të zhvillimit ekonomik dhe pikërisht për të shkuar drejt Eurozonës, ne do të duhet të vazhdojmë me procesin e deeuroizimit dhe paralelisht me forcimin e përdorimit të monedhës kombëtare.

Gazetari: *Pse?*

Guvernatori: Për shkak se përdorimi i monedhës kombëtare i jep bankës qendrore mundësi që të transmetojë më mirë politikën monetare, dhe transmetimi i politikës monetare nxit më mirë konsumin, investimet dhe kreditimin. Të gjitha çka përmenda më sipër përkthehen direkt në rritje

ekonomike dhe rritje të mirëqenies së qytetarëve shqiptarë. Paralelisht, kjo vlen për të ruajtur stabilitetin financiar, si dhe shëndetin financiar të bankave dhe depozitat e shqiptarëve. Pra, nëse kreditë do të vazhdojnë të jepen në euro dhe të ardhurat tuaja janë në lekë, atëherë në rastin e një zhvlerësimi të mundshëm të lekut, ju do të gjendeni në vështirësi të mëdha paguese. Ne kemi qenë dëshmitarë të krizave të ndryshme si pasojë e këtij faktori.

Gazetari: Po flisni për inflacionin?

Guvernatori: Po flas për inflacionin. Nëse do të kishim inflacion, njerëzit, qytetarët dhe bizneset do të dështonin për të paguar kreditë dhe kjo do të krijonte jo vetëm humbje financiare...

Gazetari: ...por edhe kaos?

Guvernatori: Do të krijonte një kaos, të cilin e kemi përjetuar edhe më parë. Për këto arsye, politikat e ndjekura në përputhje edhe me rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar kanë në themel pikërisht stimulimin e monedhës kombëtare. Në momentin që edhe Shqipëria do të arrijë në një nivel të caktuar ekonomik, atëherë politikat tona do të ndryshojnë në drejtim të adoptimit dhe përdorimit të Euros.

Gazetari: Qëndrojmë te kjo çështje tani. A kemi përpara nesh një objektiv final? Domethënë, viti 2030 mund të na gjejë në euro, apo ndoshta 2040-ta? Pra, a mund të kemi në një objektiv afatgjatë apo afatmesëm në këtë drejtim?

Guvernatori: Kjo do të varet kryesisht nga serioziteti ynë në drejtim të zbatimit të reformave ekonomike.

Gazetari: A aspirojmë ne që të shkojmë drejt adoptimit të Euros apo do të qëndrojmë konsekuent në mbajtjen e monedhës tonë kombëtare?

Guvernatori: Në këtë drejtim janë kryer disa analiza dhe vrojtime empirike në nivele të ndryshme. Mbi 90% e qytetarëve shqiptarë aspirojnë të shkojnë drejt adoptimit të Euros. Mënyra jonë e jetesës është drejt euros. Patjetër që ne dëshirojmë të shkojmë drejt euros, drejt Bashkimit Evropian. Euro është kartëmonedha, kur flasim për kartëmonedhën...

Gazetari: *Dakord, dakord, po flisja konkretisht, jo si një qasje politike, por si një qasje financiare.*

Guvernatori: Po ne sigurisht nuk kemi rrugë tjetër. Modeli ynë i jetesës, aderimi, ankora janë si Shqipëri është drejt euros. Të gjitha përpjekjet tona janë të projektuara drejt Bashkimit Evropian. Ne e kemi konfirmuar tashmë drejtimin tonë drejt perëndimit. Ekonomia jonë është ekonomi tregu e lirë dhe e hapur. Standardet tona janë në përputhje të plotë me kursin për adoptimin e euros. Për më tepër, vetë standardet e kartëmonedhave të reja dhe ndryshimet që kanë pësuar ato tregojnë synimin tonë për t'u përafuar drejt euros. Pavarësisht sa përmenda më sipër, ne duhet të jemi seriozë në kryerjen e reformave strukturore me qëllim që Shqipëria të vijojë në rrugën e zgjedhur drejt Bashkimit Evropian. Sigurisht që e gjithë kjo kërkon kohën e saj. Sa më seriozë të jemi ne në ndërmarrjen e reformave strukturore, aq më shumë do të përshpejtohet koha.

“Modeli ynë i jetesës, aderimi, ankora janë si Shqipëri është drejt euros. Të gjitha përpjekjet tona janë të projektuara drejt Bashkimit Evropian. Ne e kemi konfirmuar tashmë drejtimin tonë drejt perëndimit.”

Në drejtim të konvergimit tonë drejt euros ka disa skenarë, si ai pesimist ashtu edhe ata realistë dhe optimistë. Skenari optimist, i cili mbështetet në një sërë analizash empirike, na tregon se brenda një periudhe kohore të konsiderueshme, ne mund të kemi përmbushur standardet e kërkuara. Pra, brenda një afati kohor prej 20 vjetësh ne do të mund të adoptonim monedhën euro. Kjo mund të ndodhë edhe më shpejt nëse mbështetemi plotësisht te skenarët pesimistë.

Gazetari: *Tani unë po ndërmarr një kurs komplet tjetër, kjo për shkak se njerëzit në tregjet e hapura, po flasin gjithnjë e më tepër për monedhën virtuale. Pra, kemi parane kombëtare, lekun, euro dhe monedhën virtuale ose Bitcoin siç njihet ndryshe. Aktualisht, ndoshta është momenti që ne të mendojmë për kapërcimin nga Leku menjëherë te Bitcoin, pra pa adoptimin e Euros? Pyetja duket paksa naive, por besoj se ia vlen të diskutohet mbi këtë çështje.*

Guvernatori: Jo, patjetër që ia vlen ta diskutojmë dhe trajtojmë si çështje. Monedhat virtuale, Bitcoin, kriptomonedhat, janë jashtë kontrollit të bankave qendrore, janë disa monedha të cilat...

Gazetari: A është e ardhmja, Bitcoin dhe monedha virtuale? Dëshiroj t'ju drejtohem juve së pari si profesionist në këtë drejtim.

Guvernatori: Sigurisht që është e ardhmja, por jo në këtë formë siç e nënkuptoni ju. Bankat qendrore, Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Banka Qendrore e Anglisë dhe Banka Qendrore Evropiane, po bëjnë analiza të thella mbi impaktin e mundshëm të monedhës digjitale. Në këtë kontekst, me zhvillimet e reja teknologjike synohet që të jetë banka qendrore ajo e cila do të emetojë monedhën digjitale paralelisht me kartëmonedhën letër apo me format e tjera të saj. Ndërkohë, meqenëse, aktualisht kriptomonedha nuk është nën kontrollin e bankës qendrore, ajo mbart risk të lartë për investitorët e mundshëm. Njëkohësisht, ka edhe luhatje të ndryshme të saj, të cilat vijjnë si rrjedhojë e luhatjeve të tregut dhe që mbeten ende të pakontrolluara.

Gazetari: Pyetja konkrete është kjo: Bankat qendrore dhe ata që bëjnë politikat financiare globale, synojnë ta motivojnë kriptomonedhën apo ta demotivojnë atë?

Guvernatori: Tregjet financiare kanë në dispozicion të tyre instrumente nga më të larmishmet. Bankat qendrore dhe rregullatorët e tjerë mbajnë përgjegjësi ligjore lidhur me gjithë instrumentet e pagesave dhe elementet e tjera në tregjet financiare, prandaj sensibilizimi dhe informimi i publikut mbetet një domosdoshmëri. Parë nga ky këndvështrim, këto instrumente pagesash dhe reforma financiare duhet të administrohen, mbikëqyren dhe lançohen nga institucionet financiare për të garantuar publikun e gjerë në lidhje me to. Çdo element tjetër në tregun financiar, çdo mjet pagese ose formë investimi, e cila nuk është e monitoruar apo mbikëqyruar nga institucionet financiare, mbart rreziqe të mjaftueshme për investitorët dhe bankat qendrore.

Gazetari: Qartë, deri tani nuk ka një promovim të tyre dhe veçanërisht nga bankat qendrore. Për ta mbyllur edhe një pyetje të fundit që lidhet me diskutimin tonë për 10 mijë Lekëshin e ri, pra 100 mijë Lekëshin e vjetër. Kjo prerje e lartë e kartëmonedhës, a mbart një risk të shtuar për të pasur një inflacion në rritje? Zakonisht kur priten para të reja, nënkuptohet ideja e inflacionit.

Guvernatori: Prerja e kartëmonedhës ndjek nivelin e inflacionit dhe nuk është prerja e kartëmonedhës ajo që stimulon inflacionin. Kur ka inflacion të lartë, priten kartëmonedha me vlerë të lartë.

Gazetari: *Prandaj jua bëra pyetjen, sepse nënkupton gjithmonë këtë.*

Guvernatori: Ne nuk jemi përpara një situatë inflacioniste. Shpeshherë ndodh që situatat e vështira të pasuara nga kriza të forta ekonomike të detyrojnë shtete të caktuara të presin kartëmonedha me disa zero shtesë si pasojë e inflacionit. Në rastin tonë, prerjen e re nuk e kemi prodhuar si pasojë e inflacionit. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e një studimi disavjeçar dhe mbi të gjitha si një nevojë për mirëfunksionimin e sistemit të pagesave.

“Në rastin tonë, prerja e re 10000 Lekë nuk është prodhuar si pasojë e inflacionit. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e një studimi disavjeçar dhe mbi të gjitha si një nevojë për mirëfunksionimin e sistemit të pagesave.”


Gazetari: *Pra lidhet me borxhin që është mbi 80%. Borxhin publik?*

Guvernatori: Jo. Mund të them se nuk ka asnjë lidhje me borxhin publik. Sikurse e trajtuam më sipër, kemi të bëjmë thjesht me një instrument pagese. Pra, është një para e hedhur në qarkullim për të ndihmuar qarkullimin e parasë si mjet financiar. Nuk jemi këtu përpara një situatë inflacioniste. Madje ne synojmë që inflacioni të pësojë një rritje të lehtë për shkak se aktualisht ndodhet në një nivel disi më të ulët se objektivi i Bankës së Shqipërisë.

Gazetari: *Na shkoftë mbarë 10 mijë Lekëshi i ri! Faleminderit zoti Gent Sejko. Ishte Guvernatori i Bankës së Shqipërisë. Ky do të jetë 10 mijë Lekëshi i ri që do të hyjë në qarkullim më 30 qershor, njëkohësisht me 1000 Lekëshin e ri.*

FOTO GALERI / PHOTO GALLERY


Gubernatori Sejko në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të organizuar nga "Euromoney", 14 janar 2021 /
Governor Sejko attends the Central and Eastern European Forum organised by Euromoney, 14 January 2021



Gubernatori Sejko në Ceremoninë e Përfundimit të Projektit të Binjakëzimit "Forcimi i kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë në kuadër të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, 18 janar 2021 /
Governor Sejko attends the Virtual closing ceremony of the twinning project "Enhancing Bank of Albania's alignment with EU acquis", 18 January 2021



Guvernatori Sejko në Ceremoninë e Përfundimit të Projektit të Binjakëzimit "Forcimi i kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë në kuadër të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, 18 janar 2021 /
Governor Sejko attends the Virtual closing ceremony of the twinning project "Enhancing Bank of Albania's alignment with EU acquis", 18 January 2021



Guvernatori Sejko me Ambasadorin e ri të OSBE-së në Shqipëri, SH.T.Z. Vincenzo Del Monaco, 22 janar 2021 /
Governor Sejko receives H.E. Mr. Vincenzo Del Monaco, new Ambassador of the OSCE Presence in Albania, 22 January 2021



Gubernur Sejko në Konferencën Shkencore "Pandemia dhe rimëkëmbja – strategjitë e përbaljes dhe pritshmëritë", 9 shkurt 2021/
Governor Sejko at the Scientific Conference on "Pandemic and recovery – the coping strategies and expectations", 9 February 2021



Gubernur Sejko në një mbledhje online me Misionin e FMN-së për Shqipërinë, 10 mars 2021/
Governor Sejko: Online meeting with the IMF Mission for Albania, 10 March 2021



Gubernur Sejko në ceremoninë e hapjes së Javës së Parasë, 23 mars 2021/
Governor Sejko: Address to the opening ceremony of the Money Week, 23 March 2021



Gubernur Sejko me Ambasadorin e Japonisë SH.T. Z. T akada Mitsuyuki në Tiranë, 26 mars 2021/
Governor Sejko receives the Ambassador of Japan H.E. Mr. Takada Mitsuyuki in Tirana, 26 March 2021



*Governatori Sejko online në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Grupit të Bankës Botërore, 9 prill 2021/
Governor Sejko virtually attends the IMF and WB Spring Meetings, 9 April 2021*

Event info Hide Menu Bar
to & Video Participant Event Help

Connected



Urmimi Show

Participation

*Governatori Sejko me Ambasadorin e parë të Ukrainës rezident në Tiranë, Sh.T.Z. Volodymyr Shkurov, 15 prill 2021/
Governor Sejko meets with H.E. Mr. Volodymyr Shkurov, the first Ambassador of Ukraine resident in Tirana, 15 April 2021*



Governatori Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, 20 prill 2021 / Governor Sejko presents BoA's Annual Report 2021 to the Parliamentary Committee on Economy and Finance, 20 April 2021



Governatori Sejko në konferencën “Normalja e re, sfidat dhe oportunitetet” të Universitetit Evropian të Tiranës, 30 prill 2021 / Governor Sejko attends the Conference on: “New normal: Challenges & Opportunities”, European University of Tirana, 30 April 2021



Gubernuratori Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2020 në Kuvendin e Shqipërisë, 27 maj 2021 /
Governor Sejko: Address to the Assembly of the Republic of Albania presenting the Annual Report of the Bank of Albania for 2020, 27 May 2021



Gubernuratori Sejko me një delegacion të Bankës Botërore, 3 qershor 2021 /
Governor Sejko meets the World Bank delegation, 3 June 2021



Governatori Sejko në takim përmblyllës online me Misionin e FMN-së për Shqipërinë, 14 qershor 2021
Governor Sejko: Virtual meeting with the International Monetary Fund Mission, 14 June 2021



Governatori Sejko në prezantimin e dy kartëmonedhave 1000 Lekë dhe 10000 Lekë të serisë së re të kartëmonedhave, 15 qershor 2021/
Governor Sejko: Address at the Launching of the two banknotes, 1000 lek and 10000 lek, of the New Albanian Banknote Series, 15 June 2021



*Gubernuratori Sejko me profesionistët e rinj, pjesëmarrës të Programit LEAD Albania 2021, 23 qershor 2021/
Governor Sejko meets the young professionals participating in the LEAD Albania Program 2021, 23 June 2021*



*Gubernuratori Sejko në një takim diskutimi me Shoqatën Shqiptare të Bankave, 29 qershor 2021/
Bank of Albania meets and discusses with the Albanian Association of Banks, 29 June 2021*



*Guvernatori Sejko me një delegacion të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 1 korrik 2021/
Governor Sejko meets representatives of the European Bank for Reconstruction and Development, 1 July 2021*



*Guvernatori Sejko në ceremoninë e promovimit të librit: "Përballë krizës, sfidat e teorisë dhe politikave ekonomike", nga autorët Akad. Prof. Dr. Anastas Angjeli dhe Prof. Dr. Adrian Civiçi, 22 korrik 2021 /
Governor Sejko: Address at the promotion of the book on: "Facing crisis: the challenges of economic theory and policies", by Academic Prof. Dr. Anastas Angjeli and Prof. Dr. Adrian Civiçi, 22 July 2021*



Guvernatori Sejko me Zëvendëspresidentin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, z. Jurgen Rigtierink, 8 shtator 2021/
Governor Sejko meets with the EBRD's First Vice President, Mr Jurgen Rigtierink, 8 September 2021



Guvernatori Sejko në tryezën e organizuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, 15 shtator 2021/
Governor Sejko attends the round table on: "Economic development of Albania: Challenges and opportunities", 15 September 2021



Gubernatori Sejko në konferencën e përbashkët për shtyp online me Shefen e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, 12 tetor 2021 / Governor Sejko at the joint press conference with the IMF Mission Chief for Albania and the Albanian Minister of Finance and Economy, 12 October 2021



Gubernatori Sejko në Mbledhjet Vjetore Virtuale të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, 21 tetor 2021 / Governor Sejko attends the virtual Annual Meetings of the International Monetary Fund and the World Bank Group, 21 October 2021



*Guvernatori Sejko me Drejtorin Ekzekutiv për Shqipërinë pranë Bankës Botërore, z. Matteo Bugamelli, 25 tetor 2021/
Governor Sejko meets the Executive Director of the World Bank for Albania, Mr. Matteo Bugamelli, 25 October 2021*



*Guvernatori Sejko gjatë prezantimit të opinionit të Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin 2022, 5 nëntor 2021/
Governor Sejko presents BoA's opinion on the Draft Budget 2022, 5 November 2021*



Guvernatori Sejko me Drejtorin Rajonal të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) për Evropën Qendrore dhe Juglindore, z. Ary Naïm, 16 nëntor 2022 /
Governor Sejko meets the Regional Director of the International Financial Corporation (IFC) for the Central and Southeastern Europe, Mr Ary Naïm, 16
November 2022



Guvernatori Sejko në hapjen e fushatës ndërgjegjësuese “As i vjetër e as i ri, jam thjesht Lek!”, 17 nëntor 2021 /
Governor Sejko at the launching of awareness campaign: “Neither old nor new, I am simply Lek!”, 17 November 2021



Guvernatori Sejko në hapjen e fushatës ndërgjegjëse “As i vjetër e as i ri, jam thjesht Lek!”, 17 nëntor 2021 / Governor Sejko at the launching of awareness campaign: “Neither old nor new, I am simply Lek!”, 17 November 2021



Guvernatori Sejko në çeljen e punimeve të Workshop-it XV të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, 6 dhjetor 2021 / Governor Sejko: Welcome Remarks at the 15th SEE Economic Research Workshop, 6 December 2021



Guvernatori Sejko në takim përmblyllës të vitit, të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, 16 dhjetor 2021 /
Governor Sejko: Address at the year-end event organised by the Albanian Association of Banks, 16 December 2021



Guvernatori Sejko në takim të fundvitit me gazetarë, analistë dhe drejtues të medias dhe ceremoninë e shpalljes së fituesve të Çmimit të Guvernatorit për
Diplomën më të mirë 2021, 20 dhjetor 2021/

Governor Sejko: End-of-year award ceremony with journalists, analysts and media representatives for the Governor's Prize for Best Diploma in 2021, 20
December 2021



*Guvernatori Sejko në konferencën për shtyp mbi vendimmarrjen e politikës monetare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, 22 dhjetor 2021/
Governor Sejko: Statement to the Press Conference on Monetary policy Decision of the Supervisory Council of the Bank of Albania, 22 December 2021*



*Guvernatori në mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, 29 dhjetor 2021/
Governor: Meeting of the Financial Stability Advisory Group, 29 December 2021*

